

BIBLIOTEKA
SHËTETIT

814-31

2 52

**Petraq
Zoto**

**BREDHI
I GJELBËR**

tregime

814-32

ZP2

Petraç
Zoto

ur

ur

ur

**BREDHI
I GJELBËR**

tregime

BIBLIOTEKA E SHTETIT
SHKOLLËS
Nr. 29887

3493

SHTËPIA BOTUESE
«NAIM FRASHËRI»

BREDHI I GJELBËR

Vitet hiqeshin zvarrë. Të përzhitura nga baruti. Robëria e gjatë regëtinte, po prapë s'donte të jepej. Agimi i lirisë ende nuk po ndriste. Dukej e zhdukej, si ai dielli i mëngjesit, kur e pengojnë ca palo re.

Korriku i vitit 1911 shtynte ditët e fundit.

Ishte e shtunë.

Rrezet e diellit kishin arritur në gjysmën e derës së hapur të dyqanit. Brenda nuk pipëtinte njeri. Dita bënte përpara, po njerëzit sikur s'lëviznin pazarit. Në dyqan, njëherë, akoma nuk kishte hyrë asnjë.

Xha Vani Kosturi, shtruar shesh mbi njëfarë podiumi, vërtiste tespihet në dorë.

Me fesin e gjerë, ngjeshur në kokë fare drejt, me kravatën e çlirët, me mustaqet e rralluara e të pakrehura, binte në sy që ishte nga ata që nuk i kushtojnë shumë kujdes vetes. Kur e kur i lëshonte tespihet në gjunjë, mandej merrte e fërkonte shkopin e lëmuar. Ky që një shkop i shkurtër, i rëndë, në formën e një koni të gjatë. me një kokë të rrumbullakët prej argjendi. Në ngjyrën

e zezë të shkopit bardhësia e argjendit spikaste fort. Plakut ia tërhiqnin gjithnjë shikimin tri shkronja gdhendur në të: SJK. Spiro Jovan Kosturi. E kishte dhuratë nga i biri. Xha Vani e mbante gjithnjë me vete. Tanimë, kur kapërcente të tetëdhjetat, shkopi i duhej shumë. Mbështetej në të dhe ulej, mbështetej në të dhe ngrihej. Shkopi ishte i fortë dhe mund të mbështetej pa frikë.

SJK. Spiroja asnjëherë nuk e kishte ndarë emrin e vet nga ai i xha Vanit. As xha Vani s'e linte mënjanë emrin e t'et. Vani Cico Kosturi. Ky mbiemëri Kosturi sesi i kishte mbetur familjes së tij. Se ata vetë rridhnin nga Vakëfet. Dikur baba Kristoja shkonte dendur në Kostur. Njerëzit pyetnin: «Kur do vejë Cicoja në Kostur?» «Erdhi Cicoja nga Kosturi?» Por xha Vanit shpeshherë i flitnin dhe me një mbiemër tjetër: Shqiptari. Kur ndonjë i thoshte xha Jovan Shqiptari, ai drejtonte trupin e buzëgaz ia kthente:

«Më rrofsh, bir! Shqiptar qofsh dhe ti, jetë e mot!»

I bëhej qejfi plakut dhe kishte për se.

Vatër të shqiptarizmes e kishte bërë shtëpinë prej shumë kohe. Gjithë njerëzit e tij, e shoqja, djemtë, nipërit, vajzat e nusët me shqiptarizmën. Pa të çarë, pa një lëkundje.

«Ja arrita t'i kem tërë të mitë pas mendjes në qëllimin e shenjtë, pa le të vdes, — i thoshte së shoqes, Elenit, së cilës ia dëgjonte fjalën. — Nuk po shoh akoma gjëkafshë, thua ti? Shoh shumë. E shoh lirinë dhe mëkëmbjen e kombit tënë. Është një dritë e bardhë, e bardhë. E kam ndier kaq herë, kaq vite. Ajo po vjen, paçka se ka ca pengime e prapësi. Kush e sheh, s'ka mynxyrë që të mos mundë ta kapërcejë.»

Kundërshtarët s'lanë gjë pa bërë kundër tij. Burgun provuan, për të e për të bijtë. Shkishërimin dhe thirrjet e ca çapaçulëve: «Katirameno, Katirameno!» Kërcënimin kundër njerëzve që do të kishin të bënin me të, që ta veçonin. Që ta rrënonin. Vdiq mbesa e tij, dhespoti nuk lejoi të varrosej sipas rregullave fetare. Më parë lipsej që xha Vani të vinte në mitropoli e t'i binte ndër gjunjë dhespotit. Të ndahej nga shqiptarizma? Ç'që

ajo fjalë! I erdhi martesë e të birit, Kristaqit. Dhespoti nuk lejoi t'i vihej kurorë në kishë. Më parë le të për-ulej xha Vani. Të hiqte dorë nga «paudhësitë». Me gjithë mend e kishte dhespoti?! Po cilat quante paudhësi ai?!

Ia vranë të birin. Spiron, atë që rëndom thoshte: «Lënë tërë gjuhët e s'lënë shqipen, që edhe gurë e drurë e ligjërojnë!» Nuk qe mjaft kjo, e hoqën burgjeve xha Vanin me të dy djemtë e tjerë.

E megjithatë, gjithnjë kokën lart Vani Kosturi!

I matur, i heshtur, i duruar. «Kur ka të përpjekur me një gjë, njeriu e nieh më mirë.» Jetën e njihte. Luftën e njihte. I urtë, natyrë e butë, po atë që thoshte e bënte, e kishte të menduar mirë e mirë dhe s'e lëvizte më.

Cuditeshin disa me të: si mbahej? Cuditej ai me ta: pse, xhanëm, habiteshin? A rrëzohet lisi se i oqen ca kulpra e ferra e mundohen t'ia shpoinë trupin e t'ia thithin lëngun e jetës? Lisi ishte shqiptarizma. Ai vetë i shkrirë në të. Si shumë të tierë. Si vëllezërit Frashëri, me të cilët kishte pasur letërkëmbim. Si Isa Boletini e Bairam Curri, si Themistokliu e Mihali...

Kundërshtarët bënin të tyren, ata të vetën. «Trinia», sic e quanin treshen xha Vanit. Orhan Poiani e Thimi Marko, hapën shkollën e parë shqipe. Fara u hodh, mbiu, u rrit e po përhapej. Librat shqip vinin që nga Bukureshti në adresë të tij. Ai i shpërndante dhurësisht. Erdhi Bajo Topulli me të vëllanë, Cercizin. U krijua komiteti i fshehtë. Dolën çetat e lirisë e po luftonin. Dhespot Foti, më i ligu armik i shqiptarizmes, e gjeti vendin. Cetat shumoheshin e luftonin. Xha Vanit i gufonte zemra.

Mirëpo ja...

— Deshe gjë, usta? — pyeti si i trembur djali që diç rregullonte në një qoshe të dyqanit.

Xha Vani u përmend. Padashur kishte goditur fort dyshtemenë me shkop.

— Jo, bir, jo.

E vuri shkopin mbi gjunjë dhe mori trespitet.

Dielli e kishte kapërcyer derën. Një fashë e gjerë rrezesh binin ngultas në patoz, afër podiumit, ku qe ulur ai. Xha Vani nxori sahatin nga xhepi i xhamadanit. Mëngjesi po ecte me vrap. Lëvizti buzët, përplasi gjuhën pas qiellze. Dhe sytë nga dera.

Dikë priste. Por bënte çmos të përmbahej. Lajmi i mirë, mendoi, vjen vetë, të gjen e të gëzon. Të ligun pse ta ndjellësh?

Donte, kështu, ta merrte me të mirë durimin.

Po ja, u duk një hije para dyqanit. Pastaj një trup zuri derën. Veshur si fshatar, një djalë me vështrimin gozhdë.

«Komit nga të Ballkamenit ky», mendoi xha Vani, ndërsa zemra ia bëri tënk.

Nuk priste të tillë lajmës.

«Fshatari» bëri drejt tij, duke parë herë plakun e herë çirakun.

— Ec na porosit dy kafe te Thanas Noprani, — i tha djalit.

Vetëm atëherë komiti e ngjatjetoi plakun e i zgjati një pusullë.

— Kapedani ma dha për ty. Këndoje, unë po vëzhgoj.

Xha Vani i nderi dorën dhe i zgjati kutinë e duhanit komitit, vetë vuri një palë gjyzlykë të hollë me mbajtëse metalike, njëra anë me tel të zakonshëm, vënë dosido.

I nderti xha Vani!

Na ngjau një prapësi që e prishi fare ujdinë tonë. Qëmenatë, pa vajtur edhe koha e sulmit, u hodhën përmbi ne taborë të tërë me turq. Na zunë ligisht, të papërgatitur. Dhe ashtu na u vranë Tushi Krastafillaku, Kristaq Furrxhiu e Nuçi Lapi. Zemra ma di si po ta shënoj këtë lajm të kobshëm. E marr me mend ç'hidhërim të madh po të sjell. Me zor çamë rrethimin. Edhe ne vramë syresh, po ç'e do!

Vij e të marr dorën e të lutem të shkosh në shtëpitë e martirëve e t'ua kumtosh mandatën e hidhur.

Kjo gjëmë na ka rënduar së tepërmi. Ra mbi ne si një rrufe, nuk dimë nga e si na erdhi kaq papritur.

Tek Ura e Kadiut zumë pesë askerë e një xhandar. Na kishin ngritur pusi, po ranë vetë brenda. Dridheshin nga frika, sidoqë u thamë që s'kemi gjë me askerët ne, se luftojmë hyqymetin që nuk na jep të drejtat tona e jo ca askerë të gJORë. Ua morëm dyfektet e i përcollëm tutje.

Tashti bëj zahmet e na thuaj ç'di për këtë të pabërë e, në di, na mëso ç'të bëjmë e ku të vemë.

Po, nuk e kishin gabuar parandjenjat. Tjetërlløj lajmi priste xha Vani. Ngriti kokën. Përmbajtja e letrës i lexohej qartë në sytë e thellë të rrëmbushur, edhe në duart me damarë mavi, ku letra dridhej si gjethet nga rrebeshi i shiut.

Fytyra e plakut u zbeh. Ai u gëlltit me zor. Tespihet i shkanë në qilim e atje mbetën.

— Me gojë a të tha tjetër gjë?

— Haber pret prej teje e t'ia përmbushësh rixhanë. Hyri çiraku me dy filxhanë në zīg.

— Merre, — tha xha Vani.

Edhe vetë mori filxhanin e tij. Ngriti sytë, po nuk foli. Tjetri ndenji me filxhan në dorë, pa ditur si të bënte. Plaku vështroi çirakun pa e pasur mendjen. Ky u përkul me dorën në zemër e u tërhoq gjer te dera.

Xha Vani rrufiti kafën. Të rrufiturit u dëgjua shumë, se heshtja që si e përzishme. Xha Vani mendoi se po pinte kafën e djemve. Kafën e djemve? Oh, djemtë e ngratë! Ranë në lulen e moshës, në të hapur të ditës.

Mendja i shkoi vetiu tek i nipi, Kostaqi, komiti më i ri. Kostaqi bënte pjesë në çetën e Qamil Panaritit. Ç'bëhej me Qamilin? Spiro Ballkameni nuk dinte gjë. Po ta dinte, do ta kishte shënuar në letër. Të dyja çetat një plan të vetëm kishin. Në të gdhirë do të sulmonin Korçën dhe do të lironin të burgosurit politikë, ndër ta dhe Themistokli Gërmenjin e Mihal Gramenon, të cilët i nevojiteshin së tepërmi luftës për liri, veçanërisht në ato ditë.

«Kjo e pabërë, në është rastësi, tjetër gjë. Ama po të jetë tradhti, i kanë llogaritur edhe Qamilin me shokë. Kush të ketë dalë bese?»

Ai zuri të shkonte nëpër mend njerëzit që e dinin të fshehtë.

Komiti ktheu kokën dhe çiraku iu afrua me të shpejtë t'i merrte filxhanin e zbratur. Xha Vani u kujtua për kafën dhe e piu me ngut, me dy gllënjka. Pastaj, gjithnjë mbështetur në shkopin e vet, u ngrit me nxitim.

— Falmeshëndet kapëdanit, djalë! Të presë te limeret e Malit të Thatë, i thuaj.

Komiti e përshëndeti me respekt dhe iku me të shpejtë.

Pas tij doli edhe xha Vani. Nuk e mbante vendi. Trokiste shkopin në rrugën gjithë pluhur dhe mendonte për hallin e madh. Lipsej të piquej me Orhanin a me ndonjë tjetër nga të komitetit. Pastaj t'u dërgonte lajm Themistokliut e Mihalit në burg. Më tej... ç'udhë do t'i jepnin së papriturës së prapë? Veç të mos humbisnin kohë! Të mblidheshin një sahat e më parë. Pa lipsej të shkonte në shtëpitë e martirëve të rinj. Eh, ç'barrë e rëndë!...

Dhe prapë iu kujtua i nipi.

«Hë, gjysh, të la zemra?»

Xha Vani puliti sytë. Një copë xham i thyer i kthente rrezet e nxehta të diellit përvëlues.

Me të kapërcyer pragun e portës së shtëpisë, e shoqja, që po zbriste shkallët e gurta të oborrit, i foli me shqetësim:

— Jovan, tashti sa do të dërgoja njeri të të thërriste. Të kërkojnë në hyqymet.

— Në hyqymet?!

— Se ç'ka ngjarë, nuk e di. Po gjurulldi e madhe, më thanë.

— Na kanë vrarë tre djem.

— Tre djem, thashë!

— E zeza unë, Kostaqi!

— Tre djem, thashë!

Bëri përjashta pa hyrë fare në shtëpi.

Në hyqymet e kërkonin sa herë ndodhte ndonjë gjë që kishte të bënte me punë patriotizmi. Ai e dinte, ishte mësuar me këtë praktikë të qeveritarëve turq.

«O, të shkretën, nuk arrita të bëj gjëkafshë!»

— Eleni, moj! Çalltis e u bëj zë Orhanit a Thimit, ose ndonjë tjatri nga tanët. Dërgo njeri t'u thonë ç'po ngjet.

— Shiko, pyet për Kostaqin, — e porositi ajo.

Prapë Kostaqi! Një herë e kujtoi ai, fare papritur, të dytën e shoqja.

«Për të mirë të kujtofshim, bir! Kostaq, o trim! Ua shkove gjyshit e babait ti, ua shkove xhaxhallarëve e kushërinjve! Rrëmbeve dyfekun e u bashkove me çetat e lirisë. Kjo i kapërcen tërë bëmat tona të derisotme. Se ç'e bëre mirë! Se ç'e bëre bukur! Të kisha vërsën tënde, si ti do të bëja, jo tjetërsoj!»

Ashtu duke i folur të nipit, ecte e trokiste shkopin në rrugë dhe, i përmalluar, ia mori pa zë:

*Se mjaft në robëri,
e mjera Shqipëri!
O djem, rrëmbeni pushkët,
ja vdekje, ja liri!*

U përmend kur shkopi filloi të trokiste në drurët e urës. Aty u ndal të shihte njëherë matanë. Përtej urës ishte ndërtesa e hyqymetit. Atje dalloheshin një grumbull njerëzish që venin e vinin pareshtur.

Xha Vani e mori shkopin në dorë e shpejtoi hapat. Sapo e vunë re, njerëzit zunë të hapeshin e t'i lironin udhën. Sesi mënjanoheshin vetiu, sesi e vështronin me përgjërim, sikur s'kishin guxim t'i flitnin.

Zemra i rrahu sërish. Më fort akoma. E nderonin në Korçë, ai e dinte. Po kësisoj... Ky lloj nderimi se ç'kishte një ngjyrim dhimbjeje të thellë, një lloj nderimi krejt të veçantë.

Ai nisi t'i bënte hapat më të kujdesshëm, të mbështetej më mirë në tokë. Ecte dhe shikonte drejt. Kur

udha u hap krejt, ai prapë qëndroi e shtrëngoi shkopin në gji.

Përpara tij, plasur përdhe, gjashtë kufoma komitësh. Në mes, mu përballë, Kostaqi. Si i vënë enkas që t'i binte në sy menjëherë. I ri, i pashëm, veshur me kostumin e bandës muzikore, ku bënte pjesë përpara se të dilte komit.

Vani Kosturi ngriu.

«Mendje, mos më lër! Mos vrapo, moj zemër! Mbamëni, o këmbë!»

Komitit të vrarë i kishte mbetur syri hapur. Ai sy shikonte ngultas gjyshin. Gjysh Vani u drodh.

U ul në gjunjë e pa dhe ai. Sy ndër sy nip e gjysh. Gjysh e nip. Dhe, meqenëse nipi s'fliste, s'foli as gjyshi. Afroi buzët që i dridheshin në ballin e dëshmorit të ri. I mbështeti mbi të dhe i mbajti gjatë. Fytyra e djalit nuk ishte ngurtësuar ende. Xha Vani e përkëdheli me kujdes, mengadalë, sikur nuk donte ta zgjonte a t'i lëndonte plagët. Dhe ia uli butë-butë kapakun e syrit. Në flokët e zinj e të ndritshëm të të nipit kishte rënë ca pluhur. Plaku ia shkundi.

Ashtu, duke rregulluar trupin e nipit, dora i ndeshi në gjak. Gjak i piksur në gushë.

«Bir, o Kostaq, bir!»

Lot s'lëshonte. Zë s'lëshonte. Po me vete fliste.

Nipi shtrirë përpara e gjyshi gjallë më këmbë. Në ka gjë më të dhimbshme për njeriun, nuk besoj. Nëse më hiqet nga shpirti kjo rëndësirë që më pllakosi kështu, do të jem gur e jo njeri. Bir, mos ma vër re! Kush shkon në luftë, e di që edhe mund të vritet. Po kaq i ri, kaq shpejt, kur prisnim të na gëzoje e të gëzoheshë...»

Njerëzit përreth nuk pipëtinin. Respekti për të rënë? Hija e rëndë e vdekjes? Edhe njëra, edhe tjetra, Por jo më pak figura plot dhimbje e patriotit të stërmunduar. Përpara asaj pamjeje askush nuk dinte si të ndërhynte e ç'të thoshte. Po për të ndier, ndienin shumë, gjithë të pranishmit. Kjo e bënte edhe më prekëse atë gjendje.

Edhe se 'pllakosur nga dëshpërimi, xha Vani i pikaste shikimet dhe heshtjen e nderë. Njerëzit e shikonin atë, merrnin pjesë në dhimbjen e tij. Këto ishin ndjenjat e një ngushëllimi të gjerë e të thellë. Atje pranë një tjetër djalë i ri, Odhise Pjasto. Një djalë vështrimçiltër me xhakëtë ushtarake, shok i Kostaqit. Në bandë tok. Në çetë tok. Në vdekje tok.

«Edhe babai yt, o trim, për mëmëdhenë e dha jetën. Si babai i Kostaqit. Shokë ishit, shokë jeni, shokë do të mbeteni. Përgjithmonë!»

Xha Vani Kosturi ia fshiu gjakun nga faqet. Vajti tek i treti.

Tushi ky? I tëri! Edhe bababi i Tushit...

«Ç'bëhet kështu, ç'bëhet!»

Të tre djelmosha, ende pa mbushur të njëzetat. Në anën e djathtë të të nipit, Nuçi e Kristaqi. Të rinj dhe ata. Të pestë, djem të bandës muzikore.

Plakut i erdhën në kokë tingujt e marsheve dhe të këngëve patriotike që lozte banda. Prandaj qe krijuar. Prandaj luftonte me këngë, me pushkë. Si ta sillte rasti. Me muzikën kishin ngritur peshë zemrat e njerëzve që u dhembsej atdheu e liria. Me gjakun e tyre ua ngrinin kokat lart me krenari.

Dikujt i rregullonte flokët, dikujt i fshinte gjakun a pluhurin. Fliste me secilin, se të gjithë i njihte mirë. Kishte qenë i pranishëm kur ata patën bërë betimin e çetave të lirisë. Ishte edhe ai një ndër ata që u patën dhënë uratën për liri.

Në krye të të pestëve një burrë në moshë të pjekur. Fytyrërreptë, kockëtrashë.

«Nuk më njeh, xha Jovan Shqiptari?»

«Të njoh, Bajazit Rehova, të njoh! Kush është ai që s'të njeh? Ti u bën nder djemve. Kur janë vlarë bashkë me ty, e marr me mend si kanë luftuar.»

Nja dy vetë nga turma u ishin afruar të vlarëve e po përkujdeseshin për ta. Plaku i vështroi me mirënjohje e ndjeu diçka të ngrohtë t'i derdhej në shpirt.

— Ashtu, më rrofshi, ashtu! I vdekuri ka nevojë për

dorën e dashur të të gjallit. Është njeri. Po halldupi, halldup! I vrau djemtë e i plasi këtu.

— Edhe djemtë vranë halldupë, xha Vani. Nuk ua lanë pa paguar.

— Si the, more bir, si the?

— Vranë, thashë. Një major e tridhjetë askerë.

Plaku ndenji sikur të bënte llogari me mend.

— Na lër ne tashti. Ngrihu! Ti je njeri i nderuar.

Po, more, e dinte. Plaku diçka donte të thoshte. Po prapë iu zu zëri në grykë. Të përmbajturit me zor e shqetësonte më shumë.

Njerëzit përreth filluan të lëviznin të tronditur. Heshtja e përzishme u shprish.

— Ç'thua zotrote, Jovan Kosturi?

Përtej Xha Vani pa një palë rroba gjithë nishane e grada. Një burrec kapardisur në to. Me siguri burreci do të fillonte të llototiste, se prandaj i qe afruar. Prandaj e kishin thirrur aty xha Vanin.

«Ç'e do, na shpëtove dhe kësaj radhe! Bëre si bëre e gjene gjete një këpucëgrisur. Po ditët të numëruara i ke, spurdhjak!»

— Cili është yti?

«Ç'të ha meraku ty, more qen? Të tjerët s'kanë mënuar t'i vrasin drejtpërdrejt, mua më vijnë anës e anës. Ma sjellin vdekjen rrotull e më trembin me të, që të më vdesin zellin e kurajën. Ma plagosin zemrën, sa më keq s'ka ku të vejë, që unë të mos dajandis. Jo, budallenj s'u thua dot. E dinë që tërë të mitë janë si unë. Duan t'i thyejnë të gjithë, duke më rrëzuar mua.»

Pashai e shikonte dhe qeshte.

«Gëzohesh, ë? Mirë, zgërduhu! I solle këtu djemtë që t'i kallësh tmerr miletit të pafajçëm, po tjetër gjë po ngjet. Lipset të jesh noksan nga mendtë e të mos e pikasësh. Tmerr e frikë jo! Dhembje po! Shumë. Nderim, po, akoma më shumë. Dhe urrejtje, për ty e të tutë!»

— Cili është yti, thashë?

«Akoma ky? Paska qenë fare tuaf!»

Xha Vani çoi kokën. I pa njerëzit që prisnin në heshtje, zemërlënduar.

«Ju keni hallin tim? Të drejtë keni. Njeriu, thotë i moçmi, gjithnjë ka kohë si për t'u nderuar, ashtu dhe për t'u turpëruar. Megjithatë, udhë e gjatë ajo që kam bërë. Dhe e kam bërë me mendjen katërqind dërhëm. A kthehem dot prapa? T'i them vetes që u munduash kot së koti? Pasha, nuk epohem dot, s'jam filiz, po shkop thane me gunga! Bir, nuk jepem, jo, mos ki dert! O njerëz të mirë, shpresat po bëhen besime dhe liria është pranë, po troket. O liri e shtrenjtë, sa shumë kërkoke! Shumë kërkon e ne shumë po të japim!»

Iu kthye pashait që po dërdëlliste atje përtej. E ndanin ata të gjashtë prej tij. E pa në sy Rexhep Pallën, pashanë turk, çibanin e Shqipërisë, e i tha qetë-qetë, fare shkoqur:

— Ti do të dish cili është imi? Ama pyetje gjete të bësh! Të mitë janë të gjithë, ore!

Plaku u mbështet në shkopin e fortë e u nguros përballë pashait.

— Jona, mor, jona! — tha me gjithë shpirt plaku dhe në këto fjalë njerëzit përreth ndien besimin e madh e të patundur të xha Vanit.

U err fytyra e Rexhep Pallës. U përshkënditën sytë e tij të vegjël. Egërsi të reja filloi të sajonte truri i tij i ndezur.

Xha Vani Kosturi i pikasi të gjitha. E njihte pashanë ai. I njihte armiqtë. S'dinë të ndalur ata.

Po ballas i priti mynxyrat e reja, gjithnjë më këmbë dhe, siç do të thoshte për të miku i tij Mihal Grameno, «mbeti i papërkulur, bredh i gjelbër deri në fund».

VALLJA E NGRITJES

1.

Bimbashi rrinte qiri më këmbë.

— E nise korrierin?

— Që me sabah, pashai im. Tashti do të jetë degdisur në Janinë.

Padashur bimbashi lëvizi kokën nga dritarja sikur të donte të ndiqte udhën e korrierit dhe pashai ia pa atë blanën e gjerë. Një prerje shkarazi me hanxhar i kishte marrë gjysmën e veshit e një pjesë të faqes, që ngjante si e rrjepur. Plaga i qe përtharë, po lëkura e kuqe e pa qime ndriste, sikur mbi të të ishte jargavitur ndonjë kërmill.

— Evet, shyqyr që kryengritja nuk arriti të përhapej, — shtoi pashai me sytë te plaga e vartësit, si t'i thoshte atij: «Mirë që shpëtove me kaq!»

«Duket për ibret, jeziti, — tha me vete. — Do ta sikteris, se më tromaksi.»

Megjithatë nuk u ngut. Foli ngadalë:

— Kryengritja u shtyp, po mileti nuk është shtruar. Zjarri i urrejtjes kleit. Në e fjetshim mendjen, ai hazër është. Një xixë do. Mirëpo taborët s'bëjnë më punë. Sa më pak të dalin në sy të miletit, aq më mirë. Këta qafirë janë njerëz me shumë sedër...

Bimbashi dëgjonte i ngrirë në vend. Më kot përipqej të merrte me mend ku do të dilte pashai.

«Ë, bre, nxirre, të shkretën, se më urguse!» ia bënte me vete me mlllef.

— Me ata që ngritën krye, më thanë që ishte dhe një valltar me nam. Di gjë ti?

— Mane Takja ia thonë emrin. Është i rrezikshëm.

— Në ç'gjë është i rrezikshëm?

— Ja, në atë, që ka nam.

Pashai tundi kokën.

— E dua këtu, — tha ngadalë.

Bimbashi nderoi e bëri nga dera.

— Me të butë, mos u sill ligsht. Nuk dua të vijë i egërsuar.

2.

Mane Takja ishte burrë i pashëm. Kishte zotësi ta mbante larg mërzinë dhe, dihet, kush ia arrin kësaj, mbetet përherë i ri. Nuk e kishte parë njeri buzëvarur, sado vuajtje e dhimbje pati provuar. Gjithnjë njësoj, nuk i qëllonte asnjëherë ta lëshonte veten. Fustanellën e ndërronte rrallë, ama kapuçi i rrinte i bardhë, sikur e lante përnatë në borë të freskët. E kishte me shumë kujdes e me kohë kujdesi i ishte shndërruar në zakon. Në këmbë mbathte opinga kau, të puthitura mirë, si të ngjitura pas çorapeve të lesha. Në brez ngjishte një pishqollë të gjatë e pranë saj dy fyej, njëri prej tunxhi

e tjetri bërë nga dru bushi, me ca lajle e lule fort të koklavitura, punë më nge e një njeriu merakli.

Mane Takja ishte këngëtar, fyelltar e sidomos valltar i dëgjuar në tërë krahinën. Një dasmë a një gëzim për të qenë, askush s'e merrte dot me mend pa të. Ai ua jepte hijeshinë.

«Hej, ç'na e hoqi si me magji mërzinë!» thoshin njerëzit, të përfshirë nga hareja që sillte arti i tij.

Ata e dinin që gëzimi i ngacmuar aq përnjëherësh ishte fare i përkohshëm e shpejt do të mbytej në detin e halleve e të brengave. Dhe pikërisht prandaj e donin më shumë. Mane Takja e mundte dëshpërimin e tyre, qoftë dhe për disa çaste. Këto qenë rreze të ngrohta në dimrin e shpirtërave të sflitura e ata i çmonin e i dëshironin. Rrallësia i bënte edhe më të ëndshme. Pa kur hareja harlisej, qejflinjtë zinin e thërritnin:

«Përmbi sofër! Përmbi sofër!»

«Në tespil! Në tespil!»

Mane Takja hapte vend përreth e ia niste valles së pëlqyer, sipër një sofere një pash të gjerë. S'ishte valle ajo që kërcente ai, po lojë pehlivani. Dridhej mbi majën e opingës, hovte befas duke lëshuar një thirrje të mprehtë «eh!» ose «oh!», po aq befas ulej e ia merrte shtruar, duke sajuar figura të bukura. Dy herë njësoj nuk e lozte vallen. Gjithnjë i shtonte diçka, sipas gjendjes shpirtërore. Vazhdimisht fishkëllente lehtë. Ato pasthirrmat e mprehta bënin majë në fishkëllimën e qetë që shoqëronte vallen. I ndezur prush, valltari herë e hiqte kapuçin e bardhë dhe e mbante në dorë, herë e ngjishte në kokë anash, çapkënçe, mbi ata flokët e dendur e të sertë, kërklicë të zinj.

Ndizej valltari, merrte zjarr gjindja përreth.

...Një ditë, kur Mane Takja po lëronte në një arë afër shtëpisë, papritur dëgjoi zërin e së shoqes që nga dritarja:

— Ik, se të zunë!

Ai i nguli këmbët në plisat e butë dhe hodhi një sy rreth e rrotull. Drejt tij po vinte një koshadhe me bimbashin faqerrjepur në krye.

Mane Takja kërceu si dre në ledhin e arës e e vuri dorën në pishqollë.

— Mos u tremb, o valltar, nuk vijmë për keq! — nxittoi të thoshte oficeri.

Mane Takja qëndroi me dorën në pishqollë.

3.

— Prisni këtu, — tha bimbashi, kur arritën te pallati i pashait.

Vetë hyri brenda nga ana e kopshtit dhe portën e la hapur. Mane Takja ngriti kokën i mahnitur.

Kopshti i pashait qe një tufë e stërmadhe me lule të shumëllojta. Ai nuk kishte parë ndonjëherë aq lule në një vend të vetëm. S'ia merrte mendja se do t'i zinte syri një ditë një mori të tillë ngjyrash përnjëherësh. Mbi të gjitha lulet spikatnin trëndafilat. Por edhe ata të ndryshëm, që nga të bardhët si zambakë e deri te të kuqtë si zemër shalqiri. Gonxhet e petalet ishin të freskëta. Po ja ku gurgullonte uji i një çezme. Në mes të kopshtit uji rridhte nga goja e hapur e një luani të tunxhtë. Postafi qe mbushur buzë më buzë. Brenda masës së kulluar të ujit lodronin ngjyrat e ndezura të luleve. Përthyeshin aty rrezet e diellit e ngjyroseshin edhe ato ujëra-ujëra. Ndërronin vend e përziheshin ngjyrat në ujin, që duke rrjedhur murmuriste pandërprerë: gllu-gllu-gllu. Ngriheshin herë pas here ca stërkala të lehta, që shpërndaheshin e shkriheshin aty për aty.

— Ah! — murmuriti valltari i mrekulluar.

Bukuria qe aq e madhe dhe e beftë, saqë ai, shumë i ndjeshëm kundrejt saj, u gjend krejt i robëruar. Mezi



e përmbajti veten të sulej përmes portës së hapur, të shkonte pranë luleve të bukura e t'i përkëdhelte, ose të fladitej në ujin e kulluar të postafit. E prapsi frika e së panjohurës. Por edhe një si parandjenjë se mos, me ta prekur, pamja e bukur do të trettej.

Një bletë i zukati rreth kokës, pastaj u lëshua vrik në një lule. Petalet e saj e fshehën e zukatja reshti. Po ja tek u ndje përsëri. Bleta fluturoi në një lule tjetër, mandej më tutjë, duke përsëritur veprimet.

«Kjo bredh pa pushim, merr mjaltin çikë e nga një çikë në lule dhe shkon e e ngjesh në pite. Gjithë njëlloj, bahçevani mbledh nga anë e anës lulet më të bukura, i mbjell e i selit këtu me aq hijeshi, sa të merr mendtë.»

Dhe fill pas kësaj mendoi se edhe ai u ngjasonte bletës e lulishtarit.

«Për besë, po! Ata mbledhin e sajajnë, edhe unë ashtu bëj!»

Përngjasimi e mbushi me krenari edhe me guxim.

4.

— Hajde! — i thanë.

Një ushtar e drejtonte nëpër rrugicat e kopshtit.

— Me mend në kokë, o djalë! — dëgjoi t'i pëshpëriste dikush.

Ktheu kokën dhe e pa: një burrë i shkuar në moshë, me faqet labucere, veshur me një dolloma të vjetër. Mbante në dorë një prashajkë.

— Ti vetë je në shërbim të tij, — tha Mane Takja, duke e marrë me mend se ai plak ishte lulishtari.

— E, ashtu. Po kur sheh kopshtin e bukur, ai edhe mund të harrojë kush e selit. Me ty është ndryshe.

— Si ndryshe?

— Dhuntia jote nuk e kënaq dot, pa qenë ti vetë i pranishëm. Një kënaqësi e tillë nakatoset me smirë, zili e inat te këta njerëz.

— Hajde, barit! — thërriti me inat ushtari, kur pa se tjetri nuk po e ndiqte.

Mane Takja nuk pati kohë t'i përtyppte fjalët e lulishtarit. Që ai i dha një porosi me qëllim të mirë, kjo për të ishte fare e qartë, sepse njeriu i mençur ia pikas mendimin tjetrit sapo hap buzët të flasë. Po përse e si? Mos vallë bahçevani kujtonte që pashaji e kishte thërritur edhe atë, Manen, për ta vënë në shërbim të tij?

E futën në një dhomë të gjerë, shtruar tejteje me një qilim të madh e të trashë. Atje në krye, fundosur në ca jastëkë, pashai mbante në gojë një si shklop të gjatë e të hollë, rruaza-rruaza. E thëthinte dhe në çdo të thëthirë ndihej njëfarë gurgullime si frymëmarrja e një njeriu që e pengon diçka në fyt. Kur pashai i hiqte buzët, nëpër to kalonte një fjollë tymi si mjegull e kaltër.

— Avitu, avitu! — tha qetë e butë pashai, duke ia bërë me dorë, ndërsa e vëzhgonte me kujdes.

Dukej sikur pashai, pa rënë në sy, donte të zbulonte se ç'qe më shumë Mane Takja, valltar apo rebel.

Fustanella e Manes iu duk pashait si një ombrellë e bardhë. Këmbët e tij, mbathur me tirq të leshtë, kishin një trashësi të frikshme. Pashait iu dukën ato këmbë si dy trarë që ngulen e nuk shkulen më, po shpejt e largoi këtë pandehmë jo të këndshme. Tha:

— Ti je Mane Takja, ai që këndon?

— Unë.

— I bie gërnetës ti?

— Unë kam fyell.

— Vetë i bie e vetë kërcen vallen?

— Vallen e përcjell me të vërshëlyyer a me këngë.

Por edhe me fyell luaj.

Pashai tundi kokën. Dikujt që rrinte prapa kurrizit. të Manes i bëri shenjë. Mane Takja nuk e bëri veten të

tregohej kureshtar. Sakaq një shërbëtor i solli një kupë me sherbet.

— Pije, është i mirë.

Mane Takja mori kupën e njomi buzët. I mirë vërtet. Sherbeti kishte aromë e ngjyrë trëndafili. Gjë më të ëmbël e me aromë më të këndshme ai s'kishte shijuar. Por u përmbajt e i hodhi një sy pashait.

Pakëz zeshkam, i ri, me mjekër majuce e me sy të mëdhenj, me shikim të qetë, pashai dukej si njeri fort i sigurt në atë që bën a mendon, ose si një njeri që s'ka tjetër merak, veç të jetë i qetë në odën e tij të rehatshme. Atë çast dukej sikur tërë merak u meraku i tij ishte në do t'ia pëlqente vallë tjetri sherbetin.

— Pije e mos ki frikë, je në besën timë, — tha me të qeshur pashai.

Mane Takja mendoi se pashai po e përdorte besën si hyrje në bisedën për të cilën e kishte ftuar. Piu edhe një gllënjë tjetër e deshi ta hiqte gotën, po nuk ia zuri syri pranë shërbëtorin e s'diti si të bënte. Kupa i mbeti në dorë. Ç'donte pashai prej tij? U bë sy e veshë.

Ndryshe nga ç'priste valltari, pashai ia shkoi gishtërinjtë një vegle si harpë. Me të dëgjuar tingujt e saj, u derdhën në dhomë, duke ndjekur njëra-tjetrën, katër vajza të reja e të bukura. A thua prisnin në gatishmëri prapa ndonjë perdeje të padukshme! Vajzat ishin veshur pjesërisht me mëndafsh ngjyra-ngjyra e pjesërisht me tyl. Të bukura si në ëndërr. Mane Takja hapi sytë e puliti qerpikët. Dalja e tyre aq e beftë, lakuriqësia e pjesshme joshëse që fshihej pas atij tyli të tejdukshëm, gjithçka e panjohur e e papritur që po shikonte qyshse i qe afruar pallatit të pashait, ia turbulluan trurin e për një çast mendoi se mos i kishin bërë magji. Pashai u ngrëhos e u bë më i vëmendshëm. Mane Taka i uli sytë në qilim.

Pashai i drodhi sërish telat. Ia morën gazet. Vajzat zunë të kërcënin mbi qilimin e butë. Përdridhnin belin e vithet, duke u sjellë rreth vetes. Lozonjare, shkelnin lehtë-lehtë, shikonin lajkatare pashanë dhe vjedhu-

razi e me kërshtëri Manë Takën, i cili mendonte: «Hapu, dhe, të futem!»

— Të pëlqen? — pyeti pashai.

Manë Takja nuk u përgjigj, por uli edhe më kokën. Ishte krejt i hutuar.

— Lot kështu ti, lot?

— Unë s'jam çengil!

— Po si e qysh e rrëfen zotësinë tënde ti?

— Me sebeb.

— Ç'sebep?

— Ja, kur ka ndonjë dasmë, ndonjë...

Pashai u bëri shenjë valltareve e ato ikën në çast, sikurse kishin erdhur, gjithë duke ndjekur njëra-tjetrën me naze e fëshfërima mëndafshi. Pas lanë një erë të rëndë myshku. Manë Takja nuk e njihte atë erë dhe me mend thoshte se do të qe edhe ajo në magjinë që donin t'i bënin. Ai rrinte si mbi gjemba. Ç'po i kurdiste ky pasha? Përse të ishte kujtuar për të?

Pashai u fundos në jastëkë.

— Unë dua që ti të rrish këtu e të lozësh për mua, — tha me një mënyrë të tillë, sikur t'i njoftonte një nder të madh.

Valltari ktheu kokën vetiu andej nga kishin tkur ato femrat. A qe larguar tok me to dhe magjia?

— Hë, pse s'flet?

— Nuk e bëj dot.

— Qysh s'e bëke dot?

— Të thashë një herë, unë këndoç e luaj me sebeb.

— Në sarajet e mia sebepe ka çdo ditë. Ashtu dhe gjithë të mirat që të do e bardha zemër.

— S'janë për shijen time ato.

— Pse? — tha pashai, që dukej se mezi po mposhtte zemërimin.

— Pasha, më lër të shkoj.

— Ti do të rrish këtu!

— Unë erdha me urdhrin tënd e do të iki me dëshirën time. Kam për të mbjellë.

— Dërgoj unë njerëz të t'i bitisin tërë punët.

— S'më janë tharë këto! — tha Mane Taka dhe tregoi krahët e vet.

— Do para?

— S'ia shtrij dorën askujt unë!

Pashai fërkoj mjekrën. Ishte një kundërshtim që ai nuk e kuptonte dot. Pashai e merr pranë një copë fshatar, i thotë të rrijë në sarajet e veta dhe ky, qoftë dhe valltar i dëgjuar, nuk ia përfill dëshirën e t'i thotë: si urdhëron, pasha!

Ai deshi të bënte një politikë të ndryshme nga ajo e paraardhësve. Njëri pas tjetrit ishin gremisur në humnerën e turpit pashallarë të dëgjuar, ngaqë s'ia kishin dalë dot me shqiptarët e kësaj ane. Ai mundohet t'i njëhte këta rebelë. Ishin të zgjuar, disave t'u jepte nga një kockë. Të shtirej se ua çmonte zotësinë. Ta niste me valltarin. T'ia përkëdhelte sedrën e ta fuste në bukë të vet. Kur ta bënte për vete, ta përdorte për të zbutur të tjerët.

Pasha Ylkiu po mendonte se edhe butësia ka një kufi. Edhe pa e parë në sy, ai e përfytyronte vështrimin e habitur të bimbashit atje te dera. Po e tepronte. Pashai, pasha, mjaft të kishte një dëshirë. Le të merreshin të tjerët edhe me valltarin!

Ai ngriti kokën t'i jepte shenjë bimbashit, po pra-pë u tërhoq. Luhatej ndërmjet mendimit në duhej të këmbëngulte për ta thyer valltarin ashtu si e pati menduar në fillim, apo ta ndëshkonte për qëndrimin kokëfortë. Shpirtin e tij po e brente një krimb. Jo një, po dy bashkë. Valltari s'e kishte përfillur. Qe një gjë e padëgjuar gjëkund. Si guxonte harbuti?!

E tori dhe e tori me mend pyetjen dhe, kur lëmshi u mbështoll, ja se ç'doli: fama. Ai e kishte fajin. «Ky qafir valltar kishte serbesllëkun e namit!»

Po famën pashai e donte për vete. Valltari me aftësinë e tij duhej t'i shërbente emrit të pashait. Vetëm kështu. Si mundej ndryshë? Pashai, pasha. Harbuti, harbut. Ç'i duhej nami një harbuti?

Pashai ngriti sërish vetullat dhe bimbashi u afrua e qëndroi përballë valltarit.

— Bjer në gjunjë e kërkoi ndjesë pashait, — tha vrazhdë, në formë urdhri.

— Përse?

Përse?! Pashai ngriti sytë dhe e pa rreptë. Ah, pisi! Ah, i paturpshmi! Përse, thoshte! Krenaria ia jepte atë guxim. Dhe krenarinë nami. Ai e jo tjetër. Pashai do t'ia shkulte atë krenari. Do t'ia ngordhte. Menjëherë!

Me fjalë të cinguaru bimbashi u përpoq t'ia shpjegonte fajin. Mane Takes. Ishte sjellë në mënyrë të pahijshme, rebelë kundrejt pashait. Kjo qe njëlloj si të haje bukën e të përmbysje kupën. T'i silleshe kështu një pashai të madh, një pashai të ndritur, një pashai fitimtar...

Jo, ngulte këmbë Mane Takja! Unë s'i bëra ndonjë të keqe pashait. Dua të shkoj në punën time. Asgjë më tepër.

Pashait iu bënë sytë gjak nga tërbimi. Mos i thoshte mendja këtij kokëkrisuri t'i mbrihte qetë me të? Atë që s'e bind fjala, e shtron druri. Ajo kokë që s'bindet as nga druri, pritet, se është e pabindur, pra, e rrezikshme.

Këto mendoi pashai e turfuilloi:

— Në hekura, qenin!

5.

Në bodrumin e errët, Mane Takes i bëhej se po i mpihej trupi e shpirti. Ah, sa e shtrenjtë paskësh qenë një çikëz dritë! Hante veten. Të paktën ta kishte shkrehur një herë pisqollën, kur vajtën e i thanë që e kërkonte pashai. Të mos vinte vetë, si cjapi te kasapi, me këmbët e veta, që me fjalën e parë.

Pashai tanimë e kishte në dorë. Për punë të kryen-

gritjes. Lëre se ç'sebep gjente ai. Dhe në i bënte atë propozimin e turpshëm për ta marrë në shërbim të tij si valltar, edhe këtu xheç fshihej. Se valltarë ai kishte! Kishte ato çengitë e paturpshme, që e ndillnin me të spërdredhura e lakuriqësinë e trupit. Diçka po kurdiste pashai dhe i lipsej Mane Takja. Donte t'i hidhte hi syve. Iu ruaj dushmanit në kohë qetësie, sidomos turkut. Kur qesh e të lajkaton, hapi mirë sytë!

Këto mendonte Mane Takja, ndaj i vinte inat pse e la veten të shkonte urtë e butë pas bimbashit e të hynte në pallatin e pashait, që kishte një kopsht aq të bukur, po një bodrum të tmerrshëm. Larg, ore larg! Ta ndizte aty, mu tek ara, pa le të bëhej ç'të bëhej pastaj!

Pas ca ditësh prapë e thirri bimbashi veshprerë. Ia përsëriti kërkesën. T'i binte ndër gjunjë pashait. Kushedi, mund t'i zbutej zemra e ta falte. Jo, tha edhe një herë Mane Takja. Përse të më falë?

Pashai u xhindos.

— Mos guxojë të më flasë njeri për të! — sokëlliu.
— Më gënjeu, qeni, e m'u zvoudh! Edhe këmbët të më lëpijë e të hiqet zvarrë para meje, nuk e fal më. Varenë, harbutin! Po më parë ta mundoni paq!

Dha urdhër të ngrihej një podium me gurë e trarë dhe ditën e ekzekutimit të mbledheshin sa më shumë njerëz. Të vdiste para turmës ku kishte emër. Ashtu përçmohej më shumë e të tjerët vinin mend.

6.

Atje, përpara qindra vetave, e vunë «kokëfortin» Mane.

Pashait i kishin bërë një tendë në anë të podiumit.

Gërmadhë podiumi, zambak tenda, po askush nuk ia hidhte sytë. Të zemëruar, ballëvrenjtur, njerëzit e mbledhur aty shikonin veç njërin, valltarin. Manen e mbanin për krahu. Turma kishte ngrirë nga dhimbja për të.

Ai, që i kuptonte ndjenjat e tyre, ngriti kokën si t'u shprehte mirënjohjen e t'u thoshte: mbahuni, bre, nuk kemi për t'u tretur në këmbë!

Bimbashi shpalosi një kartë e tha:

— Ky harbut, fodull e gojëndyrë, gjene ngriti krye kundër pashait. Pashai ynë i ndritur, allahu ia shtoftë ymrin, e ka zemrën det, ama edhe zemërgjerësia s'bëri fajde. Megjithëse ka shkrehur pushkë, pashai e fali këtë, ashtu si ca të tjerë, e i zgjati dorën e miqësisë. Po ky harbut ç'bëri? E kafshoi atë dorë, qafiri! E përdhosi miqësinë, bukëshkali! Rebel ishte, rebel mbeti! Dënohet me vdekje e do të varet në çengel.

Fjalët e tij u ndoqën me heshtje varri, po, kur u lexua vendimi, njerëzit lëvizën dhe një «ah!» u ndeh dhimbshëm e kërcënueshëm.

Bimbashi u kthye nga pashai. Pastaj diçka mërmeriti. Bimbashi iu afrua të dënuarit e i tha me zë të lartë, që ta dëgjonin të gjithë:

— Zemërgjeri, mendjendrituri e shpirtmadhi pashai ynë pyet për dëshirën tënde të fundit.

Një «ah!» i dytë doli nga zemra e turmës.

Mane Takja u ndeh e i përfshiu njerëzit me sy. Pastaj u gëlltit sikur të përpinte ahun e tyre, bëri një hap përpara e tha:

— Të loz një valle.

Njerëzit lëshuan një psherëtimë dhe sikur u lehtësuan.

Valltarit iu fry zemra gjyryk kur pa se u pranua dëshira e tij. Shikimi i shkau më tutje. Atje poshtë rrokulliste dallgët e shkumbëzuara përroi malor. Fshati i tij ndodhej te koka e përroit. Nuk dukej që aty, më kot i qepi sytë andej. Iu bë sikur shihte përballë një faqe mali me gurë të bardhë gëlqerorë e tufa trëndeline e çaji. Sikur i dallonte qartë lulet e verdha. Hojzit iu hapën e ai ndjeu aromën e njohur. Kurrizi i

malit puqej me kaltërsinë e qiellit. I mbajti sytë gjatë në vijën e përthyer, e cila dalngadalë sikur u shkri fare.

Pashai e pranoi dëshirën e tij. Bimbashi përfitoi nga rasti të thoshte edhe një herë sa zemërgjerë ishte pashai i ndritur. Pastaj nxori çelësin që të hapte drynin e prangave.

Sapo dëgjoji vërtitjen e çelësit, fap u dha duarve anash Mane Takja dhe prangat i ranë përdhe. Ai i pa me përbuzje, u ngrh e u çapit në rrëzë të podiumit. Një bashkë flokësh iu shkund me rrëmbim. Mori fyellin e e vuri në buzë. Fyelli nxori këngën, kënga nxiti këmbët e vallja u hap.

— Hoop, ej! — ia bëri ai e njerëzit, mbledhur aty me përdhunë, u mbërthyen me shikim mbi trarët e podiumit, ku shkelte me aq shkathtësi valltari i tyre.

Kur hynte në valle Mane Takja, nuk mbahej më. Nuk e kishte më veten në dorë, i jepej artit të vet dhe arti e ngrinte peshë. E bënte të lehtë, të rëndë, të gjerë, të padukshëm, teh thike a petal luleje.

E zgjeroi rrethin ai, iu kthye sërish rrëzës së podiumit, shkeli në zgrip të tij, duke u përkundur në figura që i sajonte aty për aty. Dhe shikimin shpatë nga pashai. A thua i kumtonte diçka me lëvizjet dhe figurat që bënte? Pashai rrinte me syrin gati për të dhënë një shenjë; se xheç pikaste vërtet në lëvizjet e valltarit kokëkrisur.

Po ky duel nuk zgjati shumë. Sikur të pendohej për vëmendjen që po i kushtonte pashait, valltari bëri një kërcim të madh dhe hop, u gjend në mes të podiumit. Zgjodhi një vend sa një tepsi dhe ia nisi valles së tij. Lozte si për të fundit herë. Hidhej, shtrinte krahët për të prekur tokën, rrotullohej, prapë hidhej dhe «eh!» e «oh!». Tendosej këmba e tij duke u mbështetur në gishtërinjtë, shtrëngohej e përthyer te pulpa tjetër, dridheshin palat e fustanellës. Lozte me këmbë? Ai që kujton kështu, s'i njej vallet. Këmbët vetëm sa jepnin drejtimin. Dridhej gishti i madh i këmbës nën lëkurën e butë të opingës. Dridhej dhe kërciri poshtë gjurit, rrudhëzat e syrit, mëngët e gjera të këmishës, fusta-

nella. Atë që dinte të thoshte në valle, e thoshte i gjithi, si një muskul i vetëm. Hovte. Qetohej. Gëzohej e dëshpërohej, si të ishte rasti. Vallja i jepte shpirt dhe shpirti i valltarit shkrinte në të gjithçka, në një të tërë të vetme, të pandarë.

Një shkëmb i rëndonte në shpirt e ia shtrëngonte zemrën. Ai do ta flakte atë shkëmb. Nga vetja e tij, nga njerëzit e tij. Ja, aty, në vallen që kërcente për herë të fundit. Kur të përkëdhel pashai, shtri zverkun për të shkuar në të o kularin, o jataganin, thoshte një pjesë e valles. Kokën lart, ore, ballin lart, thoshte pjesa tjetër. Veçanërisht këtë të fundit, ndjenjën e mospërkuljes, për të cilën po humbiste jetën, po e derdhte në valle me bujari e zotësi mahnitëse. O njerëz, unë po vdes duke jua falur juve këtë ndjenjë! Merreni e mbajeni në mes tuaj! Mos më shikoni me trishtim, nuk po loz vallen e vdekjes unë. Jo, or, jo, ngritjen këndoju, për të kërcëju!

Dhe njerëzit e ndiqnin me lot në sy. Prush në zemër u derdhte Mane Takja me vallen e tij. Zemrat peshë ata, si klithmë gati për shpërthim.

Dukej sikur ajo valle nuk do të mbaronte kurrë. Por fare befas valltari u ul në njërin gju me dorën nderur përpara e sytë përpjetë malit. Iu bë se shqoi në shkurret e blerta bushin ku preu degën e bëri fyellin. Iu mbushën sytë, iu mbush shpirti me mall e dhimbje. U ngrit dhe e hodhi tutje fyellin e stolisur, si t'ia kthente tokës nga e kishte marrë. Pastaj iu vërvit bimbashit që t'i vinte sërish prangat.

Njerëzit u përmendën. U kujtuan ku ishin e për se dhe lëvizën me shqetësim. Bimbashi u tremb. Megjithëse me frikë, tha me gjysmë zëri:

— Pashai im, po e vramë, ky do të bëhet bajrak.

Pashai bëri sikur nuk dëgjoi gjë. U ngrit dhe ai. I zmadhuar nga dollomaja e mëndafshtë, figura e tij ra në sy dhe njerëzit u platitën në pritje. Ç'do të bënte?

Ai e kishte menduar mirë. I hodhi një vështrim triumfues valltarit. Deshi ta shihte në sy, po Mane Takja, me ballin lart, sytë i kishte hedhur atje tej, ku piqej kurrizi i malit me qiellin e kaltër.

— Aferim, o valltar! — tha pashai.

Një tjetër tendosje e të pranishmëve.

Pashai i pa të gjithë e po ngopej me përshtypjen e fjalëve të tij. Ai mendoi për efektin që do të shkaktonte ajo që do të vijonte dhe, duke hapur krahët, si të tregonte atë gjerësinë e shpirtit që kishte përmendur disa herë njeriu i tij, tha me një theksim të veçantë:

— Aferim e hallall!

Tendosja u sforcua. Por veç për disa sekonda.

— O Mane, ç'pret, ore? Je i lirë, s'dëgjon?

Me një kërcim, Mane Takja u hodh nga podiumi e njerëzit e rrëmbyen në krahë. Ndodhi diçka e pabesueshme. Gëzimi i turmës ishte si një shungullimë. Ca qanin, ca brohoritnin. Të tierë turreshin drejt valltarit, e preknin, e shtrëngonin, i flitnin. Andej nga shkante ai, dallgëzoheshin njerëzit.

Në fillim pashai e ndoqi pamjen e çuditshme me kënaqësi për përshtypjen që po bënte gjesti i tij bujar, po shpejt e pa veten të zhvlerësuar, krejt të papërfillur, si një lëvozhgë që vala e flak në breg pa çarë më kokën për të. Gjendjen e re së pari e pikasi te hutimi i njerëzve të tij. Ata s'dinin ç'të bënin e shikonin nga ai. Ai priste. Priti një copë herë. Por askush nuk u kujtua ta falënderonte apo t'i shprehte urimet e përgjëratat e zakonshme për një rast të tillë. Madje as vetë i faluri.

«Ai e ka fajin. Pas tij u turrën të gjithë. Për shkak të tij më harruan mua!» mendoi pashai, mbushur mëri e vrer.

Më të folurën e bujshme mendoi se do t'i rriste namin vetes, por, krejt ndryshe, edhe ky veprim, sikurse gjithë të tjerët kohët e fundit, qëkurse mendoi të shfrytëzonte emrin e valltarit, po bënte të kundërtën, ia shton-te edhe më famën Mane Takes.

Krimbi i pendimit e i zemërimit iu shndërrua në një gjarpër. Gjarpri kafshoi. Kafshimi i dhembti, helmi bëri të vetën.

«Gëzohuni, gëzohuni! — u hakërrua. — Edhe ti, — iu drejtua me mend valltarit, — unë prapë të kam në dorë!»

Kaluan ditë.

Pasha Ylkiu priti sa të harrohej sadopak ajo që ndodhi, vuri njerëz dhe e vrau tinëz Mane Taken. E vrau dhe u përpoq të përhapte fjalë se dikush i kishte zënë pritë për punë hasmërie e të tjera si këto.

Pashai deshi të shuante famën që gëzonte valltari e që i dukej se errësonte të tijën, po kjo ishte gjë që s'bëhej. Mane Takja u la të tijve shpirtin e vet, vallen. Ata e morën dhe e bënë të vetën. Ajo valle ua prushiste dëshirën për liri, ndaj si shpërblim e mirënjohje për krijuesin gjetën diçka të thjeshtë e të natyrshme: e përjetësuan valltarin kryengritës, duke i dhënë valles së bukur emrin e tij.

NUSJA E MALIT

Shota hodhi shtat e u bë goxha vajzë. Megjithatë i ati nuk e ndante nga vetja. Për të ajo gjithnjë mbetej bija e përkëdhelur. E vogla, e brishta, e mira. Ai e deshi atë që në djep. Jo, që më parë. Ai e deshi Shotën akoma pa lindur. Kjo dashuri kishte zënë fill tok me dëshirën për të pasur një vajzë.

Mblidheshin burrat në dhomën e Halilit. Shota aty. Rrinte në gjunjë, me gishtin mbështetur në faqe, dhe dëgjonte me ëndje çka bisedohej. Disi ëndërrimtare nga natyra, çdo ditë e më tepër i nxitej fantazia. Përfytyrimi i një vajze të re kishte me se të ndizej. Se në dhomë njerëzit nuk mblidheshin thjesht për miqësi, as për të vrarë kohën me biseda. Për bëma trimërie të së kaluarës, të së tashmes e të së ardhshmes flitej. Tërë trimëritë e kohëve të shkriheshin për këtë të ardhme.

Në atë kohë, kur një femër gjendej midis burrave, ata të gjithë ulnin kokat. Me Shotën ndodhte ndryshe. Askush nuk e shkonte ndër mend që ajo nuk duhej të qëndronte në dhomë. Në të kundërt, kur s'ishte, mungesa

ndihej shumë. Se ajo ishte rritur në prani të tyre. Bukuri e mirësi tok, një kafe a një kupë ujë nga dora e saj, qe çlodhje për cilindro.

E gjatë dhe e drejtë, fytyrëvezake, me sy si të mjegullt, Shota mbrunte në vetvete një bukuri të gjithan-shme, po si të pakapshme. Duke prekur gërshetin e lëshuar në gjoks, në pamjen e saj të menduar lexohej pak a shumë:

«Në pafshi tek unë veç bukurinë si femër, s'keni parë gjë e më fyeni.»

Ajo e ndiente se vështrimet që i hidhnin ishin pa të keq, por prapëseprapë rrinte kokulur. Jo nga zori. Më shumë nga inati. Baba Halili ishte i gëzuar që i lindi vajzë. Shota i mbante mëri këtij shorti. Pse kishte lindur vajzë? Kosova e robëruar lypte trima që t'i dilnin zot e t'i sillnin liri!

Kur qe më e vogël, pati rendur si e marrë të kapërcente ylberin, që të bëhej djalë! Vrapo e vrapo me sytë gjithë nga ai. A po e arrinte? A po i afrohej? Dhe ylberi, krejt mospërfillës, e përqueshte duke mbajtur po atë largësi, të pandryshuar, sado që ajo lodhej. Dhe e ftonte më tutje, më tutje, në një vrapim në pafundësi. Nga këto çaste naiviteti fëmijëror fare pa gjë nuk doli. Mori diçka nga ylberi. Në mos gjë tjetër, të paktën mësoi të përpiqej për atë që dëshironte.

Shpërthente kryengritja. Babai e vëllezërit, të gjithë, deri edhe Rexhepi, që s'i kishte mbushur ende të tetëmbëdhjetat, linin çdo punë në ara e kopshte, linin odën e kullën, ngjishnin armë e fishekë dhe turravrap atje ku i thërriste nderi e trimëria. Ajo mbetej vetëm me nënën. Shkonte me dhi. Qëndiste. Bënte pëlhurë në vegjë. Nënë Sala i pëshpëriste ngadalë:

— Je çikë e mirë ti, bijë. E bukur e punëtore. Gjithkush ka me të lakmue.

Dhe e mësonte të bënte sixhade, qilima, zhguna për të veshur shtatë meshkujt e shtëpisë.

Shota i bënte dhe këto punë. Madje i bënte mirë e me lehtësi. Po mendjen e kishte gjetkë. Shtëpia e zbra-

zët e trishtonte. E ç'dobi sillnin këto punë grash, kur toka digjej flakë nga hasmi i zi?

Ishte katërmbëdhjetë vjeçe kur Radisheva u dogj për herë të parë. Luftonte Isa Boletini me Xhavit pashën. Isai ishte dhëndër në Radishevë. Xhaviti nuk pati ç'ti bënte atij dhe shfreu mërinë duke djegur Radishevën e fshatra të tjera që mbanin anën e luftëtarit. Hi e shkruamb Radisheva. Njerëzit u ngjitën lart, në bjeshkë. Flinin përjashta, rrëzë lisave, a ku të mundnin. Edhe Shota. Nxirë nga pluhuri e dielli, nga era e tymi, zbathur, bridhte poshtë e lart me shokë e shoqe për të mbledhur fruta që të mbanin gjallë shpirtin.

I kishte shijuar frytet e hidhura të ndeshjes me hasmin. Ajo nuk i ishte kundërvënë me asgjë, veç me ikjen në bjeshkë. Po ky qe largim. Ndaj i gufante zemra nga mëria. Mbushur plot e përplot me urrejtje, por pa gjetur shpërthim. Kjo i sillte vuajtje.

Vetëm a me shoqe ngjitej shpateve me dhi. Merrte dhe dhinë e fqinjëve. Vëllezërit pajtoheshin argatë për të nxjerrë bukën e gojës, ajo bënte punën e bariut. Dhe e bënte si jo më mirë. Kërcente sipër shkëmbinjve. Lart, gjithnjë më lart. Deri ku mund të vente? Kënga e zogjve, era, zhurma e ujërave, aromat e luleve e gjelbërimi ia mbushnin kraharorin. Nëna natyrë i jepte njëfarë prehjeje dhe asaj. Po ku, sa larg nga ajo çka ia donte zemra!...

— Shotë, merre çiftelinë, të pastë baba!

Ajo hovte si kaprolle, rrëmbente atë vegël që i jepte hije burrërore dhe ulej në gjunjë. Shikonte pakëz mendueshëm, si i ati, mandej niste ngadalë, me zë të hollë, të ngrohtë:

«Po hip Marki në Previ,
shikon Limin me dyrbi.
— Ç'ka ky Limi qi dirgjet zi?
Vajmedet, vojnikt' e mi!
Ç'ka ky Limi qi dirgjet gjak?
Po lufton Shqipnia e ngratë!»

Këndonte bukur Shota? Luante mirë në çifteli?
Mos i bëni këto pyetje të kota. Askujt nga dë-
gjesit nuk i shkante mendja për këso pyetjesh. A të
rrëmben kënga e bukur? A të bën trim e të fortë,
sa të harrosh brengë e dhimbje, të marrësh vrull e të
ngrihesh mbi to? Po, thoni ju? Atëherë Shota kën-
donte bukur. A të ngjall krenari për vete e dëshirë për
liri një këngë e tillë? Atëherë Shota këndonte si jo
më bukur. Ndofta se dinte ç'këngë të zgjidhte. Prapë
qe meritë e saj. Dhe në e shtonte admirimin hiri i
këngëtares, meritë e saj ishte gjithashtu. E, pra, ajo
këndonte bukur!

Dridheshin telat e çiftelisë, lëviznin shkathët gish-
tat e këngëtares, përhapeshin tingujt në dhomë, jehonte
zëri i vajzës që përzihej me shpërthimin e dashurisë e
të urrejtjes. Sytë i ndizeshin flakë. Vetullat e saj hark
uleshin e ngriheshin rreptë. Ngjante sikur ishte një
këngëtar i moçëm, që vetë qe kacafytyr me armiqtë në
gryka e male të thepisura.

Shfrente dufin ajo me këngë trimërie. Shfrenin
dhe ata që e dëgjonin. Njëpërmjet këngës hidhnin va-
lle dëshmorët. Përmes tingujve-vikama e Kosovës. Det
me plisa të bardhë kryengritësit.

Në dhomën e Halil Radishevës të hapur e kishin
portën edhe djemtë. Vinin të mbruheshin me dëshirën
për liri? Apo për të parë Shotën?

Gjithnjë aq të tepërta edhe këto pyetje. Kur, va-
llë, ka qëlluar që shqiptarët të mos e përcjellin brez pas
brezi atdhedashurinë? Dhe, në anë tjetër, kur ka ndo-
dhur ndonjëherë që zemra zjarr e të riut të mos pri-
ret ndaj bukurisë vajzërore si lulja e diellit ndaj shëm-
bëlltyrës së vet?

Sytë shkëndija të rioshëve, nën përpëlitjet e zem-
rës, mundoheshin të vidhnin një çikëz nga kjo bukuri.
Sytë e Shotës në qilim.

Po shikimet i ndiente. Një lëvizje nervoze e gër-
shetit, një dridhje e lehtë e qerpikut, një e vrenjtur
paksa e vetullës mjaftonte që djemtë të rrinin urtë
e të mos shtyheshin më tej.

Një ditë ia behu tok me shokë trimi Azem Galica. E njihte 'Shota Azemin. Prindët e tyre miq e bashkëluftëtarë. Azemi hynte lirshëm në shtëpinë e Halilit. Po kësaj here ai vinte pas një mungese të gjatë. Prej më se një viti ishte bërë luftëtar i dëgjuar. Aq sa, kur ia pati pikasur trimërinë, vetë Isa Boletini kishte pyetur:

I kujt është?

Djalë i Bejt Galicës, i thanë. Nip i Kurt Selacit.

Isai kishte tundur kokën me kënaqësi duke shtuar:

Paska kujt me i ngja.

Trupshkurtër, por i ngjeshur, mustaqespic, symprehtë, Azemi ngjatjetoi me dorën në zemër dhe eci me të lëkundur drejt të zotit të shtëpisë.

— Si je, Halil Radisheva? Si jeni, burra?

Halili i dha kutinë e duhanit. Azemi e drodhi cigaren ngadalë, qetë.

Shota e ndiqte me kërshtëri. Lëkundej ndërmjet admirimit e inatit. Cila ndjenjë të ishte më e fortë? Trim i çartur, dukej sheshit. Po sesi rrinte ky Azemi, si shumë i krekosur, si... Në vështrim të parë e mori për mendjemadh.

«Pa shih, flet me burrat si i barabartë ndër ta. Ky, sak, është bërë një fodull i pashoq!»

Mirëpo burrat e ngjatjetuan me respekt dhe gjithë njëllon nisen bisedën me të, e asaj iu desh t'ia shtrëngonte frerët mërisë.

— Ç'kemi asaj Galice, o trim i Bejtës?

— Drenica është kudo po ajo.

Përgjigje e urtë.

— Si po na shkojnë punët e nanës Shqipni?

— Besa, boll kangë të reja ka qitë populli. Më kanë ngelë në mendje do vargje:

Ç'a kanë retë ç'i vetojnë?

Dy dragoj po liftojnë.

N'Kaçanik e n'Caralevë

Isa Begi, Idriz Seferi.

*Dërgut pasha me niqinmi,
Isa Begi me shqiptari.
Kaçanikut i raftë pika,
nuk e ditka ça a frika.»*

— Heu, bukur fort!

— Ty të lumtë goja, Azem Galica! Vetë ke qenë në ato beteja e fort po i ndien këngët për to.

— Kaçaniku e Caraleva, burra, jetë e mot do të mbeten vatra bisedash e këngësh trimërie. Aty e pamë forcën tonë e ç'mundemi të bëjmë.

— Shotë, a i ke ndi ti këto kangë? — pyeti befas Halili.

Shota, e zënë në befasi në kërshërinë e mëdyshtjet e saj të fshehta, u turbullua.

Azemi e pa. Nuk e kishte vënë re deri atë çast. Rrudhi ballin vetiu. Një habi për të. Sytë s'ia ndante. Heu, sa qe rritur! Heu, sa qe zbukuruar!

Shikimi i tij ishte i ngulët e si i hutuar.

Ajo uli sytë e u vrenjt. U zemërua me trimin. Si guxonte ai ta shikonte ashtu, aq serbes? Fare i pacipë! Po ajo, vetë ajo, pse i ngriti sytë? E, pra, nuk i kishte ndodhur asnjëherë një pakujdesi e tillë. Dhe hante veten. Ndihej sedërlënduar, si të kishte humbur diçka të madhe nga krenaria e saj vajzërore.

Mirë, ky Azemi, sa shkreppte kushtrimi, aty qe, i pari. Por mos vallë prandaj duhej të tregohej i paturp me të? Eh, të qe djalë ajo, pa të shihte ai! Mendjemadhi!

Për inat të tij, vuri gishtat në tela, i shkundi kumbueshëm e këndoi:

*«Jakup Feri kur ka listue,
katër veta i ka pre ni grue.
S'a kanë grue, a kanë çikë,
motra Zhujës qafëkapricë
katër veta i preu n'sakicë.»*

Azemi vuri buzën në gaz. Befas diçka iu kujtua, qiti revolen nga brezi e tha:

— Me lejen tande, Halil Radisheva!

Dhe e zbrazti tri herë.

Halil Radisheva u kënaq shumë. Në dhomë nuk kishte gëzim të vërtetë pa krisma. Shotës hem iu bë qejfi, hem iu shtua inati. Ç'kokëkrisur ky Azem Galica!

Njëherë mendoi të ngrihej e të ikte. Po këmbët s'i bënin. Bënte të ikte e s'ikte dot. Bënte të fliste e s'fliste dot.

Azemi zuri të vinte dendur.

Shota gjithnjë në gjendje shpirtërore të ngacmuar. Nuk ia falte vetes që s'i kishte treguar vendin, qoftë dhe një herë të vetme. A e kishte kuptuar atë këngë, të paktën? Se nuk janë vetëm djemtë trima!

Eh, sikur ta dinte ai, sikur ta dinte!

Kohë më parë, kur një djalë e kishte sharë me fjalë të rëndë, ajo i ishte vërsulur e e kishte rrahur paq.

Por ai nuk e përfillte fare kërcënimin e saj të heshur. Ia hidhte sytë e nuk bënte dot ndryshe. Shota kërkonte me pahir të shtynte zemrën e saj që të merrte inat, po zemra s'i bindej. Hidhte vicka edhe ajo!

Sytë përdhe vajza inatçore. Megjithatë vështrimin e tij të guximshëm e pikaste. Ai vështrim e ushqente zemrën e saj të pabindur.

Nuk kishte sesi. Kur qe ai, ajo e zgjaste këngën. Bashkë me telat e çiftelisë dridheshin ndjenjat e vashës. Azemi zhbironte me sy në zemrën e saj. Ai e kuptonte, siç nuhat i dashuruari, ç'po ndodhte në atë zemër. Secili rronte si në ankth, në pritje të diçkaje të pazakontë, të fuqishme, rrëmbyese në njëfarë ankthi, nga i cili ke dëshirë të largohesh e të afrohesh, ta shtysh tej, por edhe të kridhesh në të.

Po ja, Azemi prapë u zhduk.

Shota e humbi gëzimin e qetësinë. Kaq herë e kishte kërkuar me inat largimin prej tij. Kaq herë ishte betuar me vete t'ia vinte kufirin të prerë. Po kur kjo ndodhi vetiu, ajo u mbush me padurim.

I keqi! Mendjemadhi!

Ajo më kot e shante. Shumë agime priti Shota pa mbyllur sy. Jo më pak net kaloi pa gjumë Azemi.

Erdhi pranvera e vitit 1912.

Shtatëmbëdhjetëvjeçares Shotë sa s'i pushoi zemra, kur dëgjoi hapat e nxituar të Azemit nëpër shkallë. Ai po vinte përsëri.

«Sa mirë! Shumë i ngutur duket. Ja, po më kërkon me sy. A thua nuk i sos durimi sa të më shohë?!»

Ajo e kishte pritur. Ia pohoi vetes. E kuptuan dhe të tjerët.

E një ditë rasti e solli të mbeteshin vetëm për disa minuta. Ose rastin e sajuan vetë, pa u marrë vesh fare me njëri-tjetrin. Ai po hynte në shtëpi, ajo po dilte me shtambën e ujit. U takuan në mes të shkallëve.

— Shotë!

Shota shtrëngoi me dorë veglën e ftohtë të shtambës. Këmbët i mbafti, sytë s'i ngriti.

— Ke një hijeshi në gjithçka, o çikë, sa... unë nuk po të bëj dot ballë më!

Vajzës iu bë se mori zjarr e tëra.

Rendi tatëpjetë shkallëve, hyri me të shpejtë në ahur e i vuri kurrizin derës. Me dorën në faqe, e trembur, priti të qetësohej.

«Sa i kurajshëm! Si munda të më thotë ashtu! Dhe unë... unë e shkreta asnjë fjalë s'e qita. Mos vallë e dua? Mos vallë?...»

Shumë djem e adhuronin. Por i druheshin. Guximin e mori më trimi. Edhe ai, veç, kur e pa që bukurinë e egër po e zbuste dashuria.

Të nesërmen ajo nuk u duk në dhomë.

Mori dhitë e u ngjit lart, në mal.

Pranvera buiste. Në fshat gjithandej tumba me lule të bardha e të kuqërremta. Kishin çelur mollët. Në kodrat përmbi fshat gjelbëronin gjethet e njoma të lisave.

Dhitë kacavareshin nëpër shkurre.

Baresha u ngjitej shkëmbinje më të lartë dhe sytë tatëpjetë, në fshat. Vraponte lirishtave dhe sytë

tatëpjetë. Sikur diçka e veçantë e tërhiqte, paçka se vetë me vullnetin e saj, jo lehtë, ç'është e drejta, iu nda fshatit asaj dite. Fshati po i dukej disi ndryshe, mbase ngaqë e dinte se ai do të vinte prapë atje. Ndofta tani kishte hyrë në fshat. Ndofta po ngjitej në shkallët e shtëpisë. Ndofta po e kërkonte me sy... Mirë, le ta kërkonte!...

U shtrua pranë një burimi. Piu me etje. Mbushi grushtet e spërkati faqet I futi duart në ujë e i la t'i freskoheshin.

Burimi ishte i qetë. Uji dilte që poshtë një guri. Formonte një pellg të vogël, teprica rridhte në një vijë të ngushtë, që zbriste poshtë, me një gurgullimë të lehtë e të ëmbël. Rrjedhje e gurgullimë e pandërprerë. Gjithnjë dhe kushedi qëkur. Kushedi gjer kur. Një pafundësi e fshehtë që të josh e të habit.

Dikur nuk e ndjeu më zilen e cjamin. Brofi në këmbë e mbajti vesh. Nuk dëgjohej.

— Ej, cjam, cjam!

Hiç.

Brodhi pllajës.

— Ej, cjam, cjam!

Asgjë. Dhitë aty, cjami jo. Zilja më e madhe nuk ndihej. Si kështu?

— Ej cjam, të shitoftë zana, ku je?

Dhe zilja u shkund fare afër.

— Po në mëriz kishte rënë, ë? Hej, ma ngrive gjakun, ty të...

Fjala i ngeli në mes. Pas cjamin u ngrit figura e një njeriu. Azemi! Ai e paskësh fshehur cjamin dhe ia paskësh mbajtur zilen. Heu!

Azemi pati frikë se mos Shota ia jepte vrapit. Shota nuk lëvizi vendit, sado e befasuar.

Ai qeshi, ajo rrudhi vetullat. Tha:

— E kam ditë lufëtar Azem Galicën, jo cub!

— Desha të të shoh, o zanë e krojeve!

— Mua më thërresin Shotë.

— E di, moj. Po më pëlqen të të ngjit dhe një emër tjetër, që të shkon si më mirë s'ka.

- Kush ta lypi atë emër?
- Vetë kam qejf, o zanë!
- Zanat janë idhnake, o trim. Ruaju!
- Po, moj. E keqja e tyre le të më gjejë!
- Mandej janë të shpejta e të padukshme e s'i kap

dot.

- As kur të jep krahë dashuria?

U panë sy ndër sy, gjatë.

Asnjëri nuk u tërhoq. Azemi bëri një hap. Që aty mund ta prekte me dorë.

- Po të kërkoh qysh sot te baba yt, Shotë. Ja, që tashti po shkoj vrap. Ma jep dorën!

Ajo ia zgjati vetiu. Azemi ia kapi e ia shtrëngoi. Deshi ta shpinte në zemër, po baresha, e penduar, menjëherë, nga lëshimi i pavullnetshëm që kishte bërë, e tërhoqi me forcë dhe iku me vrap përmes gëmushave të pyllit.

Shumë gjëra kishte menduar Shota në gjithë ato raste kur mbetej vetëm, veç për martesë jo. Aq më pak për dashuri.

Mirëpo në muajin e luleve e të dashurisë, atë vit në mbarë Kosovën u dëgjua fort kushtrimi: «Të vijë, kush është trim! «Në Drenicë pishtarin e kryengritjes e ndezi Hasan Prishtina. «Betimi i Kosovës» kalonte gojë më gojë:

*«Besa-besë, një besë kemi dhanë,
ty, Shqipni, na të kemi nanë.
Besa-besë, një besë kemi dhanë,
për Shqipni jetën duem me dhanë!»*

Shota përcolli në luftë babanë dhe katër vëllezër. Dhe Azemi me dy vëllezërit e rritur më s'kishte pritur.

Vajza ofshani. Radishevës tani po i binte në hise një tjetër gjëmë, djegia e dytë.

Shota me nënën e shumë të tjerë prapë maleve. Shtrëngatat e përgjakshme erdhën njëra pas tjetres.

Edhe Azem Galicën e kapën të huajt. Po trimin nuk e ndryn dot gjatë në robëri. Drenica e torturuar

thërriste: «Djem, më dilni zot!» Kosova e tërë thërriste: «Ngrihuni, bijtë e mi!»

E dëgjonte kushtrimin ai. E kishte në shpirt, në gjak, në mendje. Ditë e natë. Kudo e kurdoherë. Me të jetonte. Dhe iku. Përmes telave me gjemba, përmes breshërisë së plumbave. Pylli i Rudnikut i erdhi në ndihmë. Radisheva e përsëndeti e iu bë krah. Nisi të merrte fluturim heroizmi i tij që na bën të krenohemi.

Shota e priste. Pas gjithë atyre anktheve, vuajtjeve, ai iu duk aq i dashur, aq i afërt, aq i shtrenjtë, sa këtë radhë nuk ia fshehu se e donte shumë, shumë. Pa të nuk mund ta kuptonte më jetën. Ai ishte i dashuri e luftëtari. Përfytyrimi i saj i realizuar më së miri. Nuk do t'i ikte më. Me të, ku t'i thoshte.

Ai tha të martoheshin. Ashtu do të bënin. Babai e gjithë të afërmit s'thanë jo.

E u bë dasma.

Shota u vesh me të bardha. Sa e bukur nusja, aq e thjeshtë dhe e çuditshme dasma. Nuk u dëgjua vaji i nuses që merr një burrë të panjohur, siç ishte zakoni. Nusja shkante tek i njohuri. Ndaj as duvaku, që mbante të fshehtë sflitëse, s'kishte ç'i duhej. Dhe ajo nuk e vuri fare.

Krushq përcjellës: Halil Radisheva me ca të paktë nga të tijtë. Krushq pritës: gjithë burrat e djemtë e Galicës, me ta dhe mjaft trima nga Drenica mbarë, shokë lufte të dhëndrit. Azemi martohet duke qenë i arratisur. Një dasmë «ilegale».

«Të ndëshkohet!» thanë «legalët».

Dhe çatisën në shtëpinë e çiftit të ri. E rrethuan. Krisi pushka nga të dyja anët. Shtëpia u bë kala. Gjithë familja me pushkë nëpër dritaret-frëngji. Edhe nusja. Vetë vjehrra ia dha pushkën.

- Nuse, a di?
- Di, moj nanë.
- Të pastë nana!

Ranë dy vëllezërit, Seferi e Zeneli.

Hovi përpjetë nga dhimbja e tërbimi dhëndri. Hapi një dritare, u hodh në oborr, u përlesh fytafyt me dy

xhandarë e i la shtrirë në vend, u sul më tutje duke sokëllirë me të madhe:

— O, prite Azem Galicën!

I thërriste vetes. Të bëhej më trim. Trefish. Dhjetëfish. U betohej vëllezërve. Nuk do t'i harronte kurrë. Do të merrte hak për ta e për shumë të tjerë. I thërriste Galicës. Të ngrihej e gjitha.

— O, prite Azem Galicën!

Dhimbje, forcë, kushtrim.

Qëllonte nënë Sherifja, pas saj kryetrimi Kurt Selaci, i ati. Qëllonte Shota e me të Halil Sejdia, Radi-sheva, vëllezërit, gjithë trimat e dhomës. Qëllonte Azemi, me gisht në këmbëz qe gjithë Galica.

Ashtu ra mbrëmja.

Xhandarët e ngritën rrethimin. Lufta u ndërpre përkohësisht. Armiqtë i trembi nata.

Nëna përkujdesej për dy djemtë e vrarë.

Zemërforta, e durueshmja nënë e Azemit, nuk e humbi toruan. I tha atij:

— Azem, shko!

Thyer nga dëshpërimi, Azemi e shikonte në sy me habi, mëdyshas.

— Ik, bir. Sa më shpejt, aq më mirë!

Oh, sa ndryshe kjo ikje! Linte në shtëpi dy vëllezër të vrarë e të pavarrosur. Linte nënën në një det gjëme. Linte nusen e re të porsaardhur, kur akoma s'ishte njohur mirë me shtëpinë e re.

Po urdhri i nënës nuk mund të kundërshtohet.

U tha Galicasve:

— Burra, amanet vëllezërit. Të m'i varrosni si u ka hije! Amanet familjen. Ma mbroni nga xhandarët e ligj!

Ai po i shikonte me radhë, nënën, vëllanë e vogël, nusen.

Kur hasi në sytë e tij, Shota tha:

— Unë po vij me ty!

Azem trimi shtangu e u zbeh.

— Ki besim tek unë. Di të luftoj e dua të luftoj!

Dëshira e saj e ngashëreu, po dhe e hutoi. Të merrte

nusen në mal?! Nuk e kishte menduar kurrë një gjë të tillë. Nuk e merrte me mend se nën hijeshinë e nuses së tij të bukur, që ai e donte aq shumë fshihej një burrëri e pashoqe, tok me urtësinë plot ndjesi të femrës shqiptare.

Nënë Sherifja ia nguli sytë nuses. E pa gjatë, dhimbshëm. Mandej u çapit rëndë-rëndë te një sënduk, nxori një palë rroba burrash e ia zgjati:

— Vishi, trimëresha e nanës! — tha. E shtrëngoi në gji dhe e puthi të renë, nusen e malit.

GJERONDAI

M'u kujtua Gjerondai.

Ai nuk është më ndër të gjallët. Pas tij vdiq edhe teto Thomaia. Shtëpinë me ç'kishin i mori i kushëriri, nja dy ara e kopshtin e madh përreth shtëpisë ia patën dhënë me kohë kooperativës. Të dy nuk lanë njeri që t'i ngjallë. Megjithatë s'janë harruar. Gjerondai, njëherë, zor të harrohet. Kur takohem me ndonjë vendas e bisedojmë për fshatin, kur shkoj në fshat, a kur shtrohet diku muhabeti për të, jo rrallë qëllon të zihet në gojë emri i tij.

Për njerëz si ai tregojnë ndodhi të shumta. Gjerondai vetë përpiquej si e si të mbetej në hije, pa i rënë në sy askujt.

Veçanërisht e kujtojnë ata që janë larguar herët nga fshati. Kushedi, nostalgjia e sjell në bisedën e tyre plakun e çuditshëm, po mbase diçka tjetër më e madhe, më e plotë. Njerëzit e zakonshëm të fshatit të dikurshëm i ka mbështjellë mjegulla e heshtjes, dhe e harresës, po hallet e brengat, ndrydhur me të keq nga

sedra e tyre e fortë, kurrsesi. Ato nuk i treti dot dheu, si planditi dot koha... Një portret i gjallë i dhimbjes ishte Gjerondai.

Unë ashtu e mbaj mend: një plak trupmadh, tërë kokalla, veshur me një zhgun të zi prej doku, të zbërdhulët nga përdorimi i shumtë. Në kokë ngjishte njëfarë kapuçi që ishte diçka ndërmjet takijes dhe kamillafit të priftit. Kishte një mjekër të bardhë si më të verdhë, të rrallë, mustaqet si mjekrën, kurse vetullat të zeza e qimeserta. Gropat e syve të tij ishin çuditërisht të thella, po vetë sytë ngjyrë hiri kishin një shikim të butë e si të mekur.

Për ne të vegjëlit ai qe një enigmë, e cila hem na nxiste kërshtërinë, hem na trembte. Shpesh afroheshim me druajtje te kopshti i tij rrethuar me gardh të lartë, thurur ngjeshur e me gjemba sipër, saqë edhe pulat në fluturim nuk hynin dot. Vetë i sillte në krahë purtekat e hunjtë nga korijet dhe gjembat nga përrenjtë e mëdhenj. Vetë e thurte gardhin. Thur e ngjesh me dorë a me sëpatë, ngjesh e rënko, sikur i nxirrte inatin apo një duf të brendshëm dikujt.

Vinim syrin nëpër vrimat e gardhit dhe vështronim. Gjerondai, po të ishte aty, vazhdimisht punonte, rrëmihte me kazmë e bel, po thellë, si të bënte ndonjë gropë. Ne çuditësim me atë lloj të punuari të tokës. Është mësuar me varret, thoshim. Se në fshat ai i hapte varret për njerëzit që vdisnin. Ai shërbente në kishë, nganjëherë fare vetëm, madje dhe natën. Kjo na e bënte edhe më misterioz, edhe më të frikshëm.

Ja, shkoja një ditë pranë kishës. Dera ishte e hapur e unë zgjata kokën. Ç'të shihja?! Në hajatin e gjatë ishin varur një mori lëkurësh bagëtish të ndryshme, përlyer me gjak e pluhur. Gjerondai midis tyre, i kthente mbrapsh e u fuste kleçka nga brenda, që të mbufateshin e të thaheshin më mirë. Ishin lëkurët e kurbaneve për shën Mërinë, që fshati ynë e luste. Ai vetë i kishte mbledhur shtëpi më shtëpi, por, të grupuara të gjitha e varur në çengela në tërë atë hajat, jepnin një pamje të frikshme, më bënin të përfytyroja

djajtë me brirë e pa brirë, me të cilët jo rrallë na trembnin plakat. Dhe Gjerondai në shoqëri me ta, fillikat, tek i ndreqte e përzinte grerat e shumta...

Merret me mend, unë u zbytha e ia dhashë vrapit. I takova shokët e u thashë kështu e kështu. Unë tregoja e ata çapëlonin sytë. Atëherë midis nesh nisi një hamendje e re, që s'kishte të sosur. Pas kësaj, kur e rastisnim në rrugë Gjerondanë, e këqyrnim si njeri akoma më të çuditshëm.

Kërshëria jonë bëhej më e fortë. Thashë që përgjonim nga vrimat e gardhit. Ai rrëmihte e rënkonte. U mëshonte kazmës a lopatës dhe vetiu i shkulej një gulsh nga gjoksi i dobët. O do të më hash, o do të të ha, ia bënte, kur haste ndonjë rrënjë të fortë grematëre.

Përbrenda gardhit, anembanë kopshtit, kishte mbjellë kumbulla gjatore. Ndonjë guximtar kacavirrej në gardhin e lartë, çirrej në gjembat ngulur mbi të dhe arrinte të mbushte xhepat me kumbulla. Po më të shumtët druhashin jo më nga Gjerondai e kopshti i tij, po edhe nga vetë kumbullat. Edhe ato sikur ruanin në vetvete njëfarë misteri. Nuk qenë njëlloj me kumbullat e tjera, që gjendeshin më të rrallë në fshat. Pemët kishin vajtur deri në njëfarë vendi e s'rritëshin më, si mjekra e të zot. Shumë të verdha, me kokrrat e vogla e tulforta, ato ngjasonin me tespihe qelibari. I kafshonim nga pak ato që na jepte shoku guximtar dhe i shihnim me sytë katër, a thua se e fshehta do të dilte si pleshti i përrallës nga ai tul kumbulle që, megjithatë, qe i shijshëm e nuk të velte kurrë.

Shpesh pranë tij shikonim teto Thomainë. Edhe ajo gjëllonte, o duke i ndihur Gjerondait në kopsht, duke mbushur ujë, o diku gjetkë. S'i kisha parë kurrë duke ndenjur as njërin, as tjetrën. E shumta, kur qëllonte ta takoja ndonjëherë në rrugë, teto Thomaia vinte duart mbi shkop e mbështetej si në një parmak dhe, ashtu e gërmuqur, lëshonte ndonjë fjalë, që më ngjante si gjëa-gjzë.

Njëherë i pata parë nga Përrenjtë. Teto Thomaia

korrtë fier, Gjerondai e shpinte me krahë në shtëpi. Unë kisha hipur në një mollçinë aty afër. Zgjidhja ndonjë kokërr të verdhë dhe e haja, po më tepër bëja sehir. Teto Thomaia erdhi nën mollçinë.

«Dridhe njëherë, ama shumë, hë, bir», më tha.

Unë e drodha mollçinën e dheu u mbush plot. Ajo i mblodhi në përparëse.

«Po këtë fier ç'e doni, moj teto Thomai?» e pyeta.

«Fierin? Për dimër e duam. E hanë bagëtia, e ç'të ngrënë. Siç hamë ne mollçinat. Ja, ti tashti ha një e rrëzon përdhe dhjetë. Po në dimër, ku t'i gjesh? Dimri, djalë, ha edhe hedhurinat e beharit!»

Sapo vajta në shtëpi, nuk m'u durua pa i treguar nënës:

«E di si më tha teto Thomaia?»

«Cila teto Thomai?»

«E, moj, nusja e Gjerondait!»

«Nuk e ka nuse!» ma priti shkurt ajo.

Dhë kështu, dora-dorës e fshehta shtohet më tepër e s'jepej. Gjerondai e teto Thomaia vërtiteshin në qerthullin e saj, e ne s'e kapnim dot. Po me kohë e kapërcyem fëmijërinë. Atëherë kjo e fshehtë tunduese mbeti si një ëndërr e vagëlluar, të cilën nuk e kujton asnjëherë të plotë, por as nuk e harron krejt.

Në të ri të tij Gjerondai thirrej Spiro. Që djalë i fortë. Punëtor e kursimtar, bëri çmos ta martonte me nder të motrën, Thomainë. Po hyri në borxh e s'e lante dot. Nga kjo mori udhën e kurbetit. Punonte e kursente shumë edhe në kurbet e zuri ca para. I lau borxhet, vazhdoi të punonte për të vënë mënjanë diçka e pastaj të kthehej në fshatin e tij, në Poloskë. Meqë i vajti mbarë kurbeti (në një letër, së motrës i shkruante se i kishte ecur fati), i blatonte një shumë të hollash mitropolisë. E bëri këtë me gjithë mend, me besimin e njeriut që s'arrin t'ia kuptojë ndryshe veç si ndërhyrje të «zotit fuqimadh», si mbarësinë, ashtu dhe prapësinë.

Pra, pas ca kohe mendoi të kthehej e ta ndërtonte ndryshe jetën. Do t'i ndihte edhe motrës, që nuk po e

shporrte dot fukarallëkun. Patjetër do t'i ndihte. Njeriu prandaj ka keq për të afërm.

Gjithë rrugës me këto mendime. Dhe rruga me vapor nga Amerika në Itali, pastaj nga Italia në Greqi e që këtej me makinë a më këmbë në Shqipëri, zgjati tre muaj e ca. Tre muaj janë goxha kohë, e në kaq kohë mund të ndodhin shumë gjëra.

Pa u nisur nga Amerika, me të marrë letrën nga motra e i kunati, u kishte kthyer përgjigje e u thoshte që të mos i shkruanin më, pasi së shpejti do të nisej. Por, kur hyri në shtëpi, motra e priti me kujë, veshur në të zeza. As kunati, as fëmija e tyre e vetme nuk u dukën. Burri kishte vdekur në mal, goditur nga mushka xanxare. Fëmija që sëmurrur dhe ashtu...

Nuk që nevoja të shkoqiste shkakun. Dukej sheshit. Shtëpia ngjante e ronitur e tëra, varfëria, shtruar këmbëkryq në çdo skaj. Jo, kaq keq kurrë nuk ia kishte shfaqur gjendjen e motra në letrat që i dërgonte. Ndofta që të mos e shqetësonte. Dhe ai e kuptoi pa ia thënë ajo: djali i saj kishte vdekur nga skamja.

Iu mblodh një komb në grykë e as fliste dot, as qante. S'vuri kafshatë në gojë e gjumë në sy atë natë. Vetëm dëgjonte. Dëgjonte historinë e dhimbshme të mynxyrës dhe shihte gjurmët e saj në fytyrën e së motrës: zbehtësi, rrudha, sytë me rreth mavi. Ajo ishte plakur para kohe. Dëgjonte e shikonte dhe një peshë i ngjishte gjoksin. E sfiliste. Diçka e shtrëngonte në fyt, truri i trazohej. I vinte të pështjellë dhe i hipte të nxehtët. Pse, xhanëm, pse? Ç'gjynahë kishin bërë që t'u binte mbi kokë një mynxyrë e këtillë? As zotit, as njerëzisë nuk i patën bërë kurrë keq. Atëherë, pse?

Pyetjet i vinin në kokë bashkë me një ngashërim të brendshëm. Ndaj nuk e zinte gjumi. Ndaj nuk tha asnjë fjalë. Ku shpresat e dëshirat dhe ku ajo që gjente! Rrëzuar të gjitha, gremisur përnjëherë, si shkundet një shtëpi nga tërmeti. Ai e shihte veten përfund gërmadhve.

Zunë të vinin njerëz për ta parë. Më të shumtët për

ta ngushëlluar. Ndër të parët kryeplaku. Si njeri që është mësuar të thotë fjalën kapak, u ul në bash e ngriti sytë nga kurbetlliu:

«Spiro, bëj gajret! Kjo botë kështu e ka. Të përndisë jemi, ajo na sjell, ajo na merr. Po ti shyqyrerdhe shëndoshë e mirë e do t'i vësh krahun shtëpisë dhe motrës së përvëluar.»

Kurbetlliu asnjë përgjigje. Më të rrallë tundte kokën. Zor ta merrje për pranim atë shenjë. Zor ta merrje për kundërshtim. Një gjë e papërcaktuar. Atij i bëhej se që në një ëndërr të llahtarshme. Nuk po e mbliidhte dot veten nga e papritura. Nuk çlirohej dot nga mendimet e trazuara. As nga ato psetë që i lindnin midis mendimeve. Bile nuk shkëputej prej tyre as kur i flitnin të tjerët. Dëgjonte e s'dëgjonte, shikonte e s'shikonte, ishte e s'ishte aty.

Të nesërmen kryeplaku i bëri një vizitë të dytë. Kësaj here ai shpejt e çoi fjalën te premtimi i Spiros për kishën.

«Zoti i vë në provë njerëzit, po nuk i braktis, tha. E njerëzit lipset t'i kryejnë gjer më një detyrat e blatimet, ndryshe...»

«Nuk i braktis? Lëre, lëre!» mendoi tjetri. «Po ç'është kjo që bëri me ne, si t'ia vësh emrin?» dhe fill pas kësaj mendoi një gjë rebeluese për zotin vetë: «Unë me bukë, ai me gurë!»

Përnjëherë ndjeu njëfarë frike, një si pendim. Rrahu ta kthente prapë mendimin, por ai tanimë kishte dalë. Megjithatë kryeplakut nuk i tha asgjë të qartë. Përgjigjet e tij shpreheshin me ca fjalë a pohime të mjegullta vetëm me kokë.

Ndërkohë, vetë, aty e kishte mendjen. Ca nga tronditja dhe ato psetë sfilitëse, ca nga gjendja e gjërave që, kur të vijnë përpara, s'ke fuqi t'i largosh. Shtëpia duhej bërë nga e para. Ekonomia duhej zënë për së njëzi. Po t'i jepte kryeplakut ç'i kishte taksur kishës, mbetej trokë. As shtëpi, as katandi s'ngrinte më. Kjo e vërtetë lakuriq ia ftohu trurin. Një pendim i thellë për premtimin e përshpejtuar e mundonte si

brengë. Mirëpo dikur tërë hamendjet e mundimet shpirtërore dolën në një pikë të vetme: ai i kishte blatur zotit për mbarësi, zoti i kishte dërguar prapësi. Pra, nuk i mbetej borxh. Një me një ishin.

I tha kryeplakut që do ta shtynte më tej blatin.

Po kryeplaku qëlloi kokëmushkë, si kryeplak. Ç'po bënte vaki kësisoj?! Blatimi është blatin! Do shpënë në vend. Patjetër! Ai, si kryeplak, po të mos çalltiste për këtë, mbante mbi vete mallkimin e zotit, po linte të dilte nga udha e tij një të krishterë të mirë. Jo, punë që s'bëhej!

E iu qep. T'i jepte, dhe sa më parë. Mos ia shpinte punën me të keq.

«Ç'është kështu, gjënë time të marrësh me zor?!»

«S'është jotja, e ke blatur.»

«De, or hall, de!»

Shkurt, kryeplaku, i nxitur nga prifti, që vetë nuk dilte sheshit, po ia nxinte jetën më keq nga ç'i ishte nxirë, nuk e linte të ndërtonte shtëpi, s'e linte të blinte gjëkafshë, një arë a një bagëti.

Kishte një mik në Ziçisht, në atë fshatin rrëzë malit. U ngrit e i vajti natën, fshehurazi, që të mos e pikaste kryeplaku. Atij ia qau hallin. U mendua gjatë miku. E pleqëroi hallin e Spiros me bashkëfshatarë të urtë. Të vente atje, i tha ai.

Spiroja ngazëlleu. Iu përtërinë fuqitë. Më t'iu përvesh punës si dinte vetë dhe ndërtoi një goxha shtëpi mu në këmbë të kodrës, atje ku i dhanë vend. Shtëpinë e bëri të madhe jo aq nga nevoja apo nga ndonjë mendim për të pritmen, po vetëm që të mos e turpëronte mikun. Se ç'qefil mund të zihej ai për një punëzi e tragëzi? Të mos mblidhnin buzët për të bashkëfshatarët e rinj, të mos pendoheshin që e kishin pranuar në fshatin e tyre.

Po ne e patëm gjetkë fjalën: ajo shtëpi e re dhe e madhe ia gëlltiti si llamje tërë paratë, vuri borxh pothua aq të tjera e prandaj një ditë u gjend prapë në kurbet.

Sërish si më parë: punë sa për tre, shpenzime sa për gjysmë njeriu. Hë-hë, qesja po mbushej. Shkoi një vit, shkuan dy e tre. Borxhet i lau. Qesja nuk iu zbraz krejt. Puna i ecte, ndaj nuk u shpejtua ta linte. Le të mbushej edhe ca! Atëherë vinte me mendjen top në fshatin e ri, ku e priste motra dhe shtëpia e re e bardhë, që nga jashtë dukej si pallat.

Në kthimin e dytë zbriti në Selanik. Gjëja e parë ishte të zinte trenin për Follorinë! Që atje pastaj shkonte më këmbë. Nuk po mësohej dot me qytetet e mëdha. U druhej, ngaqë e dinte se rëndom gjendeshin në to lloj-lloj maskarenjsh, që nga hajdutët e deri te vrasësit.

Treni ishte më të nisur. Ai pati frikë se mos mbe-tej pa hipur dhe nxitoi. Në nxitim e sipër nuk pati kujdesin e duhur e u përplas keqas te shkallët. Iu errën sytë e ra pa ndjenja. Dikush e tërhoqi, ndryshe do të rrëshqiste nën rrota. E çuan te një mjek, i cili e operoi që atë çast.

Kjo që një ndodhi shastisëse. Dergjej në një shtrat të fortë, po ku? As vetë e dinte e as dëshironte ta dinte. I rëndej vetja, nuk mendonte fare, e kishte pllakosur një ndjenjë apatie për çdo gjë e për këdo. Për ku rendte ashtu si i marrë? Në fshatin e ri? Në shtëpinë e re? Tek e motra? Te diçka ende e panjohur që e dëshironte pa e ditur se ç'që? Pesë me hiç të gjitha! Tanimë i dukeshin të largëta, të huaja, të papërfillshme.

«Ta gjesh nga s'e pandeh!» ia bënte ndonjëherë, sikur kishte parasysh fatin e një tjetri. Dhe s'i vinte keq asfare. Fundja, e përse? Kështu që e thënë!

Fatkeqësia e re e bëri pessimist. Kur e kur e shponte një ndjenjë frike e dyshimi. Edhe më parë e kishte provuar këtë ndjenjë, që e kishte zanafillën te blatimi dhe veprimi i tij i kundërt. Po e kujtonte shpesh e më shpesh dhe nisi t'i fiksohej në kokë se ajo që i ndodhi ishte një ndëshkim. Për çudi, qëndrimi ndaj atij ndëshkimi ndryshonte në çast. Herë e quante hata e merrte inat, herë e gjente me vend. Atëherë i dukej

se ai ndëshkim qe një paralajmërim. Gjynahu i tij meritonte akoma më tepër.

Në një përfundim të tillë e nxiste mjeku, i cili e dinte që i gjymtuari kishte me vete mjaft para. Ai çdo ditë i mbyllte plagën e trupit dhe i hapte atë të shpirtit. Njëherë, si rastësisht, ai tha se njerëzit që e ndienin shumë mëkatin, shkonin në Malin e Shenjtë. Të vinte në Ajnoro? (Kështu i thoshin Malit të Shenjtë në fshatin e ri.) Të bëhej murg e ta ngryste jetën duke lypur pendesë?

Spiroja e dëgjoi mendimin, në fillim, pa i dhënë rëndësi. Por dora-dorës që i përsëritej, zuri të mësohej me të. Motra? Ajo kishte fatin e vet, ai të tijin. Asnjëri për t'u dëshiruar.

Kur u ngrit nga shtrati, nuk kishte vendosur ç'do të bënte më tej. S'rastisi në njeri që t'ia nxiste dëshirën për ta jetuar jetën me të mirat e të këqijat e saj. Mjeku e kishte zhvatur paq. Qyteti e trembte. E ardhmja ca më shumë. Dhe kështu, me një plogështi e mos-përfillje për veten, ndërroi rrugë: në vend të shtëpisë së re, zgjodhi manastirin e vjetër në Malin e Shenjtë, në vend të bashkëfshatarëve të rinj, atë të murgjve hijerëndë.

Po më parë iu desh të merrte një mësim ngulitës: këtej e tutje nuk do të kishte të bënte më me jetën dhe punën e të vdekshmëve. Ai s'kishte më të afërm, veç zotit e shenjtorëve dhe sivëllezërve të të njëjtit qëllim. Nuk kishte më as pasuri, asgjë të vetën, veç zhgunit e këmishës që mbante në trup. Nuk duhej të mendonte më për botën mëkatare. Zemra e shpirti i tij do të drejtoheshin nga jeta e amshuar, e cila vinte përmes vuajtjeve të trupit dhe harrimit të vetvetes. Që t'i bënte të vetat sa më shpejt e lehtë të gjitha këto, emrin Spiro ia zëvendësuan me Silvestro dhe qesen me para ia derdhën në arkën e manastirit.

Do të shkonte gjatë, po të tregoja si e qysh nisi ajo jeta e tij në manastir. Kurbetilliu i shkretë e pati shumë zor të harronte emrin e vet, gjithë njësoj edhe qesen me para, që ia përllanë me një shpejtësi stuhie. Ky

veprim i dyfishtë që njëfarë shkundjeje e parë nga apatia që e kishte pllakosur. Ishte mësuar ai me emrin e vet. Nuk i ishte ronitur ai emër për ta hequr si një rrobë të vjetër. Ishte mësuar edhe me qesen. Kur i mbledh paratë çikë e nga një çikë, një njeri si ai mësohet aq shumë me to, saqë tërë mundimet i përmbledhen në atë qese. Nga kjo i bëhet zakon ta mbajë me vete kudo që shkon. Ai e varte në qafë e e fuste nën fanellë, ngjitur me trupin, që ta kishte përherë pas.

I zhveshur papritur e përnjëherësh nga dy pasuritë kryesore, i bëhej se e kishin zbritur nga kali në një vend të shkretët, të panjohur, pa ditur nga t'ia mbante.

Për të, manastiri i huaj, murgjit të huaj. Asgjë s'gjente sadopak të njohur a të afërt në vendin e ri. Nuk i bënëin përshtypje pyjet tumbë me gështenjë, selitur për merak, as brigjet e detit, aty të thyera, këtu të buta, që në një kohë e vend tjetër do t'i kishin pëlqyer së tepërmi. Mendje e zemërtopitur, bënte ç'i thoshin, pa u ankuar për asgjë e pa kërkuar gjëkafshë. Igumeni e caktoi të punonte në vreshtin e manastirit. Këtë e priti si njëfarë ngushëllimi. Do të rronte me vetveten. Krahët i kishte të fortë e punës nuk ia përtonte.

Tok me të punonte dhe një tjetër. Ky kallogjeri tjetër që njeri i heshtur. Spiro-Silvestroja ia diti për nder që ai nuk e mërziste me fjalë e pyetje. S'donte t'i trazohej njeri në mendimet e zgjuara nga plogështia, po të zhytura diku pa shpresë daljeje. Njëlloj si të kërkosh një kovë të rënë në një pus të thellë, të cilën kërraba s'e zë dot.

Punonin e jetonin secili më vete, paçka se u duhej të kryenin ritet e manastirit me një rregullsi sahati: dëgjimin e meshës në gjunjë, duke u falur, ngrënien e përkorë, duke dëgjuar psalme. Hera-herës Spiros i shkulej nga kraharori një gulsh i gjatë e i thellë. Murgu tjetër e shikonte me ca sy të çuditshëm, ku ndihej një qortim i heshtur, i përzier me kërshtëri e frikë. Ai

bënte të thoshte gjësendi, po shpejt pendohej, mandej ulte kokën dhe kur e kur gulshet e rishtarit i përcillte me psherëtima të përmbajtura. Në këto çaste Spiroja e shikonte një copë herë të mirë dhe e maste me sy. Tallet tjetri me të, apo i qante hallin?

Në këtë mënyrë të heshtur e njohën ata të dy njëri-tjetrin e u bënë miq, aq sa mund të kuptohej miqësia në atë vend, ku rregullsitë e jetës së zakonit përcudnohen gjer në atë pikë, saqë vetë jeta shndërrohet në një rit e aq. Se si ndodhi një ditë që heshtja e tyre u gris e u derdh një bisedë përvëluese si një rrëkezë llave.

«Pse erdhe këtu?» pyeti murgu.

«Të shenjtërohem», u përgjigj mekanikisht Spiro-Silvestroja.

«Dua të shenjtërohem, po s'më lënë djajtë! E di?»

«Jo, ç'do të thotë kjo?»

«Shkon në Selanik një murg. Me të dhe gjerondai. Ti e di që gjerondai do të thotë plak i urtë, dhe këtu kështu i thërresin kallogjerit më të ndershëm. Sheh çupa e gra të reja murgu, bën t'i heqë sytë e s'i heq dot. E vë re gjerondai e shqetësohet. Ato janë satanai vetë, i thotë, mos i shiko! Ti duhet të shikosh vetëm zotin. Satanai qenka i bukur, gjerondai, e më pëlqeka. Zotin s'e kam parë e s'e di si është. Ngri sytë nga qielli, o mëkatar i perëndisë, e urdhëroi plaku. Ti ke veshur këtë rrobë që të shenjtërohesh. Murgu s'pati fuqi të bënte ndryshe e ia ktheu: Dua të shenjtërohem, o atë, po s'më lënë djajtë!»

Spiro-Silvestroja dëgjoi në heshtje, po nuk qeshi, siç priste tjetri. Ky u vrenjt.

«Rrëfenja përdoret rëndom për të thënë që shenjtërimi është një gjë... hiçgjë!»

Këtu murgu i ri ngri kokën. Tjetri dukej sapo e kishte nisur bisedën, se pyeti:

«Ç'ke bërë në jetë?»

«Hiç, kam punuar.»

«Tjetër?»

«Asgjëkafshë.»

«Po ç'mëkat të shtyu të lije jetën e të mbyllesh këtu?»

«I blatova zotit ca para e nuk ia dhashë kishës.»

«Vetëm kaq?!»

«Të vërtetën thashë.»

«Paske qenë i marrë!»

«Si, si?»

«Qenke i marrë, them. Pse, vihet këtu për kaq gjë?!»

«Po përse vihet?»

«Për shumë e shumë më tepër. Tërë ç'sheh këtu, janë ca biçimër, që jeta i pati nxjerrë në mezhde e s'i qaste më. Disa kanë ardhur që t'i shpëtojnë hap-sanës për krimet e shëmtuara që kanë bërë diku, se këtu s'i zë ligji. Këta janë më të ligjtë. Ngrysin ditët me veshjen e murgut, po nga e tyrja s'heqin dorë e bëhen makutë, hileqarë, pederastë. Ca të tjerëve, se e mbushën kupën me zullume e s'u mbante më, ndaj jeta u qe pështirosur. Këta rrinë si të venitur, s'çajnë kokën për asgjë. Disa të paktë, me besimin e verbër të shenjtërimit. Nga këta dalin ashkëtinjtë. Ke parë ashkëtinjtë?»

I kishte parë. Ngujuar në shpella, veçuar nga çdo gjë, ditë e natë duke u lutur. Pa shtresa, pa mbulesa, veshur me leckë. Kohë më kohë u lëshonin para guvës ndonjë krodhe peksimet e një sapllake ujë. Ata s'përgjigjeshin dhe qe e kotë t'u flitje. Po ai që vinte aty, as që kishte qejf të fliste nga krupa që provonte.

Murgu u mënjanua, sikur t'i kishte thënë të gjitha. Iu desh Spiros ta pyeste:

«Po ti?»

«Çfarë, unë?»

«Pse u bërë murg ti, kur m'i ditke gjithë këto fëlliqësi?»

«Unë?... Mos m'i hap plagët, o njeri i mirë!»

Ai u mbështoll me zhgunin e lerosur, kryqëzoi duart e u thye më dysh. Ishte e qartë që nuk do të fliste më.

Spiros sepse iu dhimbs edhe ai, edhe vetja. Pezmi

ia shtrëngoi zemrën e iu shtri në qenien e tij si një re murrashe dhe e plogët. Monotoni, kotësi mbushur me psherëtima pendimi. Po aq duhet, sa të ngacmohet sadopak gjendja e plogët. Si atëherë kur hapet një portë që ka ndenjtur për një kohë të gjatë e mbyllur. Ti ke parë veç masën e dërrasave puthitur me njëra-tjetrën, por, sapo kërkëllin çerçiveja, vëren në brendësi një korridor, një derë tjetër, një dhomë, një...

Ishte akoma i ri dhe e tmerronte mendimi se do të duhej të kalonte aty, në një vagëllim ndjenjash e dëshirash, ndofta nja tridhjetë vjet. Bobo, ç'kishte bërë!

«Eh, o i mjerë! Matufepsesh nga dëshpërimi, të bëhet mendja dhallë dhe vete i bie murit me kokë. Kur ndien dhimbje, vjen në vete, po sa para bën?»

Nganjëherë i bëhej se ai gadishull me një emër të lakmueshëm për njerëz pendestarë, ku çdo shtet me fe ortodokse kishte manastirin e vet, nuk ekzistonte realisht, por qe pjellë e një përfytyrimi të dalldisur. Jeta përtej tij, sado e keqe, sado e mundimshme, të paktën kishte shpresën për shoqëri e njeriu jepej në ndjekje të saj dhe s'i rëndej vetja. Kurse aty... Shtëpia, fshati, motra, që atje larg sikur e thërritnin: «Ku je? Pse s'vjen?» Atë e përvëlonte dëshira për t'i parë rishtas, mirëpo... kjo nuk varej më nga ai.

Brerjet e ndërgjegjes ia bënin jetën në manastir edhe më të mërziqshme. Po vetëm kaq. Vetëm kaq? Shpesh e shkante ndër mend këtë pyetje dhe tërhiqej i trembur.

Një ditë igumeni e mori si shoqërues për në manastirin fqinj. Spiro-Silvestroja i vuri velenxën mushkës më të shëndoshë dhe e bëri gati që të hipte igumeni. Kur ky hipi, mushka rënkoj e vari trupin si t'i ishte thyer kërbishtja. Edhe igumeni rënkoj, pasi samari mezi e nxinte.

Rruga kalonte afër spileve ku rrinin asketët. Njëri nxori kokën si spiun. Igumeni sikur s'e pa. Befas Spiro-Silvestroja përfytyroi një lisharës të madh dhe tërë asketët, me mend i vuri në njërën anë, në tjetrën igumenin. Igumeni i ngrinte asketët në hava.

Spiroja në fillim qeshi me vete me përfytyrimin e çuditshëm, pastaj u vrenjt. Krahasimi ia zvetënoi të dyja palët dhe pati frikë se mos bënte ndonjë gjë të padëshiruar, ndaj eci kokulur. Po ja tek u duk manastiri fqinj. Mushka qëndroi e mori frymë thellë, igumeni zbriti me të keq. Një murg i ri, me faqe të njoma si vajzë, se nga doli me të shpejtë e zuri t'i përgjerohej igumenit.

Spiro-Silvestroja u mor me mushkën. Ia fshiu kurrizin e djersitur. Këtë punë e bënte më nge e me qejf. Pastaj tha se do të ishte mirë ta pyeste igumenin në do të ktheheshin shpejt, që të dinte ç'ta bënte mushkën.

Kur u kujtua ai, igumeni nuk dukej gjëkund. Kërko këtu e kërko atje, më në fund shtyu derën e një kthine të veçuar dhe menjëherë zuri kokën me dorë e u zbraps i tronditur.

«Zot, më ruaj mendjen!» ia bëri e rendi të fshihej pas mushkës, si të ishte ai vendi më i sigurt.

Dhe atje, i strukur pranë saj, zemra e mendja i morën vrull e s'dinin të ndaleshin. Igumeni me atë murgun e lapardhosur... Gjer këtu?! Nuk do ta besonte kurrë, po të mos i shihte me sytë e tij. Por kjo... kjo... këtë s'e ngrinte kandari. Gjer këtu?!

Bisedonte me veten, pyeste e përgjigjej, hutohej e trimërohej. Pastaj mori një vendim. Ishte një vendim i prerë, i guximshëm, i dëshiruar me kohë, po që pas-kësh dashur veç një shtytje... Meqë guximi do edhe mençuri, ai u tulat mbi një gur dhe ndenji në pritje. Askush nuk mund të diktonte tek ai njeriun e rebeluar. Edhe igumeni vetë, pak më vonë, i hodhi një vështrim të vëngër, po nuk pikasi gjë të dyshimtë.

U vunë prapë në udhë. Igumeni në mushkë, murgu pas, në këmbë. Kur e kur e hiqte mushkën për kapis-talli. Përpëlitjet shpirtërore nuk e mundonin më. Në të kundërt, ndiente dëshirën për hakmarrje: këta ishin të poshtër! T'u sillej pa mëshirë! E patën gënjyer? T'i gënjente dhe ai.

Kur po shkonin pranë një qimitiri, Spiroja, gjithnjë kokulur, si një murg i përvuajtur, tha:

— Kam lënë një shtëpi atje tej... S'di në i takon manastirit, meqë unë pëlqeva të bëhem murg, apo fshatit ku gjendet. Vetë nuk i kam dhënë dot karar.

— Manastirit, o i bekuar! Qysh e vënke në dyshim ti?

— Shtëpia është në fshat, e fshati larg.

— Shtëpia shitet e bëhet para.

— E, ashtu, dhe andej kushtojnë, po ja që...

— Mos e sflit shpirtin, o i bekuar!

— E ç'të bëj tjetër? Shtëpia është larg.

Igumeni picërroi sytë. Ai vuante nga mania që ta bënte manastirin e tij më të pasurin e më të dëgjuarin dhe kështu të ngrihej në shkallën e hierarkisë fetare. Raste të tilla nuk donte t'i linte pa shfrytëzuar.

— Shko e shite dhe eja prapë, — tha.

— Nuk mëkatoj?

— Jo, nuk mëkaton. Shite dhe eja shpejt! Shko!

Atë ditë në skelën e vogël të manastirit po ngarkohej një maunë me qereste. Ai hipi në të dhe u nis pa humbur kohë. Me të dalë në stere, rrëmbeu një gur të madh dhe e hodhi prapa. Nuk do të kthehej më, sikur zvarrë ta hiqnin!

Pastaj, ik të ikim! Me tren? Me makinë? Jo, o njerëz të mirë! S'kishte durim. Po dyshimit, kësaj fare të keqe ç'ti bënte? Ndaj, ik të ikim! Më këmbë, duke iu mënjanuar kalimtarëve. Ku ngrysej, nuk gdhijej, gjithnjë i shoqëruar nga frika se mos igumeni ia kish-te pikasur mendimet a pendohej dhe dërgonte kallogjerë apo korofillakë që ta kthenin. Dhe, keni parë ju? Kjo frikë i shtonte forcat për të ecur e i pakësonte lodhjen e urinë.

Kësisoj u kthye sërish në fshat, pranë së motrës, e cila e kshte qarë për së gjalli.

Prapë them se do të vente gjatë të tregoja habinë e fshatit për kthimin e tij të çuditshëm. Ditë të tëra ai s'e kapërceu pragun e shtëpisë. I vinte zor nga njerëzit. I vinte turp e s'e kuptonte nga se më shumë.

Për atë, që i qe rrumbulloshur mendja e ishte veshur kallogjet, apo që iku nga manastiri, gjë kjo fare e pazakontë. Në vetvete ndiente edhe frikë, edhe turp, veç jo pendim për hapin e dytë. Në çaste të kthjellëta tërë qenia e tij synonte në një drejtim: të mos e kthenin në atë burg të shpirtit që e kishte emrin manastir. Prandaj s'dilte fare. I bëhej që ja, sa të shkelte përjashta, do ta rrëmbenin për ta çuar atje. Kush? Kushedi. Ndofta ndonjë xhandar, ndonjë... Në përfytyrimin e tij përziheshin igumeni e kryeplaku, korollofillakë e xhandarë, bëheshin një të gjithë e i përhiheshin si ca stihi që prisnin te gardhi përtej oborrit.

Do të thoni që qe frikaç? Jo, aspak. Por qe njeri i padjallëzuar, jo fort i ditur dhe veprimi që kishte bërë me aq vrull, tani, pasi qe kryer, e shqetësonte. Lohja e mundimi i ditëve të tëra që kaloi udhë e pa udhë e kishin çuar në një gjendje shpirtërore gati të sëmurë.

Po koha ka sheshuar gjëra edhe më të tmerrshme. Kur erdhi e diela dhe tingëlluan këmbanat, ai u drodh. Një çast kujtoi se binin pikërisht për të, si një hakmarrje e zhurmshme. E motra, që diçka rregullonte në kamaren e ikonës, qëndroi para tij e habitur.

— Ç'pret, nuk do të vish në kishë?

— Në kishë?!...

Ai u përmend. Si ta shmangte atë pyetje aq të thjeshtë? Si t'ia bënte shikimit të butë të së motrës? Dhe më tej, ç'shpjegim t'i jepte fshatit në gjithë të dielat që do të vinin, në gjithë të kremtet fetare? Që-kurse e hodhi atë gurin e madh në detin Egje, sikur kishte hedhur tej edhe urën që e lidhte me zotin e kishë. Po s'qenkësh aq e lehtë. Mirë me zotin e kishën, po me njerëzit, si të bënte me ta?

Për të mos ia prishur së motrës, u ngrit e vajti. Pa qejf, pa shpirt. Zuri një qoshe e ndenji duke mposhtur atë vrundull shikimesh që ment e përpinin. Sikur vinte nga bota tjetër! Po ja ku iu afrua epitropi e i tha që gjerondai e kishte vendin pranë priftit, si ndihmës i tij. Që nga ai çast iu ngjit përjetë edhe

emri Gjeronda, edhe puna e të shërbyerit në kishë. Shpejt e pa se ky shërbim qe një mjet për të mënjanuar çdo telash të mundshëm, si dhe për t'iu shmangur kërshtërisë e qortimit të dikujt. Nuk shkonte më tej gjykimi i tij.

Për punë i hanin ɥuart. Donte të punonte. E zinte punën e s'dinte ta ngrinte kokën. I thoshte prifti a epitropi:
— Merr ndonjë pare, Gjeronda. Se shpirt ke, po dhe trup.

— He — he! — ia bënte ai e fytyra i ngërdheshej, varte vetullat e nxirrte përpara dorën me gishtërinjtë tërë gunga, që s'i shtrinte dot plotësisht, si ta pengonte diçka.

Paret e kishës ishin pako gjë. Për të rrojtur nuk mjaftonin. Deri atëherë motrën e kishte mbajtur mëshira e njerëzve të mirë. Me të ardhur ai, ajo reshti. Duhej mbajtur dhe motra. Dhe ta mbante një çikë mirë, se shumë kishte vuajtur e qe plakur e kërrusur, sa të dhimbsej ta shihje.

Iu qep kodrës ranore ngjitur me shtëpinë dhe bëri atë kopshtin e madh me mollë e dardhë, ftonj e kumbulla gjatore. E mbillte me qiçra, buxhak e fasule. Pa hapi dy ara në Përrenjtë, vend qosele, ku mbinin veç uthka e bar pate, e i mbolli me grurë e thekër. Më parë i punoi, si nuk kishte punuar njeri në fshat. Qilizmë të gjithë tokën. Me krahë. I qarkoi arat me hendekë e gjemba që të mos ia dëmtonin bimën bagëtia, mblodhi nëpër lëndina bajga e pleh të grumbulluar prej kohe e ua hodhi të mbjellave. Kur erdhën të korrat, gruri e bëri kallirin peshk, thekra ca më tepër. Gjerondai e sheshoi udhën deri te lëmenjtë, që kuajt e ngarkuar me duaj të mos troshiteshin e ta shkërmoqnin grurin, dhe ferrat anash të mos i vidhnin kallinj. Bënte dhe punë të tjera në fshat. Bleu një gomar të fortë e mbartte me të pleh për ato shtëpi që i kishin burrat kurbetit. Nuk hynte kurrë në pazar, sa t'i jepnin.

Dhe kështu. eja ditë e shko. Gjerondai veç në punë. E shtrëngonte kaq nevoja, apo frika për afrimin e pleqërisë, që çdo i moshuar e druan e e mendon? Një gjë e them me bindje: i pocaqisur nga ligjësitë e një

kohe kur ligësitë bënin ligjin, ai gjente kënaqësi vetëm në punë. I pazoti të krijonte jetën, se kishte mbetur i gjymtuar, ai krijonte nëpërmjet punës. Dhe nëse e punonte thellë tokën, nëse e plehëronte e i qarkonte të mbjellat me hendekë e gjerdhe të mos i dëmtoheshin, provonte kënaqësi të veçantë tek shihte bimën të mbinjte e të hidhte shtat, sythet e pemëve të çelnin lule e pastaj kokrra e këto të rriteshin e të piqeshin ngadalë, nën mbikëqyrjen e tij të përhershme. Ai fliste me to si me fëmijët, u gëzohej atyre si të ishin fëmijë.

Fshatarët s'e përfytyronin dot në gëzime. Po a dinte të qeshte, vallë? Kur në të vegjëlit e hasnim rrugës, na gozhdonte në vend, në fillim frika për qenien e tij enigmatike, pastaj ndryshimi i habitshëm i fytyrës së tij. Tërë tiparet i zbruheshin vetiu, sytë i bëheshin të butë e shikimi vaj.

Më vonë e pashë një herë në dyqanin e fshatit. Shitësi tregonte një ndodhi me kripë. Gjerondai e shihte në sy e në gojë dhe qeshte duke bërë: «He-he-he!»

Tanimë nuk punonte dot. Në fshat që ngritur kooperativa. Atij i jepej një ndihmë e përmuajshme prej saj dhe ca kursime po i kishte mënjanë e nuk i trembej pleqërisë. Po të ndenjurit pa punë e mërziste. Këtë mangësi e plotësonte ndryshe. Dendur shkonte në ato vende ku mblidheshin njerëzit. Ai, që një jetë të tërë kishte ndenjuri i veçuar prej tyre, tani s'bënte dot pa ta. Rrinte midis të rinjve dhe dëgjonte kur flitnin për filma e ngjarje të tjera të gëzueshme. Gjithnjë i vëmendshëm e me një kënaqësi gati fëmijërore. Qeshte tok me ta. Ia ngrohte shpirtin jeta e tyre, e qeshura dhe gëzimi i të rinjve. Këto ishin ca ndjenja të këndshme, shumë të këndshme, dhe të pashijuara më parë. Ai u dha pas tyre e pleqëria nuk i rëndej.

Vetëm në vitet e fundit të jetës fshati e njohu atë dhe si njeri me kërkesa shpirtërore. Ndofta prandaj në përfytyrimin e bashkëfshatarëve ai është njeriu që jeta e handakosi, po s'e vuri dot poshtë. Ai ngriti krye ndaj prapësive të kohës-mynxyrë i ndihmuar nga puna. Tek ai koha gdhendi një pjesë të vetë fshatit të dikurshëm.

30, VJESHTË E DYTË 917

Befas era shkundi fort dritaren. Një fletë pjer-gulle, ndjekur nga dy-tri pikla shiu u përplas në xham. Përjashta ishte vrenjtur. Shtëllunga pluhuri ngriheshin nga rruga e përziheshin me retë e ulëta. Qielli i mugët varej përmbi shtëpitë.

Çatia krisi.

Themistokliu rrudhi vetullat. Pastaj, si të kujtohej për diçka, i ktheu shpinën dritares me vrull dhe u drejtua nga tryeza. Sipër saj, në një fije letër të patharë ende nga boja, ishte shkruar:

«30, vjeshtë e dytë 917.

Rrëfëni ju, nëpunës, shembullin tuaj të mirë në kryerjen e detyrës, që ta marrin vesh të gjithë, tanët e të huajt, se dimë të qeverisim me drejtësi e urtësi! Qëndroni gjithnjë besnikë të Republikës dhe ruajeni atë nga çpifjet...»

Nuk e vijoi më tej leximin. I nguli sytë përpara, mendueshëm. Përse po e lëshonte këtë qarkore? Ç'e kishte shtyrë të jepte këso porosish për vartësit? As-

një shkak i dukshëm. Porositë i dilyn në brendshmi, si një kushtrim ende i pashpërthyer. Nuk qe e para herë që e ndiente afër rrezikun. Kësaj radhe ai vinte si një gërryerje e ngadaltë, e vazhdueshme, që zgjerohet dita-ditës e fitonte truall. Si ta ndalte? Ç'lehd të ngrinte e ku?

Afro një vit në autonomi Korça me krahinat përreth. Një vit s'është shumë, por as pak jo. Ishin bërë mjaft gjëra të mira. Po edhe sa pengesa, sidomos kohët e fundit! Në marrëdhëniet me francezët po ndehet një re kërcënuese, ngarkuar me pabesi. Themistokliu i druhej gjendjes së turbullt, të papërcaktuar. Ndryshe me komandantin e parë, kolonel Dekuanin. Me të pati një përplasje, që në fillim.

«Franca do t'i trajtojë mirë shqiptarët, arka e saja ka pasuri.»

«Shqiptarët kanë arkën e tyre, ata janë mësuar të cingarisën me dhjamin e vet.»

Koloneli gati qe hutuar nga përgjigjja e prerë dhe e ashpër.

«Vjen si mik, a si armik?»

«As si mik, as si armik, po si një shqiptar i ndershëm, që pranon të bëjë marrëveshje me francezët në të mirë të Shqipërisë.»

Një copë herë Dekuani e kishte parë me inat. E megjithatë qenë marrë vesh, se kolonelin e shtrëngonte nevoja për t'i pasur të sigurta prapavijat. Po iku ai e u zëvendësua nga gjenerali Sal. Gjenerali Sal...

Themistokliu rrallë takohej me të. Gjenerali nuk fliste hapur. Për çdo gjë e sillte fjalën si rastësisht. Po të mos i dilte për mbarë, tundte kokën si për të thënë: «Aq më keq për ty, unë të dola borxhit!»

«Borxhin e s'ëmës! mëmëriti Themistokliu ndërta e solli ndërmend. Askujt nuk i kemi borxh ne. Të tjerët po, na kanë boll. S'i qas mendja e njeriut paudhësitë që na kanë bërë. Nuk kanë qenë mjaft vuajtjet e luftërat tona në shekuj, po na tashti, plasi donomaja e madhe dhe në trojet shqiptare u sulën si lukuni ushtritë sërbe, austriake, italiane, bullgare, greke,

franceze. Kush ka mbetur më? Për besë, zor të gjendet vend ku të kenë shkelur kaq ushtri! Të tëra për të zezën tonë. Në këtë katrahurë ne bëmë si bëmë dhe ngritëm Republikën autonome. Që të ketë shenjë Shqipëria. Që t'u vihet fre lakmive të ndyra. Mirëpo gjeneralit francez s'i pëlqeu. Koloneli e miratoi, ky e kundërshton dhe përpiket ta gremisë. Ç'luhet te këta francezët?»

U hap dera e brendshme dhe në prag u duk e shoqja. Ajo eci lehtë e shpejt drejt tij. I sillte kafe. Mirë, do ta pinte një kafe. Ai e mori filxhanin, si i sëmuri barnat.

Dhoksia s'ia ndante shikimin. Asnjëherë s'e kishte parë kështu, kaq të zhytur në mendime. Ç'po zbruhej kësisoj burri i saj, ai që edhe punën, edhe të menduarit e kishte gjithë vrull? Ai që hante jo kur i hahej, po kur i mbetej kohë, që flinte jo kur i flihej, po kur mbaronte punë, të cilat dendur shkonin deri në mesnatë! Sa herë e kishte pritur me sofrën shtruar, që t'i tregonte se qe me të shpirtërisht!

Ai ngriti sytë dhe e zuri në befasi të shoqen tek e vështronte me përgjërim e frikë.

E ndien edhe kjo, mendoi dhe hoqi përbrenda. Ç'i linte pas, po t'i ndodhte gjë, veç emrit të mirë, të cilin edhe atë donin t'ia njollosnin? Me se do të jetonte ajo, nëna, dy fëmijët e adoptuar? Po, vërtet, goxha familje! Dhe shtëpinë e kishte vënë befa...¹⁾

E shoqja nxori një mollë nga xhepi i përparësës. Molla qe e kuqe, ta hante syri.

— Merre, Misto. Ta solli një fshatar. Jepja, më tha, i shijojnë këto atij, e di unë. I thashë të hynte e të të priste, po ngutej, e la torbën e iku.

Themistokliu e fërkoj mollën dhe e vërtiti në duar, si për ta njohur nga vinte. Një mall i largët e mbështolli të tërin si na mbështjell kujdesi i njerëzve të dashur.

1) peng

— S'm'u dha ta pyesja për emrin. Kush të ketë qenë?

— Gorar, — tha Themistokliu duke mos ia ndarë sytë mollës.

C'donte gorari? Me siguri për t'i shprehur gatishtëmërinë. Çudi si ndihet rreziku! Asnjëri s'të thotë gjëkafshë shkoqur, e prapë e kupton, ashtu si e merr vesh afrimin e stuhisë një çoban i zgjuar.

— Misto, njerëzia kanë stimë për ty, ndo fshatarë, ndo qytetarë qofshin. Si i bën kaq shpejt për vete?

— Jo unë, — u përgjigj qetë ai, — është qëllimi që i jam vënë.

Po, vërtet, ajo duhej ta kishte kuptuar vetë. Sido që s'ndaheshin dot qëllimi nga ai vetë. Kur hyn burri në shtëpi, i pati thënë një grua, gruaja duhet të dridhet. O nga frika, o nga epshi. A s'e thotë edhe kënga? «Kur më vjen burri nga stani, fër-fër-fër ma bën fustani!»...

Kur vinte Mistoja në shtëpi, ajo fërgëllonte e tëra, por jo nga frika. As nga epshi. Qe një ndjenjë ku e ku sa më e fuqishme. I fortë ishte burri i saj, i rreptë, i tmerrshëm për ca. I lëpiheshin disa e ia kishin frikën, të tjerët e respektonin e e admironin. Vetë ajo bënte pjesë ndër këta të fundit. Që në ditët e para të martesës hyri në telashet e tij dhe kjo ia bënte më të afërt. Përditë e më mirë ia njihte dëshirat e mëdha burrit të saj të fuqishëm dhe gjithnjë zbulonte tek ai virtyte të vyera, që ia shtonin dashurinë e admirimin, tok me zellin për t'i ndihur të përballte punët e shumta e aq të dobishme, të cilave ai u kishte vënë supet e forta.

— Po ti mos ua vër veshin të ligjve, smirëzinjve. Edhe francezët të nderojnë.

«Vërtet thua?» pyeti ai me sy.

Dhe, duke e hetuar më tej, ai mendoi:

«E beson atë që thotë, apo kërkon të më qetësojë? Po ta vështrosh hollë, as unë s'jam çliruar edhe nga kjo pandehmë, jo më ajo! Pa sikur të vësh në hesap dekoratën e lartë që më dhanë ca ditë më parë tok me

gjithë ato lavdërime publike të gjeneralit... ec e merre vesh!»

Dhoksisë s'i tha asgjë nga këto. Përkundrazi, i tha diçka krejt tjetër:

— Ti, Dhoksi, je grua e mençur dhe... e mirë! — e i zgjati dorën.

Zënë dorë për dore vajtën e u ulën në kanapënë e madhe shtruar me velenxë thekëgjatë. Ajo ngriti kokën dhe e pa në sy. Edhe ai po e shikonte. Thirrjo! Çudi, greqisht kjo fjalë do të thotë egërsi, kurse për Miston e saj njerëzit e përdornin në kuptimin e njeriut trup-madh e të fortë, sikundër që ishte. Ai burrë me pamje të ashpër, ballëgjerë e me sy të mprehtë bojë qielli, me mustaqe të sërta, me shikimin e tij mund të ndalte në vend një qen të tërbuar. Po para saj bëhej i brishtë e i butë dhe ajo në këso rastesh e trajtonte si të vogël. Një trill i çuditshëm ky, pranuar heshtazi, ndofta nga që s'kishin fëmijë. Dhe, kur ai ishte në qejf, ia merrte këngës. Herët e tjera ia niste ajo. Që t'ia përndante lodhjen e mërzinë.

Gjithë duke e parë në sy, ajo ia mori shtruar:

— *Apo zënë ta dëgjova dhe moj,
kur, moj, m'i ngjitje shkallët...*

Themistokliu u kthye i tëri nga e shoqja. Veç kënga nuk do t'i kishte shkuar ndër mend në ato çaste. Megjithatë nuk e theu zakonin. U drejtua e qëroi zërin dhe ia mbajti. Tingujve të ëmbël që mbushnin ajrin si një qëndismë e bukur cohën e bardhë, iu shtua zëri i trashë por i ngrohtë i këtij burri shteti.

Kënga i rrëmbeu e i ngriti peshë, siç bën ajo gjithnjë me qejflinjtë e saj.

Në atë harrim të këndshëm kërcitën dërrasat e çardakut. Dhoksia u ngrit rrëmbyer.

— Fake Gora do të jetë, — tha Themistokliu.

Ai qe vërtet. Me fustanellë, jelek e tirq dhe opinga me xhufkë. Ashtu si kishte hyrë gjithë çeta një vit më parë në Korçë.

— Ata qentë guxuan të vinin gjer këtu, rrotull shtëpisë. Ua kërcëlliva njëherë dhëmbët dhe e morën bishtin ndër shalë, po ç'e do!..

Fake Gora i tha me të keq ato fjalë. Sikur shkulte kërcunj. Themistokliu e pa të fshinte qafën nga zori dhe iu dhemb.

«Eh, or trimi i Gorës!» As në kohën e hyrjetit, as kur u ngrit flamuri në Vlorë, as kur Korça u bë Shqipëri Vetëqeverisëse, Fakja nuk i ishte ndarë. I qante syri për fshatin, punë të tjera më me rëndësi i patën dhënë, por ai s'iu nda. Kaq shumë e donte? Kaq besnik i ishte? Apo i zgjuar e me nuhatje e ndiente që mëkëmbja e vendit s'po ecte në udhë të qeruar?

— Misto, më doli nga mendja, — ndërhyri e shoqja. — Qëparë ardhni Nikoja me Alon, pastaj xha Vani.

— Ç'donin?

— Do të vijmë prapë, më thanë.

— Mirë, mirë. Fake, ulu.

Trimi i Gorës u ul në fron dhe pushkën e mori midis gjunjëve. Tha:

— Ay edepsëzi, ay i fëlliquri, ay Adem bajga ka thënë ca gjëra për ty, që të vjen të pështirë t'i përsëdytësh. Dhe ata zotërinjtë francezë rrinë e dëgjojnë...

— Po, njëfarë Adem Beqiri. Nuk e njihte. E përfytyronte si një njeri jargaman, një qull, një nga ata që shesin edhe prindët për të shpëtuar lëkurën. Ku i gjente syrëteja¹⁾ këta biçimë? I dënonte për t'i trembur, e pastaj këta ktheheshin e depononin ç'i lipsej asaj.

— ... Medemek, sikur këtë Ademin vetë ti e paske nisur të pjekë një oficer austriak e t'i japë një kartë tënden.

Si s'lodhej syrëteja me këto çpifje, që vijonin prej disa muajsh? Në fillim larg e larg, pastaj duke u afëruar...

— Po ti, ç'thëua, o Fake? E di që edhe ty të kanë të dyshimtë?

— Mua shupeli? Të më marrin pleshtat! Unë ua bëj

1) Sigurimi në ushtrinë franceze

hundët përshesh! Po... o kapedan, mos na e nakatos muhabetin! E ç'jam unë? Gjetkë rrahin ata. Kokë duan. Se, po u hoq koka, trupi bie si cung.

Themistokliu bëri të qeshte.

— S'është për të qeshur! Unë them t'u rrëfejmë grushtin. Mos i lëmë të bymehen si kokoshi në pleh, viranët. Na trembin, t'i trembim! Veç më jep urdhër, po kam borxh t'i ngre tanët ku janë e ku s'janë. Bëj, në daç, një kartë për Saliun. Gjej njeri unë t'ia shpjerë me një firomë. Ma ha mendja që as ai s'do të mënojë.

Themistokliu heshti. Pas pak Fake Gora lëshoi një psherëtimë e u ngrit të shkonte.

— Prit, do të dalim bashkë, — i tha Themistokliu.
— Dhoksi, sonte nuk vonohem, — shtoi.

*
*
*

Dy policë francezë po përgjonin te qoshja. Me të parë Themistokliun, u zbythën e bënë më tutje. Themistokliu përmbajti veten, kur e zuri për krahu Faken, i cili u lëshua të zihej me ta. Ç'donin aty policët francezë? Kush i kishte dërguar? Deri këtu kishte vajtur puna, sa ta mbanin në mbikëqyrje?

I nxehur, vijoi rrugën. Fake Gora çapitej me nxitim që të mos mbetej pas.

Në rrugë kishte mjaft lëvizje. Disa njerëz ndaleshin dhe e ngjatjetonin Themistokli Gërmenjin, ca të tjerë bënin sikur s'e shihnin. Afër ndërtesës së administratës shqiptare ua preu rrugën një karrocë e bukur, elegante, që ndriste si e porsalyer me vernik. Themistokliut i tërhoqi vëmendjen. Nuk i kujtohej ta kishte parë ndonjëherë në qytet. Brenda në të, një burrë veshur civil shikonte me shumë kujdes. Themistokliu u vrenjt. Nuk e njihnte atë njeri. Për një çast shikimet e tyre u takuan. Njeriu brenda në karrocë vuri dorën në mustaqe si me nervozizëm e filloi t'i shtronte me një lëvizje që shprehte kënaqësi.

«Ç'të jetë ky e nga ka ardhur?» mendoi Themistokliu e ndjeu një të shpuar në kraharor. Më parë nuk vinte njeri i huaj në qytet pa dijeninë dhe lejen e autoriteteve shqiptare. Bile, kur patën ardhur dy të dërguarit e Esad pashës, ai menjëherë shkoi te komandanti francez, protestoi ashpër dhe, pa u ngrysur, i përzunë.

Shumë gjëra kishin ndërruar në muajt e fundit. Syrëtesë po i shkonte kali në urë

«Syrëteja me kohë është bërë vegël e dikujt që s'na do. Kush nuk na do ne? Esad pasha me tarikatin e vet, një. Ca grekë të fandaksur në qeverinë e Athinës dhe ca grekomanë të ndyrë këtu, dy.

Venizelloja, të mos harrojmë, i vuri drunë mbretit e hyri në luftë përkrah Francës, por ndaj nesh është më i lig se mbreti. Franca tashti atij ia ka nevojën më shumë se neve. Ky Glavani¹⁾ ka të ngjarë të jetë njeriu i tij. Po ushtarakët francezë? Eh, sa shpresa vumë në ujdinë me ta! Thamë se janë të përkohshëm e të mos e humbisnim rastin... Mos jemi rrëfyer naivë, duke besuar ca si shpejt? Po mbase kemi dhe arsye. Njëzet e ca vjet që i përngjaj atij udhëtarit, i cili sheh një dritë natën dhe lëshohet drejt saj, pa marrë në sy përrenj e ferra. Kudo ku kemi pikasur një rreze shprese për qëllimin tonë, nuk ia kemi përtuar fare, nganjëherë pa arritur të ndajmë të vërtetën nga e shtirura.»

Ndërkaq kishin arritur në zyrë.

— Ec i thuaj Zoit të vijë. Po munde, hidhu edhe te xha Llambroja, — i tha Fakes.

*
* * *

Po binte mbrëmja, kur u kthye në shtëpi. Dhoksia po e priste në dhomën — zyrë.

1) atë kohë shef i sigurimit në Korçë

— Më këshillojnë të largohem për ca kohë. Sa të qetësohet gjendja, — tha.

E shoqja s'arriti të kapte domethënien e plotë. E këshillonin, mirë, po ç'kishin vendosur? Ç'do të bënte ai vetë?

Miqtë e bashkëpunëtorët e shihnin gjendjen shumë shqetësuese. Po flitej hapur se do ta arrestonin. Me atë karrocën e bukur kishte ardhur një ushtarak i lartë. Ai s'vinte për mirë. Themistokliun e përcollën deri në shtëpi. Fakes i thanë të kishte mendjen, ndër-sa ata vetë u përhapën nëpër qytet.

Ai vente e vinte në dhomë. Së shoqes i tha të shkonte mañanë, që të mos bëhej merak e ëma.

Pas pak tringëlloi zilka e portës. Tringëllitja qe përpëlitëse, si për alarm. Hyri me rrëmbim Nikoja, ndjekur nga Fake Gora. I pari tha me një frymë:

— Sonte të ngrenë për në Selanik. Ka ardhur kastile shefi i syrëtesë në Armatën e Lindjes. Gjoja ju fton kryekomandanti ty dhe gjeneralin e këtushëm.

Themistokliu pa me habi Nikon, pastaj Faken, si të thoshte: «Po kjo?». Fake Gora rrotullonte sytë e s'e mbante vendi.

— Aq më mirë! — ia bëri me mllëf. — Do të kërkoj të bëhen anqeta të kthjellëta dhe të dalë e vërteta në shesh. T'i jepet fund kësaj komedie, që po zgjat kaq shumë!

— Vështro mirë, çfarë thua, kapedan! — ndërhyri Fakja. — Mos vallë të duan t'u shkoqësh ndonjë turbullirë që kanë në kokë? Ruajna zot! Kësaj ftese s'i zihet besë, mos e prano!

— Përse të trembem? Më akuzojnë që u shërbej austriakëve. Po pse? Për interes xhepi, s'ka gojë njeri të thotë. Të ishte për para, do të mos përzihesha fare me punë të këtilla. Dyqani i biçikletave, hani, hoteli në Manastir, secili mund të më bënte të pasur. Po tërë e dinë se paratë që nxirrnim, për Shqipërinë i kemi prishur. Për lirinë e mëmëdheut, gjer në kacidhen e fundit. Ia di për nder tim vëllai, Telemakut, atdhetar e njeri si ai, që më mësoi si t'i shpenzoja paratë që

më binin në dorë. Për ndonjë shpresë politike? Ne e dimë që austriakët nuk janë shprehur për pavarësinë e Shqipërisë. Përse, pra, përse?

Nikoja u gëlltit, s'dinte ç'të thoshte. Fake Gora bëri përpara.

— Këto, kështu si thua ti janë, po unë them të mos u biesh në dorë. Njëra nga të dyja: o të mbash pranë vetes sa më shumë trima e, në guxofshin të vënë dorë mbi ty, të derdhet gjak mu në mes të qytetit, o të largohesh një sahat e më parë!

Këtë Fake Gora e tha si me pahir. Themistokliu ia nguli sytë. Fake Gora s'u dha. Themistokliu u mat të thoshte diçka, po vuri re të shoqen që qëndroi në të hyrë të dhomës.

— Dhoksi...

— E mora vesh, Misto — Ajo i bëri me nxitim ato dy hapa që e ndanin prej tij. — Bëj si të këshillojnë miqtë, o im shoq. Shpirti ma di që ta them edhe unë këtë, po... Fundja, sa të shkoqitet puna, ti rri gjëkund ku ata s'të gjejnë dot. Shokët le t'u thonë se je në Devoll a diku gjetkë. Tërë e dinë që ti shkon shpesh fshatrave.

Ai u mendua. Në Selanik, pranë komandës së armatës, gjëllonin turli njerëz që s'ia donin të mirën as atij, as Shqipërisë. Kush ia bënte ftesën nëpërmjet kryekomandantit? Ftesa ishte diplomaci. Ose donin t'ia mbushnin mendjen për ndonjë gjë të rëndësishme, ose që ashtu si e gjykonte Fakja, një arrestim i maskuar.

— Mirë, po ju dëgjoj, — tha. — Niko, shko e qetësoji tanët. Sapo të vendosem diku, do t'ju njoftoj që të piqemi. Ndërkohë, mbahuni fort. Fake, mendo ku do të vemë dhe vëzhgo përreth gjersa të erret. Dhoksi, më sill rrobat e malit dhe ndonjë gjë për udhë.

Dy burrat bënë menjëherë ç'u tha e dolën. E shoqja ndodhej në mëdyshje.

— Sesi më duket e gjithë kjo, Misto. A është e mundur që ty...

— Dhoksi, ti lëçit shumë, je e zgjuar, po politika është një qene, që... Vetë Napoleoni i tyre e ka thënë:

ka vetëm kokë, jo zemër. Por... shko, shko e bëj si të thashë.

Kur ajo doli, ai iu kthye mendimit që sapo kishte shprehur.

«Politika një gjë pa zemër? Po kur i vihesh një qëllimi të madh, kur të shtyn një çështje e shenjtë... pa shpirt s'mundet! Në hulli të këtilla të zorçme zemra të shtyn më tepër. Ose të dyja, zemra e truri tok. Pa bujë, si puna e njeriut të mirë, që kurrë s'e nxjerr gjoksin. Sa për ata që nuk e vënë në kandar kujt e sa u prish punë ajo që bëjnë, ata qofshin! Si bejlerët makutë! Si grekomanët! Njerëz të shtënë e jo të pjellë. Si ato gratë e përdala, që e humbasin një herë nderin dhe pastaj, në vend të shikojnë si të ndreqen, jepen pas qejfeve e dëfrimeve. Kujtojnë se kësilloj shijojnë jetën. Një jetë kafshërore! Se, për të jetuar si njerëz të vërtetë, u mungon ajo më kryesorja gjë, nderi!...»

Ai u përmend e shkoi te tryeza e punës. Gjërat me vlerë mendoi t'ia jepte Dhoksisë që t'i ruante diku.

Letra, shkresa, çarkore. Intestimi: «Shqipëri Vetëqeverisëse» dhe «Republika Shqiptare» në shumë dokumente.

Një letër. Shkrimi i tij i kujdesshëm.

«Nuk më mbetet kohë të merrem me poshtërsitë e të poshtërve. Do mëkëmbur Shqipëria. Për këtë gjë duhet punë e mund e jo llafe. Në ua vënç veshin llafeve, kohë humbet e nervat prish...»

Ia dërgonte një miku që e këshillonte të kishte mendjen. Eh, të kishte mendjen! Kush i hyn një pune të tillë, e di që s'është shesh me lule. Ja, shih ç'shkruan ky edepsëzi, ky...

«Dëgjo këtu, more kokëmushkë, more antikrisht! Ç'kërkon të bësh? A nuk e shikon ku qorrollisesh? Po fut farën e përçarjes, po e zvjerdh turmën ortodokse nga prehri i ngrohtë i helenizmës, po prish miqësinë me popullin grek. Ndërro udhë, sa s'është vonë!»

— Kaposh pendëfryrë, që s'di ç'do të thotë fjala miqësi, pale më popull! — shfreu dhe e bëri copë-copë atë letër. Bile u çudit si e kishte mbajtur. E quante

kohë të humbur të merrej me to. I dukej se ulte veten, po t'u kushtonte vëmendje.

Një radhor me shënime. Radhor i përdorur shumë, me kapakë të kuar ngjyrë vishnje. E shfletoi ngadalë, me mall e dhimbje.

«Betohem përpara flamurit të kuq dhe shkabës me dy krerë se do të luftoj gjer në vdekje për çlirimin e mëmëdheut tënë, Shqipërisë... dhe do të qëndroj besnik deri në fund e, po të tradhtoj vendin e shokët...»

Sa rishtarë në çetë i kishin përsëritur me emocion ato fjalë, që ai vetë i pat kopjuar nga kanonizma e Bajo Topullit! Binin në gjunjë dhe e puthnin cepin e flamurit. Ja, sikur e ka para syve Faken, djalë të ri, të turpshëm, me sytë zjarr.

«Përse kërkon të vish në çetë?»

«Për lirinë e vatanit.»

«Ne kemi një fjalë ku e ku më të bukur: mëmëdhe!»

«Mirë, për lirinë e mëmëdheut, atëherë!...»

Po pse i mbetën sytë te fjalët e fundit të betimit? Ç'qe kështu? Ai s'do të tradhtonte. Kurrën e kurrës! Do të rrinte ca kohë fshehur. Sa të kthjelloheshin ngatërrsat. Sa t'u dilte boja shpifësve të fëlliqur.

Megjithatë ndjeu njëfarë turbullire. Si i hutuar shfletoi më tej. Gjerasimi ky? Pa dale, pa dale!

«Kush çalltis për mëmëdhenë në këto kohë të ndërlikura, lipset të mos i ketë menjtmet te mirësitë e vetes, përndryshe s'arrihet e s'fitohet gjësend, pasi përkujdesjet e tepërta për vetveten janë si një qerthull që, po hyre, zor të dalësh dhe kush sheh veten shumë, i sheh të tjerët pak ose asfare.»

Fjalë, po fjalë! I kishin bërë përshtypje me kohë e i pati shënuar aty me kujdes. Po kur pati dalë në atë gjykim Gjerasimi i ngratë? Mundet pasi shpëtoi nga Shahin Matraku. Edhe Shahini! Gjysmë komit e gjysmë hajdut. Bjeri t'i biem! Pastaj iu bë mik me kokë Gjerasim Qiriazit. Mjaft që njeriu të hyjë në udhën e mirësisë, pastaj e gjen vetë ç'të bëjë e si ta bëjë... Po sa i ri vdiq Gjerasimi i drejtë e i kënduar!...

E njihte dhe duheshin.

«Vdes njeriu, po mendimet rrojnë, edhe bëmat e tij gjithashtu. Ja tek i kam fjalët e Gjerasimit. Sa e çuditshme kjo botë!»

Më poshtë vinte një shënim i shkurtër, i prerë, tronditës:

«Gjer tani munda ta mproj veten, po këtej e tutje nuk do të mund. E di që kanë vendosur e kanë marrë masa për vrasjen time.»

I kujt ishte ky shënim? I Papa Kristo Negovanit? I Petro Nini Luarasit? I Kadri Gjatës? Të tre njësoj, të njëjtin fund patën.

Edhe këta martirë i njihte. Iu duk sikur i kishte pranë. Mund të rrinte kokëllart përpara tyre. E kishte shpirtin të larë e faqja s'kishte pse t'i skuqej. Që djalë i ri për Shqipërinë qe përpjekur. Dhe në mos kishte hequr e vuajtur! Pëllëmbë më pëllëmbë i kishte shkelur viset e Jugut! Edhe në dhëra të huaja, gjithë për atë qëllim. Punë me kokën në torbë në qytet, përpjekje për shkollat shqipe, luftë në mal, me gazeta, me se i kishte ardhur ndoresh.

— Janë edhe sot e kësaj dite midis nesh, — tha. — Me rrezik në cdo cast jetuan, por nga bëmat për mëmëdheun s'u tundën asnjëherë. E dinin ç'u tirrej, po s'u dhanë. Thjesht për burrëri e qëndresë? Jo, dicka më shumë. Ja, merr Kadriun. Kadriu i gjorë! Kur turqit më shpunë në burgun e Janinës, Kadri Giata s'la gur pa luajtur që të më lironte. Sikur të kishte rënë në burg vëllai i tij. Kujt i bëre keq, mor Kadri trimi? Titakçinjtë¹⁾ e drodhën fjalën, sapo u bënë zotër. Klubet shqiptare zënë t'i mbyllnin njërin pas tjetrit. Të Janinës jo. Kadriu mbahej. Mbylle! Jo! Ia shterrën mjetet, ai shiti mall e gjë dhe s'hoqi dorë. Titakçinjtë morën inat. Dhespoti mori inat. Vunë njerëz, i zunë pushi dhe e vranë. Ia prenë kokën dhe e shëtitën fshat më fshat. Që t'u futnin tmerrin shqiptarëve. Po a i futet tmerrri shqiptarit kësilloj—? Hajde, kokë, hajde! S'mbeti gazetë

1) xhonturqit

në gjuhën shqipe pa shkruar për Kadriun. Zjeu vala e urrejtjes ndër shqiptarët e ndershëm. Kurveleshasit u ngritën. Vrasësit s'dinin ku të futeshin. Po hakmarrja i gjeti. Dhe klubi s'u mbyll...

Befas, zbuloi një gjë që s'e kishte shkruar ndër mend gjer atë ditë: pas çdo vrasjeje të një patrioti, vala e mëmëdhetarisë, në vend që të binte, siç mbanin shpresë armiqtë, ngrihej si dallgë, më me hov.

U mbështet në shpinëzën e karriges dhe vështrimin e nguli diku përpara. Shkëndijonte një dritëz në atë vështrim:

Ç'do të ndodhte në Korçë pas ikjes së tij?

Ç'u vlente më shumë kundërshtarëve, koka e tij, apo nëpërkëmbja e figurës së tij?

Të qe e para, nuk e kishin vështirë, mund ta bënin me kohë. Dhe nëpërkëmbja s'qe e lehtë. Të ndërrosh mendim në sytë e njerëzve për dikë, do kohë e mund. Gjersa të gjendet mjeti që t'i bindë. Dyshimi është hapi i parë. Po hodhe farën e dyshimit...

A e kishin mbjellë këtë farë kundërshtarët? Po, veçse dukej që nuk mbinte. Dhe ata s'reshtnin me shpifjet, akuzat e tërthorta e me vështirësitë në treg. Dhe për çudit, si shpifjet, ashtu edhe ftesa e dyshimtë i arrijnë në vesh me shumë lehtësi. Kaq e lehtë të qe syrëteja, sa t'i shpëtonin sekrete të këtilla? Mos vallë ajo vetë ishte e interesuar që ai t'i merrte vesh?

Themistokliu u dha krejt pas kësaj hamendjeje të re. Pse ngulmonin kaq shumë tek ai? Ai dhe ngrehina e patriotëve, krahina autonome, ishin një, nuk shqiteshin. Mirë, këtë gjithkush e dinte. Hiq Themistokliun e vër një tjetër, ç'bëhet? Ngrehina mbetet. Mund të dëmtohet pak, po, për t'u rrëzuar, s'rrëzohet. Po ç'duhet për ta shembur? Jo heqja e Themistokliut, po turpërimi i tij. Të lëkundurit, aq do të donin, një lëkundje. «E, ore, ja ç'na qenkësh! Punonte për nencet e na shitej si shqiptar i kulluar!» Të vendosurit: «Pse, të ikte, pak janë sakrifikuar?» Dhe autonomia merrte ngjyra të dyshimta, siç donin ta bojatishnin armiqtë e saj.

Prandaj i lëshonin rrugëve ato sekretet ata! Që

ai të trembej e të ikte. Ikja tinëz atyre u jepte dorë për lloj-lloj marifetesh. Po të linte detyrën, të linte istikamin, kundërshtarët merrnin në dorë gurin e madh shkatërrimtar, të cilin, kur të donin mund ta hidhnin mbi grehinën e patriotizmit.

U hodh në këmbë me rrëmbim. Kërciti dhëmbët me një urrejtje të pazakontë. Provoi një shtrëngim të çuditshëm në zemër. Në çast e mbuluan djersët. Mori një peshqir dhe fshiu ballin, kraharorin, duart. Tani po ndihej i çliruar si pas një banje, i kthjellët si pas një mësimi të përvetësuar shkëlqyeshëm dhe i fortë si pas një së diele në gjueti.

Ai t'u jepte mjete për të luftuar e për ta vënë poshtë atë që mezi arritën ta bënë? Sa të varej prej tij, kurrë! Në mënyrë të pavetëdijshme edhe më parë ikjen e shihte si veprim të shëmtuar. Tanimë ai e gjipte hapur si tradhti.

Merrte dhe anën tjetër. Ja, do ta futnin në burg. Mirë, e pastaj? Edhe njeriu më i paanshëm do të donte ta gjykonin faqe tij, pa të bindej për fajet që donin t'i vishnin. Po fakte ata s'kishin e një gjyq të hapur s'bënin dot. Ta vritnin tinëz? Jo! S'mund të gjendej patriot i ndershëm të mos e vinte gishtin te vrasësit e të mos i ndëshkonte. Atëherë ç'mbetej? U drodh kur mendoj për një gjyq me dyer të mbyllura. Ky do të qe një gjyq formal, mjet i verbër në duart e qëllimkëqijve. Dhe kjo nëpërmjet ushtarakëve francezë. Këta me siguri ishin në hall për atë «parol d'honuer» që i kishin dhënë. Po të ikte, ua zgjidhte hallin e ata fare bukur do të shtireshin për të shenjtë.

Kështu duhej të qe puna. Ç'shpresë të mbante më?

Pastaj arriti në përfundimin se një krim ndaj tij do t'i mblidhte grusht mëmëdhetarët e ata do ta mbronin çështjen e shenjtë.

— Ajo që u bë, nuk do të zhbëhet! — foli me zë.

E përfshiu një ndjenjë e gjerë përtëritëse. Ia shkundi plogështinë ajo ndjenjë, po i ktheheshin gjallëria e forca.

Kur vajti rishtas pranë tij, e shoqja u habit. Ç'kishte ngjarë? Ai dukej si në mëngjeset pas mbledhjeve të

gjata, kur kishin vendosur për ndonjë gjë me shumë rëndësi.

F'are pa zhurmë hyri Fake Gora. Ai s'vuri re gjësend dhe, kokëvarur, pa qenë i bindur në të mirën e asaj që do të bënin, tha:

— Nisemi? Përjashta u err.

— Nuk do të erret, Fake!

Fakja e Dhoksia ia ngulën sytë.

— Nuk do të shkoj, — sqaroi ai. — Dëgjoni këtu, të dashurit e mi, ata këtë duan, që unë të iki fshehurazi. A s'e pikasni që po na nxitin ta hedh këtë çap në greminë? Por unë s'bie në pusinë që më ngrenë. Nuk i thashë vetes luftëtar i mëmëdheut që të kursej veten, kur e do e mira e tij. Po të jetë që koka ime vlen më tepër e prerë sesa e gjallë dhe e tulatur, unë zgjedh të parën! Pa asfare ngurrim!

Trimit të Gorës i shkëlqyen sytë nga admirimi për heroin. I bëhej se që në ëndërr, në një ëndërr të çuditshme, të bukur, të lehtë, që të ngre lart, lart... Ama e kishte prerë kapedani të qëndronin?! Topi s'i çante!

Dhe ia mori këngës:

— *Nukë prapsen trimat, jo,
kur e marrin vrullin, o!*

Themistokliu shtangu. Fakja këndonte ngaherë, po kësaj radhe zëri i dridhej, sido që përpiquej ta kishte të qetë e burrëror. Zëri i trimit kishte përpirë ndjenjat e shqetësimet e atij çasti të madhërishtëm. I ngarkuar edhe vetë me to, Themistokliu e shtrëngoi në krahët e fuqishëm dhe e puthi në ballë. Mandej u mbështet në supin e tij dhe, teksa e shihte të shoqen sypërlotur, tha ngadalë:

— Në më ndodhtë gjë, amanet familjen!

Po ajo e dëgjoi. Me të keq u mbajt. Pak më parë i shkoi në mendje se mos i shoqi kishte marrë ndonjë lajm shpresëmirë. Po shpejt e kuptoi ç'po ndodhte në shpirtin e tij. Iu bë pranë e ia shtrëngoi dorën me të

dyja duart. Burri trim ndjeu në vete gurgullimën e fuqisë dhe të guximit.

*

*

*

Atë natë e morën dhe menjëherë e çuan në Selanik. Tri ditë më vonë u bë gjyqi me dyer të mbyllura. Brenda javës e vranë. Pas një muaji Republika Shqiptare u quajt Kazaja e Korçës. Francezët e cunguan autonominë, po nuk guxuan ta hiqnin. Ashtu siç e kishte menduar, edhe i vdekur Themistokli Gërmenji i ndihmonte asaj që të mbahej, siç u mbajt.

NJË ZË, NJË SHPRESË

«Mësuesi i mësuesve, ai që i ka mësuar shqipen vetë Pandeli Sotirit, gjendet në pranga! Dhe përse? Ç'bëri? U mësonte bashkëfshatarëve në Qestorat të shkruanin gjuhën amtare. Edhe të moshuarit venin me qejf tek ai. Pa zunë të nxiteshin nxënësit e normales greke e ai s'përtonte. Ua bënte të lehtë mësimin Baba Kotoja, të lehtë e të ëmbël, se ai është dashuruar një herë e përgjithmonë me këtë të uruar shqipe. E ato ditë plot fryt të pleqërisë i mbusheshin me dritë e gaz. Po nuk e lanë. Qeveritarët turq të sanxhakut e morën zët. Peshkopi i Gjirokastrës s'e shihte me sy të mirë. Shpifën e trilluan të paqena kundër tij.»

«E goditën me gurë, e rrahën, e ndoqën. Të sfilatur si mos o zot, e futën në Jedi Kule. Zor të ketë hequr e pësuar njeri ato që po pëson e heq Koto Hoxhi. Në këtë moshë, pa dritë, pa shpresë, vështirë të dalë që andej plaku i mirë.»

Vajzës së re, Sevasti Qiriazit ia thoshin emrin, i pikonte në shpirt kur dëgjonte këto fjalë. Veçanërisht

për ato të fundit. Me sytë e mendjes e përfytyronte atë, të mirin e të munduarin Baba Koto. Ja tek e shihte në një shpellë të errët, dergjur në një det dhembjeje e dëshpërimi.

«Baba Koto!»

Mësuesi plak bën të ngrihet e s'ngrihet dot. Sikur nuk është i sigurt në i flasin atij, apo ndodhet në ëndërr.

«Baba Koto, unë jam këtu!»

Ai ia del më në fund të kthejë kokën dhe e shikon vajzën me një ndjenjë të dyfishtë, gëzimi e mosbesimi, dhe zgjat dorën që ta prekë e ta afrojë. Një dorë e bardhë, e hollë, e tejdukshme...

Ky përfytyrim i shfaqej asaj herë pas here. Dalngadalë, si pa u ndjerë, ai iu kthye në dëshirë. Ngado që vente, çfarëdo që bënte, nuk shkëputej dot prej tij. Dëshira e përfshiu të tërën, si një brengë.

Dëshira lind nga një nevojë. Qëllimi e ndez e i jep shtysë. Vullneti e këmbëngulja e ushqejnë. Sidomos të të rinjtë e hedhur, të dhënë pas diçkaje që i përpin.

*
*
*

Koto Hoxhi ishte mik i familjes Qiriazit. Kur shkante në Stamboll a kur kthehej nga Stambolli, ai qëndronte në Manastir dhe për një ose dy ditë që mysafir i Dhimitër Qiriazit, babait të Sevastisë, me të cilin ishte vëlla në shpirt. Baba i mirë, njeri i butë e i ndershëm, Dhimitër Qiriazit e mbante shtëpinë hapur për mëmëdhetarët. I priste e i përcillte buzëgaz e ndiente kënaqësi kur ua lehtësonte rrugëtimin. Pale po t'u sillte ndonjë shërbim që i ndihmonte në punën e tyre të shenjtë! Atëherë bëhej me krahë dhe për ditë të tëra buburonte nëpër shtëpi shend e verë, duke bërë që e gjithë familja të vinte në qejf, si në ditë gëzimi. Këtë ndjenjë ua ngjalli në shpirt dhe fëmijëve të vet, nga

të cilët i pari, Gjerasimi, u dha i tëri pas lëvizjes patriotike.

Sevastia qe vajzë e vogël, kur e pa për herë të parë Koto Hoxhin. Ai rrinte pranë vatrës, mbështetur në një jastëk, si Baba Dhimitri, në dhomën e madhe shtruar me qilim. Bisedonin me ëndje, si njerëz që e duan shoku-shokun e kanë kohë pa u parë. Atje më tutje, nën musandren e madhe, ulur mbi një senduk, Gjerasimi i tha së motrës me zë të ulët:

«Ky është Baba Kotoja. Mbye mend këtë emër, Sevasti. Është një nga të njëzeteshtatët që bënë në Stamboll shoqërinë e të shtypurit të shkronjave shqipe.»

Burrë nja gjashtëdhjetë vjeç, fytyrërrumbullakët e ballëgjjerë, me flokë të përhimë, të rrallë, vajzës së vogël iu duk njeri i madh, i veçantë, si ata të përallave e rrëfimeve, të cilat i pëlqenin aq shumë. Ndofta nga mënyra se si ia paraqiti i vëllai, që dukej se kishte një nderim të veçantë për të. Si e përpirë nga një habi, ajo nuk ia ndante sytë, ndaj çdo fjalë e Gjerasimit e rriste edhe më figurën fisnike të mësuesit të hershëm.

I ati e thirri pranë.

«Puthi dorën Baba Kotos.»

Ajo bëri shpejt ç'i thanë, me druajtje, po dhe me gëzim.

«O, qenke vajzë e mbarë ti! Si ta thonë emrin?»

«Sevasti Dhimitër Qiriazhi.»

«Nga je ti, moj Sevasti?»

«Jam nga Kolonja.»

«O, o, sa mirë! — Koto Hoxhi qeshi me të madhe e u nxit ta pyeste edhe më vajzën e zgjuar. — Po, a s'më thua, ç'je ti?»

«Unë jam shqipëtare!»

«Bukuri, besa, bukuri! — Mësuesi ngazëlleu, sytë e butë e të dashur iu njomën, zëri iu drodh. — Ke parë ti, — iu kthye Dhimitrit, — ke parë që prekem si fëmijë kur dëgjoj një fjalë të ngrohtë për këtë të uruar e të ngratë Shqipëri? Po nuk e pashë të përçapet e të zërë ta ngrohë dielli i Përlindjes, s'do të më tretë dheu! —

Koto Hoxhi psherëtiu, ndërsa vajza e shikonte edhe më me habi përmallimin e tij. — Po, a s'më thua, moj bijë, di ta shkruash shqip atë që the qëparë?»

«Di!» — tha vajza me gaz dhe ngriti kokën e pa nga Gjasimi, si për ta falënderuar që i kishte mësuar shqipen e nuk do të turpërohej përpara atij njeriu të madh e të çuditshëm.

Gjasimi shpejtoi t'i jepte letër e penë dhe ajo shkroi me lehtësi: «Unë jam skipëtare!»

«Shumë mirë, shumë mirë! — tha me të qeshur Baba Kotoja. — Ti qenke një skipëtare e vërtetë! Jetë e mot e tillë qofsh, bijë!»

Dhe e puthi në ballë e i dhuroi një libërth të vogël që e mbante me vete.

«Po këtë sh-në s'e gjetëm e s'e gjetëm dot, — i tha Gjasimit. Kështu nuk është mirë. Veçanërisht te fjala «shqiptar» e «Shqipëri», s-ja që përdorim sikur të ngec në grykë. Lipset ta gjejmë e ta kemi tonën.»

Mësuesi i hershëm të nesërmen iku. Në kujtesën e vajzës ai mbeti si një figurë e fuqishme, e dalë nga legjenda.



...Koto Hoxhi në burgun Jedi Kule!

Këtë radhë nuk ishte fjala as për legjendë, as për fantazi. Ishte realiteti vetë, poshtërues e ndrydhës gjer në skajin më të tejme. Burgu famëkeq Jedi Kule që një nga institucionet që njihej më tepër në kreit Perandorinë e gjerë Osmane. Plakej e dobësohej Perandoria, forcohej burgu, si për të kompensuar fuqinë. Ngritur mbi rrënojat e një kështjelle të moçme, Jedi Kuleja ishte zgjeruar e me kalimin e kohës ishte shndërruar në një përbindësh që stërmundonte ata, të cilët guxonin të mos e pranonin si hyjnore e të përjetshme Perandorinë Turke. Mbyllnin atje më të rrezikshmit, mbledhur nga tërë anët e Perandorisë. Pa dritë,

pa ushqim e veshje, në tortura të pareshtura, që t'ua vritnin guximin e shpresën. Ai që hynte atje, zor të dilte më. Por edhe ndonjë që dilte, mund t'i jepte çdo «kokëkrisuri» shembullin se si katandisej ai që kundërshtonte. Dhe Koto Hoxhi tanimë ishte mjaft i moshuar.

Shoqet e kolegjit kishin ca kohë që çuditeshin me përhumbjen e Sevastisë, aq më tepër që e njihnin dhe e dinin sa vajzë e gjallë ishte ajo.

— Ç'ke, moj? — e pyeste me ngulm Hyrija.

Hyrija ishte një vajzë e brishtë, me tipare të bukura, shoqe e mirë. Nuk ia thoshte dhe aq në mësim, ndaj ia kishte nevojën Sevastisë. Hyrija qe shqiptare me origjinë. Po kur u njohën, nuk dinte asnjë fjalë shqip. Sevastisë i vinte çudi e inat. Shqiptare e të mos dinte shqip?! Për të kjo ishte një gjë sa e pabesueshme, aq dhe pa kuptim. I ishte vënë t'ia mësonte Hyrijes gjuhën amtare dhe ia doli t'i mësonte mjaft fjalë shqip, se, kur ndodheshin bashkë, duhej të flitnin vetëm shqip, ndryshe Sevastia vrenjtej e Hyrija i druhej zemërimit të saj.

— Kam një hall, — i tha Hyrijes.

— Ç'hall, moj?

Qerpikët e gjatë të vajzës së brishtë u drodhën.

Sevastia ia shpjegoi me pak fjalë dëshirën e madhe për të parë Baba Koton.

Hyrija nuk i hyri thujse fare brenda hallit të saj. Po meqenëse ky hall e mundonte shoqen, ajo e gjeti të udhës të merrte një pjesëz. Pra, i dha fytyrës një shprehje trishtimi. Aq miturisht e bëri këtë, sa që Sevastia vuri buzën në gaz me pahir, si për të mëshiruar naivitetin e tjetrës. Menjëherë u pendua që i ishte hapur, por kësaj nuk kishte ç't'i bënte më.

Për habinë e saj, të nesërmen, Hyrija kishte vajtur më herët se zakonisht në shkollë dhe po e kërkonte. Sapo e pa, e hoqi mënjanë, ia mori të dy duart në të sajat e i tha si me frikë e ankth:

— A e di... a e di... Im atë është efendi i Jedi Kulesël!

Dhe i rrotullonte sytë e mëdhenj e i përpëliste qerpikët, sikur ajo vetë ta kishte fajin për hallin që e mundonte shoqen.

Sevasti Qiriazit vërtet i bëri përshtypje ajo që dëgjoji. Deri atëherë Hyrija nuk i kishte thënë se me ç'punë merrej i ati dhe dukej që as vetë s'e dinte mirë. Efendi, vetëm kaq thoshte.

— Ti nuk do të më mbash mëri? Ti do të më kesh prapë shoqe?

Hyrija pyeste e përgjerohej me fjalë, me sy, me zemër.

Sevastia mendonte tjetër gjë. Një gjë të dhembshme. Ku nuk i gjeje shqiptarët! Anekënd Perandorisë, në punë nga më të ndryshmet, se s'i mbante dot vendi i tyre. Kishte nga ata që ruanin të pacenuar patriotizmin e nuk e ndanin kurrë veten nga Shqipëria. Ruanin gjuhën, zakonet, karakterin shqiptar dhe përpiqeshin të ndikojnin te të tjerët për të bërë edhe ata të njëjtën gjë. Këta ishin krenaria e kombit. Njerëz të nderuar ndër shqiptarët. Vëllezërit Frashëri, Pashko Vasa, Koto Hoxhi, babai Dhimitër e vëllai Gjerasim, gjithashtu.

Po ca të tjerë, oh, ca të tjerë bënë një karrierë të turpshme, ngritur mbi vuajtjet dhe mjerimin e gjinj-djes së nënshtruar me përdhunë. Ndofta prandaj nuk e bënë veten që ishin shqiptarë. Dhe fëmijëve nuk ua mësonin shqipen. U druheshin, u vinte turp. Përpiqeshin të harronin kombësi e atdhe, që të mos u rrinin mbi kokë si gjykatës të pamëshirshëm në veprimet e tyre të shëmtuara. Këta njerëz mbanin më kot shpresë që të mashtronin vetveten e të tjerët dhe jo rrallë drama e tyre shndërrohej në tragjedi...

Po meqë ishte shqiptar dhe kishte në dorë, ky babai i Hyrijes a mund t'i ndihmonte sa për të parë Baba Koton? Mbase i kishte mbetur diku në një skutë të ndërgjegjes një fije shqiptarizmi. Nuk do t'i lutej për ta liruar. Veç për ta parë. Kjo s'ishte kushedi që. Ia tha Hyrijes.

Dhe Hyrija të nesërmen ngazëllente.

— Që sot! — i tha. — Ti do të vishesh si djalë e të presësh përpara hapsanës.

*
*
*

Jedi Kule, në të dalë të Stambollit, si e pëgëra e tij, i madh, i hallakatur, me kulla e ndërtesa të shumta, me mure të larta, si një përbindësh qorr, rrihte të ngjallte në mos madhështi, të paktën përshtypjen e sundimit. Në këtë pikë e ndihmonte heshtja e frikshme, gati e përzishme, që ndehej në gjithë perimetrin e burgut dhe shtrihej rreth e qark në një largësi që shkonte deri pesëqind metra nga muret rrethuese. Portat e mëdha të hekurta, veshur me llamarinë të trashë e heshta majëmprehta përsipër, ngjanin si një barrierë që pengonte gjallërinë e jashtme të hynte brenda dhe dhembjen e brendshme të dilte jashtë. Ato binin në sy që larg si myhyri i llangosur i një katilfermani.

Rojat rrinin në të dy anët e portave si çelësa të ndryshkur.

Sevastia qëndroi larg tyre. Për të shkuar kohën, u përpoq të dallonte të shtatë kullat, sipas emrit të burgut, po nuk ia doli dot dhe, befas, i rëndoi në zemër një peshë ndrydhëse. Ishte e tronditur, i dukej e largët, e pamundur ajo që po bënte. Më pas e shtrëngoi veten të sillej mospërfillëse kundrejt burgut të tmerrshëm e hijes së tij të rëndë, duke e çuar mendjen te takimi i ardhshëm.

Si kaloi nja një orë, portat e mëdha u hapën tejtejt.

Një karrocë e zezë, tërhequr nga dy kuaj të fuqishëm, doli me të shpejtë. Kur po i afrohej Sevastisë, karroca qëndroi, u hap dera e saj nga u duk një kokë burri, i cili, pasi pa me vërejtje vajzën veshur tebdil, u kthye nga kafazet e bërtiti:

— Hej, lëreni këtë djalosh të hyjë e të shohë atë që dol

Urdhri i atij burri përkonte me misterin që vishtë krejt burgun dhe hapësirën përreth.



Ajo eci pas një gardiani, që dukej sikur kishte një kobure të madhe në brez nga tufa e çelësave të rëndë, varur në rripin e mesit. Ai nuk tha asnjë fjalë, madje nuk ia hodhi sytë fare Sevastisë, sikur aq i bënte kush ishte e ku do të vente. Dukej i zymtë dhe i mërzhitur. Sevastia nuk po e kuptonte dot nëse atë pamje ia jepte ndjenja e detyrës, apo bezdia e urdhrit ca të pazakontë, për të shoqëruar «djaloshin.»

Por ajo e mënjanoi këtë hamendje dhe filloi të mendonte për takimin e afërm, por s'po e linte emocionin, që po i shtohet nga çasti në çast.

Gardiani ecte shpejt, pa marrë parasysh që ndjekësi nuk dinte ku të shkelte, se korridori ishte i errët e aspak i sheshtë. Sevastia ecte me kërcime, që të mos i ndahej asnjë hap, ndryshe do të përplasej diku.

Qelia e Koto Hoxhit nuk ishte larg. Ndofta gardianët mendonin që ai do ta kishte të shpejtë e kështu nuk do t'u duhej të hiqnin keq.

Ndërsa gardiani vërtiste çelësin në drynin e madh, Sevastia u mbush me frymë një herë, dy, që të ndalte rrahjet e shpejtuara të zemrës. Ai e shtyu derën, i bëri shenjë të hytë dhe vetë nisi ecejaket në korridor.

Sevasti Qiriazit ia nguli sytë territ të qelisë. Diku, nja një hap e ca përtej derës, shqoi një gjë pa formë. Si atëherë kur ngrihet mjegulla a mugëtira e mëngjesit, nisi të qartësohet ajo masë pa formë e ja tek spikati figura e një plaku shtrirë në shtrat. Me fytyrë të bardhë, me mjekër të bardhë, me flokë e mustaqe të bardha. Të bardha akoma dhe vetullat. Menjëherë përfytyrimi i dikurshëm i njeriut që del nga legjenda iu përhi me forcë vajzës.

— Baba Koto? — pyeti ajo si e trembur.

Në vend të përgjigjes u ndje një rënkim i thellë. Vajza pati frikë se mos ai kishte humbur dëgjimin a nuk fliste dot dhe vetiu e përsëriti pyetjen, duke i vajtur edhe më pranë.

— Kush je ti e nga më njeh?

Zëri i plakut, i butë e i zvargur, doli si nga një thellësirë.

— Oh! — ia bëri vajza, si të thoshte: «Gjene mirë që folka!»

— Të njohin ata që duan shqipen e Shqipërinë, — tha afër veshit të tij.

Koto Hoxhi arriti më në fund të dallonte një djalosh me qëndrim e vështrim përgjërues, gati t'i hidhej në krahë, me shenjën më të parë të tij.

— Paç uratën, bir!

— Nuk jam djalë, Baba Koto.

— Vajzë këtu?!

— Unë jam skipëtare! (E shqiptoi kështu që ta kujtonte...)

— O, o!

Koto Hoxhi vuri dorën në ballë. Kjo qe një shprehje që s'mund të harrohej lehtë, po vitet, mosha, burgu e kishin fundosur diku thellë dhe ai e shihte si midis mjegullës. Ai u përmend dhe foli:

— Afrohu, bijë, afrohu!

Sevastia i ra ndër gjunjë, ia mori dorën në të sajën dhe ia puthi.

— Si është babai, moj bijë?

— Ashtu, si lis. I dashur, zemërbardhë e i papërtuar si gjithnjë.

— Si lis, the?

Koto Hoxhi mbështeti dorën në anë të shtratit. U dëgjua një krisje. Sikur do të thyhej diçka. Shtrati apo kokallat e plakut? Sevastia u drodh. Pastaj shpejtoi ta ndihmonte mësuesin që të ngrihej. Me shumë mundim ai arriti të qëndronte ndenjtur. Psherëtiu thellë. Ia shkoi dorën ballit. A thua fshinte djersët? Po ç'djersë mund të kishte ai trup i shndërruar në skelet? Vajza,

që e shihte pa ia ndarë sytë, për pak ia shkrepri të qarit.

— Po, po, ndryshe nuk mund të jetë Dhimitër Qiriazi. Në ka gjësend që e shquan fisin tënd, bijë, dhe që yt atë e ka trashëguar fort mirë, kjo gjë është të qëndruarit i papërkulur në mjerim. E di sa ka hequr e s'është dhënë kurrë e ia çmoj për nder, se dua të jem posi ai. Por edhe vullnetmirë është, trim e plot guxim në rrezik.

«Ky thotë ato gjëra që i pëlqejnë për vete dhe mirë bën. Po im atë i meriton lavdërimet e tij, e unë jam krenare për të», mendonte vajza e Dhimitër Qiriazit.

Ajo u çudit se si ai mundi të fliste aq shumë. Me ato që tha, Koto Hoxhi sikur e kaloi provën më të vështirë. Po dilte nga një përhumbe e kotësi ku ishte dergjur prej javësh. I vinte të mos e besonte që dikush kishte hyrë deri në atë thellësi ku qe fundosur ai dhe po bisedonte me të. Rraskapitja po i largohej pakëz e pati dëshirë të fliste, të mësonte ç'bëhej atje lart, përjashta, në botën e luftës e të shpresës.

— Gjerasimin, moj bijë, tët vëlla, si e kam?

— Shqiptar me mish e me shpirt, Baba Koto. S'kërkon e s'mendon gjë tjetër.

Plaku puliti sytë. Përgjigjja nuk iu duk e qartë. A ishte i lirë? Mirë që kërkonte! Po si, ku? Dendur e mundonte dyshimi se mos edhe patriotët e tjerë kishin pësuar fatin e tij. Me ditë, me javë, më kot pati pritur ndonjë shenjë që nga jashtë. E sa më tepër kalonte koha, aq më i theksuar bëhej dyshimi i tij.

— Punon për shqipen?

— Do të punoj, thotë, për mëmëdhenë, gjithë jetën, sa të rroj.

— I lirë?

— Me pengime, doemos.

Me mundim të madh Koto Hoxhi lëvizi vendit. Prapë krisën kokallat e tij.

«Sa e kanë munduar!» mendoi me dëshpërim Sevastia.

— Ashtu kam besuar qëkur. Është i zgjuar, është i besës, është i papërtuar.

«Po, natyrisht. Ai mbaroi shkëlqyeshëm kolegjin amerikan të Samokovit dhe, që t'i shërbente vendit të tij, sado me mundim, nuk pranoi katedrën që i dhanë atje. Dhe, kur mua më porosit ngaherë të mos harroj që jam shqiptare, është vetë më parë i tillë megjithësej.»

I tha me ç'punë merrej.

— Në këmbë të Kristoforidhit. Edhe Kristoforidhi është mik me kokë i shtëpisë suaj, sikundër shumë mëmëdhetarë që kanë gjetur në atë shtëpi zemër e ngrohtësi. Është nevoja që ne të përdorim tërë ç'na mundet që të hapet e të kërrejë rrënjë farë e shqipes. Dhe ai mirë bën. Por, a s'më thua, shkruan vjersha?

Ca poet edhe vetë, plaku kishte pikasur dy vargjet që vajza futi në përgjigjen për të vëllanë. Mendjeshkathëta Sevasti fërgëlloi kur ai ia diktoi hilenë.

— Shkruan! — tha e gëzuar dhe, për t'ia bërë qejfin, recitoi:

*O vëllezër shqipëtarë,
lidhuni ndë dashuri!
Erdhi koha e mësimit,
të fitojmë dituri.*

*Mos mënoni, mos mënoni,
punën tuaj mos harroni,
epni sot me duar plot,
ndë mos mbjellçi, s'korrni dot!*

— Po kjo qenka fare e bukur, fare e bukur! Gjerasimi ynë shkoka udhës së ndritur të Naimit gojëmbël, e, ç'i paska hije!

Fytyra, fjalët, shikimi i plakut, po fitonin një ngjyrë përtëritjeje çuditërisht të shpejtë. Duke e vënë re këtë, vajza shtoi:

— Ca vjershave im vëlla, u vë melodi e i bën këngë. Dhe ajo këndoi ngadalë, lehtë:

— Lul'e bukur posi dielli,
kush të mbolli ty këtu?
— Lum ay njeri i urtë
që më sheh e më bekon,
vetvetiu nuk kam mbirë.
lum ay që kupëton!

— Këto vajtkan punë e madhe për nxënës të mbarë. Ka ndër mend të hapë shkollë Gjerasimi?

— Të dy, mësues! Gjersa të mbaroj unë kolezhin, ai do të bëjë gatitjet e pas kësaj do të hapim në Korçë shkollën shqipe për vajza. Puna vete mbarë, e mua më s'më pritet.

— Po kjo është... kjo është... s'ka sa e mirë gjë! Gjerasimin e dinja, ty të mësoj tashti kush je! Gjallë stërgjysh Mëhilli.

Sevasti Qiriazit iu bë qejfi nga fjalët e Koto Hoxhit. Baba Mëhilli kishte qenë shumë trim, këmbëngulës e i patundur. Vetiu filloi të mendonte për veten. Nuk qe e lehtë të ndiqte kolegjin e Stambollit. E para femër shqiptare që merrte arsim të lartë. Kolegji ishte katër vjet. Kaq gjatë nuk mund të duronte. Deshi të fillonte drejt e në vitin e dytë. Kur i thanë që s'lejohej, kërkoi të jepte provime plotësuese, i dha e fitoi. Deshi të hynte në burg që të shihte Baba Koton, hyri. Donte me gjithë shpirt të hapte bashkë me të vëllanë shkollën e parë shqipe për vajza. Tërë shpresat atje, gjithë besimin atje!

— Çdo vonim në të lënë të gjuhës shqipe, do ta sosë durimnë e shqiptarëve. Tashti, moj bijë, ne nuk mbahemi më.

— Baba Koto, ne e kemi të çelur udhën e mirësisë. Ferrat e gjembat e parë i keni çkukur ju. Mbi ju ra dhe mëria e parë. A e di ç'ka shkruar një mëmëdhetar? «Përpiqu, Koto, përpiqu, Si qiriri tretu, digju!» Se: «Mblidhi, shokë, e bëjmë benë, të ngjallimë mëmëdhenë!»

Tek dëgjoi vargje shkruar për të e pastaj dy nga të tijtë, e kapi ngashërimi. Koto Hoxhi, burri trim i

shqipes, fshiu sytë e s'foli dot. E kishte drobitur mo-sha, e kishin drobitur vuajtjet, e kishte dobatur ca më shumë burgu me mundimet e vetminë. Po burri di të mbahet e të mbetet burrë dhe, sapo i japin shenjën më të vogël, bramp ia bën dhe, duke mposhtur çdo gjë, ngrihet më këmbë.

— Ashtu, më paç uratën, ashtu. Më i dituri ynë, Samiu, e ka thënë fare çkoqur: «S'ka Shqipëri pa shqiptarë, s'ka shqiptarë pa gjuhë shqipe, s'ka gjuhë shqipe pa shkolla shqipe!» Po, a s'më thua, di gjë-kafshë, qysh janë e çfarë bëjnë vëllezërit e ndritur? Avduli ka hequr më parë në këtë të nxirosur burg, ku heq unë sot.

Sevastia iu mënjanua përgjigjes për Avdylin, që pati dalë nga Jedi Kuleja me shëndet të ronitur. Tha me një frymë:

— Naimi po bën një libër të madh e të bukur për të pavdekurin Skënderbe. Kur qe këtu Gjerasimi, më shpuri një ditë tek Ai. Nuk do ta harroj kurrë, kurrë! — Vajza shtrëngoi duart në kraharor, sikur atje do ta mbante zotimin. — Motër, më tha, nuk mund të bësh gjë më të mirë nga ajo që ke ndër mend bashkë me tët vëlla. Arsimi është arma që zhduk errësinë. Gruaja lipset të jetë e mësuar, se ajo rrit e edukon fëmijët. Po të jesh besnike e durimplotë, do t'ia arrish e mëmëdhethi do të të ketë në zemër. Dalç faqebardhë, motër!» Dy herë më quajti motër! E më porositi ta lajmëroj kur të marr diplomën. Do t'i vërë myhyr në ministri, tha. Me myhyr ministrie marrka më tepër vlerë në sytë e qeveritarëve turq. Oh, ligjërimi i tij të prek në zemër e të mbetet në mendje përgjithmonë! Kush e ka parë një herë Naimin, s'i shuhet kurrë nga shpirti flaka e mëmëdhedashurisë! Lum si ti, Baba Koto, që ke shok e mik Naimin!

Dhe ajo, si të kujtohej befaz se po e vononte gjë-në kryesore, shtoi me zë të ulët:

— Ai po çalltis për ty!

Nuk gënjente. Ia kishin thënë fjalët e Naimit:

«Hyqymeti ka marrë frerët ndër këmbë e është

vërsulur kundër nesh e na kllat në burgun e katilëve. Po s'do të shkojë shumë e do të pengohet. Druaj se Koto Hoxhi nuk do t'u qëndrojë dot mundimeve që pjell mendja e ligë e barbarëve turq. Kam në sy tim vëlla, Avdylin, që është sa gjysma e moshës së tij e megjithatë doli fare i legëdisur. Të shpejtojmë në përçapjet tona! Veç mos e lërë shpresa mësuesin e patrembur!»

Dhe mësuesi i patrembur po mbahej. Atij i rrihte zemra me vrull. Një forcë e re i vërshoi përbrenda.

— Më rrofsh, bijë! O, ç'dritë solle në këtë të nëmur qeli! O, ç'lajme të mira që më dhe! S'paskam vdekur edhe, se njerëzit më kujtojnë. Jam gjallë, e shoh se filiza të rinj i shtohen kopshtit të bukur të shqiptarizmes!

Sevasti Qiriazhi u drodh e lotët i veshën sytë.

Tani po e kuptonte dëshirën e saj. Pikërisht këtë kishte dashur: t'i silte mësuesit fjalë të ngrohta, t'ia ushqente shpresën e pastaj shpresa vetë do të punonte tek ai e do ta mbante gjallë.

Sa mirë kishte bërë, sa mirë!

VIJ NGA SHQIPËRIA

*Vajte te Bismarku brenda,
ndenje në skami,
ç'të pijen edhe të thanë:*

*- Djalë, nga je ti?
- Unë jam nga Shqipëria,
Avdul Frashëri,
ju lutem, shikoni mirë
ju për Shqipëri.*

Këngë popullore historike

I

Në Berlin arritën pasdite. Ishte maj i vitit 1879. Kur zbritën nga treni, midis turmës laramane që priste në stacion, Avdyli shqoi një fes të kuq dhe vetiu u zbraps. Njeriu me fes të kuq ishte mbështetur me fodullëk në derën gjysmë të hapur të një karroce luksoze. Dorën e mbante mu përmbi stemën me gjysmë hëne, si për të tërhequr vëmendjen ndaj saj. Ndehej për të parë më mirë (a për t'u parë më mirë), duke çakërritur sytë nëpër dyert e ngushta të vagonëve.

Avdyli deshi të mënjanohet, po që vonë, ndërsa Mehmet Vrioni u shkëput prej tij dhe shpejtoi ta ta-

konte. Njeriu me fes të kuq, tepër i gëzuar që i gjeti shpejt, përshëndeti me dorën në zemër:

— Ju ngjatjetoj, zotërinj! Zoti Abdulla beu¹⁾ më dërgoi enkas për ju. Ju bën selam e ju fton në ambasadë.

— Ejvallah! — falënderoi Mehmeti.

Abdyli iu desh të bënte mjaft përpjekje që të sillej si i kënaqur nga ftesa. E kuptoi se do të ngërdheshej, po të shtirej të buzëqeshte, ndaj fërkoj faqen me dorë.

«Kudo njëlloj këta, mendoj. Në dukje të dashur e të sjellshëm sa më s'ka. Patjetër e kanë marrë porosinë të na mbajnë në mbikëqyrje, që të largohemi nga Evropa me ujë në shoshë.»

Vërente nëpunësin turk, ndërsa kujtonte ministrin e jashtëm, Karatheodor pashën, në atë takim e shkur-tër, kur i pati shpënë kërkesat e Lidhjes.

«Evet efendi! Shqiptarët janë shtylla perëndimore e Perandorisë. Padishahu ju ka në shpirt. Do t'i shohë dëshirat tuaja.»

«Kur?»

«Shpejt, sa më shpejt.»

Nga mënyra se si ministri e përsëriste fjalën «shpejt», Abdyli ndjeu një shtrëngim në zemër, njëlloj sikur ai t'i kishte thënë se nuk do t'i shihnin kurrë ato kërkesa.

«Si mund t'u mënjanohem!» mendoj. Ndërkaq iu kthye nëpunësit të ambasadës:

— Po mirë, zoti Mehmet le të urdhërojë. Ai është ca i pamundur e ka nevojë të prehet. Sa për mua, hë-përhë më pëlqen të jem një El Rashid.¹⁾

Njeriu i ambasadës ngriti vetullat fort i habitur. I zënë ngushtë, u kthye nga tjetri si për t'i kërkuar ndihmë a që t'ia shkoqiste ai përgjigjen aq të papritur të Abdyli, por Mehmeti, ashtu i drobitur nga udha, s'i

1) Atë kohë ambasador i Turqisë në Berlin

2) Kalif arab i njohur për udhëtimet e fshehta.

dha rëndësi e u çapit te karroca e hipi duke bërë një lëvizje me dorë që të niseshin.

Karroca luksoze iku. Abdyli e ndoqi me sy dhe iu duk sikur ajo po ecte më lehtë pa të.

«Aq më mirë!» mendoi si me mlllef.

Ndihej i çlirët e i lehtësuar. Po pikërisht nga kjo ndjeu njëfarë shqetësimi. Ç'do të bënte? Nga t'ia fillonte? Ja, mund të vente ku të donte dhe pa turqit pas, e pastaj? Se mos që e keqja vetëm te shoqërimi i tyre!..

Njerëzit në stacion po shpërndareshin.

Kërkoj dhe ai një pajton. Karrocieri që iu drejtua, sesi e pa vëngër. Ishte një burrë bullafiq, çehrevrarë, me ca rroba të gjera e një kasketë të përdorur shumë. Priti hijerëndë që Abdyli t'i jepte adresën. Ky anoi kokën dhe mbylli sytë si për gjumë. Karrocieri u nis pa fjalë.

Abdyli, pa e pasur mendjen shikonte supet e tij të gjera. Në shpirt i rëndonte një peshë.

Karroca qëndroi para një bujtine dykatëshe, muret e së cilës i kishte mbuluar shermasheku. Bujtina që e vjetër, por e mbajtur mirë. Ngjiti shkallët e drunjtë pas shërbyesit, që do t'i tregonte dhomën. Dhoma binte erë sapun. Atij i pëlqeu. Mbylli derën e u ul në cepin e shtratit të rregulluar me kujdes. Fërkoj tëmthat. Nuk që e mundur t'i tulaste mendimet, as t'i vinte në radhë. U ngrit e vajti te dritarja.

E hoqi mënjanë perden. Kadifeja rrëshqitëse i peshoi në dorë. Këta gjermanët çdo gjë të rëndë e kanë, tha dhe vetë u çudit pse mendoi atë gjë. E hapi njërin kanat. Në dhomë vërshoi një ajër i lagësht. Me të dy bërrylat u mbështet në pezulin e dritares.

Qyteti i madh që zhytur në mugëtirë, si në një mjegull të dendur. Dritat e zbehta të fenerëve me gaz feksnin aty-këtu si ca ombrella të verdha. Megjithëse pranverë, s'ndihej asnjë aromë. Qyteti ngjante i zhveshur, i ftohtë e i shpëlarë. Abdyli i bëhej se ndodhej në një stacion të largët, ku kalonin vazhdimisht udhëtarë mospërfillës, të mërzhitur nga udhëtimi i gjatë,

Qytetet, ku ia kishte dashur puna të vente, i kalonte në kujtesë si pemët në dritaren e një treni të shpejtë. Kujtoi Stambollin. Minare, trëndafila, çallma, kësula të kuqe. Megjithatë i bukur. Eh, Stambolli! E pati lakmuar vajtjen atje që të mbante lidhje me patriotët anekënd Shqipërisë. Atëherë krahinat e Shqipërisë kishin më afër Stambollin, sesa njëra-tjetrën. I tillë që administrimi otoman. Pastaj në Janinë. Liqeni përmbri, me atë valëzim që pllaquritej në breg. Uji i kulluar, qielli i kaltër. Dhe, më tej akoma... Frashëri ky?

Më i madhi i Frashëriotëve, mbështetur në pezulin e dritares së hotelit të Berlinit, mbushet me frymë dhe kënaqet e kënaqet nga përjetimi. Pyje të virgjra gjithnjë të gjelbra, erë e këndshme plot aroma lulesh, ajër i freskët, ujë i ftohtë e i lehtë, gjumë i ëmbël. Dy orë gjumë në Frashër barabar me katër a pesë orë në një vend tjetër!

Naimi, që kishte shkuar për klimë, hera-herës i ushqente vëllezërit me kujtime të bukura e të dhimbshme për vendlindjen. Të dy me Samiun e dëgjonin në hesh-tje dhe një mall i butë i pushtonte lehtas.

Të paskëshin fat e të bëhej shpejt Shqipëria, do të shkonin së toku e të pushonin ca kohë në fshat. Apo s'kishin nevojë për pakëz prehje vëllezërit e tij! Shuhe-shin në punë ditë e natë pa u ankuar asnjëherë. Të vetmin ankim e kishin për gjendjen e mjeruar të Shqipërisë. Gëzimi e shpresa e tyre ishte përlindja e saj. Po treteshin për të bijtë e saj të mirë, ata njerëz zemërmirë, të urtë e të mençur, që i ishin dhënë me mish e me shpirt mëkëmbjes së vendit.

Befas u ndal: a ishte ai me vëllezërit e Komiteti i Stambollit kreu i lëvizjes shqiptare, apo vetë kjo lëvizje i kishte nxjerrë në ballë e i shtynte përpara? Çdo ditë e më fort po bëhej më e qartë kjo e fundit. Ja, për një çast që tronditur nga ngjarja e përgjakshme e Gjakovës. Dhe Malo Gjoni, që i ishte gjendur pranë, i pati thënë:

«Të erdhi keq a çudi? Kështu nisin e kështu bitisin këto punë.» Dhe fap, e kishte goditur dyfekun, si

t'u binte shpatullave të një djali të mbarë. «I thamë Maxhar pashës te lyente kundrat me sapun. S'deshi të dëgjonte. I thamë Abdulla Drenit të mos i bëhej furkë. S'zuri mend e u bë. Epo, ne u dolëm borxhit të dyve, më qafë paçin veten. Ti do të thuash që Abdulla Dreni që goxha burrë. Ç'ti bësh? Kush përzihet me krundet, pulat e hanë!»

Ajri i freskët bëri t'i kalonin të dridhura në trup. Diçka e largët, si e harruar, po i sillej në kokë. Ç'që ajo gjë? Me se lidhej? Nuk po e kapte dot.

Barra e kryefamiljarit, që i pati rënë herët mbi supe, po edhe puna si nëpunës finance në vilajetin e Janinës, e kishin bërë njeri praktik. Si ai bujku, që ndan më parë grurin nga kashta, pastaj nga çekllasat, gjersa e bën kokërrqëruar për në mulli, Abdylti iu vu të sqaronte mendimet, që ta niste mbarë ditën e nesërme.

Në Romë italianët i kishin nxitur. Njëri nga personalitetet e larta, Poneli, kishte pranuar që Kongresi i Berlinit kishte gabuar për shqiptarët. Në Paris Vadingtoni¹⁾ ishte sjellë me përzemërsi, megjithëse më shumë që kujdesur të tregonte sa mirë e fliste greqishten dhe të ekspozonte kulturën e gjerë që zotëronte! Në Londër, biseda e lord Selisborit kishte qenë as mish as peshk. Gazetat evropiane po shkruanin për përcapjet e dy misionarëve shqiptarë dhe për vetë çështjen shqiptare. Popullariteti duhej, ndihmonte. Por s'mund të kënaqej vetëm me të Abdylti. Aq më tepër kur, ndërmjet fjalëve të bukura e buzëqeshjeve, kishte hasur diku një përpjekje për ta shtrembëruar çështjen, diku një kërcënim të fshehtë, diku...

«Sa e madhe forca, aq edhe ideali!» i kishte thënë një diplomat për ta tërhequr nga ballafaqimi i ashpër.

Tani që iu kujtua, kjo thënie e shpoi si gjemb. Forcat fizike i kemi pasur shumë më të pakta në krahasim me ato të kundërshtarëve. E si çamë përmes udhës plot ferra të historisë? Si s'u zhdukëm në qindra vjet robëri romake, në dyndjet sllave, në katërqind e ca vjet errë-

1) Atë kohë ministër i Jashtëm i Francës.

sirë osmane! Me siguri na ka mbajtur ideja kombëtare ngulur te çdo shqiptar që në prehër të nënës, ide që ka ushqyer forcat e pakta fizike e i ka bërë të qëndrojnë e të mos jepen kurrë.»

Atij po i përtërihej në kujtesë historia me gjithë ata shembuj të një trimërie e qëndrese të rrallë. Tani në fund dhe ngjarja që bëri bujë, para se të nisej në Evropë, vrasja e Maxhar Pashës. Qindra e mijëra luftëtarë më këmbë, mbushur me mëri e urrejtje, të gatshëm të ndesheshin me sulltanin e Fuqitë e Mëdha, pa përfillur fare vendimet e tyre!

I entuziazmuar, po dhe si i trembur nga ajo ngjarje, ai kishte thënë me vete se, pasi Evropa ta shkoqiste mirë e mirë punën, atëherë do të mund ta shihnin drejt problemin shqiptar. Me këtë mendim që nisur së bashku me Mehmet Vrionin.

...Fytyra iu përskuq nga një vërshim i furishëm gjaku. Po i dukej se, duke ndenjur gjatë në Evropë, po i braktiste edhe luftëtarët, edhe Lidhjen, e cila ishte bërë jeta e tij. Jo, nuk do ta zgjaste më!

«Italia e Franca nuk janë më këllëçthyerë se Turqia, po s'u pret mirë dhëmbi, ndaj nuk thonë; as po, as jo. Anglia kushedi përse i bën bisht çështjes sonë. Gjermania e Bismarku janë ndryshe. Them se këtu do të marrim një përgjigje të qartë», mendoi dhe e ndjeu se akoma jetonte tek ai bindja për ta ndrequr me të mirë punën, në sajë të drejtësisë së Fuqive të Mëdha.

II

Bujtinari po u jepte shpjegime pyetjeve të tij me një frëngjishte të çalë e të ngathët. Abdyllit i vinte për të qeshur, po kjo e nxiti ta përdorte atë

gjuhë, sido që dhe ky nuk e zotëronte fort mirë.

Doli në një rrugë të drejtë, ku blirët kishin lëshuar cmaqe lulesh. Fletët e gjera u rrinin luleve sipër tamam si llapa. Dukej sikur ishin në një garë të pafundme: gjethet zgjeroheshin për të mos i lënë, cmaqet e luleve zgjateshin për t'u ikur. Gjithsesi blirët e shëndetshëm lëshonin erë të këndshme e të kënaqin syrin, po sa keq, njerëzit o i druheshin kënaqësisë së tyre, o nuk u pëlqente, se në atë rrugë ishin të paktë dhe nxitonin.

Kaloi një pajton elegant që rrëshqiti me të shpejtë, duke prishur monotoninë.

Abdyli e ndoqi me sy e shpejtoi hapat.

Kur arriti në fund të rrugës, një ushtar i krekosur, që i doli përpara, i la të kuptonte se ishte i ndaluar kalimi më tej. Më pas rruga zgjerohej e mbaronte në një shesh. Pas këtij sheshi ngrihej një pallat i madh, hijerëndë, si çdo gjë përreth sheshit.

Një pajton ikte, një vinte. Ca funksionarë prisnin e përcillnin.

«Kjo do të jetë kancelaria, tha ai. Dhe këta janë me siguri diplomatë të huaj. Këto ditë Berlini gëlon syresh. Ku venë gjithë këta? Ç'bëjnë? Kongresi mbaroi e s'ka të mbaruar. Një punë që zvarritet, s'është e mbarë. U mblodhën që të zgjidhin krizën lindore, ama ca punëve u dhanë udhë të prapë. Për ne s'pyetën fare. Dhe unë kam ardhur vetë i dytë t'u them që ka Shqipëri. Ka pasur e ka, ndaj, për hir të së vërtetës, duhet ta ndreqin atë vendimin e padrejtë.»

Shikonte sheshin e mendonte se do t'u duhej dhe atij e Mehmetit të kalonin nëpër të, që të takonin ndonjë burrë shteti gjerman. Cili do t'i priste, vallë? Ç'qëndrim do të mbanin gjermanët ndaj çështjes shqiptare? Dukeshin si të çanësuar. Mirë, tani e dinte ku qe kancelaria. Të shkonte e të merrte Mehmetin dhe ta vinin në lëvizje edhe këtë gur. Apo... sikur ta provonte një herë vetë? Fundja, ç'qe për të bërë, le të bëhej!

Ushtarit i foli me shenja, duke i lënë të kuptonte se qe i huaj e kishte punë zyrtare. Ushtari e përcolli te

një tjetër, ky te një i tretë dhe pastaj u gjend përpara një zyrtari që e përshëndeti me kokë dhe qeshi paksa për mirësjellje.

Abdyli foli së pari turqisht. Zyrtari picërroi sytë e mermëriti nëpër dhëmbë një si ankim. Ngjante sikur donte të thoshte: mos vallë jam i shtrënguar t'i di gjithë këto djaj gjuhë që bërbeliten këtu? Abdyli e ktheu greqisht. Gjermani po njëlloj. Atëherë vizitori përdori frëngjishten e pasigurt. «Ui, ui!» u përgjigj gjermani, që psherëtiu i lehtësuar. Pas kësaj mori qëndrimin serioz të njeriut që pret të dëgjojë.

«Këtij guaku lipset t'i imponohem. Është kush është, por o të hap udhë, o ta mbyll dhe bjeri këmbës ti.» — mendonte Abdyli.

Me një vetëpërmbajtje plot dinjitet i tha se kush ishte e përse vinte. Zyrtari s'po vendoste dot ç't'i përgjigjej. Pastaj, kur Abdyli përsëriti kërkesën, ai drejtoi trupin e zgjati dorën.

Kërkonte kartëvizitën! Abdyli nuk kishte kartëvizitë. Duke parë sa me seriozitet e priste atë nëpunësi gjerman, ai mendoi se edhe një gjë e tillë mund t'i prishte punë. Futu dorën në xhep fare kot. Dora i preku një diçka të fortë e të lëmuar. E nxori ta shihte. Fotografia e tij. Kishte dalë me kostum kombëtar. Një ditë më parë ishte çmallur me të e i kishte mbetur në xhep.

Nëpunësi zgjati dorën edhe më. Abdyli pa atë, pastaj fotografinë dhe menjëherë i shkoi ndër mend se mund ta përdorte. Pse jo? E ktheu nga pas, shënoi: «Abdyli Frashëri, përfaqësues i Lidhjes Shqiptare» e ia dha zyrtarit.

Gjermani në fillim shtangu. Pastaj qeshi, prapë u ngurosoi e prapë qeshi. Kjo kartëvizitë e pazakontë e ngathtësoi atë dhe nuk po dinte si të vepronte.

Ndërkohë Abdyli shënoi në një copë letër adresën e bujtinës e ia dha edhe atë. Gjermani mermëriti prapë «Ui, ui!» e tundi kokën.

Abdyli u ndje i lehtësuar. Iu kthye më me nge rrugës së bukur me blirë. Ecte ngadalë, i qetë, i sigurt, duke thithur me ëndje aromën e këndshme. Po men-

donte që, nëse audienca do të bëhej, cili do ta priste vallë?

Pandehma se mund të ishte Bismarku vetë, i shkaktoi emociione. Për Bismarkun flitej aq shumë kudo. Ç'burrë që, vallë? Apo diplomat, si sa e sa të tjerë? Eh, këta diplomatët! — mendoj. Skotë e ngatërruar. U mungon çiltërsia, paanësia, shpesh edhe burrëria. Buzëqeshje të shtirura, lajka akoma më të shtirura, seriozitet Jupiteri një çast, biseda tërkuzë në një çast tjetër. Si gjarpërinj. Zvarritje, vëzhgim, sulm, tërheqje. Prapë vëzhgim e prapë sulm. Të koklavitura bisedat me ta. Të vështira e të lodhshme. Eh, sa ndryshe mund të dukeshin nga Stambolli! Vëllezërit e Pashko Vasa, sado të mençur, nuk mund ta kuptojnë këtë. U dashka ta prekësh, t'i marrësh erë, të provosh cingrisjen e nervave teksa ndien si afrohet e largohet shpresa, këtu gati ta kapësh, atje fare e padukshme. Ne jemi të çiltër, të hapur, guximi s'na mungon, ndaj zor ta bëjmë tonën diplomacinë. Dhe në e bëfshim, do të jetë ndryshe, kështu jo...

Në bujtinë u kthye vonë.

Në mbresat e këndshme që i kishte lënë dorëzimi i asaj fotografie-kartëvizitë, u zhvesh e ra të flinte duke kujtuar se do të bënte një gjumë të mirë. Mirëpo, me të rënë në shtrat, një gjë e mprehtë sikur e shpoi nga brenda. Nuk ndjeu asnjë dhimbje po u ngrit ndenjor. Diku thellë po i përvijohet një fytyrë e njohur, e ashpër, me një shikim të mprehtë.

Ishte Malo Gjoni.

I habitur për takimin e beftë, as nuk e largoi, as e afroi.

Udhëtonin të dy para se Abdylit të nisej për në Itali. Zbrisnin nëpër një grykë mali. Aty-këtu midis shkrepareve shkëmborë dukej e zhdukej një copë fushë, pastaj qyteti. Malo Gjoni hipur në një mushkë korane këndonte:

Col Delia, sysahati,

i lumtë goja, fort vikati:

—Vetë po jes, pashën po e çarti!

Ç'qe ky Malo Gjoni? Toskë e dinte Abdyl, gegërisht këndonte Maloja. Malo Gjoni! Dy emra që u përkitnin feve të ndryshme tek i njëjti njeri. Çudi me shqiptarin, tha. Paçka se ka qënduar në mes feja, ai ruan të pandryshuara zakonet, këngët. Mëmëdhedashurinë, po se po. Kockë e fortë, nuk e mbrun dot e huaja. Feja e shqiptarit është shqiptaria. Mirë e ka gjetur Pashko Vasa. Kjo është e vërteta e jetës vetë. E pyet Malo Gjoni: ç'je ti? Dhe ai ta jep përgjigjen pa u menduar fare: shqiptar jam! Të lipset t'i bësh një puetje të dytë që të të thotë ç'feje i përket. Dhe përgjigjen e kësaj e jep duke mermëritur.

Hipur mbi një mushkë sivake e rehatuar mbi një velenxë, që Maloja ia kishte shtruar në samar, Abdyl mendonte për të.

Fshatar qe Maloja, po e kishte lënë fshatin e jetonte me qiraxhillëk. I pati sjellë shërbime dhe jo vetëm një herë. Sesi i gjendej pranë kur vinte në Prizren, në Gjakovë a kudo gjetkë. Në udhëtime të këtilla s'ae më qiraxhi, po shoqërues e luftëtar, besëlidhës i pakursyer.

Ia pa qafën e rreshkët. pjekur naa dielli e era, lëkundien e lehtë naa troshitja e mushkës në të tatëpietë dhe pati një dëshirë aë të dinte më shumë për të. Kur po matej ta pyeste, Malo Gjoni e la këngën e u kthye anash në samar.

— Abdyl bej, ç'marrkam vesh: zotrote degdisesh Evrovit, të bësh Shaipëri? Ë, Abdyl bej?

Kjo Abdyl bej! Të paktën ky qiraxhi e luftëtar tok, njeri i mirë e i vuajtur, të mos e thërriste me atë titull. Ndoshta se e dinte që ai ishte shpërnqulur nga fshati prej zullumeve të një beu. Ndoshta naaë vetë Abdyli rronte me punën e vet e jo me bejllëkun e ronitur. A t'i bënte të ditur se ai e vëllezërit e përdornin me qejf emrin e babait e të fshatit, por gati hiç fare atë titull?

— Kështu, Abdyl bej?

— Po, o njeri i mirë.

— E, eh! — rënkoj Malo Gjoni.

— Pse më pyet, Malo?

— E, ashtu. E di? Më shkrepni njëherë t'i bija udhës me të prerë. Isha lodhur e mërzhitur pa masë e s'më durohej sa të sosja në shtëpi. Do ti, ngava një udhë që m'u duk e paqme, po ç'e do, më shpuri në një pyll e atje humbiste. Hej, ç'hoqa unë i gjori gjersa dola në një tragë!

— Demek, unë kam zënë një udhë qorre?

— I mençur je vetë, po... a ta them edhe një llaf?

— Thuaje.

— Nijet të mirë ke. Mall e gjë shite për këtë nijet, ti qofsh, e të paçim. Po me mëshirën e të tjerëve, them, s'bëhet Shqipëri. Rusia, thua ti? E ka marrë nën sjetull shkjaun. E bëri beli sot e një vit të shkuar. Franca grekun. Pa çoc ma thotë mendja që Evropa Ruisë ia ka shupenë e s'e lë të dalë në det, po dhe turkun e do kështu si është katandisur, të panavaksur, ama, jo të zhbërë. Ndaj them që e vajtura tek ata është si ajo rrota e pestë e qerres.

Maloja e shaloj prapë mushkën. Sërish ia mori këngës, po një tjetre:

«U shoqç, moj Evropë, eee!»...

Pas pak diç iu kujtua, e la këngën në mes e shtoi:

— Me dirsë e ha bukën unë, ti e di. Po në udhë njeriu has turli syfete. Ku ta dish ç'janë. Ti i jep vaktin, ai të hidhet përsysh. Aherë fap ia bëj unë dhe...

Ai përveshi pakëz silahun e u dukën tek rrinin ngjeshur në të një kobure e një kamë...

U mbështet në jastëk e ia nguli sytë dritares. Përmes perdeve të rënda gjente vend e hynte një fjollë e zbehtë drite. Tundej lehtë perdja nga era dhe fjolla e dritës dridhërohej e binte në murin përkarshi.

Ç'donte Malo Gjoni? Një kohë e pati harruar krejt, pse po i kujtohej pikërisht tashti, kur priste takimin më të rëndësishëm?

Luhatja ndërmjet sigurisë e pasigurisë për misionin që kishte marrë përsipër, kishte hedhur rrënjë

në shpirtin e tij. Krimbi i dyshimit e gërvishte vazhdimisht. Sado e vagëlluar, sado e çoroditur, megjithatë, shpresa për suksesin e misionit s'i qe shuar.

III

Pas dy ditësh i thanë se do ta priste Bismarku.

Ky lajm e tronditi, bile iu duk si një ogur i mbarë. Më në fund!

Audienca do të bëhej në shtëpinë e kancelarit.

Abdyli nuk u çudit aspak. Ministri i jashtëm anglez, lord Selisbori, gjithashtu në shtëpi i kishte pritur. Druhej të bënte takim me ta në ministri, meqë nuk kishte pranuar një dërgatë bullgare ca kohë më parë. Bismarku kushedi ç'shkak do të gjente. Ose kot, ashtu i qe tekur.

Ndihej i emocionuar e mezi i pritej. Sikur ta kishte dhe Mehmetin! Në takime të tilla një shok është gjë e madhe. Mbështetje, forcë, më tepër siguri. Po Mehmeti...

Shtëpia e Bismarkut qe e madhe dhe hijerëndë. Me rojë përjashta e në korridore. Një burrë i veshur me frak e çoi në një sallon të gjerë me pak mobilje. Pa fjalë, si në një rit, gjithnjë duke e parë vjedhurazi me kërshtëri, shtyu një derë tjetër dhe hynë në një sallon të dytë më të përmbledhur. Përballë ndodhej një tryezë e trashë me një ngjyrë të kuqe të errët si narden. Ajo dukej në kabinet si një shkëmb i rëndë, prapa së cilës bënte rojë një poltronë e lartë.

Nuk arriti të vinte re gjë tjetër, se u hap dera anësore. Një shërbëtor që hyri me nxitim prej andej, shtyu dhe kanatin e dytë e u përkul duke qëndruar si i ngusrosur.

Në derë u duk një burrë hijerëndë, veshur me një kostum të thjeshtë junkeri. Ai qëndroi një çast si në mëdyshje. Dukej sikur po ngrurronte të hynte. Për një çast Abdyli iu duk sikur Bismarku do të kthehej prapë. Ai e njohu, se e kishte parë shumë herë portretin e kancelarit nëpër gazeta. Por e dinte trupmadh e si kaba, ndofta për shkak të disa karikaturave ku atë e paraqitnin të tillë. Në të vërtetë figurën e tij e zvogëlonin ca dera e madhe dhe kostumi i thjeshtë. Pastaj, kur e vuri re mirë, u bind që ai kostum e tregonte shumë autoritar.

Bismarku zuri vend në karrige. Që atje i hodhi një sy vizitorit. Në fytyrën e gjerë, si të mbufator, me nofulla të shtrënguara fort, mustaqet e sarta si qime derri ngjanin si të ngjitura me llak.

Gjëja e parë që i ra në sy Abdyli qe zyrtësia e kancelarit. «E shpërndante ai përreth zyrtësinë, apo duke thithur zyrtësinë e mjedisit bëhej dhe vetë mishërim i saj?» Abdyli u shkund e hoqi dorë nga këto hamendje.

Afër tryezës rrinte në këmbë dhe shoqëruesi me frak. Gjithçka në kabinet kishte ngrirë. Tiktaku i një ore muri e bënte heshtjen dhe më të ftohtë.

Bismarku u ndeh pakëz dhe me vështrimin e topitur sikur tha: «Ë? Ç'është?»

Pastaj u lëshua në poltronë. Gishtin e madh e nguli në filiqen e shiritit anësor të uniformës. Në qëndrimin e tij të papërcaktuar lexohej diçka ndërmjet «Po të dëgjoj» dhe «S'ta kam ngenë».

Ai ktheu kokën nga njeriu me frak, që, me sa dukej, e kishte këshilltar. Këshilltari u përkul kur ndeshi shikimin e tij.

Për Abdylin audienca qe sa e çuditshme, aq dhe e paqartë. E përligji me mend duke thënë se njerëzit e ngritur në shkallën më të lartë të pushtetit bëhen tekanjuzë e mundohen t'u japin ngjyra origjinale ceremonive të tilla.

— Zotëri, vij këtu si zësjellës i kombit shqiptar...

Bismarku lëvizi njërën vetull. Këshilltari u shqetësua dhe bëri një hap, sikur ta ndante më mirë dis-

tancën ndërmjet vizitorit e kancelarit. Abdyli nuk e gjeti dot me mend shkaku e shqetësimit të tyre. Dhe s'kishte si ta gjente.

«Ç'është ky që më drejtohet në mënyrë kaq të rëndomtë? Dhe pse s'ka mësuar gjermanisht, meqë kërkoi audiencën time? Ah, kjo Franca! E vë poshtë ushtarakisht, ia shtrëngon fytyrën ekonomikisht, thua se vate, mbaroi dhe ja, ngrihet atje ku s'e pret: edhe një njeri nga një vend i humbur, pa shtet, vjen e më flet frëngjisht!»

Duke u grindur kështu me vete, Bismarku u përpoq të sillte ndër mend ç'dinte për Abdylin. Ai që i pati dhënë kartëvizitën e tij të çuditshme, i bëri të ditur që Abdyli ishte deputet në parlamentin turk dhe udhëheqës i lëvizjes shqiptare. I hodhi një sy hetues. Burrë në moshën e pjekurisë, rreth dyzet vjeç, ballëgjjerë, veshur hijshëm, Abdyli fliste me guxim dhe kancelari gjerman u zemërua me të, por edhe e simpatizoi.

«Unë Shqipërinë e kam quajtur thjesht një shprehje gjeografike. A e di ky?» i shkoi në mendje e u ndeh të dëgjonte më mirë.

— Kombi ynë ka gjuhën e vet, traditën dhe zakonet e vet të lashta e të lavdishme. Ai është më i vjetri komb në Ballkan dhe një nga më të vjetrit në Evropë...

Bismarku rrudhi prapë vetullën. Dhe prapë këshilltari u shqetësua. Kancelari provonte një ngacmim gati alergjik kur dikush i vishte një kombi tjetër lashtësinë e lavdinë, sikur këto virtyte t'u takonin vetëm prusianëve.

— Ç'kërkon nga unë? — i ra shkurt Bismarku.

— Të ndryshohet vendimi që copëton trojet e vendit tim.

Kancelari lëvizi rëndë-rëndë.

— Mirë, dëgjova, — tha.

Këshilltari mori drejtqëndrim. Abdyli u ndodh edhe një herë para një gjendjeje të papërcaktuar. Me intuitë e mori vesh që kancelari i kishte dhënë fund audiencës.

«Si, me kaq?» hëngri veten Abdyli.

— Thashë që dëgjova, — përsëriti Bismarku e u kthye nga njeriu i vet, duke vënë dorën mbi tryezë për t'u ngritur.

— Pas së dëgjuarës, vjen e folura, — tha Abdyli ngadalë, shkoqur.

Teksa bëhej gati të shpërthente, kancelari bëri një konstatim të leverdishëm, që ia uli tërbimin.

«Idealist, mendoi. Paska akoma idealistë? Këta janë njerëz të fryrë nga dukja e fjalët. Po t'ua përkëdhelësh egon, i bën për vete. Në atë zonë ku pleksen kaq interesa politike të kohës, një kokëkrisur si ky mund të më hyjë në punë.»

E ftoi Abdylin të ulej.

— Ne personin tuaj shoh një burrë të shquar, — i tha.

Abdyli u ngreh. Ku dhe përse po i zinin pritë?

— Zoti kancelar, unë jam këtu si përfaqësues i Lidhjes Shqiptare, — vërejtí. — Në më pak se një vit Lidhja jonë tejshkoi edhe mendimin e ëndërrimtarit më të zjarrtë. Shqiptarët janë bashkuar rreth saj, gati të vdesin me armë në dorë, në qentë nevoja, po nuk lejojnë t'u rrëmbehen trojet.

Bismarku e pa me dëshpërim. Gjynah, s'e kishte gëlltitur dot karremin. Do të qe gjë e bukur. Po të hiqte dorë, a të provonte rishtas? Njeri i sertë. Turqia i kishte fajet. Prandaj gjendej buzë varrit ajo. Se nuk ua mblidhte rripat ca të këtilëve. Po ç'kujtonte ky, se mos ishte në oborrin e sulltanit? S'e dinte ky se Bismarku nuk pyeste jo më për Shqipëri e Lidhje Shqiptare, por as për vetë Turqinë? Shumë po e duronte. Vetullngrysur theksoi:

— Kongresi i Berlinit nuk u thirr të shpërblejë Turqinë. Kush humbet, paguan.

— Veçse jo me tokat tona. Turqia të sajat i ka në Anadoll.

— Turqia është perandori. Dhe ju... ju jeni një shtetas i saj. Apo e mohoni?

Abdyli i bëri bisht përgjigjes së drejtpërdrejtë.

— Ajo që kërkojmë ne ka të bëjë me Shqipërinë.

Shqiptarët gjithnjë kanë ruajtur një gjysmë pavarësie, që kurrkush nuk ka guxuar ta shkelë. Është koha që mëvetësia jonë të bëhet e plotë. Ne shpresojmë në për-krahjen e Evropës, e jo më të na copëtohet vendi.

Bismarku trazoi letrat që kishte mbi tryezë.

— Unë e kam thënë: përfshirja e një mase të konsiderueshme nga raca juaj... luftarake në territorin e një shteti fqinj, kërcënon vetë të ardhmen e atij shteti. Sa për ndonjë krahinë... sikur njohëm të drejtat e një krahine tuaj...

— Të Mirditës, — nxitoi ta kujtonte këshilltari.

— Hë, po, Mirdita!

«Venomet e Mirditës!» tha me tallje Abdyli.

Bisedën e ngau në shtegun që i hapi vetë kancelari.

— Kombi, siç e dini fare mirë, nuk është një grumbull krahinash që mund të veçohen e të bashkohen sipas interesave të njërit apo të tjetrit shtet. Ishte fort i ligjshëm zemërimi i gjermanit të ndershëm kur Napoleon i sillej si ia donte qejfi me ndarjen dhe administrimin e Gjermanisë.

Bismarku u thartua në fytyrë. Ky vizitor i krisur guxonte të bënte krahasim ndërmjet Gjermanisë dhe një vendi të humbur, pa shtet! Dhe ç'gjuhë përdorte, se!

— Jo me inat, ne s'jemi në luftë, — e këshilloi si një mësues. — Perandoria Turke, me sa di unë, nuk e ka njohur asnjëherë kombin tuaj.

— Po të qe ndryshe, nuk do të isha sot para jush. Ne kërkojmë të drejtat tona.

— Kongresi i Berlinit do të jetë historik për fatet e botës, — u mburr kryetari i tij.

— Po jo të bëjë padrejtësi të reja!

— Ashtu?!

Bismarkut iu bë dhe më e fortë ndjenja e pendimit, që e shqetësonte, pasi rëndësia e detyrës e shtrëngonte të përmbahej dhe e pengonte kësisoj të sillej siç ia donte qejfi, në pajtim me karakterin e tij të rreptë. Ndërkaq iu kujtuan disa fakte që mendoi se do të ki-

shin tërbuar edhe kancelarin më të butë: shqiptarët nuk e njihnin vendimin e Kongresit dhe kishin guxuar të vritnin një mareshal, Mehmet Ali Pashën, të dërguarin e Turqisë dhe të vetë Kongresit, për t'i bindur ta zbatonin atë vendim.

Ai u ngrit e shtrëngoi fort kartolinën që vërtiste në dorë. Abdyli e njohu: qe kartëvizita e tij.

Kancelarit i kishte bërë përshtypje ajo kartëvizitë. Ia kishte nxitur kërshtërinë. Qe një shkak më tepër për ta pranuar Abdylin. Po ndryshe e përfytyronte takimin me të: përujje, ca fjalë si hyrje për madhështinë e tij, pastaj ndonjë lutje me gjysmë zëri. Kancelari mund të bënte ndonjë premtim të mjegullt, jo më shumë.

Kurse tani padashur kishte hyrë në një dialog të papëlqyeshëm. Iu duk se do të ishte fyes për të, po ta vazhdonte akoma.

Abdyli fërkoï mjekrën. Keq e më keq po shkonte takimi. Ta dinte kështu, s'do ta kishte kërkuar kurrë.

«Ky s'më kupton, apo s'do të më kuptojë? Me sa shoh, hallet tona në një vesh i hyjnë, nga tjetri i dalin. Apo s'i futen fare në kokë? Si mund të mallëngjehet ky njeri?»

Bismarku më në fund mendoi se i gjeti fjalët e mbylljes.

— Nuk jemi thirrur të ringjallim gjëra të vdekura e të harruara, — tha hijerëndë. — Historia njih shuarjen e kombeve edhe më të mëdha e më të qytetëruara. I shkrijnë në vetvete më të fuqishmit. Ky është vullneti i historisë.

Abdylit sikur i hodhën në kokë një kovë me ujë të ftohtë. Me ç'mend kishte vajtur t'i kërkonte drejtësi këtij përbindëshi? Ja, aty mbaronte diplomacia e dorezave të bardha! Kthetrat kishin dalë sheshit.

«Malo Gjoni, o trim!» mërmëriti me dhimbje në shpirt, duke sjellë ndër mend këshillën e shoqëruesit, të cilit tanimë i shtoi një virtyt të ri, atë të politikanit të zgjuar, me këmbët në taban...

«Epo mirë, më s'kam ç'të humbas!» mendoj dhe u ngrit e i qëndroi përballë kancelarit.

— Shqiptarët kanë luftuar qindra vite me romakët e bizantinët. U qëndruan rrebesheve të dyndjeve sllave. Po luftojnë prej më shumë se katërqind vjetësh me turqit. A nuk dëshmojnë këto që kombi ynë mund të luftojë akoma, dhe me cilindo?

— Ç'komb? Unë nuk njoh komb shqiptar! — tha me përçmim Bismarku.

— Mosnjohja nuk është baras me mosqenien! — iu përgjigj flakë për flakë Abdyli.

— Zotëri!

Nga gjoksi i Bismarkut shpërtheu një zë metalik që jehoi gjatë në kabinet. U duk sikur në gojën e tij në vend të dhëmbëve kishte dy sërë plumbash. Abdyli nuk u shqetësua, po përkundrazi u gëzua që tjetri s'e mbajti dot veten. Le të shtirej për Qezar a Napoleon Bismarku, punë për të, po për Shqipërinë të mos fliste kështu! Për kombin e tij, për luftën e tij, ai e ngrinte zërin në kupë të qiellit dhe e derdhte gjakun pa ngurrim. Kancelari ta dinte mirë!

Sjellja e vizitorit qe aq e pazakontë, saqë për një çast kancelari s'diti ç'të bënte. Dhe prapë vështroi fotografinë që mbante në dorë. Ndenjur këmbë mbi këmbë, Abdyli e vështronte që andej me mospërfillje. Opinga me xhufkë i tregonte kancelarit tabanin si një gradë e kthyer përmbys.

Ndërkaq, si për t'i vënë kapele bisedës e për t'i ulur ndjenjën e triumfit, Bismarku tha:

— Nënshtroruni vullnetit të historisë!

Këto fjalë tingëlluan si një këshillë që i jepet një fëmije: «Hë, mëso dhe rri urtë!»

— Historinë e vendit tonë e njohim më mirë nga kushdo tjetër. Ajo nuk na mëson të nënshtrohemi.

— Sa para bën? Historinë, dihet, e bëjnë fitimtarët.

— E kush na i përcaktoka këta?

Pyetja goditi si predhë. Kancelari bëri të mblidhte grushtet dhe shtrëngoi fotografinë. E hapi pëllëmbën e

e pa. Pa atë, pástaj Abdylin, përsëri fotografinë. Për të parën herë mendoi se mos ai ia kishte dhënë me qëllim atë kartëvizitë të çuditshme.

Vërtet, mos donte t'i thoshte ai vizitor që kombi shqiptar rron e do të rrojë, pa pyetur fare as për atë, kancelarin e hekurit?

Ai e grisi fotografinë më dysh. Nuk u mjaftua, i vuri të dyja copat mbi njëra-tjetrën dhe i grisi prapë. Pástaj i flaku përdhe.

Abdyli iu dhimbs. Iu duk sikur i kishte këputur diçka të brendshme, të shpirtit. Por, teksa shihte copëzat të binin në qilim, një gjë e madhe, e fortë i dilte së brendshmi. Po ndiente se tek ai po ndodhte diçka. E kuptoi: po ndahej përfundimisht nga një iluzion, që i qe ngulur kushedi qëkur dhe që e mbante me shumë shpresa.

— E shoh se përçapjet tona ju nuk i përfillni, zotëri. Nuk na vjen mirë, natyrisht. Ne do të donim që bota e qytetëruar t'i çmonte më ndryshe përpjekjet e një populli liridashës. Por... na vjen keq! Veç, ta dini mirë, nuk do të rrimë duke pritur në mëshirën e fatit, apo... tuajën. Puna juaj me Traktatin mbaron, puna jonë si shqiptarë këtu fillon!

Pas këtyre fjalëve, si të mos kishte ndodhur asgjë e pazakontë, përkuli pakëz kokën në shenjë përsëritjeje e ktheu krahët. Nuk priti shoqëruesin. Doli vetë nga kabineti i kancelarit dhe nxitoi në korridor. Ndihej vetëm kumbimi i hapave të tij. Rojat e shihnin të vrenjtur, gati ta arrestonin, me shenjë e parë, për shkak se po sfidonte qetësinë, e sidomos zyrtësinë e atij pallati, duke u sjellë me aq mospërfillje.

Kur u gjend jashtë, në rrugën me blirë, ai pshëretiu thellë e u mbush me frymë fort, disa herë radhazi.

«Ja ç'na qenka dhe ky Bismarku! I fuqishëm si perandor, i padrejtë si sundimtar, mirëpo, kur ia përplas të vërtetën në sy, ngelet si guak, i duket si rrufe e rënë nga qielli, se nuk është mësuar kurrë ta kundërshtojnë.

«Tashti duhet ikur. Një sahat e më parë. Ne bëme ç'na takonte. E nxorëm edhe këtë merak. Zëri u dha, u përhap. Do të ziejë ca kohë. Diku do të gjejë miratim, diku kundërshtim. Po, për të shuar, nuk do të shuhet më. Veç në ndenjshim ne duarkryq! Po kjo s'ka për të ndodhur. As sot, as mot! Këtej e tutje shqiptarët do t'i marrin me pahir ato që u takojnë!» tha, si të merrte një zotim, kryetari i Lidhjes Shqiptare.

ROBINJA

Vetëm, në një humbellë të errët e me lagështi, Hasa, nuse e re nga fshati Bregac i Kosovës, truante fatin e saj të zi. Pse s'e kishte marrë ndonjë plumb ose ta kishte përshkuar tejtejt ndonjë kamë? Përleshja kishte qenë e ashpër e mizore dhe nga të dyja palët kishin gjetur vdekjen shumë njerëz. Ashtu nuk do të torturohej nga mendimet ogurzeza, që ndjell një nuse e re dhe e bukur kur bie robinjë në duart e armikut, me të cilin është gjakosur e kundër të cilit ka marrë hak.

«Veç robinjë të mos bëhesha! Zot, o zot, ç'më gjeti mua të shkretën!»

Ditën e parë nuk shihte gjë prej gjëje. Po dalngadalë sytë iu mësuan në njëfarë mënyre me atë terr të dendur dhe atëherë, me një kërshëri përzier me frikë, nisi të vëzhgonte gjithçka. Nga njëra anë ngrihej një mur i trashë me gurë të mëdhenj, vënë njëri mbi tjetrin si kishte qëlluar. Ndonjëri dilte më tepër e formonte njëfarë pragu. Dukej më shumë si një prëzim i prerë në shkëmb, sesa si mur i bërë nga dorë

njeriu. Njëpërmjet të çarave midis gurëve të mëdhenj muri djersinte kushedi prej sa kohe. Përfund bulëzat e djersës së ftohtë sikur pikseshin e shndërroheshin në një myshk të gjelbër në të zi. Teprica pikonte poshtë ritmikiisht, pandërprerë.

Hasa mbante vesh. Pikat kishin secila tingëllimin e vet, të ndryshëm e të ngjashëm njëkohësisht. Truri i saj i nxehtë gjeti njëfarë prehjeje. Po nuk kaloi më tepër se një orë, kur pikat sikur u grupuan në një të vetme dhe kjo pikë e vetme i bëhej sikur i binte mu në çaçkë të kokës. Vuri të dyja duart në kokë. Nuk i pengonte dot. Çdo pikë, një cingërisje shqetësuese nervash. I zuri veshët me pëllëmbë. Ashtu po, pikat e tmerrshme nuk kishin më fuqi. Oh, sa mirë! Psherëtiu e lehtësuar. I hoqi duart, gjithçka u përsërit më me egërsi. Si të bënte? Nuk mund t'i mbante duart vazhdimisht shtrënguar pas veshëve.

Afër shtratit të drunjtë gjendej një shtambë uji. Një shtambë qafëgjatë, me një vegël, si lejlek. Sikur ta vinte nën pikë? E provoi, po s'doli gjë.

Robinja psherëtiu me dëshpërim dhe e la ku ishte.

Pastaj u ul e i gërreu gropëzat e pikave. I mbushi me dhe të skërmitur. Në dheun e shkrifët pikat binin butë-butë, si në pambuk. Kjo mund të durohej.

Hasa ndenji në rrëzë të shtratit dhe vijoi të vëzhgonte përreth. Ngriti kokën lart. A kishte tavan, vallë? Sado që u mundua, nuk e shqoi dot. Diku ndodhej një brimë e që atje vinte pakëz dritë. Anët e vrimës ngjanin me një zgërbonjë lisi.

— A thua qelia është ngulur e tëra në tokë e që andej mund të dilet përjashta?

Zëri i saj i mekur pati një tingëllim të çuditshëm, sa ajo nuk e njohu dhe u tremb.

Jehona e zbehtë humbi skutave. Asnjë zhurmë tjetër. Asnjë zë njeriu. Asnjë frymë gjallese. Sikur e kishin varrosur për së gjalli në një gropë të madhe, të thellë. Iu duk vetja si në një shkretëtirë të nëndheshme, të largët e të pështirë.

— Kuku, e shkreta unë!

Edhe një herë akoma nuk e njohu zërin e vet. Edhe një herë u tremb prej tij.

«Qyqja, po bëj si një çikë e lazdruese!» mendoi.

E patën hequr shpejt nga burgu i Gilanit. Gilani gjendej afër fshatit të saj. Andej lufta vijonte. Azemi e Shota me komitet mund të mësynin burgun e të lironin atë e të tjerë. Se do të kishte edhe të tjerë shqiptarë në burgun e Gilanit. Ajo nuk i kishte parë, por e dinte. Sa ndenji në atë burg, shpresat nuk e lanë asnjëherë. Mirëpo e çuan në kështjellë. Natën e patën hequr. Natën udhëtuan. Ajo nuk arriti të merrte vesh asgjë. Me atë pak sërabishte që dinte, mundi të kapte nja dy fjalë: Nish dhe kështjellë. Ç'lidhje kishte ndërmjet tyre? Kështjellën e dinte ç'qe. Pati dëgjuar për të. Në një këngë të moçme për Skënderbeun. Për Nishin nuk kishte dëgjuar. Mund të qe ndonjë fshat a qytet. Ose krahinë. Pra: Nish e kështjellë. Kështjella e Nishit.

Këtë emër mbante varri ku e kishin rrasur? Megjithëse natë, në të hyrë i pati dalluar konturet e trishituara të rrënojave të hershme.

Diku thellë u dëgjua një gjëmim i mbytur. Gjëmimi sa vinte shtohej e kthehej në rrapëllimë. Hapat e dikujt, që ecte nëpër llagëmet e kështjellës. Hapat qartësoheshin gjithnjë e më tepër, gjëmimi shtyhej më thellë. Pra, dikush po afrohej. Hapat u ndalën para qelisë. Nëpër të çarat e derës u luhat një dritë. Ky dikush u kollit si me ngërç.

«Hej, po ky druhet, apo diç sajon?»

Pas një kollitjeje tjetër paralajmëruese, dera e rëndë, që kriste, u hap. Nën dritën e pakët të një feneri me qiri, Hasa u përpoq të shihte. Ishte një njeri fytyrëzbehtë, i dobët, me një kobure të rëndë varur në brez. Koburja qe, pa dyshim, e madhe për të dhe ia tërhiqte poshtë me ngulm rripin e gjerë. Nuk dallohej në qe ushtar apo xhandar.

— Dëshiron të dalësh përjashta?

Hasa ia nguli sytë.

— Mbase ke ndonjë nevojë?

Njeriu i pakët pa përtej robinjës, si të druhej mos haste sytë e saj hetues. Në shikimin e tij, gjithashtu dhe në sjelljen e qëndrimin e tij binte në sy një si lodhje. Robinja u mundua të pikaste ndonjë qëllim të keq, sado të fshehtë, po s'ia arriti dot.

— Ditë a natë është? — pyeti për të fituar kohë.

— Ditë.

Oh, sa do të donte të dilte, qoftë dhe për një minutë të vetme! Të thithte një herë ajër të freskët. Të ngopte sytë me dritë e diell. A do të kishte diell përjashta? A ishte i kthjellët qielli, vallë?

Prapë ngurroi. Në qeli, sado keq, sido që e veçuar, sepse ndihej më e sigurt. I druhej çdo ndryshimi të gjendjes. I bëhej se do t'i sillte diçka të befte, të keqe.

Njeriu te dera nuk ngutej. Një herë i ktheu sytë nga ajo. Sytë e tij nuk ishin të egër, as lakmues, më tepër shprehnin njëfarë kureshtjeje. «A thua të ketë shkja të mirë?»

Kjo qe një pyetje që i erdhi befas në kokë.

Më në fund kuturisi. E kërkonte me ëndje një çikëz dritë. Do ta kishte pas pak. Edhe ajër sa të donte. Të freskët, të pastër. Ndoshta përjashta do të dëgjonte ndonjë zog. Ndoshta...

Ajo ecte pas shoqëruesit.

E befasuar nga drita (ishte ditë e bukur, me diell), Hasa, që s'po ngopej së pari qiellin e kaltër, nuk vuri re aspak një oficer që ia qepi sytë me habi e eps. Robinja u befasua nga bukuria e ditës, oficeri nga bukuria e robinjës.

— Khe, khe! — u kollit oficeri.

Shoqëruesi vetiu bëri një hap përpara, si t'i ndante. Robinja ktheu kokën. E pa oficerin dhe vuri pëllëmbët në fytyrë. Nuk kishte me se tjetër të mbulohej.

— Hej, ti, sille në zyrën time! Tashti! — tha oficeri.

«Kuku!» mërmëriti Hasa e u drodh, duke e parë me frikë oficerin që shkante përpara.

U kthye nga shoqëruesi.

«Ky duket më ndryshe. Do t'i them, do t'i lutem!», mendoi, por as atij s'i tha gjë.

Oficeri ndenji më këmbë karshi dritares së vetme të zyrës. Ishte i gjatë, i ri, me mustaqe të holla. Nuk e ktheu kokën. Me sa dukej nuk e kishte të lehtë të sillej mospërfillës. Me buzën e poshtme të tultë përkëdhelte mustaqet.

— Ti ke vrarë tre nga tanët, — tha qetë e si i shkujdesur.

Ngjante se po u fliste dritares a hekurave të saj.

«Po të mundja, do të kisha vrarë më shumë. Besa, nuk do të nginjsha pa ju faruar krejt!» iu përgjigj me mend Hasa.

Asaj iu mbushën sytë me lot. Shpagimi për dy vëllezërit e dashur, Xhemën e Delinë, nuk shlyhej dot një me një. Pastaj burri...

Ia nguli shikimin oficerit me neveri e urrejtje. Se po ia hapte plagët. Po ia trazonte keq. Kurse ajo, tanimë robinjë, s'bënte dot më asgjë për të shprehur dufin.

Oficeri sërb e ndjeu mbi vete shikimin e saj e u kthye. Kur hasi sytë e tij, qerpikët e gjatë e të dendur të robinjës u përpëlitën. Ai shtangu i mahnitur.

«Zot, ç'vështrim! Zot, sa e bukur! Kjo të ha me sy e të ther me vetull e me qerpik!»

Dëshira që ta shtinte në dorë sa më parë e përpiu krejt. Bukuria e egër e saj, ai shpirt krenar mbushur me mëri, e tundonin fort.

— E di ti, ç'i pret ata që bëjnë një krim kaq të shëmtuar?

Oficeri më parë donte ta trembte që ajo ta zbuste kundërshtimin.

«Ç'është ajo femër që s'i kupton këto marifete të shpëlara? Qite kokën, gjarpër!» mendonte nusja e re.

Oficeri mendonte ndryshe.

«Robi është skllav. I nënshtrohet vullnetit të të zot. Robinja është skllave. Qoftë dhe e bukur si kjo shqiptarka. Unë jam zoti i saj. Mua do të më nështrohet. O perëndi, ku ma gjete zemrën! Një zog i tillë s'të vjen çdo ditë në dorë. Asaj i dhimbset jeta. Çdo

femre i dhimbset jeta, sidomos kur është e bukur. Ia ka frikën vdekjes. Bën ç'ti thuash, që të shpëtojë. Unë do t'i premtoj jetën dhe ajo, nga luaneshë e egër, siç është tani, do të bëhet dele. Jo dele, si tepër vulgar ky krahasim. Shqerrë. Jo, as shqerrë. Nuk më pëlqen të zbutet kaq shumë. Drenushë. Hë, po. Një drenushë e kolme, e shkathët, e bindur.»

Atij i lexohej në sy ajo që përfytyronte.

Ndjenja e vetëmbrojtjes e paralajmëroi robinjën të ruhej. Më parë të fshihte gjoksin që i gufonte nga mllefi nën jelekun e hapur. U theye më dysh e ndenji kërrusur. Nuk qe mjaft. Tirqit e zinj i rrinin shtrënguar pas këmbëve. Ajo u ul në një stol dhe mbloodhi gjunjët. Mirëpo me gjunjët bashkuar format e rrumbullakëta të kofshëve shquanin më mirë. Oficerit makut iu bë edhe më joshëse e s'ia ndante sytë. Vetiu iu afrua. Sytë i ndritnin me një shkëlqim të keq.

Robinja e pikasi babëzinë e tij e u drodh. Shpirt-përpëlitur, hodhi një shikim të nxituar përreth.

Pikërisht në atë çast ngjau diçka fare e papritur e si e habitshme. Shoqëruesi i robinjës, gardian a rojë. Ç'ishte ai njeri i çuditshëm, deri atëherë hequr mënjanë, siç e donte rregulli në marrëdhënie me eprorët, u gjend përpara robinjës dhe iu shkreh asaj:

— Pa çohu ti! Kush të tha të ulësh? Zoti oficer më këmbë, ti ndenjuri!

Hasa u ngrit, e tëndosur e si në pritje. Oficeri, mbetur si guak, ia nguli sytë vartësit. Ç'i fuste hundët atje 'ku s'i takonte? Po 'tjetri vuri buzën në gaz me mirësjelljen e të pafajshmit e i tha:

— Nuk e meritonte, zoti Miliq? Kjo robinja na qenka shumë e guximshme dhe aspak e respektueshme ndaj jush.

Zoti Miliq vuri dorën në shpatë. Qëndrimi kanosës e bëri hijerëndë e si të çoroditur.

— Dëgjo, ti, nuk të ftoi kush. Pa m'u hiq sysh! Nuk kam nevojë të marr mend prej teje. Na lër vetëm!

— Si të urdhëroni, zoti Miliq, por unë them... — ai guxoi t'i afrohej e t'i pëshpëriste gati në vesh: —

Ju e dini vetë si është më mirë, ama unë nuk ju këshilloj ta zemëroni robinjën e lezetshme.

Hasa nuk mundi të merrte vesh ç'i tha. Por ajo vuri re që oficeri e shikonte si me pendesë dhe, sido që përsëri s'ia ndante sytë, nuk i kundërshtoi tjetrit kur ky i tha robinjës të dilte nga zyra.

Sapo kapërcyen pragun e u mbyll pas tyre dera e zyrës, shoqëruesi lëshoi një rënkim e pëshpëriti:

— Ej, ç'do të të marrë më qafë bukuria!

Hasa u tremb e vetiu u mblodh grusht. Pastaj përnjëherë mori guxim e tha:

— Po ti, kush je ti?

— Unë?!...

«Si t'i përgjigjem? Pyetja e saj është e çiltër, si ajo vetë. A t'i them që më është mbushur shpirti vrer nga këta Miliqët e mallkuar? A t'i them që ziej nga dëshira t'u hidhem në sy e të nxjerr dufin që më mundon? Ata bëjnë krime e poshtërsira, mua më rëndojnë në shpirt. Por... jo, jo, nuk bën. Sa të mund, do ta ndihmoj. Këtë po.»

— Ti më mbrojte prej tij, — shtoi me zë të ulët Hasa.

— Unë?!.. Hë, po! Gardiani yt jam, — tha ai, sikur të kishte thënë: «A s'është mjaft që po të dal në krah? Më tutje mos shko!»

Kur u ndodh prapë vetëm, mori frymë thellë, u ul ndenjtur në shtrat dhe e lëshoi veten. Lotët, që i ridhnin çurg nëpër faqe, ajo nuk i fshiu. Lotët ia veshën faqet e nxehta dhe rrëshqitën më poshtë. Edhe gusha i digjte. Në çdo dënesë a lëvizje, sado të vogël, shtrati kuiste: ving-ving!

«Ej, ç'do të të marrë më qafë bukuria!»

Dhe fill pas kësaj, ajo porosia që i pati dhënë një grua kur do ta merrnin xhandarët:

«Hasë, moj bijë, lirinë e humbe, ruaj nderin!»

«Po qysh, moj, qysh ruhet nderi kur je robinjë? Të ndryn hasmi në qeli, të thërret kur të dojë. Po s'je zot i vetes apo s'të doli kush zot, qysh t'ia bësh? Mandej del dhe një mustaqe që ta vë syrin...»

Hasa gati foli me zë, sikur t'i drejtohej. Një shpresë e vakët i regëtinte në kraharor kur sillte ndër mend atë tjetrin, shoqëruetin. Ç'të ishte ai, e pse i sillej aq butë? Sa mirë kishte vepruar atje në zyrë!

Që ishte zemërdhemshur, e ndiente. E kishte mbrojtur nga lakmia e oficerit. Mirë, po përse? E mandej, ç'mund të bënte më ai?

I drejtohej zotit me lutje të nxehta që t'i dilte krah. Ta ruante e ta mbronte nga e keqja më e madhe. Çdo gjë ishte gati t'i falte. Do të bënte fli gjithçka tjetër, sado të shtrenjtë e të dashur. Sikur të shndërrohej në një plakë të zgërlaqur e kësisoj të mos i vente syri tek ajo, jo më oficerit spitullaq, por askujt tjetër! A nuk i kishte pëshpëritur ai tjetri diçka që kishte të bënte me rrezikun e bukurisë? S'ka femër të mos dëshirojë të jetë e bukur. Po kur arrin të ketë inat bukurinë e vet, qoftë dhe për një çast të vetëm, merret me mend ç'fuqi e ç'zor e shtyn deri në atë pikë.

Dalngadalë lotët iu shterën. Me sy të njomur filloi të shikonte përreth. Po gjithçka ia vriste vështrimin e butë e të ëmbël nuses së bukur dhe atë e pushonte një brengë e dhembje e paanë.

Kushedi sa njerëz të mirë kishin vuajtur në atë qeli para saj! Kushedi sa ngjarje të dhembshme kishin parë ato mure të vrazhda! Kushedi sa njerëz ishin torturuar në atë shtrat të drunjtë! Ndofta edhe kishin vdekur. Dhe ajo rrinte mbi ato vdekje...

E llahtaritur, kërceu nga shtrati. Shtrati krakëriti me ankim.

«Eh, ku ta dinte Skënderbegu, a kush tjetër e ka bërë këtë kështjellë, përse po përdoret! U bë për t'u mbrojtur nga hasmi i zi. Cili hasm vallë? Ndoshta nga turqit...

Ç'mizor ky hasmi! Vjen kur s'e pret, të mësyn pa shkak, të ther, të grabit.»

Nga mendimet që shkonin përtej moteve e përtej kështjellës, robinja zbriti prapë në qeli.

Te këmbët e saj ajo shtamba qafëgjatë. Rrinte e

qetë, e patrazuar, gati t'i shërbente njeriut që ia kishte nevojën.

«Kushedi kush të ka bërë, moj e shkretë! Ta dinte ku do të katandiseshe, me dorën e tij të thyente, megjithëse ke dalë e mirë!»

U ul dhe e preku me dorë. Shtamba kishte një ftohtësi të këndshme. Qe punuar me mjeshtëri. Gryka qe e hollë, elegante, po ashtu dhe vegla e vetme. Tjetra, këputur që në rrëzë, dëshmonte sa me kujdes ishte pjekur shtamba. Një shtambë e punuar hollë dhe e pjekur në masë, del jo vetëm e bukur, po dhe e fortë.

Hasa e lëmoi grykën e gjatë. Dhe prapë iu bë se preku diçka të padukshme, ngjethëse. Duart e atyre që kishin pirë ujë me të. Që qenë e s'ishin më. Se nga ajo qeli vështirë të dilte kush i gjallë. Por, sidoqoftë, shtamba veçse mirë u kishte bërë. Ua kishte shuar etjen atyre të mjerëve, i kishte ftoritur, kur ishin në ethe e në sfilë. Pa do të kishin shpëlarë gjakun e torturave me ujin e saj... Shumë shërbime të vyera, vërtet!

Me shtambën në dorë ngriti kokën e mbajti vesh. Sikur u ndje sërish gjëmim hapash. Zemërdredhur e lëshoi me kujdes shtambën. Hapat vinin, zemra i ikte. Dorën në zemër nusja robinjë, si të desh ta mbante. Të mos përpëlitej aq shumë, se e bënte të dobët, të brishtë kur duhej të qëndronte e fortë, e papërkulur. Zemra ia dëgjoi qortimin. Nisi të rrihte më ngadalë, më burrërisht.

Në të çarat e derës së rëndë sytë e saj diktuan sërish luhatjen e një drite. Hapat nuk qenë të ngathët, të zvarritur, si herën e kaluar. As kollitje prej njeriu të druajtur nuk pati kësaj radhe. Dryni i madh vërtitej e godiste pa mëshirë derën. Nuk donte t'i bindej dorës së pastërvitur që mudohej ta hapte. Ajo dorë nuk dridhej nga pazotësia, por nga ngutja. Dhe, nëse dryni s'donte të hapej, robinja pikasi ethet e padurimit të njeriut matanë derës. Asaj i shkoi mendja tek oficer Miliqi.

Kërceu mbi shtrat e u mpak në skajin e tij.

Më në fund çerçiveja kërciti me një tingull gër-

vishtës. Hasa puliti sytë që iu vranë nga drita. Jo, nuk ishte gabuar në pandehmën drithëruese. Ai, Miliqi makut, po e shikonte që nga dera e hapur dhe qeshte nën ato mustaqet e holla. Përpiqej t'i jepte fytyrës një shprehje të ëmbël, po kjo lapardhosje e bënte edhe më të neveritshëm.

Ai hyri si me druajtje, shkoi deri te kamarja e gurtë në mur dhe vuri atje fenerin. Hasa ndiqte veprimet e tij dhe vëzhgonte nga dera. A ishte ai tjetri atje? Nuk po dukej.

Dera mbeti për pak kohë e hapur. Ajo mendoi një veprim të guximshëm. Po të sulej e ta kapërcente para se...

Po oficeri e vuri re e nxitoi ta mbyllte me shul. Pastaj tha:

— Ai hajvani, matufi plak, na e la në mes bisedën tonë.

«E ka ndëshkuar, të shkretin!»

— Ti ke vrarë nga tanët, i ke lyer duart me gjak. Ne jemi të pamëshirshëm ndaj atyre që na kundërshtojnë.

Ai mbajti vesh fjalët e veta. Hasa nuk po reagoonte. Ajo përgjonte vazhdimin, si një gjë të ditur që më parë.

— Po ti je femër. Ç'është më e veçantë akoma, një femër e re dhe e hijshme.

Hasa shikonte përdhe majat e çizmeve të lustruara të oficerit. Po të lëviznin çizmet, atëherë të kishte mendjen.

Oficeri i ri mendoi se fjalët që tha kishin bërë efektin e dëshiruar. Së pari, një shtendosje. Kur të flasin për bukuri, natyrisht të vjen mirë. Pastaj lind një fije shprese. Ai do t'ia ushqente shpresën. Pikërisht atë do të bënte.

— Kur ke përpara një armike të tillë, dua të them të re e të bukur, zemërimi të bie e ndëshkimi zë e zbutet.

Robinja në të njëjtin qëndrim. As foli, as lëvizi.

Oficeri përpiquej të fliste sa më thjesht, gjysmë sërbiht, gjysmë shqip dhe ishte fare i sigurt që ajo e

kuptonte. Pra, meqë rrinte e heshtur, shpresa ishte mbjellë në zemrën e saj. T'ia ushqente edhe më.

— Unë do të ta lehtësoj dënimin, moj bukuroshel! Tanimë ajo do t'i ngrinte sytë. Patjetër. Dhe do t'i lutej. Pa sikur t'i binte ndër këmbë, atëherë ai, ngadhënjimtar, mund të bëhej zemërgjerë. Pastaj do t'ia kërkonte atë shpërblimin e vogël, shumë të dëshiruar. Oh, kur ajo t'i përpëliste ata qerpikët e gjatë!... Le që edhe asaj do... Dhe ai qe djalë i fortë e i ri.

Po Robinja prapë mbeti e ngurosur. Sikur nuk dëgjonte fare. Sikur të gjitha ç'kishte thënë oficeri, qenë jashtë vëmendjes së saj.

«Kur të lajkaton një burrë, ruaju! Ose, në ta ka qejfi, lëri të kuptojë se të pëlqejnë lajkat. Njëra nga të dyja. Po ç'i pështirë ky, ç'i pështirë! Si s'e kupton që unë s'dua t'ia shoh bojën!»

Kur çizmet lëvizën, ajo ngriti kokën. Oficeri bëri një hap drejt saj.

— Unë do të të ndihmoj.

Qerpikët e robinjës u drodhën.

— Do të të liroj.

Ajo hapi sytë.

— Që tani!

Hasa u zbraps e u struk pas murit.

— Veç dua një kujtim të bukurisë sate të rrallë. Një...

Heshtjen e robinjës oficer Miliqi, i përpirë nga lakmia, e mori për ngurrim.

«T'ia rrëzoj krenarinë sa më parë, sa më butë, ndryshe... Oh, ndryshe, kush dreqin e di ç'dallgë mund të ngrihen në zemrën e saj. Se femrat det i paqëndrueshëm janë.»

— Askush nuk do ta dijë!

— Po unë vetë?

Ishte e para herë që ajo fliste.

— Ti, po! — tha qetë e djallëzisht ai dhe zgjati dorën.

— Hiqu!

Oficeri, sikur pikërisht këtë priste, e kapi nga

llërët. Ajo ia largoi me rreptësi. Kundërshtimi e nxiti oficerin. Ai e zuri me të dyja duart, më fort. Hasa i dha një të shtyrë e liroi krahët. I fyer në sedër, Miliqi u vërsul si dem, e pushtoi me forcë dhe e shtriu në shtratin e drunjtë. Nusja u përpoq t'i shpëtonte shtrëngimit të tij të hekurt.

Qe një përlëshje e egër. Oficeri rrekej t'ia mposhte kundërshtimin robinjës, duke ia shterur fuqitë. Aq, sa të thyhej një herë. Në të kundërt, robinja deshi t'i shpëtonte nga duart. Përndryshe... Ajo e dinte mirë kuptimin e asaj «Përndryshe»... Lufta e saj merrte kështu një qëllim të epërm e ia shtonte forcat. Në përlëshje e sipër ajo gjeti rastin t'i jepte një të shtyrë përdhunuesit e ai e pa veten në patosin me llucë. Shau me fjalë të ndyra, u ngrit e u vërsul më me tërbim. Robinja u hodh nga shtrati te dera. Kur ai u sul atje, ajo kërceu në qoshen e tejme. Që aty sërish në skajin e shtratit.

Oficeri qëndroi për një çast.

— S'ke ç'bën, ti je robinjë, — tha.

— Për lirinë, po. Për nderin, jo. Mos të të gënjejë mendja!

Miliqi shtrembëroi fytyrën. Sikur ta kishte qëlluar me një dackë. Në burg në dorën e tij, dhe të mbahej aq krenare? Dale, pa të shihte ajo!

Në një kërcim tjetër robinja rrëzoi padashur shtambën qafëgjatë. E pa vetëtimthi e i erdhi keq për të. Po shtamba nuk u thye. U derdh një gërqe ujë, vetëm kaq. Hasës i vetëtiu në kokë një mendim i krisur. Të mbrohej me atë shtambë! Pa e tjerrur gjatë, e rëmbeu e iu kërcënua ndjekësit.

Ai u ndal një çast. Vetëm një çast. U zgërdhi, qeshi me të madhe, me tallje. Përmbloodhi forcat që të mos e linte t'i shpëtonte më. Ndërsa ai ia pushtoi gjunjët, robinja ngriti shtambën lart me të dyja duart dhe i ra me të në kokë. Uji që rrodhi me gurgullimë zgërlaqi dhe më fytyrën e babëzitur të oficerit. Ai i vari duart, u kalamend e bëri prapa që të mbrohej nga ndonjë goditje tjetër, po koka i ra në një pjesë të dalë të murit.

Lëshoi një klithmë, u gërmuq e ra me hundëza mbi truallin me baltë.

Robinja e pa e u llahtaris.

Ai nuk po e ndiqte më, nuk po lëvizte më. Me një të kërcyer ajo u gjend te dera, hoqi me sa fuqi pati shulin e rëndë e doli si e çakërdisur.

Në korridorin-llagëm, tutje, hynte pakëz dritë. Si në grykën e ngushtë të një pusi. Ajo dritë se si i ra në sy menjëherë. E ndolli me një forcë tërheqëse të jashtëzakonshme.

Në vrap e sipër ajo dëgjoi diku një rënkim, një përpjekje të dikujt për t'iu afruar derës, një zë që kërkonte ndihmë. Dhe mbi këto, një thirrje alarmuese e një urdhër të rreptë që të ndalonte. Të ndalonte? Si ta linte dritën? A mund t'i bënte dot ballë ndjelljes së saj të fuqishme? Ishte aq e këndshme, aq e dëshiruar, aq e bukur...

Ajo vrapoi më shpejt. Edhe pak, edhe pak. Gryka afrohej e zgjerohej, drita e saj shtohej. Ndihej e lehtë, sikur fluturonte.

Kur arriti daljen, përveç thirrjeve alarmuese, dëgjoi një krismë pushke. Pastaj dhe një të dytë. Krismat u shtuan. Një plumb i fishkëlleu mu përmbi kokë. Ajo gjithnjë përpara, pa u ndalur. Drita afrohej, zmadhohej. E ndillte pareshtur, çdo çast më fort.

Krismat u prenë përnjëherësh. Në vend të tyre ndjeu një të therur në brinjë. Dicka e nxehtë e përshtoi tejprtej. Një ngrohtësi kapitëse ia kapuloi trupin. Trupi iu flashk, fuqitë e lanë. Ra.

Para se të humbiste ndjenjat, sytë e saj të bukur rrëmbyen një copëz dritë. Kapakët e rënduar iu mbyllën ngadalë e butë-butë dhe copëza e dritës mbeti përgjithmonë brenda tyre.

ISUF ARAPI

Shënova këtë titull e ndër mend kam edhe kapetanin e dëgjuar Isuf Arapi, edhe vallen që mban emrin e tij. Për kë të shkruaj më parë? Ka një lidhje të ngushtë ndërmjet tyre. Vallja ndofta kishte një emër tjetër, se është më e moçme, por, pas asaj që kishte ndodhur në trevën ku luhej, nuk mund t'i mbetej emër tjetër, se e tillë lidhje e shkrirje u krijua.

Ka qenë ajo kohë kur bejlurçinat mbinin si kërpuhat pas shiut. Sapo i thoshin vetes se ishin më ndryshe nga të tjerët, ata bëheshin kapadainj, harbonin mbi kuaj e përdornin kamxhikun. Njeriu nuk mund të rrijë pa bërë gjë dhe, po s'u mor me një punë për të qenë, bëhet i egër e punon prapësira, ca më tepër ata që kësisoj e shtonin pasurinë e porsavënë. Fshatarët hiqnin keq dhe ishin në një gjendje pasigurie e tmerri për ditën që vinte. Zullumet e bejlurçinave e mëria ndaj tyre bënë që Isuf Arapi e të tjerë trima të paepur të linin shtëpi e katandi e të merrnin malet, të dilnin kaçakë. Të ndërsyer keqas, pa e pasur

dhe fort mirë të qartë mërinë, vritnin e pritnin zabitë e asqerë turqie, bejlerë zullumqarë, si e sillte rasti.

I tillë ka qenë dhe Isuf Arapi.

Një ditë prej ditësh ai e ca shokë të tij i zunë bejlerët e krahinës e i shkuan në satër të gjithë, pa përjashtim. Mëria ishte e madhe dhe kaçakët e kryen ndëshkimin e tmerrshëm pa iu dridhur aspak dora. Pastaj shkuan fshat më fshat, që ta bënë të ditur ndëshkimin e rreptë. Ta mësonte çdo njeri. Kështu rritej fama e kaçakëve. Të mësonin fshatarët si e vinte në vend me ashpërsi drejtësinë Isuf Arapi.

Lajmi përhapej më shpejt se të vinte në fshat Isuf Arapi dhe u shpinte fshatarëve një gëzim ngjethës. Të hiqnin qafe bejlurçinat këpusha e të egra, qe, pa dyshim, dëshira e tyre, ëndrra e tyre e zjarrtë. Shpëtimi i pritur vinte nga shpata e Isuf Arapit. Po më tej? Kapedan i njohur ishte Isuf Arapi. Fama e tij kishite vajtur me kohë në atë trevë. Flitëshin kaq gjëra të çuditshme për të. Thoshin që qe trim i marrë, njeri tej mase i rreptë. Po thoshin edhe se qe dinak e i pa-afreshëm. Ndaj fshatarët gëzoheshin për atë që ai kishite bërë, por ishin dhe si të trembur. A qe vërtet shpëtim ai që sillte Arapi i tmerrshëm? Vetë ai ç'qëndrim do të mbante kundrejt fshatarëve? A do të rrinte gjatë asaj ane me çetën e tij, apo do të ikte shpejt? Nëse po, ç'do të bëhej pas ikjes së tij?

*
* *
*

Fshati i tërë, të mëdhenj e të vegjël, kishin dalë te sheshi para kishës. Veshur e ngjeshur si në ditë të kremte, këndonin e hidhnin valle. Kurrë ndonjëherë ai shesh s'kishte parë aq njerëz njëherësh. Nga kërshëria, po më tepër edhe nga interesimi për të mësuar si do të shkonte më tej fati i tyre, ishin mbledhur atje gjithë sa mund të vinin.

Pritnin Isuf Arapin.

Ndërsa të rinjtë përfitonin nga rasti për të dëfryer, të moshuarit, që s'mund të rrinin veç duke bërë sehir, bisedonin për çështjet që i shqetësonin.

— Më kot e frenojmë gëzimin, o miq. Pse e tjerrim kaq gjatë? Kësaj i thonë të kërkosh qimen në vezë. Isuf Arapi për drejtësi çalltis. Sa për flori, o të keqen vëllai, ai e di sa zgërbonja lisi mund të ketë mbushur me to! E si, pastaj, do ta hajë malli për kacidhet tona?

— Ai që ka shumë, do më shumë. Ky është arrareti i të pasurve.

— Epo...

Dhe kjo «Epo...» qëndronte si një pikëpyetje e madhe. Pikërisht kjo ua jepte atë ndjenjë pasigurie. Mirë, bejlurçina s'kishte më. Po kush do t'i viltë taksat? Mos vallë Isufi vetë do të zinte këmbën e atyre që kishte vrrarë? Po të qe ashtu, hajde t'ia dilje me të!

Ca të tjerë e gjykonin më ndryshe. Sidoqoftë, thoshin, ai ua preu kokat shushunjave. Kjo qe gjë e mirë. Po të jetë se do të bëhet vetë si ata, do të gjendet një kokëprerës edhe për të.

Kryeplaku, më i paduruari nga të gjithë, ishte një-kohësisht më i trondituri. Sido që të ndodhte, vala e parë do të binte mbi të, se ai do ta takonte i pari. Me mend përsëriste fjalët që do të thoshte. Sa më tepër i përsëriste, aq më i paqetë ndihej. Çukiste dheun me bastun e kohë më kohë nxirrte qostekun e shikonte orën me kapak floriri.

— Duket gjë? — pyeste ai një djalë që e kishte porositur të vrojtonte përtej kodrës.

Më në fund djali u lëshua me vrap tatëpjetë duke thirrur: «Po vijnë, po vijnë!» Njerëzit i prenë bisedat e dëfrimet e u tendosën në pritje.

Në fillim u duk një re e vogël pluhuri. Pastaj në krye të asaj reje spikati një shpurë kalorësish. Kuajt ecnin lirshëm, në qejfin e tyre. Troku i kuajve mbi urën e drunjte u dëgjua si një rënkim. Shpura mori kthesën për në fshat.

I pari vetë Isuf Arapi i famshëm. Hipur në një kalë të madh të bardhë. I bëshëm e me atë tallaganin e

zi hedhur supeve ngjante me një zotëri të rëndë që në të parë të ngjallte hutim. Nga silahu i purpurt i dilnin dorezat e stolisura të dy kobûreve. Syzi, zeshkan e i vrenjtur, pa zbritur nga kali, shkonte i heshtur midis dy rreshtave të fshatarëve që e shikonin me habi. Dukej i mërzitur e sikur mezi priste sa të mbaronte ceremonia, e cila nuk përkonte fare me ndjenjat e tij. I shtyrë nga ato ndjenja, një herë puliti sytë, sikur të gjitha sa shihte ish-in një tallje e aq. Po, kur kryeplaku tha ato fjalët e parapërgatitura, kapedani e pa të udhës të zbriste nga kali e të dëgjonte me seriozitet.

— Zoti ia shtoftë ymrin kapedanit të madh Isuf Arapi, të cilin fshati e pret si i ka hije një trimi e bamirësi të pashoq!

Kapedani ngjatjetoj me kokë, vuri dorën në zemër, përveshi buzën e sipërme si për të qeshur, po nuk qeshi, e tha:

— Mjerë ai, që u bie më qafë njerëzve të pafajshëm, të cilët unë i kam marrë në mbrojtje!

Kryeplaku u shushat, sikur ato fjalë kapedani ia drejtoi atij, ndërsa fshatarët, që i pritën me kënaqësi, ia falën atë qëndrimin prej fodulli. Me dorën në zemër e uruan dhe e ngjatjetuan edhe ata.

Pas kësaj kryeplaku, ca i trembur, i përçoi në shtëpinë e vet. U shtruan në një konak të gjerë mbi shilte të buta, duke i bërë nderet që i takonin një njeriu me rëndësi. Dalngadalë fshatarëve po u ikte ajo habia e takimit të parë me këtë kapedan të habitshëm, që kishte aq madhështi dhe shoqërues të armatosur. Që ishte ca i vrenjtur e hijerëndë, që nuk po i qeshte buza, me mend e përligjën duke thënë se ashtu, ndofta, duhej të qe një kapedan me famë.

Nga ana e tij Isuf Arapi s'e ndiente veten mirë. E shqetësonin gjithë ata njerëz, apo dhoma që e ngushtë? Mezi mbushej me frymë, por, i duruar siç qe nga natyra, ngrysi vetullat e s'e bëri për fjalë. Nganjëherë mbyllte sytë për një çast. Mbase do të donte të mbe-tej vetëm e të qetësohej.

Kryeplaku rrinte si mbi gjemba. Ku dihej ç'i shkrep-
te në kokë mysafirrit kokëkrisur? Kryeplakun sikur e
mundonte edhe ndonjë gjë tjetër. Të paktën atë për-
shtypje linte qëndrimi i tij i frikshëm, kur të tjerët
nuk po druhehin më.

— Mos është ca si zagushi, kapedan? — tha me
gjysmë zëri. — Po të jetë se urdhëroni, pranvera çatisi
tashti dhe bukur është edhe jashtë...

— Posi, posi! — nxitoi të përgjigjej Isuf Arapi.

Dhe dolën e zunë vend te sheshi, ku edhe natyra,
edhe fshati dukeshin si jo më mirë. Isuf Arapi rro-
tulloi sytë mbarë e prapë. Vërtet bukur! Ca bilbila
këndonin nëpër ahet e mëdha që sillnin fllad me erën
e pandërprerë shushuritëse. Kraharori i gjerë i ngrihej
e i ullej si kacek, po për të folur nuk foli e as qeshi
fare.

I vunë përpara mish qengji të pjekur në hell e pulë
të zier e të skuqur në gjalpë, verë e rrush të freskët,
mbajtur në tallash, djathë. Ai hante e pinte fare pak,
gjithnjë në heshtje. Ishte për t'u çuditur se, me sa
flitej, kur binte në të ngrënë, ai s'dinte të ngopur.

Fshatarët ia morën një kënge të sajuar ato ditë.
Kënga fliste për bëmat e tij. Isuf Arapi dëgjonte duke
u përtypur me përtim.

«Këta kremtojnë e janë të gëzuar. I shpëtova nga
ata makutë delenxhinj. Po pse nuk qetohem dot?»

Ai do të donte të gëzonte tok me fshatarët mikpri-
tës, po për çudi, sa piqej me ta, i mekej gazi e vrenj-
tej. Fshatarët i bënin vërtet ndere, por edhe i trembe-
shin. Ai e nuhaste druajtjen e tyre. Pse silleshin
ashtu, xhanëm? Pse e kishin atë droje ndaj tij, rrinin
të pasigurt, ndonjë edhe si miu prapa poçes?

«I çlirova apo i robërova këta njerëz?...»

E njihnin për trim që s'i dridheshin as dora e as
qepallat para rrezikut. Ai ndëshkonte pa mëshirë cilindo
që e kishte mbushur kupën. Por e njihnin edhe si njeri
pa shpirt, pa zemër. Ai e dinte, paçka se asnjëherë s'e
kishte bërë veten e nga kjo anë nuk u binte në sy
njerëzve. Në vetvete bluante në kokë këto mendime.

Veçanërisht në ca raste të veçanta. Ja, krahas kënaqësisë që kishte për përmbushjen e detyrës, po provonte dhe një ndjenjë të dytë, të fshehtë, shqetësuese.

«Eh, si s'paskam zemër? Kam, ore, kam! Por... ja, ashtu, i kam vënë gur përsipër. Ndoshta kam vrarë, mbase më shumë sesa duhej, po sikur të të dridhet dora e në i lënç ata edepsëzë, ç'bëhet pastaj? E pëson ti, e pësojnë shumë të tjerë si ti...»

Duke bërë emër si kaçak, ky njeri shpirtzjarr e kra-hëçelik, shkante me mendimin që i kishte dalë zot së drejtës e së mirës. I patën djegur shtëpinë, i patën vrarë e syrgjynosur të afërmit, nga kjo që bërë i ashpër e i ngrysur dhe dufin e shfrente në mënyrën si ia kishin punuar atij vetë. Vrulli i rrëmbyer i hakmarrjes kishte përfshirë edhe ndonjë tjetër padrejtësisht. Për këto vriste mendjen më pas. Shpagimi i sillte kënaqësi të shkurtër e sflitje të gjatë, sepse nga shkoqitja më nge ai shpagim, siç thamë më lart, nuk dilte gjithnjë i qëruar.

«Zemër, po, kam edhe unë. Zemra ndien, mendja peshon. Po që se një gjë anon nga e drejta, zemrës i do vënë fre, se të pengon!»

Kështu mendonte e kështu bënte Isuf Arapi. Mirëpo ja, si mbaronte punë, i vinte radha zemrës, që çlirohej nga freri e gjykonte. Dhe gjykonte ashpër. Në ndeshjen e ndjenjave me mendimet i lindte ai shqetësim torturues.

Sido që i pushtuar nga këto ndjenja, megjithëse përbrenda tij ziente ndeshja, Isuf Arapi mundi të kapte një ndryshim të të papritur të gjindjes, se zhurmat qenë ndërprerë.

Ngriti kokën e pa nja dhjetë gra e vajza, të gjitha njësoj nga shtati e bukuria, që dolën në shesh e u kapën dorë për dore. Ishin veshur po ashtu, njëlloj, me xibunët e errët, përfund e anash me garniturë gajtani të kuq, jelekë të qëndisur me fillosh të verdhë si ar, të hapur në mes për t'u lënë vend gjoksoreve të bardha, të qëndisura edhe ato, me shami të holla me lule në kokë e në brez, me çorape vija-vija. Të dhjeta kishin

po të njëjtën krehje të veçantë. me shamitë kapur me karfica diku në mes të kokës. Pafta e zinxhirë, karfica e rruaza të verdha e ngjyrë argjendi zbukuronin veshiet. aq të hijshme edhe pa ato.

Isuf Arapi i pa me radhë niërën pas tjetrës e i nandehu motra ndërmjet tyre. Ndofta shikonte akoma turbull, zhytur siç qe në shoqetësimin e vet.

Si u varguan në shesh, gratë ia morën një kënge e nisën të kërcenin sipas melodisë. Një cast ai dëgjoi e pa, ashtu si gjithë të tjerët. Po pastai përnjëherë e përshkuan mornica në trup e iu bë sikur iu shkëput dicka. Ndiënjat e mendimet iu hoqën mënyrë, u ndeh përpara dhe shikonte e dëgjonte i mahnitur.

Ajo qe një valle e kënduar. Këndonin ato që e hianin, këndonin dhe shoqet e tiera mbledhur grumbull aty mënyrë. Kënga qe e shtruar, me ndonjë ndërroreie të vogël, në të cilën merrej sulm për të viuar më tej. Ashtu dhe vallia. Disa hapa para, të niëtraitshme, lëkundie të hijshme të trupit në vend mbi majat e këmbëve, përsëri përpara e pak më shpejt e, në afrim të ndalesës tjetër, me një ngritje të shkathët, këmba e maitë vente tek e diathta, pastai e diathta vazhdonte me niëfarë zvarritjeje të shpejtuar, ndjekur nga tjetra po me atë ritëm.

Kishte një paitim të habitshëm ndërmjet këngës e valles dhe ky paitim shkonte më tej, lëvizjet e këmbëve ishin në harmoni të plotë me lëkundien valë-valë të trupit e të kokës së valltareve. Asnjë nërkulie, asnjë sforcim. Vallia rridhte. Atë e përshkonte një lirizëm i këndshëm që të rrëmbente. Valltaria e kreut valëviste mbi kokë e anash një shami të hollë, e fundit i përgjigjei po në atë mënyrë me dorën e kundërt. Tekstet e këngëve përziheshin. Vallia filloi me «As tinë, more» e vijoi me të tiera. Por Isuf Arapi nuk ua vinte veshin fjalëve. Atij i kumbonte në vesh një «Tra-la-la-la-laa, la!» ritmike, herë e qetë e herë me hove të papritura. Shikonte mimikën e valltareve, lëvizjet e hijshme të trupit, mbaitur drejt e me krenari, lëvizje që u jepnin këmbëve të tyre një theksim që atij i arrinte në zemër.

Vallja ngërthente ndjenja të përkundërta, e Isuf Arapit i ngjante se zemra e tij plot tallaze qe hapur aty në shesh e lozte atë valle mahnitëse. Qe përquendruar i tëri në të, sa njerëzit shikonin herë vallen e herë kapedanin, krejt të hutuar.

— I pëlqejnë këmbët e mbushura të grave me ato çorapet lara-lara, që i bëjnë aq joshëse! — pëshpëriste ndonjëri.

— Po gjokset, jo? Pa shih njëherë! Ato janë edhe më joshëse, veçanërisht për një që i shikon për herë të parë. Ej, kush u bë sebeb të hyjnë gratë në valle!

Ndërsa kryeplaku finok, që ndiqte me vëmendje atë që po ndodhte me kapendanin, shpejt e hoqi frikën se mos ai bënte ndonjë ngatërresë. Ai vinte re si i zgjeroheshin flegrat e hundës, si i zmadhoheshin sytë e si merrte frymë me hope, ngaqë e mbante pezull një copë herë. Fytyra e gjithçka e tij, tërë qenia e kapedanit në ato çaste jepte shprehjen e njeriut që e ka përpirë diçka megjithësej, po jo shenja epshi. Ai nuk i lëvizte fare sytë, a thua shikonte në një pikë të vetme.

«Ky do të ketë ndonjë brengë të madhe që e sfilit», arriti në përfundim kryeplaku dhe ky mendim e bëri të merrte frymë i lehtësuar, se deri atëherë atij e nja dy të tjerëve edhe se hanin e pinin, edhe se duke-shin të gëzuar, nuk po u ndahej frika e pasiguria për ndonjë të papritur.

«Kështu duket si shqerrë e kaq i ndjeshëm, se e ka përpirë vallja, po ç'bluan në kokë vallë? Tha të mos kemi frikë nga askush sa kohë që ai është kapedanin i çetës. Tha që këtej e tutje mjerë ai që i përdor keq fshatarët... ku e kishte fjalën?!... Ç'i ka këto ky? Pastaj, edhe me fshatarët, që na i marrka në mbrojtje, të mos e bëjë si ai që e shpëtoi gjënë e gjallë nga ujku dhe e hëngri vetë! Kush i zë besë? Dhe sa mund të dajandisë me hyqymetin ky? Se, ja, prite ndonjë rrebesh mbi të! Por, megjithatë, i duhet shpëtuar ndonjë zemërimi të tij të beftë...»

Dhe tërë kujdesi i kryeplakut qe që ta përcillte një orë e më parë. Pastaj ai do të ishte larg e nuk do ta

ndiente kaq tepër praninë e tij të rëndë. Po pse s'hante e nuk pinte ai? Mos vallë nuk ia kishte gjetur dot zemrën? Kush dreqin e dinte ç'shije kishte ai njëri! Harxhet harxhe dhe...

Mirëpo, kur vuri re që Isuf Arapi ishte zbutur e shkrirë pas valles, kryeplaku u bëri shenjë valltareve të vijonin edhe ca. Sa më shumë zgjatej vallja, aq më tepër qetësohej ai.

Kapedani kaçak vërtet nuk shikonte fare nga hapet e nga mbylletj vallja. Tërë shqisat, me to edhe përfytyrimi, tërë qenia e tij ishte përqendruar në një pikë të vetme. Ai e shijonte vallen në tërësinë e saj, e kjo tërësi shkrihej me qenien e tij nëpërmjet lidhjes të shumta, të padukshme. Mendimi e ndjenja, që vishnin vallen, sa vinte e bëheshin më të qarta. E pandalshme, me lëvizje të shkathëta e të hijshme plot poezi, me atë melodi të shtruar, vallja shprehte një gëzim disi melankolik, një gëzim të lindur përmes vuajtjesh e hidhërimesh, sikur vuajtjet e hidhërimit të ishin shkrirë e bërë njësh me lirizmin e këndshëm e të gëzuar.

Asnjëherë nuk qe zgjatur aq shumë ajo valle. Secila nga ato të dhjeta e kishte vënë re tendosjen e kapedanit dhe vallja shtrihej e shtrihej. Inkurajimi është nxitje e çlodhje. Ato kërcenin e me bisht të syrit he-tonin kapedanin hijerëndë. Jo, në ato çaste atij nuk i shkonte mendja te hiret e tyre. Ky do të qe një shkak që ta linin vallen sapo e nisën. Po Isuf Arapin e kishte thithur krejt vallja e, pra, si t'ia linin pa plotësuar atë kënaqësi që ishte njëkohësisht edhe e tyrja? Po më në fund u lodhën, ndaluan pak e ia filluan një valleje tjetër, me tjetër melodi.

«Male, more male, keni shumë halle!»

Isuf Arapi boshatësi mushkëritë me një psherëtimë të gjatë, u tërhoq prapa duke parë e dëgjuar si i topitur. Valltarët u panë sy ndër sy e këmbyen vallen.

«Njëzet e pesë gërsheta,
t'i numërova, pa fjeta...»

Kryeplaku e pa se as kjo s'ia tërhoqi vëmendjen kapedanit.

— Lozin mirë gratë tona, kapedan!

— Valle e mirë, — tha ai.

Kur një plak rrahu t'i bënte qejfin duke i për-
krahur mendimin, Isuf Arapi tha për së dyti:

— Një valle punë e madhe! Ta drithëron shpirtin
e ta jep në dorë.

«Sikur të ketë pasur shpirtin tim e shqetësimin
tim ai që e ka sajuar! Besa, po, sikur e ka sajuar
kasten për mua!»

Atij iu kujtua kënga që kishin ngritur për të, dhe
pyeti se mos kështu ishte bërë edhe vallja.

— Është valle e moçme kjo, o kapedani ynë i madh!
— tha kryeplaku duke lëpirë buzët.

— Valle, po valle! Ta vërtit shpirtin si fugë! Të bën
të qash e të qeshësh, të ngre e të përpjek! Eh!

Që kur zbriti nga kali, ishte e para herë që fliste
në këtë mënyrë, shpenguar e si me duf. Kryeplaku
ngazëllente. Jo, s'mund të presësh asgjë të keqe nga
një njeri që e rrëmben dhe e bën për vete një valle!
Atë e vërtit, si të duash, mendoi ai.

— Popull i vuajtur ky yni, — mori zemër e tha
një i moshuar. — Helmi nga gazi s'i është ndarë kurrë,
gjithënjë pranë e pranë i ka pasur, si motër e vëlla. I
ka shkrirë e i ka bërë një në këngë e në valle. Shpir-
tin e vet e ka derdhur në to.

— Në të parën veçanërisht, — pohoi Isuf Arapi.

— Ashtu vërtet, atë e kemi vallen e valleve në këto
anë.

Kur dëgjoi këto, kryeplaku u ngrit e thirri:

— «As tinë, more!» moj gra!

Në shesh dolën gra e vajza të tjera. Isuf Arapi u
tendos sërish.

Kishte dëgjuar këngë e kishte parë valle ai. I pël-
qenin mjaft, megjithëse vetë as këndonte e as kër-
cente. Po kurrë s'i kishte pëlqyer kaq shumë ndonjë.
Vallja e kënga e gllabëruan të tërin, ia përshkuan shpir-
tin, që i dridhej si një tel i hollë, gati në të këputur.
Të ishin vërtet aq të bukura, apo vallë ishte ndodhur
ndonjëherë në të tillë gjendje shpirtërore? Kushedi

Kënaqësia e fitores në ndeshje me dhimbjen që sillnin veprimet e bëra, tek ai takoheshin shpesh. Atë ditë gjithë ato takime u poqën e u bashkuan në vllug të shqetësimit, kur tallazet përplaseshin pandërprerë në zemrën e tij ndezur prush.

— Kushedi, kushedi, — tha me zë. — Kjo valle më pëlqen tej mase, kjo sikur të jetë bërë për balsam.

Ai i mbërtheu sytë sërish te një pikë, ku gratë e hirshme, si njëra, tjetra, gjatë kërcimit formonin figurë magjepsëse, në të cilat hapej e shkrihej shpirti i tij aq i gjerë e i shqetësuar, aq i pasur me ndjenja të përkundërta, si vetë jeta e bëmat e tij.

Gratë ndërroheshin herë pas herë. E para ia linte vendin së dytës, duke i vënë në dorë shaminë e pas kësaj shkonte në fund.

Kur mbaroi vallja, Isuf Arapi e lëshoi përsëri me hope frymën e mbajtur pezull dhe dorën e madhe ia shkoi ballit. Në ballin e tij bulëzonin djersët, sikur ai vetë të kishte kërcyer.

U mbush me frymë e u ngrit. I madh, i kënaqur, falënderoi e i hipi kalit, sikur ta kishin ngritur erërat. Ndihej i çlirët e i lehtë dhe i bëhej se do të merrte fluturim.



Sa ndenji në atë trevë, nuk iu nda ajo ndjesi e madhe dhe e gjerë. Se në çdo fshat, para se të vinte ai, arrinin jo vetëm fama e tij, por edhe fjala për vallen e pëlqyer prej tij.

Në një fshat, gjatë gostisë, njëri u ngrit e tha:
— «As tinë, more!», vallen e kapedan Isuf Arapit!

Dhe që atëherë vallja dhe Isuf Arapi u bënë një.

Vallja e bukur ka arritur deri në ditët tona. Emri e bëmat e Isufit, kaçakut të çuditshëm, të rreptë e zemërndjeshëm, jetojnë në brendinë e saj të gjerë e të pasur, plot lëng jete e ndjenjë, si shpirti i begatë i krijesit të madh popull.

DISA NGA TË SHUMTËT

Ishte verë e ne shkonim me bagëti. I kishim çuar nga Kodra e Kopaçit. Ilaci, shoku im, s'rrinte dot në një vend, se nga bridhte, duke kërkuar kushedi që nëpër dëllinja e ferra. Unë u ngjita në majën e sheshtë të kodrës, rashë përmbys në lëndinë dhe mora të lexoja një libër me përralla. Gushën ma gudulisnin fijet e barit. Zhumbrica e dëllinjat lëshonin një aromë të fortë, dehëse. Njeriu që donte të rronte i vetëm, dilte nga përralla e më shikonte me inat, sikur i vinte çudi që kishte mbetur gjallë njeri tjetër, veç tij. Mund të ketë pasur ndonjëherë gjëkund, thosha me vete, njerëz si ai i përrallës? Se xha Koli, që ne e donim, na thoshte shpesh që njeriu ka keq për njeriun.

Ai punonte në një arë rrëzë kodrës.

Burrë i shkurtër, trupngjeshur, nja pesëdhjetë vjeç, xha Koli e kishte shkuar jetën kurbetit, duke bërë dru e qymyr në Malin e Shenjtë e gjetkë. Reforma i dha ca tokë e një ka. Pas kësaj u shtrua në fshat. Sapo u bë bujk, s'e ndante nga vetja hostenin e gjatë. Mbë-

shtetej në të e na shikonte vrenjtur. Të bëhej se nga çasti në çast do të na e vishte me hosten kurrizit, po ja tek i qeshnin sytë, fytyra i zbutej, buzët i hape-shin vetiu e ia niste një së qeshure me gërgëmë. Ne kukurisnim në fillim për ta ngacmuar, pastaj na qeshej vërtet dhe e qeshura shndërrohej në një kor hareje.

Xha Koli u ul në mezhdë të çlodhej e na thirri pranë.

— Shihni ç'fshat të bukur kemi, o djem, shihni! — tha papritur duke zgjatur dorën përpara.

Fshati shtrihej atje poshtë, në grykën e zgjeruar të përroit. Përroi shkonte përmes, plepat e shelgjet e shumta në të dyja anët e tij sikur i tregojnë rrugën dhe e porositin vazhdimisht që të rrijë urtë, të mos bëjë ndonjë marrëzi e të lëshohet nëpër fshat apo nëpër ara. Në të dalë të fshatit vjen e zgjerohet një luginë e sheshtë, shumë e bukur e pjellore.

— Fshat i bukur e i moçëm, — përsëriti xha Koli. — Të bën rehat shpirti e të vjen të thërresësh: ju lumtë, o të parët tanë, se e keni zgjedhur vendin punë e madhe! Se e keni ngritur fshatin në rrëzë të kodrave, hem për të kursyer tokën e bukës, hem për t'u mbrojtur. Pa, sa për këtë, gjithnjë i kanë vënë gjoksin.

— Si e kanë mbrojtur, o xhaxhi Koli, kanë luftuar? — pyeti Ilaci, të cilit i pëlqenin shumë bisedat e të rriturve.

— Ta merr mendja! Ja, një herë na ia vuri syrin një bej. Është fshat për myslimanë, thoshte, se ka ujë me bollëk. O të bëhet çifligu im e zicishtarët të ndërrojnë besë, o të shpërngulen gjetkë e unë të sjell këtu çifçinjtë e mi! Ngrihet një burrë nga fshati ynë e i vete mu në saraje. O bej, të kam një llaf! Hë, ç'do? Mos të ha gjëkafshë koka? Tyt, edepsëz! Jo, po thashë. Se, po të të hajë, eja të ta kruajmë! Neve s'na vë dot kular Turqia, ej, kokë, jo të na vësh ti! Kështu e bëri zicishtari. Ama dyfekun me vete e mbante.

Dita-ditës xha Koli na e nxiste dëshirën për të njohur të kaluarën patriotike të fshatit tonë. Secili prej nesh sillte në bisedë atë që kishte dëgjuar nga të rri-

turit. Njëri pa^s tjetrit vinin e lartësoheshin në përfytyrimet tona të ngacmuara figurat e xha Gaqos, Naqos, xha Dones, Mitit të gjatë...

Por ja, qëlloi që mua të më ecte më shumë se shokëve të mi.

Po kërkoja në një sënduk të vjetër dhe fare pa-pritur gjeta një libër të vjetër. Libri kishte kapakë prej kartoni të trashë, të zi. E shfletova ngadalë, me një kërshtëri jo edhe aq të ngacmuar, kur që në faqen e parë më ra në sy një shënim që më përpiu. «E shqipëroi Fan S. Noli.» Një libër i Fan Nolit të dëgjuar? Unë e shfletova më tej dhe, pa arritur të lexoja akoma ç'shkruhej brenda, qëndrova edhe një herë në faqen e fundit. Aty ishte shtypur një listë e ndihmëtarëve, të cilët Fan Noli i falënderonte, duke thënë që kishin bërë një punë të mirë për kombin tonë.

«Vëllazëria Donaçi-3 lira», shkruhej në listën e ndihmëtarëve...

U hodha përpjetë nga gëzimi për zbulimin tim. Këta ishin babai e xhaxhai i xha Kolit. Fluturova me libër në dorë te shokët, shtëpi më shtëpi, e ua tregova, duke mbajtur gishtin atje ku duhej të lexonin.

Secilin veç, e të gjithë tok, na gëzuan sa s'thuhet ato fjalë. Kjo po, i kalonte të gjitha njohuritë tona të pakta për fshatin ku kishim lindur. Nuk do të përmendim më «thoshin» e «thonë», po e zezë mbi të bardhë, fjalë të shkruara nga dora e vetë Fan S. Nolit! Fshatarët tanë nuk ishin mjaftuar vetëm brenda për brenda fshatit, por shkonin më tutje, kishin ndihmuar në botimin e librave shqip, dhe kur, pa! Në atë kohë kur për një punë të këtillë xhandarët e Turqisë të kallnin në burg.

— Vemi te xha Koli! — i thashë Ilacit.

Xha Koli e ngrinte ugar arën e Kopaçit. Porsa na pa që nxitonim, ndali qetë.

— E di përse kemi ardhur? — tha Ilaci.

— Keni gjetur gjësendi tjetër?

Unë e mbaja librin prapa kurrizit.

— E merr dot me mend, e merr?

— Më jep ta shoh!

E lëshova në duart e tij librin me kapakë të zinj. Ai e pa me vëmendje, pa treguar as habi, as kureshtje, siç prisnim ne. Në këtë takim vumë re një si mall për diçka të njohur më parë. Lexonte aty-këtu. Duke lexuar, lëvizte buzët dhe duart i dridheshin lehtë. Dukej që ai libër çdo çast e më tepër ia shtonte emocionin dhe e shkëpuste prej nesh atë, xha Kolin hokatar që njihnim.

— Ti e paske ditur, — thashë qejfprishur!

— Ëhë, — ia bëri ai si i përhumbur.

— Tregona ndonjë gjë për ta! — iu lut Ilaci.

— Nesër, — tha ai mjaft prerë.

Nuk na erdhi mirë që na e shtynte një ditë më tej sqarimin. Ama kjo e shtoi kërshtërinë tonë. Ndërkohë u përpoqëm vetë që të mësonim ndonjë gjë nga njerëz të tjerë e atëherë vumë re sa pak dinim akoma për të kaluarën e fshatit.

— Njerit prej tyre i thoshin Pando Shqiptari, — më tha nëna. — Ky i sillte alfabetaret në thasët me grurë. Kamje s'vuri, po emër me nder bëri e ishte mik me të krishterë e myslimanë.

Ilacit, gjithashtu, i kishte folur i ati.

Vëllezërit Donaçi, tha ai, nuk ngjanin fare ndërnyjet tyre. Xha Pandoja shkruante e lexonte shqip e greqisht. Ishte i ditur, fliste pak e me konak. Xha Iloja nuk dinte shkrim e këndim, ama që i gojës. Ato që dëgjonte nga i vëllai, ua thoshte të tjerëve më mirë se ai vetë. Në sy të xha Pandos nuk fliste, po veç dëgjonte.

E nesërmja na gjeti tek ugari i xha Kolit.

— Nuk ju paska zënë gjumi, ho-ho! Hi-hi-hi! — qeshi me të madhe xha Koli.

Ne nuk ia pasuam të qeshurën, siç bënim gjithnjë. Tjetër merak na mundonte, gjë që ai, si i mençur që qe, e pikasi menjëherë.

— Babai im ishte burrë i shkurtër, ja, si unë, — tha. — Thonë që i ngjaj shumë në të parë. Turqia e bejlerët e mbyllën fshatin nga ana e poshtme. Sino-

rin ja, përtej kishës ia kishin vënë. Llëngat e Ndënvirët, Brodat — tërë arat e mira ia kishin rrëmbyer. Ziçishtarët kopaçitnin nga vreshtat e në Qesaret lart, mirëpo me skërkat s'ironin dot e zunë të ngisnin kurbetin. Babai me xha Ilon vajtën në Ajnoro. Prisinin dru e bënëin qymyr, krasitnin gështenjat e gdhendnin qereste. Pa merreshin edhe me qiraxhillëk.

Ashtu i thonë një ditë babait të shpinte me mushkë në manastirin e Hilandarit një zotëri që kishte zbritur në skelën e vogël të Kariesit. Ky Kariesi, që thua ti, ishte si biçim kryeqytet i Ajnoros. Se Ajnoroja ishte vend me manastire e murgj, e keni dëgjuar ju? Mirë, plaku pranoi. Zotëria ishte ca i zbehtë në fytyrë, me sy të mëdhenj, fort i sjellshëm. Në udhë e sipër përpiquej t'i jepte muhabet xha Pandos sonë. Flitnin greqisht. Po sesi u pengua mushka e u përgjunj, zotëria mënt ra e atëherë plaku e goditi me purtekë vitheve dhe e shau. «Ngorç!» i tha, ama jo greqisht.

Zotëria vuri buzën në gaz e ia ktheu shqip edhe ai: «Mos e shaj mushkën, o njeri i mirë, keq pati dhe ajo.»

Fort i çuditur që dëgjoi t'i fliste në gjuhë të nënës, plaku ngriti kokën dhe e pyeti zotërinë nga ishte e kush ishte dhe kësisoj u njohën. E gjeni dot me mend cili qe ai? Ë, e gjeni?

Ilaci përveshi buzën e mblodhi supet. Unë u mbështeta në gjurin e xha Kolit me sytë ngulur në buzët e tij.

— Ai na paskësh qenë Naim Frashëri vetë, or të uruar! — Ai vetë, ju them! U njohën, e Naimit nuk i erdhi hiç mirë që ziçishtari s'ia kishte dëgjuar emrin. Jo se vuanë për t'u dukur. Ju jeni djem shkollë e do ta dini patjetër që më të shumtët e librave Naimi i botoi pa emër. Mirëpo në atë kohë emri i tij, a mbiemri, rrëfente pak a shumë lidhjen me shqiptarizmen. Një shqiptar patriot nuk mund të mos e kishte dëgjuar ndër mëmëdhetarët mbiemrin e nderuar të Naimit.

Me turp plaku i tha Naimit që kishte mësuar dosido greqisht. Sa për shqipen, e para herë që dëgjonte se shkruhej dhe ajo. Naim Frashëri psherëtiu dy herë.

Një herë nga dhemka, se një shqiptar s'e dinte që shkruhej shqipja, herën tjetër i lehtësuar ç, meqë vuri re se xha Pandoja ishte shqiptar i ndershëm e nuk e fshihte të vërtetën. Që të mos e zgjat shumë, Naimi i mësoi plakut tim shkrim e këndim në gjuhën tonë. Gjersa vdiq, ai e pati për nder të madh. «Ma ka mësuar shqipen vetë Naimi mua, ej, kokë! Gjen kollaj ti një njeri kaq me fat?» thoshte ndonjëherë.

Që thua ti, Naimi vuante nga veremi e kishte vajtur në Ajnoro për hava. Po mikrobi i shqipes i kishte hyrë më thellë nga ai i sëmundjes. Zunë të vinin pako në emrin e tij. Me libra shqip, të tijtë e të patriotëve të tjerë. Vinin nga Stambolli, nga Bukureshti, nga Sofja. Në rrugë të fshehta, dorazi. Ca libra Naimi zuri t'ia jepte xha Pandos dhe ai me xha Ilon i shpinin në Selanik, në Manastir e në Korçë, aty i merrnin të tjerë që t'i çonin gjetkë a t'i vinin në punë. Sillnin edhe në Devoll. Këta vëllezërit i shpërndanin vetë ndër njerëz të besuar.

Hë-hë, na i bien në erë kësaj pune korofillakët e Kariesit e igumeni i manastirit ku punonin pleqtë tanë. Igumen i thoshin të madhit të një manastiri. Vë një njeri ky igumeni që të spiunojë Naimin. Se Naimi nuk ishte njeri dosido dhe s'ua mbante të hapnin sherr me të, pa u siguruar mirë e mirë. Thoma, Thoma e quanin atë spiunin. Ky Thomai i njihte tanët, e ashtu u vete një pasdite në konak. Jep e merr me fjalë, mundohej ta kallte në kurth xha Pandon, po xha Pandoja ia bleu shpejt mendjen. Mirëpo spiuni iu bë rrodhe. Do ti të rastisë një herë kur xha Pandoja po këndonte një libër shqip! Bëri ta fshihte, po çnë, ku i shpëtonte syrit të verdhë të spiunit!

«Ç'po këndon, o Pando, nema ta shoh ca!» i thotë.

«Ç'të lipset ty?»

«Hiç, desha ta di.»

«Nuk është punë për ty.»

«Ç'paske kështu sot ti, që ma pret llafin si me mykë?»

«Ik, o Thoma, se s'ta kemi ngenë!»

Thoma spiuni e bëri surratin korminë e i mori si me shaka fjalët e babait.

«Unë e di pse s'ma jep!» tha me djallëzi.

«E përse?»

«Se ajo vivëll është e aforesur!»

«Mos, more! I ditur shumë ti!»

«Ja, lidhim bast? Vivëll shqip është!»

«E se të jetë?»

«Gjuhë shqip me të shkruar s'ka. Po të kishte, do ta dinte bota e do ta njihte edhe sulltani, edhe Patriku. Ato grama janë shpikje të satanait. I bëjnë ca e ca, që s'mendojnë tjetër, po si e si t'i vënë pishën në shpirt llauzit të paditur e ta ngatërrojnë.»

«A ç'na çan kokën!»

«Je edhe ti një ndër ata!» tha atëherë spiuni, duke e rrëfyer me gisht.

Plaku ishte i duruar, po xha Iloja, që s'kishte folur fare, e mbase nga kjo ziente përbrenda ca më tepër, një të kërcyer bëri, e zuri për gryke spiunin dhe e shkundi paq.

«Vëllanë tim të shash ti? O i merr prapë llafet, o ta dhashë gurmazin në dorë!»

Thoma spiunit i kërcyen sytë pofka, u tremb e u tërhoq e tha se nuk e kishte me Pandon, ama Pandoja, në donte të mirën e tij e të vëllait, të mos nakatosej me atë turkun, kështu e quajti Naimin, i poshtri, që nuk kishte vajtur në Ajnoro të shëronte veremin, po që t'u prishte mendjen besimtarëve të urtë.

Kur dëgjoi gjithë këto palavira, më nuk duroi dot as xha Pandoja.

«Lipsu, mor i lig!» i tha e ia ngjeshi me shkelm bythëve dhe e qiti për dere jashtë.

«Dale, pa më shihni! Po s'vajta që këtij sahati te kajmekami e tek igumeni, mos më thirrshin me emër! E të shihni, pastaj, ç'kam për t'ju punuar unë, që s'jua mbush syrin, si juve ashtu dhe atij të veremosurit!»

Pleqtë thanë e ndoqën me gurë, si një zagat të zgjebosur.

Ngrihen e venë te Naimi dhe i thonë kështu e

kështu. Naimi ua dha tërë librat që kishte. Babai mbushi me ta nja katër teneqe e i fshehu në një shpellë. Pas kësaj mëmëdhitari i madh gjendej jashtë çdo rreziku, po vetë ata jo, se Thoma spiuni do të bënte të tijën, doemos. I kërkuan ndjesë e u përshëndoshën me vjershëtorin. Do t'ju kem në zemër, u tha ai, si mëmëdhetarë të ndershëm e si vëllezër të dashur. Janë fjalët e tij, ë, nuk shtoj asgjë! Siç m'i ka thënë plaku, ashtu jua them juve.

Që atij sahati zbritën në skelë, gjetën një hamallko, si quheshin aty anijet e vogla që mbartnin qereste, dhe ikën, duke e lënë konakun me plaçka e laçka.

Xha Koli ndaloi e na hetoi me sy. Në nuk pipëtinim fare. Të tendosur, ndiqnim me ëndje çdo fjalë të tij. Ilaci kishte hapur gojën e sytë sikur i qenë zmadhuar. Xha Koli luajti gjurin dhe unë, që isha mbështetur në të, shkava e u përmenda.

Më vinte shumë keq që xha Koli e kishte prerë si me thikë bisedën e tij aq tërheqëse, por ai na pas-kësh ruajtur nën të papritur shumë të këndshme.

Ai futi dorën në torbë dhe, si prestigjizatori që të shikon në sy, ndërsa nxjerr pëllumbin nga shamia, fap ia bëri e nxori një libër të vjetër, me kapakë të kuqërremtë, si në ngjyrën e tjegullës së pjekur mirë. Të petkëzuar e të leshavitur, nuk merrej vesh në ishin prej kartoni kapakët e tij, apo prej një cohe të veshur me letër të butë. E mbajti pakëz përpara, pastaj na e afroi secilit me radhë, që ta shihnim më mirë.

Sami Frashëri; Shqipëria ç'ka qënë, ç'është e ç'do të bëhet, botim i vitit 1899.

Me fletët tërësisht të zverdhura, me qoshe të ngrëna, me disa germa që sot nuk përdoren më, na bëhej se libri vinte nga thellësia e kohërave e sikur mbartte me vete tërë peripecitë që janë kaluar për t'u shkruar gjuha jonë.

Më ngjalli në shpirt një ndjenjë admirimi të paanë. Nuk di të kem vlerësuar ndonjë gjë aq shumë, sa atë libër në ato çaste. Ndofta ngaqë vinte pas një tregimi prekës.

Në faqen e parë të librit dikur kishte pasur ca fjalë me shkrim dore. Koha i pati fshirë e nuk dalloheshin më. Xha Koli tha se ashtu e mbante mend atë libër. Sa për fjalët me shkrim dore, sqaroi që do të ishte ndonjë shënim o i Naimit, o i Samiut, se një ishin të dy, shtoi ai, ç'donte njëri, e donte dhe tjetri dhe ç'dinte njëri, s'rrinte pa ia thënë edhe tjetrit.

— Për sot kaq, — tha duke u ngritur në këmbë. Një herë tjetër, të tjera.

Prapë mendova sa pak dinim ne për fshatin e fshatarët.

Pastaj më shkoi ndër mend diçka tjetër. Historia, mendova, shkruan për njerëzit e ngjarjet, përmend më kryesorët e thotë që ata mbështeteshin te masat. Po masat janë shumë e nuk mund të përmenden me emër të gjithë...

MËNGJESI I RRETHIMIT

Një dhomë e madhe, e zhveshur, sa syri nuk të ndalej gjëkund. Muret dhe dyshemeja dëshmonin që shtëpia ishte e re, e porsandërtuar. Xhandarët serbë e patën djegur me gjithë ç'kishte brenda për inat të Azemit. Galicajt e ngritën nga e para, akoma pa u fashitur mirë tymi, në shenjë dashurie për të. Pastaj dikush i solli nënë Sherifes një mbulesë, dikush një orendi. Një fshatar i dhuroi një lopë. Se në shtëpi të zbrazët njeriu nuk rron dot edhe se Galicajt nuk mund ta linin përgjysmë bamirësinë e tyre. Megjithatë, që të plotësohet shtëpia me tërë ç'i duhen, do kohë e deri atëherë mangësia ndihet gjithandej.

Në dysheme, afër vatrës, ishte shtruar një shkorsë e vogël.

Në njërin anë rrinte nënë Sherifja, në tjetrën Shota. Atje përfund, në një shtrat druri, flinte një mbesë e Sherifes, me të cilën ajo jetonte. Nga gjithë familja e madhe në shtëpi kishin mbetur vetëm ato të dyja, nënë e mbesë, dhe Azemi e Shota, kishin dalë në mal.

Nusja kishte ardhur fshehurazi, nga mesi i natës, që ta shihte e t'i thoshte të kujdesej e të fshihej diku, pasi ato ditë ushtria serbe do të mësynte sërish asaj ane.

Rrinin pranë e pranë. E shuan dritën, që të mos ngjallnin ndonjë dyshim për syrin e të ligut. Biseduan gjatë, me zë të ulët, që të mos zgjohej e vogla.

Nata qe e qetë. Kur e kur lehnin qentë nëpër fshat. E lehura e tyre fillonte diku me potere, kushedi përse, dhe përhapej gjithandej. Pastaj platitej një copë herë.

Shota pa hënën dhe iu kujtua ajo fjala që thotë se qentë lehin me të. Po hëna nuk trazohej fare. E qetë, e bardhë, mospërfillëse, ajo varej e plotë në kupën e qiellit aq afër dritares, sa dukej si një sy i madh që për-gjon brenda.

Shota iu kthye nënë Sherifes. Trupmadhe, krejt e thinjur, qëndronte drejt, si e gdhendur në gur. Drita e hënës e lante në njërën faqe.

«Kushedi sa net i gdhin kështu, në shoqëri me hënën! Na pret ne, merakoset e bisedon me të. Hëna s'di të flasë, po ja, e lan me argjend dhe ajo zbardhet gjithnjë e më shumë, shpejt, si pa kohë. Si s'u lodhe e nuk u lige një herë, moj nënë! Zemër po zemër paske! S'u dhe e as ke për t'u dhënë. Ty, pra, të ngjet Azemi!»

Nënë Sherifja Shotës nuk i ngjasonte me asnjë grua tjetër. Kur kërkonte shëmbëllim për të, vetiu i kujtohe-shin femrat e këngëve të moçme, ato luaneshat e pashoqe, për të cilat edhe vetë kishte kënduar e këndonte me ëndje.

Nënë Sherifja çmallej me nusen e mendonte për djalin.

— A iu shëndosh krejt plaga?

— Tashti nuk e ndien më.

— Tre muaj lëngoi ai, e nëna nuk dinte kurrëgjël!

Këtë s'qe e mundur ta harronte. Azemi në shpellën e pyllit, i plagosur keq. Nusja i shërbeu përmes ashpërsisë së motit, gjithnjë e ndjekur nga armiku. Por e shëroi që e shëroi!

— Trimëresha e nënës!

Sa herë e kishte thirrur kështu,

Shota mendoj se nëna ndërkohë me siguri kujtonte Ademin e vogël.

«I shkreti Adem. U shërua nga plagët e vdiq nga një gjë që s'do t'i shkonte kurrë ndër mend njeriu! Dhe nëna... si s'u ankove një herë, moj nënë!»

Shotës iu dhimbs nënë Sherifja. Papritur i lindi dëshira të bënte çmos që t'ia përndante mendimet e këqija e dëshpërimin.

— Bacë Bajrami na çoi letër, — tha.

— E mandej?

— Në Shqipërinë e bërë, atje në Vlorë, vëllezërit tanë e hodhën në det dushmanin italian. Dhe dushmani italian është më i madh së serbi.

Nënë Sherifja kishte dëgjuar për pushtuesit italianë. Po si e qysh hidhet në det ai e ç'është vetë deti, këtë s'e dinte. Ajo përfytyroi një ndyrësirë që, po ta lësh, të qelb shtëpinë.

— A thua do ta hedhim në det dhe dushmanin serb? Ç'thotë bacë Bajrami?

— O do ta përzëmë që këtej, o s'mbetet asnjë nga ne gjallë! Kështu thotë Azemi. Bacë Bajrami është me ne. Do t'ia dalim në krye, nënë!

— Të pastë nëna! Po ti moj trimëreshë, vërtet shkove vetë e hyre në qytet dhe e vrave naçallnikun mu në shtëpinë e vet, siç më kanë thënë mua?

— E kishte hak.

Nënë Sherifja ia kapi dorën e ia përkëdheli.

— Kush e ka bërë hak, mëria jonë e gjen. Vdekjen mbjellin, ajo i korr e do t'i korrë. Të gjithë! Ty të kujtohet ai i egri e i pashpirti, Kostë Vojvoda. A i patëm ndonjë faj ne atij? Ç'të keqe i bëmë? Besa, veç të mirave asgjë tjetër! Kur na pati pushtuar austriaku, erdhi me aeroplan që nga Selaniku, i dërguar nga qeveria serbe. Na tha të bënim marrëveshje e të luftonim armikun e përbashkët. Ashtu bëmë. Kosova është shqiptare. Këtë e pranoi atë kohë vojvoda, po mandej e harroi. Sa shporrëm austriakun, u turr mbi fshatrat e Kosovës e vrit e digj për të kallur tmerr e nënshtrim. U tubuan çetat. More, a nuk po e shihni ç'bën katili? Ky e çarti

besën. Oburra, mbi të! Ushtri kishte, topa kishte, mitraloza kishte. Po mëria jonë nuk mbahej kurrsesi. E gjeti. U plagos. Ngeli me një sy, po dorë s'hoqi gjer-sa e vramë.

Shota fliste e nëna përfytyronte një përbindsh të verbër me thikë në njëren dorë e urë zjarri në tjetrën.

Kostë vojvodën e njihte. E kishte pranuar në vatrë tok me Azemin. Kishte ngrënë e kishte pirë ai në shtëpinë e saj. Sillej mirë një kohë, vërtet. Pastaj e kishte kthyer fletën.

«Po ç'duan këta dushmanët, xhanëm? Kush u fut drejtin në bark, që lënë shtëpitë e tyre e vijnë këtej të na therin e të na djegin? Nuk kanë nëna këta, nuk kanë motra? Nuse e çika s'kanë?»

Vetëm me pak fjalë ia jepte shpjegimin: dushmani është i lig. Vjen e u bie më qafë njerëzve të mirë, këta durojnë sa durojnë, po dhe durimi e ka një cak, mandej ngrihen e bëjnë luftë me të. Po lufta s'është e lehtë.

— Dushmani ka ushtri të madhe, o bijë. Druaj se ju ngujon e ju vret! Ashtu ka hapur fjalë.

— Në tokën tonë të na ngujojë dushmani?! Kjo nuk ndodh kurrë, moj nënë. Mos ki dert!

Hëna po zbehej.

— Nënë, unë tashti do të shkoj.

— Jo, bijë, ne akoma s'jemi parë mirë.

— Më pret Azemi, e bëhet merak.

— E di ai, e di që edhe unë kam dëshirë të çmallem një ditë me nusen.

Shota nuk ia prishi.

Në mëngjes atë e këputi gjumi. U hepua e mbështeti kokën mbi duar. Ashtu fjeti. Merrte frymë ngadalë e flinte qetë, pa bërë asnjë lëvizje. Pushkën ulur në vatrë, pranë gjunjëve, nagantin në brez.

Nënë Sherifja e shihte dhe mendonte për të.

Atë kohë kishin reshtur fjalët e këqija për nusen që pati dalë malit tok me burra. Në vend të tyre ishte ngritur ylli i sokoleshës që nderonte Kosovën mbarë. Nënë Sherifja krenohet me nusen njëlloj si me Azemin. Ajo nuk pati menduar asnjëherë keq për

të. Vetë ia pati dhënë bekimin, kur i dha për të veshur rroba djali. E deshi që në të parë. Për hatër të Azemit? Jo, besa! Edhe se me fustan nusërie akoma, Shota atë natë rrëmbeu pushkën. E trimëresha njeh trimëreshën dhe e do.

Nuk ngopej së pari.

Një nuse me rroba komiti! Ç'i shkonin punë e madhe! Po t'ia prisje gërshetin, Shota do t'i ngjante një djaloshi të bukur, të cilit ende s'i ka dirsur qimja në faqe.

Tirqit i qenë kojtur në gjunjë. Gajtani që brejtur në aq vende, po një shqepje s'ia shihje.

Të kujt kishin qenë ato rroba?

Nëna më kot u mundua ta kujtonte. Kishte hapur sëndukun e i kishte marrë atë natë të paharruar, kur i kishin rënë dy bij e tjetri, Azemi, duhej të shkonte, ndërsa nusja e tij e re, e porsamartuar, tha se do të vente dhe ajo me të. Ngjarje të tilla janë të rralla, ato e robërojnë dhe vetë kujtesën. Po Shotës i shkonin fare mirë, sikur të ishin prerë për të.

Drita e mëngjesit ia kreu ballin nuses. Balli e faqet e saj, përcëlluar nga dielli e era, e kishin humbur butësinë. Vetullat, të zeza dikur, dukeshin si gësh-tenjë tani. Ndofta ngaqë lëkura nuk qe aq e bardhë si atëherë. Po aty, nën mjekrën e vogël të rrumbullt, në atë pjesë të shkopsitur të mitanit, zbardhonte gusha e nuses. Një damar i hollë rrihte lehtë, ritmikisht në atë bardhësi të zbuluar paksa.

«Çika mbetet çikë, ani se bëhet trimëreshë», tha me vete nënë Sherifja e psherëtiu.

«Si bën atje në mal, moj nusja e nënës! Për shtrat nusëror ke tokën e fortë. Për djep pushkën, fëmijë-krismën e saj. Nëna do të donte t'ju kishte pranë e të përkundte një djep. Eh, sa do të doja! Një fëmijë e ngroh shtëpinë. E ngroh dhe e mbush. Në shtëpi një fëmijë ndihet më shumë se dhjetë të rritur. Po dhe ti do të doje. Plastë ajo femër që nuk dëshiron të përkundë fëmijë...

O dushmanë të mallkuar, nga erdhët e përse? Si

ju duron zoti, si s'ju goditi montja që në rrëzë! Ne të zezat kurrë nuk kemi lakmuar shumë. Jetë e liri duam. Edhe shpesët e pyllit e kanë, jo më njerëzit. Se në liri jeta pjell jetën, djepi rrit fëmijën e fëmija gëzon prindin...»

Në rrugë u dëgjua gërthitja e lopçarit.

Ajo u ngrit e eci me majat e gishtërinjve. Lëshoi lopën, e bashkoi me tufën e u kthye. Shota ishte zgjuar.

— Fli, nuse, fli!

Si ta kishte gjumin në qerpikë, Shota i mbylli ata e fjeti prapë. Nata kishte qenë me zagushi, mëngjesi vinte i freskët. Nënë Sherifja mori e i hodhi një robë.

Në degën e kumbullës nxori syrin dielli. Përshkoi xhamin, hyri në dhomë, ngacmues. Dielli të shkund e të nxit për punë.

Nënë Sherifja shkoi e mbushi ujë, e mbylli me kujdes portën, ndezi zjarrin e vari në çengel kusinë me qumësht.

Shota i ndiente përgjumësh këto lëvizje e zhurma të këndshme e të harruara, por ato nuk ia trembën gjumin, përkundrazi, ia lezetuan e i ndollën ëndrra të bukura.

Ndërkohë vajza e vogël u ngrit shesh në shtrat, duke fërkuar sytë. Pastaj, kur vuri re se dikush flinte pranë vatrës, tha e befasuar:

— O nënë!

— Shëëët! — ia bëri nëna me gishtin në buzë. E lehtë si pupël, vajza eci këmbëzbathur në dyshe-me, qëndroi përpara komitës e nuk iu durua pa thënë:

— O nënë, po kjo qenka nusja e Azemit!

— E di, e di, po ti mos u ndiej, se ajo është e lodhur.

Vajza dëgjoi, por, të largohej, nuk qe e mundur. U ul në gjunjë me sytë ngulur te Shota. Dukej se mund të priste ashtu me durim ndofta gjithë ditën me shpresën që, kur komitës t'i dilte gjumi, atë të shihte të parën e ajo e para t'i hidhej në qafë.

Një rreze dielli lodroi në fytyrën e nuses. Ajo buzëqeshi e fytyra iu ngroh. Vajza e vogël fërgëlloi.

Mendoi se Shota do të zgjohej, por ajo lëvizi buzët në gjumë e prapë buzëqeshi butë, ëmbël.

— O nënë, nusja e Azemit po qesh!

— Mirë, pra, po ti hesht! Ajo i qesh fëmijës.

— Cilës fëmijë?

— Fëmijës së vet.

Vajza rrotulloi sytë, tepër e gatshme ta shihte e ta përkëdhelte fëmijën e nuses së Azemit.

— Ku është?

— E ka ajo në vetvete, po ti mos u ndiej.

Vajza heshti vërtet, fort e habitur dhe pritë.

Ndërkohë përjashta u dëgjuan zhurma hapash të rëndë.

Nënë Sherifja zgjati kokën në dritare e u tërhoq menjëherë. Përtej avllisë kishte parë dy ushtarë serbë.

— Shotë, nuse, çohu! Dushmani!

Shota u hodh drejt e në këmbë me pushkën në dorë.

— Ku?

U dëgjua një thirrje e fortë:

— Ju kemi rrethuar e s'keni ç'të bëni. Dorëzohuni!

Të dyja gratë u panë në sy dhe heshtën në përgjim, sikur vëzhgonin në zemrat e tyre. Thirrja që nga jashtë u përsërit. Një zë i dytë, më pranë, shtoi:

— Azem Galica, krali të garanton jetën e një rrogë të përvitshme.

Shota iu afrua me kujdes dritares.

— Azem Galica, a po më dëgjon?

Pyetjen e shoqëroi një plumb. Plumbi shpoi xhamin, që u bë copash dhe ra me zhurmë në këmbët e komitës. Ajo e dalloj nga fjolla e tymit pushkën që kishte shkrehur.

— Me kë na takon të flasim? — pyeti e u bë gati.

Pas avllisë u ngrit përgjysmë figura e një oficeri.

— Unë jam...

Nuk e mbaroi dot fjalën. U thye më dysh e ra me kokë në avlli. Një ushtar, me sa duket ai që rrinte pranë oficerit e që kishte qëlluar në xham për t'i trembur, shpejtoi t'i vente në ndihmë. Shota e qëlloi edhe atë.

Nënë Sherifja e shpuri të mbesën nën musandër.

— Këtu të rrish! — i tha me të rreptë.

Vajza e vogël u mblodh kruspull e rrotullonte sytë, duke parë herë gjyshen e herë Shotën. Kur hasi vështrimin e saj, Shota i buzëqeshi, e fëmijës iu ngroh ca shpirti i trembur.

Nëna hapi musandrën, rrëmoi nën rroba e nxori dy pushkë e mjaft fishekë.

— Porta është e fortë, i kam vënë llozin, — tha.

Nusja e falënderoi me sy për qëndrimin burrëror. E dinte që ashtu do të sillej e jo ndryshe.

Shtëpia u sulmua njëherësh nga të katër anët. Krismat ndiqnin njëra-tjetrën, përziheshin, e dyta përpiqej të gëlltiste të parën, po nuk ia arrinte dot. Thyheshin me zhurmë xhamat, fishkëllenin plumbat që shkonin bosh, skërmiteshin copëra balte e cifla guri nga muret.

Gratë mbanin vesh, a thua prisnin diçka... Nganjëherë edhe qëllonin.

— Ruaju, nënë, mos rri përballë dritares!

Vetë Shota qëndronte përbri, herë në njërën e herë në tjetrën anë të dritares. Shikonte me njërin sy e, kur bindej se plumbi nuk do t'i shkonte kot, qëllonte.

— Shotë, mori bijë! M'u vodh njëri e na hyri gjer rrëzë murit. M'u bë se kishte një teneqe vajguri në dorë.

Shota kërceu në atë anë.

«Ku?» pyeti me sy. Si mori përgjigje, hoqi nga brezi njërën nga dy bombat dhe e hodhi poshtë në drejtimin që i tregoi e vjehrra.

U dëgjua krisma e bombës dhe u duk një tym i zi. Bataritë iu qepën shtëpisë më me tërbim. Rrethimi që i plotë e i egër. Shota u vinte vesh krismave për të gjetur me mend se sa mund të ishin rrethuesit. Duhej të ishte një batalion a më shumë. (Një batalion, me një shtëpi...

Jo më pak e ndiente rrezikun nënë Sherifja. Ajo nuk e llogariste veten fare.

— Larg e le Azemin? — pyeti.

— Andej nga Çiçavica.

Po, larg ishte. Nuk do t'i dëgjonte krismat. Zor të mbanin shpresë te ndihma e tij. Veç në e kishte marrë vesh që serbët do t'ia behnin para kohe. Po sikur të përpiqeshin e të çanin një shteg sa të shkante tinës nusja me mbesën? A mundej, vallë? Ajo po kërkonte sytë e nuses.

— Ruaju, bijë! — tha.

— Kush ka rrojtur treqind vjet, moj nënë?

Nënë Sherifja e kuptoi se qe e kotë të mendohej. Nusja nuk do të pranonte të ikte. Edhe iu dhimbs, kur dëgjoi përgjigjen e saj të mençur, edhe i erdhi mirë për atë përgjigje.

— Ne, të gjalla s'u biem në dorë, — tha. — E më shumë s'kanë ç'të na bëjnë.

Shota tundi kokën në shenjë pohimi. Ajo ishte komitë, luftëtare. E komita e njuh rrezikun e mësohet me të. Është ndeshur shumë herë me vdekjen e ajo nuk ia kall dot tmerrin, në të kundërt, sa më dendur ta hasë, aq më lehtë e ka ta shohë drejt në sy, pa iu dridhur aspak qerpiku. Nënë Sherifja komitë nuk ishte. Nuk kishte dalë ndonjëherë malit ajo. Po zemër, veç, zemër prej luftëtareje kishte!

Komita e shihte luftëtaren nënë dhe ndiente t'i rritej në shpirt dashuria për të. Një valë admirimi po i ngrihej së brendshmi, një si afsh përmallimi. Sytë iu njomën e qerpikët iu drodhën. Ktheu kokën dhe e pa. Edhe nënë Sherifja atë po shihte. U panë disa çaste pa i hequr dot sytë nga njëra-tjetra, me shpirt të ngrehur, me sy të njomur. Vetiu bënë nga një hap për t'u afruar e atëherë Shota tha me zë të dridhshëm:

— Ma bëj hallall, nënë!

Nëna ia shtrëngoi kokën në gji.

— Ma bëj hallall, nuse!

E u përqaftuan, duke u shtrënguar fort, përmes plumbave. Që do të luftonin deri në fund, s'kishte dyshim. Më tepër kishin hallin e njëra-tjetrës, sesa të vetes.

Secila shkoi sërish te vendi i vet. Secila nga një

dritare. Në shtëpinë e re Galicajt nuk i kishin bërë dritaret të ngushta, po çka, frëngji e llogore bëhet edhe dritarja e gjerë, kur ka kush lufton pas saj.

Dikur nëna tha:

— Po këta Galicajt ku janë? E pra, nuk e kanë zakon ta lënë të vetin ngujuar nga dushmani.

— Janë në ara e në punë të tjera, — tha Shota. — Hasmi gjuajti rastin kur burrat nuk gjenden në fshat. E dëgjove vetë, ata e dinë këtu Azemin.

— Aq më keq për ta!

Një ushtar i kishte dalë në shenjë. Shota shtiu mbi të.

— Por, megjithatë...

Nuk e vijoi mendimin. Sesi i dukej! I bëhej që diçka nuk shkonte. Në një mëngjes të bukur, në mes të fshatit të Azemit... E pra, ajo e nënë Sherifja ishin në vendin e vet, në shtëpinë e vet, në Galicën e vet. Ku ishin Galicajt, vërtet? Në ara? Në punë? Mirë, po a nuk i dëgjonin krismat, a nuk e shihnin tymin? Dhe në ishin burrat larg, po gratë ç'bënin?

Pyetjet ishin qortuese për Galicajt. Sikur të kujtohej papritur, vuri duart si bori e bërtiti me sa zë pati:

— O, prite Azem Galicën, ej!

Reshtën një grimë krismat. Sikur thirrja t'ua kishte këputur kokën.

Në heshtjen e shkurtër, diku larg thirrja u përsëdyt. Nënë e nuse mbajtën vesh. U ndehën të dëgjonin më mirë. A ishte thirrje nga jashtë, në shpinë të rrethuesve, apo zëri i Shotës përplasej në faqe shkëmbinsh a muresh dhe kthehej mbrapa? Oh, sikur të përsëritej!

Dhe zëri u përsërit. Jo, një, po disa.

— O, prite Azem Galicën!

— ...prite...

— ...Azem Galicën!

— O, prite...

Jo, nuk qe jehonë! Ishin zëra. Shumë zëra që thërrisnin, dikush më afër e dikush më larg parullën e njohur. Zëra e pas tyre krisma. Shkëputeshin nga dri-

taret e shtëpive të Galicës, në fillim nga shtëpitë më të largëta, pastaj gjithnjë duke u afruar. Pa kaluar as gjysmë ore, nga çdo shtëpi e fshatit u ngrit kushtrimi e u ndien krisma pushkësh që, të shumëfishuara, u rrokullisën si ortek mbi armiqtë, të cilët, nga rrethues, befas u gjendën të rrethuar.

— Galicajt, nënë! — thirri Shota e u sul ta për-qafonte sërish, po ndryshe nga hera e parë.

— Po, bijë!

Shpirti i gufonte komitës, jo aq se po i shpëtonin rrethimit, sesa për bukurinë e veprimit të menjëher-shëm të bashkëfshatarëve.

— O, prite Azem Galicën! — bërtiti prapë, fort, e ndezur nga kushtrimi, Shotë Galica.

COPËZA NGA NJË JETË

I. XHA MIHALI

Kush ka qenë në Korçë, patjetër e ka parë Monumentin e Luftëtarit Kombëtar. Pak më sipër, nga e majta, ngjitet përperjetë një rrugicë me kalldrëm. Sapo hyn në të, të zë syri një shtëpi të vogël, njëkatëshe, me një pllakë metalike në portë. Ti i hedh një sy shënimit mbi atë pllakë dhe vetvetiu qëndron për ta parë më mirë. Këtu paska jetuar patrioti i Rilindjes Mihal Grameno, përsërit me vete plot nderim për kujtimin e atij njeriu, që luftoi me pushkë e me penë. Kërshëria s'të lë të largohesh.

Shtëpia ka bodrume të thella, një oborr të ngushtë e ca shkallina të gurta që zënë fill qysh te porta e jashtme. Në krye të shkallinave është një verandë prej druri, e vogël dhe e ngushtë edhe ajo.

Tani shtëpisë po i bëhen ca meremetime. Nja dhjetë vjet më parë aty banonte gruaja e heroit, Niqi Gramenoja. Bashkë me disa shokë shkuam për vizitë në një përvjetor të partriotit. Niqi, një grua e mbajtur mirë, doli vetë të na e hapte derën dhe na priti më këmbë në të hyrë të verandës. Dukej e mësuar me vizita. Sillej me përzemërsi e fare shpenguar. Bëri çmos që ta ndienim veten sa më çlirët. Po kjo s'qe gjë e lehtë. Me të kapërcyer pragun e portës, më kapulluan ca mendime e ndjenja. Sytë e mi përpinin gjithçka. Në murin përballë, një fotografi e njohur e Mihalit me Çerçizin, por e zmadhuar. Çerçizi, i drejtë, i ri, i gjatë, me dylbitë në gjoks. Mihalit, mbështetur në një pushkë të shkurtër, me bërruc krahëve. Sytë e tij të qeshur sikur më ftonin ta hiqja druajtjen. Pak më tej një fotografi tjetër, ku heroi ishte në moshë të thyer. Fytyra e shëndoshë, e pastër, flokët thuajse të rënë, sytë po atë, të butë e të çiltër. Në kënd shpalosur flamuri kombëtar. I zbardhëllyer, me nja dy vrima nën kokat e shqiponjës. Flamuri më çoi larg. Shikoja çetën në një majë mali, Çerçizin në vrojtim, Mihalin me flamur në dorë, herë duke e valëvitur e herë ngulur në shkëmb. «Përmbi shkëmbinj e gurë, lirinë të ngjallimë!» dukej sikur këndonte ai me një zë të shtruar, të sigurt...

Nga mali u ktheva në dhomë, pa m'u shuar për asnjë çast kërshtëria. Një tryezë e vogël në mes. Pranë saj një karrige me ndenjësë kashte. Nën të një mangall i ndritshëm bakri...

— Të tëra siç ishin në të gjallë të tij, — tha Niqi, që e kishte ndjekur shikimin zhbirues.

Zihesha ngushtë sa herë që ajo më drejtohej mua. Me ngathtësi belbëzoja përgjigjen. Dy shokët afër meje ende s'u kishin gjetur dot vend duarve të tyre! Mirë që ishte me ne Aleko Skali. Ai e mbante gjallë bisedën. Ai dhe Niqi Gramenoja. Leko Skali ishte aktor e shkrimtar, njeri fort i dhënë pas traditave patriotike e kulturore. Kur fliste, sytë i ndritnin e vendi s'e mbante. Nuk qe e mundur të mos e dëgjoje me ëndje.

— Më dërgonte nganjëherë nëna. — tha ai. — Vija duke rendur. se xha Mihali më donte. Rrinte ia, këtu, në mes të dhomës, kërrusur mbi këtë tryezë. Mangallin me prush ndër këmbë, një velenxë hedhur krahëve, shkruante e shkruante...

— Ashtu e kishte zakon, tamam si thotë Alekoja, — ia merrte anën Niqi Gramenoja.

— Afrohesha në majë të gishtave, i dilja përbri dhe zgjatja kokën për të parë ç'kishte hedhur në letër.

«Ë. mor Leko, hë, mor nip, ç'kërkon, shkronjëtor do të bëhesh edhe ti?»

— «Ëhë!»

«Po a e di që është e zorçme?»

«Ua, e zorçme! Se nuk e shoh unë! Ty të shket pena sikur e di mësimin ujë!»

«Qerratuci, si thotë!» ia bënte ai dhe ma fërkonte kokën e qeshte shumë.

Pastaj vrenjtej e i ngulte sytë diku si i përhumbur.

«Sado e errët nata, dita vjen se vjen!» shtonte si për vete xha Mihali.

Këto fjalët e fundit «xha Mihali», Lekoja sikur i theksonte ndryshe, i mëshonte fjalës. e ngopte emrin e shtrenjtë me njomësi e ngrohtësi. Ai kishte përvojën e aktorit. Të merrte për dore, të ngrinte nga vendi e të shpinte lehtë, pa u ndier, atje ku shkonte fjala e tij. Tok me të të bëhej se shihje njeriun për të cilin të fliste, xha Mihalin. Copëza tregimesh për bëmat e tij shkonin e vinin në bisedën e asaj dite.

Unë po shënoj disa syresh.

2. EJA, MBLIDHUNI KËTU, KËTU!

Dhespot Foti ra shakull nga kali pak më tutje Gurit të Capit, në udhën që shkon përmes ahishtave. Shumë të këqija u kishte bërë shqiptarëve. Ishte nisur për në Kostur, që të kurdiste prapësi të tjera. E kishte mbushur kupën. Çeta ia kishte bërë benë dhe e qëroi nga faqja e dheut.

Çerçizi i fryu gjashtores, a thua druhej se mos i qe fëlliqur. Pastaj e futi në brez dhe dha shenjën e nisjes.

Komitët morën kurrizin e Moravës e dolën përmbi fshatin Floq. Pastaj iu ngjitën Qafës së Kazanit. Mihali nuk i bëri dot ballë tundimit. E donte natyrën e bukur e s'ngopej me të. Ndenji më këmbë e hodhi një shikim përreth. Nga Qafa e Kazanit dukeshin fare mirë fusha e Korçës, Devolli e pllaja e Kolonjës.

Komitët ecën edhe ca dhe ranë në Kolonjë. Mesnata i zuri në një pyll, e atje qëndruan të flinin nja tri-katër orë. Në mbrëmje duhej të gjendeshin në Dangëlli, ashtu u shkruante një kombëtar, si i quante Mihali patriotët e mirë.

Kur u zgjuan në mëngjes, Çerçizi dëgjoi ca zhurma e vuri dorën në brez. Mirëpo Hajredini, që ishte karauill, i bëri me dorë të qetohej e të mos kishte merak. Hajredini rrinte këmbëkryq pas trungut të madh të një ahu. Fytyra i kishte marrë një shprehje ngazëllimi, sikur shikonte ndonjë ëndërr të bukur.

Kapedani i çetës u bë kureshtar për ngazëllimin e tij. U ngrit e ndoqi me sy shikimin e karauillit. Pak më tutje rridhte me gurgullimë një përrua i cekët. Në anën tjetër të përroit nisnin kullotat e Gramozit. Një tufë dhensh i ishte qepur pllajës shkëmbore. Dhentë qëmtonin mustakët e barit ndërmjet gurëve. Përplaseshin këmborët nëpër gurë, po dhentë ndiqnin me zell barin e shijshëm dhe ngjiteshin lart e më lart.

Tufa e dhenve në kullotë të ndjell paqe në shpirt. Çerçizi e provoi menjëherë këtë ndjesi dhe u kthye nga shoku:

— Mihal, fle, a je zgjuar? Shih, shih!

Mihali u shtriq e zgjati kokën.

Një zë rioshi dallonte mbi zhurmën e këmborëve. Ulur në një shkëmb, një djalosh nja pesëmbëdhjetë a gjashtëmbëdhjetëvjeçar skërmiste me kërrabë cifla gu-ri shtuf e këndonte lehtë e lehtë, pa e ditur se kishte dëgjues.

— Dëgjo, Mihal, dëgjo!

Mihali mbajti vesh.

Të gjithë ne, o shokë,

të lidhim besënë,

se fjala jonë është:

Liri për Shqipëri!

Eja, mblidhuni këtu, këtu!...

Djaloshi këndokësh «Për memëdhenë»!

Komitët e ndoqën të mahnitur deri në fund atë këngë.

Bariu i vogël kishte vesh për muzikë, e kjo s'është për t'u çuditur. Barinjtë ia thonë në këngë e melodi. Të dëgjuarit e tingujve të shumtë në natyrë, pastaj këmborët, ua mprehin veshin. Shpejt a vonë vënë fyellin në buzë. Nga një nevojë për të shkuar kohën, ai bëhet shok i tyre i ngushtë e i dashur. Fyelli i ushtron në melodi e meloditë i futin në këngë, të cilat i kapin aty për aty.

Djaloshi, pra, këndonte qetë, i ngeshëm. Zërin e kishte të pastër e të butë. Nuk i gjeje dot të metë a ndonjë shtrembërim. Por komitët ngazëllenin jo aq për mënyrën e të kënduarit, sesa për këngën vetë. Ishte kënga e tyre. E njohura, e dashura, frymëzuesja. Flamuri i dytë i çetës.

Dhe këngën, dihet, e kishte bërë Mihal.

Çerçizi tha:

— Në më pak se një vit kjo këngë u hap gjithandej e i prin dëshirës për liri. Mihal, ti duhet të jesh i lumtur.

Mihali ia bëri po me kokë. Ai po jetonte një çast shumë prekës. Zemra i gufonte, e ndiente veten të lehtë, plot fuqi. I vinte të sulej përtej përroit, ta shtrëngonte në gji këngëtarin e vogël, që i bëhej se e kishte të afërm e të shtrenjtë. Iu duk sikur takoi një të njohur të vjetër për të cilin e kishte pikur malli.

— Ti do të shkruash akoma shumë, Mihal. Patjetër! Unë uroj që tërë të shkruarat e tua të kenë fatin e kësaj kënge.

— Ma bën qejfin, Çeço. Po ta shohësh hollë-hollë, atë këngë nuk e bëra unë, po qëllimi ynë i shenjtëruar. Unë vetëm sa e hodha në kartë.

— A po ti e ngjeve penën në qëllimin e shenjtëruar, — plotësoi kapedani i çetës.

Mihali nuk tha jo. Ai e pranoi mendimin e shokut si një të vërtetë dhe si një mësim.

3. URATË PËR LIRI

Nënë Lina ishte një grua trupmadhe.

— I-i, moj e zezë, ti nganjëherë silllesh si të jesh burrë! — i thoshte një fqinjë, kur Lina ia priste muhabetin shkurt, si me sëpatë dardhari.

— Pse, s'e di ti? Unë për mashkull u nisa, po u bë një lajthitje! Sa isha e vogël, me djemtë lozja.

Dhe «gë-gë-gë!» qeshte e fshinte sytë që i lëshonin lot nga hokat e gëzimi.

Një ditë të vitit 1887 të shoqin e thirrën në mitropoli, te dhespoti i Korçës. Ai u kthye që andej i dëshpëruar.

— Hë, mo, ç'të tha, i paçim uratën? — e pyeti me shpoti Lina.

— T'i heqim djemtë nga skolia shqipe. Përndryshe...

— E çë përndryshe?

— Do të na aforisë.

— Posi, posi! M'u bëftë kurban Fillotheçka! Pse, surratin e tij ka Krishti? Krishti s'është grek, që!

— Por, mos është shqiptar?

— Shqiptar? Pika të rëntë, ç'thua! S'është as shqiptar!

— Turk?

— U-u, ç'gjynatoset ditëpreri!

— Po ç'është, atëherë, sipas mendjes sate?

— Se mos e di unë! Po dhespoti nga na e mësoi që qenkësh grek? Mos i preu kërthizën?

Pastaj nënë Lina u kthye nga të bijtë.

— O djem, unë bekimin jua kam dhënë. Bijtë tanë jeni, por edhe të asaj që ju jep emrin. Se ju thërrsim Mina, Mihal, Koço e kështu me radhë, po asnjëri nga emrat s'ju thërret të gjithë njëherësh! Them Mina e përgjigjet Minai, themi Mihal e kthen kokën Mihali. Ama porsa ndonjëri thotë shqiptar, përgjigjeni të gjithë. Apo s'e kam mirë? Mirë që ç'ke me të!

Mihali i vogël dëgjonte e mezi e mbante të qeshurën.

— Hë, ç'm'i përdredh turçkat ti? S'të pëlqen?

— Shumë!

— Jo, po thashë!...

Kur u rrit, Mihali mburrej që i kishte ngjarë së ëmës. Nga ajo kishte marrë çiltërsinë e zemrës dhe guximin. Posi ajo, nuk e tirrte gjatë një punë. Vendoste shpejt e prapa s'bënte. Sapo u takua me Bajon e Çerçizin në Bukuresht e sapo mori vesh ç'kishin ndër mend të bënin, u dha fjalën e u nis me ta në Çetën e Lirisë.

— Hallall, o trimi i nënës! — tha atë kohë nënë Lina.

Qëlloi shumë herë që çeta të vente në shtëpinë e Gramenos. Nënë Lina binte copë për djemtë e malit. U lante rrobat, u bënte për të ngrënë. Pa kishte qejf

të këmbente nga një fjalë me komitët, veçanërisht me Çercizin.

— Jot ëmë, — i thotë Mihali, është shumë trime.

Çercizit iu bë qejfi, natyrisht, e vuri buzën në gaz.

— Për trime, trime është. Po që të ta kalojë ty... unë këtë s'e them dot.

Nënë Lina u kthye nga Mihali. Ky e mbajti veten, duke kafshuar buzën, që të mos qeshte. Se nuk i kishte thënë ndonjëherë që nënë Hasa ia shkonte për trimëri.

— Hë, se të dyja të forta jeni!

— Mirë, ashtu qoftë. Të fala të m'i bësh, o bir, kur të veni tek ajo. Por, a s'më thoni, kështu, kallo-gjerë do të rri iu? Nënë e mira duan nipër e mbesa!

Çercizi tregoi pushkën.

— E po... — ia bënte ai.

— Nënë, po ti!... — shtoi si me qortim Mihali.

— Mirë, de mirë! Unë një llaf iu thashë. Bëni si të dini e si të jetë mirë për Nënë e Madhe.

— Hë, më rrofsh! — dhe Mihali fërkoj duart nga kënaqësia.

Një ditë, në një bisedë të tillë, nënë Lina, që s'po ia ndante sytë dritares, kërceu përpjetë duke thirrur:

— Xhandarët!

Mihali hapi çepenin e komitët u zhdukën nënër dalien e fshehtë. Por ata, në ngutje e sipër, kishin harruar dy revole, një gjerdan me fishekë e një teqevrë. Ajo nuk e humbi aspak toruan. Rrëmbeu dërrasën e bukëve, hodhi mësallën sipër e mbështolli me të armët. Pastaj përveshi mëngët e i krioi llërët me miell.

Xhandarët trokitën fort në portë. Duke vënë përparësen, ajo doli e ua hapi. Xhandarët u derdhën shkallëve, duke e marrë edhe atë përpara. U printe një oficer.

— Ku janë haidutët? — pyeti oficeri.

— S'kemi haidutë ne!

— Ku janë kacakët?

— S'kemi kacakë ne!

— Domuze! Ku i ke komitet?

— Mos shaj, zabit! Komitet janë atje tek lipset të jenë.

— Okllama! — ulëriu oficeri.

— Okllama? Peqe, zabit, bëni okllama, po të kam rixha, nagasi cazë, se kam për të shpënë bukët në furrë!

Xhandarët kërkuan në të gjitha anët. Në dërrasën e bukëve s'u shkoi mendja. Ikën duke u hakërruar, ndërsa nënë Lina me duart në mes qeshi e qeshi. Djemtë u kthyen në dhomë. Çercizit i pikonte buza vrer që kishin harruar armët. Po kur nënë Lina u tha si ua kishte punuar xhandarëve, qeshi edhe ai.

— E nisa që e nisa me magje, do t'ju bëj një byrek, djem!

Komitët e hëngrën byrekun e në të errur bënë përpjetë rrugicës e dolën te mulliri i Mborjes. U futën në gji të Moravës, shtruan gunat në gjethet e thata afër Cezmës së Gjergos. Atje fjetën atë natë.

Mihalin nuk e zuri gjumi. U vërtit një copë herë. U ngrit e ushqe u zjarrin dhe ndenji kërrusur mbi të.

Oshëtinin malet. Ahet e mëdha ndesheshin me erën. Ai që e përcillte, ngrinte lart me krenari e madhëshi kurorën vigane. Ai që e priste dallgëzohej me përkëdheli, pastaj e shtynte te tjetri. Gryka poshtë, e sunduar nga errësira thithte gjithë oshëtimën.

Një nga komitetë gërhiste. Me siguri Zemani, mendoi Mihali. Hapat e karaulit mezi ndiheshin. Karauli bënte rojë më larg, tek ata dy shkëmbinjtë, plasur në lëndinë.

Mihali ngrohej e shikonte përreth. Përpiqej të sillte ndër mend çdo shenjë të atij limeri. Përtej përroit ishte vargani me gurë të mëdhenj, që ai e quante Shkëmbi i Plakës. Guri i mesit që më i madh, plaka vetë, të tjerët përçark tij, gati njëlloj si tufë me dhen.

«Prill, o im vëlla, më jep dy ditë hua, ta thaj plakën me gjithë ç'ka», mërmëriti me vete.

Rrinte zgjuar, shikonte e mendonte e gjumi se nga

bridhte. Le të bredhë, le të bredhë, nuk më lipset tashti!

Mihali nuk kishte gjumë kur çeta kalonte ndonjë rrezik a vështirësi, ose kur ai vetë kishte ndonjë shqetësim. Pas pak nxori një fletore me kapak të zhubrosur e nisi të shkruante në dritën e zjarrit.

Dikur u zgjua edhe Çerçizi. Hodhi gunën krahëve e i shkoi pranë Mihalit.

— Ç'hall ke, Hoxhë?

Mihali ktheu kokën nga ai. Sytë i kishin marrë një shkëlqim të çuditshëm, ndërsa fytyra një pamje të përmalluar, ëndërrimtare. Çerçizit iu bë se ai do ta përqafonte.

— Kam mall për nënat, Çeço, — tha e shikimin ia nguli zjarrit. — Ti e njeh nënën time dhe e do. Unë e njoh nënë Hasën dhe e dua. Luanesha të dyja. S'kanë tjetër merak, veç qysh edhe qysh të nderojmë armët e Shqipërisë. A do të ishim si jemi, pa trimërinë e nënave tona? Ja, nuk më flihej sonte e m'u dha të bëja një vjershë. Edhe nuk e kam mbaruar, po ti mund ta lëçitësh.

Çerçizi mori fletoren dhe lexoi shënimet e shokut. Pasta j ngriti sytë dhe, duke i mëshuar çdo fjale e çdo vargu, përsëriti me zë:

— Merr uratën, bir, prej meje
edhe armët i gatit,
se ardh' dita e shënuar,
dolla ylli e na ndrit!»

4. HYRJETI

Në korrik të 1908-s shkrepri një rrufe në të kthjellët: hyrjeti. Liri për kombet e shtypura. Xhonturqit këtë lajm e botuan në gazeta dhe e përhapën me korrierë në të katër anët e Perandorisë Turke. Lajmi bëri bujë. Armët heshtën, cetat u shpërndanë, e komitetët u kthyen në shtëpitë e tyre. Nuk i trazonte njeri. Madje qeveritarët turq i thërritnin në festimet që bënin. Një festë e veçantë u bë në Selanik. Ishin ftuar aty edhe Mihali me Cercizin. Një javë e ca si në dasmë. Me të ngrëna, me të pira, me fialime. Foli dhe Mihali.

Megjithatë, si ai ashtu dhe Çerçizi, kishin një si drojë. As vetë nuk e kuptonin nga se. Kushedi, kushedi. Afro dy vjet luftë në cetë. Mal më mal, fshat më fshat, avtet më avtet. Në të tëra viset e Jugut. Kishin shumë shpresë te liria. E prisnin dhe do ta sillnin. Ishin të vendosur. Prandaj kishin marrë parasysh çdo gjë. Kurse ajo kishte ardhur papritur e përnjëherë. Me një ferman të sulltan Hamittit.

Po ca të tjerë, jo të paktë, nuk përmbaheshin fare.

«Pse të lodhesh e të derdhësh gjak, mor jahu? Liri do? Një qeveri e mirë, një sulltan i urtë dhe ja, liria u bë!» thoshin këta të tjerët dhe buçariteshin poshtë e lart me festën mbi sy.

Erdhi një cast kur do të ndaheshin. Çerçizi me Bajon e kishin udhën nga deti, me një anije që shkonte në Korfuz. Mihali do të ikte me tren.

Të dy shokët ranë në krahët e njëri-tjetrit. Kapëdanë të cetës, luftëtarë trima që kaq herë s'e kishin përfillur as vdekjen, ndarjes nuk po i bënin ballë. Ajo derdhte në zemrat e tyre atë përmallim që t'i njom sytë e ta zbrum gjithë trupin dhe fjalët i fundos thellë. Rrinin ashtu të përçafuar, duke ndier së brendshmi ngashërimin e shoku-shokut, po nuk flitnin fare.

— Nga na mbiu ky hyrjeti! — tha më në fund Çerçizi.

— U pjekshim shëndoshë e për së shpejti, Çeço!

Tjetri e shtrëngoi dhe një herë në krahët e tij të fortë, pastaj nxitoi të arrinte të vëllanë, që po e priste pak më tutje.

Mihali mendoi se do të ishte shumë e dhimbshme për të të qëndronte ende në Selanik, tani pas largimit të Çerçizit. Hipi dhe ai në trenin e Manastirit. Zuri një kupe më vete. Nuk donte të fliste me njeri. Shpirtin ia kishte kllaposur pikëllimi. Fishkëllima e lokomotivës i ngjante si një vajtim i zvergur klithës. Ajo fishkëllimë e shponte në zemër.

«Më vjen të qaj e të thërres... Po ç'është kështu, o të shkretën!? Ne s'u ndamë përjetë. Prapë do të piqemi e karta do t'i dërgojmë njëri-jatrit. Mirëpo, megjithatë... sesi u çardallos puna kësisoj... Na zuri gafil ky hyrjeti. Ndaj nuk e mbledhim dot mendjen. Dhe koha qysh edhe qysh të ikë sa më parë. Atë punë ka, atë bën. Kurse njeriu... njeriu është tjetër gjë. Koha çapit pa u ndalur asgjekundi e asnjëherë, po a shkon barabar me bëmat e njeriut? Qëllon që këto të ecin më ngadalë, a më shpejt, a me kohën tok. Si të jetë njeriu. Mirë, edhe kësisoj ngjet. Po a e ka në dorë veten njeriu?»

Ai mendohej gjatë. Dhe gjithnjë i dilte në shteg ky i paprituri hyrjet. Hyrjeti e kishte ndërprerë si me thikë rrjedhën e jetës dhe të luftës së tyre. Ndaj i gëzonte, po dhe i hutonte.

Nuk ndenji fare në Manastir. Nisej për në Korçë karvani i qiraxhiut Thimi Ormanlliu dhe Mihali shkoi me të.

Thimi i ngarkoi barrët në tri mushka, ndërsa njërin kalë e mbajti për vete e tjetrin ia dha Mihalit. Ky qe një kalë i pakët, çil, i urtë e i shtruar si dele.

«Mbi të mund të flesh a të menjtosh sa të duash!» gesëndisi Mihali dhe, pa e bërë të gjatë, e shaloi. Më tej lidhi pas kaptellit të parmë litarin e kapistallit, kryqëzoi duart në gjoks e puliti sytë me një ndenjë rehatie.

Atij po i pëlqente udhëtimi në heshtje. Tjetër herë

mund të kishte shumë muhabet, se ishte njeri i fjalës, po kësaj radhe jo. Ndofta prandaj u ngut të gjente Thimin për këtë rrugë të gjatë e të lodhshme prej Manastiri në Korçë. Thimi qe nga ata njerëz që, po s'u fole, nuk flasin.

Ecnin përbri liqenit të Prespës. Brigje të buta e të thyera. Një pllajë me dushk të dendur përgjatë liqenit. Pastaj më lart ahe të mëdha me gjelbërim të ndezur. Përmbi masën e aheve ca kullota të gjera. Tufa dhensh kullotnin në to. Deri në rrugë ndiheshin mbytur këmborët e shumta. Era nuk lëvizte fare. Faqja e liqenit ndriste si vaj. Kur e kur kërcente në sipërfaqe ndonjë krap. Shkëlqente në rrezet e diellit barku i tij i argjendtë. Peshku zhytej e uji flluskonte përreth. Vija e rrethit zgjerohej, zgjerohej, derisa shkrihej tutje.

Bukuria qe e jashtëzakonshme. Mihali po qetohej njëfarësoj.

Mirëpo ky udhëtim i rehatshëm u prish në të hyrë të një fshati. Aty ua preu rrugën një ombash me nja tre a katër xhandarë.

— Jasak!¹⁾ — thirri ai.

— Ç'eshtë, bre? — pyeti Thimi i habitur.

— Hajde këtej! — tha ombashi dhe e kapi për freri kalin e Thimit.

Ombashi é kishte gojën të shtrembër dhe, kur foli, u duk sikur bëri një përpjekje të mundimshme për të kapur me buzë xhufkën e kësulës së kuqe, që lëkundej përmbi veshin e tij të majtë.

— Pse, mor zot? — u ankua Thimi.

— Hajde, bëj si të thonë!

— O zotëri, po kemi udhë të gjatë, bre!

— Paske shumë llafe ti! Eh, ç'prisni ju? — tha ombashi, duke u drejtuar nga xhandarët.

Xhandarët e zbritën Thimin dhe shtynë me kon-dak kalin e mushkat andej nga tregonte me dorë ombashi.

1) Ndaluni!

Mihali ndërhyri e tha:

— Dale, zoti ombash, ti as nuk na pyete fare kush jemi e ku vemi!

— Ç'më hyn në qese mua?

— Po kujt i hyn?

— Komandantit.

— Cili është komandanti yt?

— Ahmet beu.

— Xhon, apo nga të vjetrit?

Ombashi zgjati dorën te koburja dhe e pa rreptë.

— Mbaj gojën! Ahmet beu është xhonturk safi!

— Fort mirë! Po a nuk i thua të piqemi me të?

— Ngenë tënde ka ai!

Mihali e pa që s'do të merrej dot vesh me ombashin. Përdori edhe një marifet të fundit.

— Unë po vij nga Selaniku, — tha.

— Edhe?

— Isha i ftuar në festimet e hyrjetit.

— Këto ia shit ndonjë tjetri. Tashti qepe e bëj ç'të thonë!

I futën në një plevicë, rrethuar me gardh e thekërishte sipër, derën e së cilës ombashi e mbylli nga jashtë. Mbante erë fushnji. Dukej, aty flinin dhentë. Thimi ndenji me gjunjë, prapa derës, si një rojë. Merakosej për ngarkesën dhe druhej se mos hynin xhandarët e ia shkarkonin. Kur e pa që ata s'po nguteshin për një gjë të tillë, e shtroi ca mendjen e zuri të dremiste.

Përrjashta dëgjoheshin hapat e xhandarëve. Më tej erdhi deri në plevicë një klithmë e mprehtë gruaje, pastaj ca lebetitje fëmijësh. Mihali mbajti vesh. Ombashi hyri me vrundull e ia mbërtheu sytë.

— Ja, e sheh?

— Çfarë?

— Ca e ca këtej e kanë marrë me grysh, — tha ombashi.

— Pse? — tha Mihali, që s'po kuptonte gjë.

— Duan liri, medemek!

— Po lirinë e jep Konshuta¹⁾.

— Hë gjuhëgjatë më qenke edhe ti! E jep Konshuta, jo se nuk e jep, ama, por... A s'më thua, ç'e di lirinë ti?

«Me këtë hajvan, sa më pak fjalë, aq më mirë», mendoi Mihali. Nuk mori mundimin t'i përgjigjej fare. Kjo gjë e nxiti ombashin ca më tepër.

— Ka kut liria, mor jahu! Nuk është ik ti, të rri unë!

— Kështu thonë në këtë fshat.

— Se mos vetëm ata! Ti the që vjen nga Selaniku. Atje mund ta kenë mendjen të shtruar, po këtej... Ngrihet tjetri e thotë si pa të keq: duam qeveritar vendas. Duam shkollë në gjuhën tonë. Beu të mos na rrahë, të mos na grabitë. Po me se të rrojë beu, s'e shkojnë asfare ndër mend! Duam këtë, duam atë! Pse, ç'është Konshuta, mal me pilaf dhe oburra të hamë? Jo, mor jahu! Ka kut!

«Ky duket i trashë, por të paktën e thotë açik si e ka kuptuar hyrjetin. Beu i këtejshëm e komandant Ahmeti nuk ma merr mendja ta kenë kuptuar ndryshe. Më thuaj më ke rri, të të them cili je. Po fjete me qorrin, gdhihesh çakërr. Ombashi me ta rri, ata dëgjon, si ata gjykon.»

— E ç'bëri Ahmet beu me këta fshatarë?

— Ua lidhi këmbët me rrip të dyfekut. Ç'të bënte tjetër? Gjersa t'u vijnë mendtë e t'i bien ndër gjunjë. Pastaj, si të bëjë emër beu i tyre! Se ai është ankuar.

Ombashi u kujtua që e kishte lëshuar ca si shumë gojën, u kthye të dilte dhe te dera tha me ashpërsi:

— Mos bëni përjashta! Urdhër i Ahmet beut!

Thimi, krejt mospërfillës për sa ndodhte, gjithnjë me mendjen te ngarkesa që kishte marrë në Manastir, vente sa nga njëra mushkë, te tjetra. Shikonte mos kishte rënë gjësendi udhës dhe shtrëngonte ndonjë litar të çliruar.

— Thimi, o Thimi! — i foli Mihali.

1) Kushtetuta turke e vitit 1908

— Ë? — ia bëri Thimi me gjysmë zëri.

— Ç'thonë në Korçë për këtë hyrjetin?

— Hyrjeti? — Thimi vuri gishtin në buzë e iu afrua. — Rrota e qerres ndau në mes një bajgë. Bajgë mbeti nga njëra anë, bajgë nga ana tjetër.

Mihali qeshi me zë. U mendua, prapë qeshi.

«Ç'e tha punë e madhe! Po ma paske mendjen femër, o Thimi Ormanlliu! Pikës i ke rënë! Bajgë të vjetrit, bajgë të rinjtë. Për besë, zor të gjendet e thënë më shkoqur.»

Për të parën herë Mihali mendoi se dëshpërimi që ndiente nuk kishte të bënte veç me ndarjen nga Çerçizi. Ja, paskësh qenë edhe ai dyshimi brejtës për hyrjetin. Për lirinë që sillte ai. Një liri e druajtur, e ndrydhur. Një liri si parë kallpe. Dhe pas saj gëlojnë Ahmetët e ombashët si ky! «O kasolle, ku na mblodhe! E të mendosh sa njerëz çmenden nga gëzimi për të!...» Mendimet i shkuan fluturim tek ajo puna e lavdëruar, që e lanë në mes të rrugës.

«Çetat patën një fillim, tha me vete. Patën vazhdim. Po fund jo. E preu hyrjeti. Lipset ta kenë edhe fundin e tyre të natyrshëm. Atëherë dhe vetëm atëherë liria vjen e tërë, plot gaz e dritë, ne do ta presim krahëçelët e ajo nuk ka pse të ecë e druajtur. E fortë, e guximshme duhet të jetë.

I mbajtën aty kot së koti një javë të tërë. Për qejf të Ahmet beut. Se dyshonte shoku i tij, beu i asaj ane, të cilit i kishte hyrë lepuri në bark dhe gjithë sa kalonin andej, i bënte shkaktarë të zgjimit të fshatarëve.

— Paçka nga vonesa, por, po nuk mësuam edhe nga pësimet, jemi të humbur për fare, — tha Mihal Gramenoja kur u vunë sërish në udhë.

5. «ELINËT»

Në rrugën për në Selanik Mihali me vëllezërit Topulli qëndruan disa ditë në Janinë. Janina ishte çoroditur nga rrëmuja që kishte ngjallur kudo hyrjeti. Gëzim e dyshim, habi e frikë. Ndofta prandaj qytetarët i prisnin komitët me brohori. Sikur shikonin tek ata gurin e provës.

Në Janinë Mihali u njoh me redaktorin e gazetës «Pelloponisos». Dukej burrë i matur e serioz.

— Si shkoni me elinët e Shqipërisë? — e pyeti Mihalin.

— Në Shqipëri nuk ka elinë, — i tha qetë Mihali.

— Qysh, në Korçë, Gjirokastër, Berat e Vlorë nuk ka të krishterë?!

— Ka shumë, po ata janë shqiptarë.

— Jo, jo, këtë mos e thuaj kurrë. Se të krishterët janë elinë e jo tjetër.

Mihali e mati me sy. Ta merrte seriozisht bisedën me të? Po ndërkohë Çerçizi i foli me emër.

— Qysh, ti e paske emrin Mihal?! — pyeti fort i çuditur redaktori i «Pelloponisos».

— Ashtu ma thonë.

— Po ti qenke vetë elin, mor vëlla! Mëkat, mëkat i madh që të kanë gënjyer turqit e të bënë shqiptar!

«Të jetë vërtetë kaq mendjefoshnjë?» gati foli me zë Mihali dhe tjetrit iu kthye e i tha:

— Tashti që ti ma mësove kombësinë, do të përpiqem të bëhem elin.

Greku u ngrys.

— Pse tallësh, mor zot?

«Se të të pëlcasin!» i erdhi në majë të gjuhës Mihalit.

— Nuk ndahet kurrë feja nga kombësia, mor vëlla. Për fe a për atdhe, ky është bajraku i luftës së kombeve me Turqinë.

«Ta kishim bërë tonin këtë bajrak ne, na kishte marrë lumi. Po ne adhurojmë tepër lirinë, ndaj feja nuk na i zë dot sytë.»

— Shqiptarët kanë fenë e turkut, — ngulmonte tjetri. — Në rron akoma Turqia në Evropë, rron se i bëhen shpatë shqiptarët. Pa shqiptarët Turqia nuk do të mbahej dot dhe Greqia do të ishte bërë e tëra me kohë. Revolucionin tonë shqiptarët e penguan.

— Në e ditsh mirë historinë, o zotëri, nuk të ka hije t'i frysh ca gjëra e të lësh mënjanë si të paqena të tjerat. Ti më përmend ca shqiptarë turkoshakë që e paskan penguar revolucionin dhe i harron ata shqiptarët e shumtë, pa të cilët revolucioni juaj as do të ishte bërë, as do të kishte fituar.

— Ata ishin... grekë, — mërmëriti greku.

«Oh!» hoqi përbrenda Mihali e i erdhi t'i sulej me grushte atij mohuesi.

Pastaj e mati me sy nga koka te këmbët dhe mendoi se nuk ia vlente të prishte gjakun. Gazetari dukej naiv, po kokëmushkë, me një bindje të verbër në ato që thoshte:

«Është për t'u çuditur gjer në ç'masë e bëka budalla njeriun propaganda e keqe!» mendoi dhe në vend të urrejtjes ndjeu keqardhje për bashkëbiseduesin.

6. VËLLAI I DHËNDRIT

«Do të dalin, pra, udhëheqës shqipëtarë për kombin e tyre, që t'i përmbledhin e t'u thonë se s'janë as kaurë, as turq, po vetëm shqipëtarë? Këtu qëndron bashkimi e përparimi.»

M. Grameno

Zunë fjalë, këmbyen nishanet dhe pas kësaj Mihali me njerëzit e tij vajtën te nusja për të shkelurat.

Nuk vonoi shumë e nusja u dha te pragu i odës së burrave. E gjatë, e hijshme. Shtrëngoi të dy duart në vjega e tabakasë dhe sytë ia nguli kupës me liko.

«E gjora, kushedi si i përpëlitet zemra!» mendoi Mihali për të.

Hokatar si gjithnjë, ai ia shkeli syrin atij që pati pranë, si t'i thoshte: «E mirë, ë?»

E fejuara e tij vërtet u ndodh ngushtë. Ngriti pakëz kokën, po s'arriti të merrte vesh nga ta niste qerasjen. Një gëhre i vinte, një i ikte. Kafshonte lehtë buzën e gati u drodh.

Të gjithë e kuptuan gabimin. Mihali që i njohur në Korçë e më tej, ndaj askujt nuk i shkoi ndër mend t'i jepte shkoqitje nuses se cili ishte. Në raste të këtilla nuset i mësonin me shenja, duke u thënë ku rrinte, i sati nga e majta e të tjera si këto. Niqi e kishte parë një herë e thoshte me mend se nuk mund ta ngatërronte, po ca nga druajtja, ca nga pasiguria, u hutua e s'po i njihte dot as ata që i kishte parë shumë herë.

Iu drejtua një burri të pashëm, me mustaqe të sërta, syshqiponjë.

Burri i pashëm luajti vendit.

— Nuk jam unë dhëndri, — tha me gjysmë zëri, që të dëgjonte vetëm ajo. — Unë jam vëllai i dhëndrit.

Mihali po bëhej gati ta përcillte me ndonjë shaka gabimin, po nusja, për çudinë e të gjithëve, vuri buzën në gaz. Gjithë me të qeshur tha, ngadalë edhe ajo:

— Atëherë ti do të jesh Çerçizi!

Çerçizi ishte vërtet. Mënyra e ngrohtë, shumë e çiltër me të cilën iu drejtua nusja e Mihalit atij i bëri përshtypje të veçantë. Mihali kishte shumë vëllezër. Disa ishin aty. Po nusja i kishte folur atij, Çerçizit, sikur ky të kishte qenë vëllai i vetëm i të fejuarit të saj. Akoma më tej, sikur ky të qe vëllai i nuses vetë.

Çerçizi vuri dorën në zemër. Një ndjesi e lehtë dhe e butë e përshkoi të tërin.

«Nuse të mirë marrka Mihali», mendoi.

Nxori nga xhepi një portofol, gjëja më e çmuar që mbante me vete. Portofolin e kishte punuar me dorën e tij. Me rruaza të vockla kishte thurur më nge flaurin kuqezi, dy pushkë të kryqëzuara dhe nën to: «Ç—M 1908».

E lëshoi mbi tabaka atë kujtim të shtrenjtë, dhuratë për nusen e shokut e vëllait.

LARGIMI I DYTË

E para herë që bisedonin ashpër. Kjo dukej jo aq nga toni, sa nga brendia e bisedës.

Komisar Petroja gjithnjë përpiquej të sillej korrekt me anglezin, pa i dhënë shkak për pakënaqësi. Major Geri gjithashtu i përgjigjej në të njëjtën mënyrë, i matur e fjalëpakë.

Mirëpo ja, u desh ky mëngjes dimri që marrëdhëniet e tyre të ndeheshin në atë masë, sa që një oënim tjetër, sado i vogël që të ishte, mund t'i këpuste fare.

Shtabi ndodhej i rrethuar. Majori anglez tërë natën u vërtit në shtrat e s'vuri dot gjumë në sy. Me të hapur dita, kërkoi takim me komisarin.

- Të dorëzohemi, - i tha.
- Si?!
- S'kemi ç'të bëjmë, gjendja është pa shpresë.
- T'u vemi vetë gjermano-ballistëve, si cjapi te kasapi?!
- Lufta i ka këto.

Komisarit i flakërinë sytë e zinj, ata sy gjithnjë të butë e të qeshur:

— Dorëzimi është më i keq se vdekja. Të biesh rob, do të thotë të vrasësh ndërgjegjen, të humbësh dinjitetin, të sakrifikosh vetë qenien si njeri.

Majori mbloodhi buzët. Propozimi i tij nuk u prit mirë. Komisari u zemërua me majorin që kishte marrë guximin të shfaqte atë mendim. Major Geri iu afrua zjarrit. Nderi duart t'i ngrohte. Deshi të mposhtte shqetësimin. Të fitonte kohë. Nuk qe fjala për të ndrequr gabimin. S'kishte bërë ndonjë gabim. Ato që tha, i tha me bindje, pas një nate të mundimshme, në bisedë të gjatë me vetveten. Por mbase mendimi nuk duhej thënë ashtu nxituar, si një e rënë me shpatë. Ai mendoi se kjo gjë do ta kishte nxitur atë nervozizmin e komisarit.

Komisari i ktheu krahët dhe i mbërtheu sytë te dritarja e mjegulluar. As mizëria e flokëve të dëborës nuk ia tërhoqi dot vëmendjen.

«Mos vallë edhe dorëzimi ynë bën pjesë në misionin e tij? Mbase sot e tregoi fytyrën e tij të vërtetë. Ç'të bëjmë me të pas këtij propozimi të turpshëm?»

* * *

Nja tridhjetë e pesë vjeç, i gjatë e i hijshëm, me sytë ngjyrë hiri, major Geri dukej sikur kishte bërë ushtrimet e veçanta që të hiqte nga trupi çdo grimcë dhjami të tepërt. Egërsia dhe ashpërsia e vendit nuk qenë aq të forta, sa ia patën paraqitur. Megjithatë thoshte me vete se parapërgatitja kishte qenë e dobishme. Rrallë i qëllonte të ecte më këmbë. Kurdoherë gjendej një kalë a një mushkë dhe shërbyesi, një ushtar italian nga ata që mbetën të shpërndarë pas kapitullimit të Italisë, sillej me të si me një zotëri hijerëndë.

Në këto javë që po kalonte pranë shtabit të qarikut, majori ngjante si një turist i ngeshëm. Pyeste për

historinë, malet e njerëzit me po atë interesim që merrte të dhëna për luftën që bëhej në Shqipëri. Hynte me qejf në biseda për zakonet e doket e vendit. Nganjëherë ashtu shkarazi e hidhte fjalën te lufta me ballistët, të cilën, si gjithë BLO-të¹), e quante luftë civile, duke lënë të kuptohej se ajo qe thjesht pasojë e zakoneve të ashpra.

Komisar Petroja e shikonte në sy.

«E beson vërtet këtë që thotë? Ky e shpjegon me zakonet tona të egra. Ka të tjerë që na e veshin fajin neve, që jemi «intransigjentë» me ballistët!» mendonte komisarë.

Duke e përmbajtur inatin, ai ia kthente ngadalë e qartë, me po atë kujdes që një marangoz i mirë ngul gozhdët në një dërrasë të thatë:

— Te ne nuk ka luftë civile. Sa për tradhtarët, ata janë horra të pandreqshëm.

— Nuk na intereson morali, po shërbimi i tyre. Nuk duhen lënë përpjekjet për t'i kthyer kundër gjermanëve. Pak më tepër tolerancë...

— Përpjekje janë bërë më shumë sesa mban durimi. Më sa mbin mjekra e qoses, aq mund të mbahet shpresë te një kthesë e tillë e ballistëve.

Majori nuk shtyhej më tej. Por as nuk hiqte dorë nga e tija. Pasi kalonte ca kohë, prapë e sillte fjalën tek ajo temë.

Ndërmjet të dyve zhvillohej pareshtur një dialog i heshtur, me prirje zhbirimi.

Major Geri:

«Ky djalë i ri është komisar. Si djalosh është i pashëm. Në fytyrën e tij të njomë mustaqet e zeza duken si të sajuara. Pse i ka lënë? Ndoshta për t'u dukur më me peshë, që të ketë më tepër autoritet. Sidoqoftë, një vajzë e bukur do ta dashuronte menjëherë...»

Vetëm shkollën e mesme ka kryer, po anglishten e zotëron mjaft mirë. Një surprizë e vërtetë, të gjesh në

1) Oficerë të misioneve angleze

një vend të tillë të prapambetur, të cilin tanët s'e kanë përfillur kurrë, të gjesh, them, një partizan të të flasë anglisht! E njeh Dikensin e Miltonin, le më Shekspirin e Bajronin, sikur të kishte studiuar në Kembrixh. Flet për gjeografinë e Anglisë sikur ta ketë shëtitur atë më këmbë!...»

Padashur bënte një krahasim me veten.

Më parë ai nuk dinte asgjë për Shqipërinë. Vetëm disa ditë para se të hidhej këtej pati marrë ca njohuri në Athinë, prej zonjës Hezllak. Ishte njëfarë kursi orientues për psikologjinë, zakonet, gjuhën, folklorin. Shumë pak.

Major Geri nuk qe nga ata që e qetësojnë lehtë ndërgjegjen. E linte mënjanë Shqipërinë, duke ia veshur fajin mospërfilljes angleze. Merrte një shtet tjetër të njohur, Francën. A dinte ai për Francën, aq sa komisari shqiptar për Anglinë? Gjithë njohuritë e tij vërtiteshin rreth Parisit. Sa më tepër shtyhej në përfytyrime përtej kryeqytetit francez, aq më e dendur i dukej mjegulla.

«Dhe të mos harrojmë se unë kam kryer studime të larta dhe një kurs special...», mendoi jo pa zili për Petron.

Kur rasti e solli të takohej me një tjetër major anglez, BLO, si dhe ai, Emeri quhej, një njeri që i shihte të tjerët nga lart, qeshi me cinizëm.

«Vërtet nuk i njohke shqiptarët, i tha. S'është për t'u çuditur, or mik. Shqiptarët janë mësuar të bëjnë karrierë në shërbim të të huajve. Më të zellshmit, më të zotët, i vihen këtij qëllimi qysh herët, nën një shtytje të ethshme për para e pushtet. Kjo shtytje është tradicionale, babai ia përcjell djalit, dhe tanimë u është futur në gjak.»

Major Emeri i shtjellonte më tutje shpjegimet e tij, sipas të cilave shqiptarët kishin mbetur akoma në rendin fisnor, Jugu kishte hyrë në feudalizëm, dhe kjo falë atij pasioni që përmendte majori tjetër anglez. Ai shtonte pastaj se shqiptarët në thelb nuk e kanë ndjesinë e kombësisë së tyre, përshtaten kudo e aq u bën.

Geri nuk e përtypi dot këtë gjykim. Paqartësia për një tog gjërash e ndiqte kudo. Nuk e bënte veten të kërkonte shpjegim. Po koha vetë sqaronte herë një gjë e herë një tjetër, gjithnjë në kundërshtim me mendimin që i kishte shprehur oficeri aristokrat.

Kur një ditë deshi t'ia shpërblente shërbimin një fshatari, duke i dhënë një anglezkë, fshatari e pa me urrejtje e i ktheu shpinën pa e përshëndetur fare. Komisarari që u ndodh aty, i tha me mirësjellje:

«Në doni të fitoni simpatinë e shqiptarit, bëhuni më i kujdesshëm me të. Simpatinë me simpati, besën me besë, mirënjohjen me mirënjohje, shërbimin me shërbim, kështu e ka shqiptari.»

Ndërsa për atë çështjen tjetër po komisarari, të cilit ia pati sjellë fjalën me marifet, tha, sikur fliste në një miting, a sikur bënte një deklaratë në një konferencë shtypi:

«Lufta jonë do t'i japë fund një herë e përgjithmonë asaj kohe kur bashkatdhetarët e mi shtrëngoheshin ta përdornin zotësinë e tyre në shërbim të të huajve. Kur të vijë liria, gjithë aftësitë tona do t'i derdhim për të ndërtuar një Shqipëri të re, të bukur, e cila të rrijë ballëllart përkrah shteteve të tjera të përparuara!»

Major Geri kishte mbetur njëlloj i habitur si me mendimet e kolegut të vet, ashtu dhe me fjalët krenare të komisarit. Ai u ndodh kështu në një pikë të ndërmjetme, prandaj edhe të pasigurt e të paqëndrueshme. Lëkundjet, kuptohet, ishin herë në një anë e herë në tjetrën, shpesh duke ndërruar brenda ditës a çastit, në varësi me forcën që i shtynte.

Ja, ndodheshin në shtëpinë e një malësori. Ç'është ky mik, pyeti ai. Anglez, i tha komisar Petroja. «Ingliz?» Malësori ia nguli sytë me dyshim, duke bregtur me dhembë fletën e lagur të cigares që po dridhte. Major Gerit i bëhej se ai brente e lagte po ashtu me pështymë emrin e tij.

Po gjente kudo mikpritje, po jo miqësi. Besim ca më pak. Dyshimi i tyre mbase e ka burimin në ndonjë paragjykim, mendonte. Ose është një frikë e përjetshme

nga të huajt për shkak të historisë plot pushtime shka-
tërruese. Kurrsesi nuk arrinte të pranonte që edhe
një malësor, plak analfabet, t'i ndante shtetet në miq e
armi, pale më që të dallonte në politikë ç'ishte e vër-
tetë e cila e shtirur.

«Inglitera, o djalë, është putanë e madhe!» i tha
malësori komisarit.

Me zë të ulët komisar iu përgjigj diçka që mbante
erë qortim. Majorit nuk ia përkthyen as fjalët e malë-
sorit, as të komisarit dhe ai e kuptoi që biseda nuk qe
në të mirë të tij. Me vete edhe atë fjali e lidhi me atë
mënyrë të dyshimtë, që shihej kudo e kurdoherë. Ngaqë
i bëri përshtypje, i mbajti mend fjalët tingull për tin-
gull. I vuri detyrë vetes që të mos i harronte. Kur e
mësoi pak më vonë ç'kuptim kishte fjala «putanë», u
skuq i tëri dhe u nervozua. Këtë fyerje kaq të rëndë
nuk duhet ta pranoj, mendoi. Të ikte në çast. Por nuk
iku. Kur vdes njeri, thotë një fjalë e urtë, ditën e parë
bien dyzet këmbana, të dytën tridhjetë e nëntë e kë-
shtu me radhë në zbritje; hidhërimi vjen duke rënë.
Disa ditë më vonë major Geri jo vetëm hoqi dorë nga
mendimi për të ikur në shenjë proteste, por padashur
zuri ta shihte veten me një sy kritik. Ç'kishte bërë ai,
që të meritonte atë dyshim që e ndiqte hap pas hapi?
Ç'kishin bërë të tjerët, bashkatdhetarët e tij, që të shi-
hej e tërë Anglia me dyshim e inat?

Nuk i hiqej nga koka mendimi prej kolonizatori i
Emerit. Mos vallë tërë anglezët ishin mësuar ta shiko-
nin veten si të tillë kudo e kurdoherë? Ndofta dhe ai
vetë nuk bënte përjashtim. Mosvlerësimi i të tjerëve
është shenja e parë. Ai kalonte nëpër Shqipëri si në një
muze. Shihte shumë gjëra, formonte mendimet e veta
për to, po pak u vinte rëndësi mendimeve të shqiptarë-
ve. Madje në fillim i vinte çudi kur e kundërshtonin për
ndonjë gjë, sido që gjithë kujdes kur flitnin. Megjith-
atë, ku ai e ku aristokrati Emer! Ai i trajonte shqiptar-
rët si njerëz të egër dhe Shqipërinë si kreqjt të paqenë,
të paaftë për të ecur pa mbështetjen e një shteti tje-
tër. Pastaj zhbirimi i tij shkante më tutje. Ndalej gjatë

në dy fakte kokëforte: gjithnjë i përsëritnin porosinë që Lëvizja Nacionalçlirimtare duhej të bashkëpunonte me Ballkomin; BBS-ja jepte lajme po aq për Lëvizjen, sa dhe për Ballkomin. Këto dy fakte i shkaktonin inat për të tijtë dhe simpati për partizanët. Por edhe për ta kishte vërejtje.

«Janë krejt të pazotë për të toleruar. Janë konspirative, enigmatikë. Apo unë nuk kam arritur dot t'i zbërthej?»

Pyes komisarin për forcat partizane të qarkut, dhe ai me buzë në gaz jep vetëm numrin e batalioneve. Po sa partizanë ka një batalion? Sipas rastit, thotë. Nuk janë njëlloj. Si kështu? Epo, akoma nuk jemi ushtri e rregullt ne, po partizanë. Diku më shumë, diku më pak. Pastaj e hedh fjalën gjetkë. Se në qarkun e tij venë e vijnë vazhdimisht dy-tri brigada. Po sa partizanë ka një brigadë? Tri deri pesë batalione!»

Kështu. Ai ndiente mëri për komisarin, që i drehdonte aq me lezet dhe i vinte inat me veten, që s'po mundte t'ia dilte me të. Në fillim e pati marrë thjesht për shoqërues e përkthyes, paçka se i tha që ishte komisar. Punë e madhe se qenkej komisar. Ai vetë ishte major dhe përfaqësonte një Britani të Madhe! Që që i ri, kjo i pëlqeu. Aq më mirë, mendonte. Ai do të bëjë ç't'i them, i mungon përvoja, i mungon autoriteti. Mirëpo komisari jo vetëm nuk vepronte verbërisht, siç e këshillonte ai, por dita-ditës i kundërshtonte gjithnjë e më shumë, ashtu me të qeshur, sikur kishte të bënte me një plak tekanjor, të cilit s'donte t'ia prishte haptas. Madje, ndryshe nga dëshira e tij, shpesh majori po ndiente autoritetin e komisarit, bëhej i druajtur e mbushej me emocione, gjë që s'e kishte provuar prej kohe, ndofta qëkurse kishte qenë student...

Komisari Petroja:

«Ti, or mik, nuk duket të jesh njeri i keq. Më bëhet se je i ndershëm në shpirt, veç s'e ke veten në dorë. Herë-herë të kujtohet që je përfaqësues i një

perandorie, e cila gjithnjë ka luajtur me fatet e botës. Dhe kërkon të të shkojë kali në urë edhe këtu. Jo, ore! Prandaj luftojmë ne? Ju njohim, ju njohim.»

Në çantën e tij ndodhej një letër e Shtabit të Përgjithshëm. Në atë letër shkruhej qartë ç'qëllim kishin misionet angleze, megjithatë të silleshin me kujdes e maturi me ta.

«Mua më ka zënë me ty, o anglez. Shkurt muhabeti, më ka pjellë belaja.»

Që nga dritarja komisari e shikonte anglezin në profil. Ai gjithnjë pranë zjarrit. Duart përpara si të ngrira. Komisarit iu bë se ai përgatitej për veprimin që kishte propozuar. Ja, po t'i ngrinte duart edhe pak...

Poshtë bluzës së trashë angleze, majorit i dukej një fanellë leshi. Komisari i uli sytë në vëzhgim. Edhe çorapet prej leshi i kishte.

«Ç'e do, çorapet e fanellën u shtrëngove t'i veshësh, i pranove, me gjithë qibrën tënde të madhe. Po tjetër gjë s'more prej nesh. Mua më dukej se diç po merrje, kur t'i vjen e m'i përmbys të gjitha me atë fjalën që më the.»

Dëbora kishte reshtur e koha që hapur krejt.

Komisari bëri një hap. Dyshemeja krisi. Majori Geri ktheu kokën. Sikur priste përgjigje.

«Edhe kjo na lipsej, të mbajmë nën mbikëqyrje majorin, se s'kemi tjetër ç'të bëjmë!» mendoj me inat.

Atij nuk i shkonte ndër mend aspak se majori me të vërtetë mund të dorëzohej. Në këtë rast mendonte se përgjegjësia do të binte mbi shtabin e qarkut e atë vetë, që kujdesej posaçërisht për misionarin e huaj.

Trokitën lehtë në derë.

— Xhezo? — pyeti komisari.

Hyri me rrëmbim një partizan me trup si kërcel, me vetulla si gjemba, të trasha e të ngatërruara.

- Urdhër, komisar!
- Ç'bëjnë shokët?
- Matanë janë. Ty po të presin.
- Kemi gjësendi për të ngrënë?
- Vetëm ca qumësht.
- Arrin për të gjithë?
- Një nga dhia, dy nga vija dhe...
- Mirë, sillna nga një gotë.

Partizani bëri të dilte, po vështrimi i tij kapi atë të majorit anglez, i cili po rrinte me mëdyshje. Ishtë i zbehtë nga pagjumësia. Paniku e kishte zhvlerësuar çuditërisht shpejt.

- Po ky derr, ç'pati, o komisar, mos i ka mbushur gjë?

- Jo kësisoj, Xhezo, e kemi aleat.

- E di, bre, por... sesi m'u duk ashtu. Pata një kohë në shtëpi një bubeshkë. Ti më merr vesh, bubeshkë ne i them kones. Gam-gam tërë ditën derrja. Po, po një të parë ndonjë qen të madh në rrugë, bishtin ndër shalë, që thua ti dhe vente e ngulej mu nën hambar. Me nder teje, i shpëtonte shurra dhe më shikonte ja, si ky, me bishtin e syrit. Doemos, e ndiente dhe ajo që e kishte menderosur!

- Iç, mor dreq! - ia bëri komisari dhe, që të mos shpërthente të qeshurën, ia bëri me shenjë të shkonte, ndërsa dorën tjetër e shtrëngoi në gojë si për të ndaluar një gogësimë.

- What's up? What's up? - pyeti me ngut anglezi.

- Asgjë.

- Sjell ndonjë lajm të ri?

- Jo, jo.

Hoka e Xhezos lodronte në fytyrën e komisarit. Majori, i cili e pikasi këtë, hetoi një çast, pastaj tha diçka që, siç dukej, e kishte menduar gjatë bisedës:

- Me gjermanët rrethues ka forca të Ballkomit. Po?

- Po!

1) Ç'ndodh?

— Sikur të dërgohej një njeri që të merrej vesh me ta?

— Tepër vonë, zotëri. E kemi shpjeguar kaq herë këtë. Ata i kanë lyer duart me gjak. Nuk shtrohet më çështja të merremi vesh, po si t'i luftojmë më fort. Pa mëshirë, gjer në fund!

— Megjithatë, në rastin tonë...

Majori e la fjalën në mes. Herët e tjera për ballistët kishte folur duke përsëritur si papagall një temë bajate, se ashtu e urdhëronin. Kësaj here deshi të thoshte se jeta e tyre, jeta e tij varej nga një marrëveshje e pjesshme me ta. Ai i trembej për vdekje rrethimit. Kujtonte me lemeri se mund të linte kokën në një vend kaq të largët, ku s'do t'i dihej as edhe varri. Po u druajt ta thoshte mendimin deri në fund, duke ia parë përgjigjen tjetrit në sy.

«Ç'më dërdëllit gjithmonë për ballistët ky? Shok i tyre është? Atëherë arrestimin e ka pak», mendoi komisarari.

Dhe përsëri iu kujtua ai raporti që e kishte lexuar fare rastësisht.

Majori i dërgote raportet e tij me radio ose me postë. I dërgonte diku në një manastir në qarkun e Vlorës. Njëherë i pati dhënë një zarf një korrieri partizan, korrierit i dolën përpara ballistët dhe e vranë, zarfi ra në duart e tyre, pastaj po këta ballistë u kapën nga partizanët dhe letrën, tanimë të hapur, ia dhanë komisar Petros. Raporti i drejtohej qendrës së SOE-s në Kajro:

«Lëvizja NÇL e ka situatën në dorë. Ka simpatinë e popullit. Me gjithë operacionin e rreptë gjerman, nuk jepen, por edhe kundërveprojnë. Janë të sakrificës, ndofta ngaqë bazohen jo në rendin ekzistues, po në shkatërrimin e tij. Sa trima, sa të guximshëm e sa vendosmëri kanë partizanët, aq të kundërta i gjen këto virtyte te Ballkomi. Ballkomi është diskredituar. Të mbahemi ende me ta, do të thotë të vihemi në pozitë të vështirë. Si të përgjigjemi kundrejt një qëndrimi të tillë?»

Sa herë e sillte ndër mend këtë raport, Petroja ndiente një si pendim për dyshimet ndaj major Gerit. Xhezoja solli gotat me qumësht të ngrohtë.

— Urdhëro! — tha komisari. — Bukë s'kemi.

Majori e pa në sy, si t'i thoshte: «E prapë e shkoni nëpër mend qëndresën?» Po gotën me qumësht e mori. Nxori nga çanta një çokollatë të madhe, e përveshi letërën mbështjellëse deri në mes dhe nisi ta hante duke e përcjellë me gllënjka qumështi. E kafshonte nga pak, ngadalë, si me pishmanllëk.

Papritur te oborri i shtëpisë plasi një predhë. Shtëpia u drodh, trarët kërcitën e nja dy xhama u thyen.

«Këta nuk nguten, tha me vete komisari. Për t'u cuditur! Ndoshta e bëri të vetën manevra jonë. Kushedi sà na dinë! Ndoshta kujtojnë që kanë rrethuar vetë Shtabin e Përgjithshëm dhe po bëjnë një shtrëngim të ngjeshur për të mos u shpëtuar asnjë. Ky rrethim është i trefishtë: ata, dëbora, mungesa e ushqimit. Lidhja jonë me forcat partizane ka ditë që është prerë, rrugët janë zënë. Dhe dëbora vijon të bjerë. Ky fshat është bërë trokë. Mezi sigurom bukë për nja tre muaj. Këta tre muaj kanë kaluar qëkur...»

— E përpiktë, — tha majori anglez për predhën. — Ata janë në shenjë. Mund të binte edhe këtu.

Ai ishte zverdhur dhe gati dridhej. Megjithatë copën e pangrënë të çokollatës e futi ngadalë-ngadalë në çantë.

«Ç'njerëz! Marrin ç'u jep, po kurrë s'japin. Ne ndajmë kafshatën e gojës me të, kurse ai...»

Komisari nuk arrinte ta kuptonte plotësisht majorin anglez. Ai kishte ca virtyte të mira, por edhe disa gjëra që s'ia pranonte kurrësi.

Një predhë e dytë ra pak më larg, përtej gardhit.

— Dhe ju mendoni akoma qëndresën?! — tha majori anglez.

— Patjetër.

— Në këto kushte, qëndresa, të më falni për shprehjen, është marrëzi, — tha me bindje ai.

— Mua do të më pëlqente ta quaja burrëri.

Majori e pa me habi.

«Tragjedia e një kombi të tërë, — mendoi dhe i uli sytë. sikur të trembej se mos tjetri ia pikaste këtë gjv-kim. — Prandaj është vrarë e sakatuar ky komb. Se nuk përfill as kohën, as historinë. po i merr ato siç i marrin ca kalorës pendëfryrë e i fton pa të keq në duel. Kokërisje!»

— Nuk ju kuptoj. Me të vërtetë nuk ju kuptoj, — tha me zë.

— Po e la zemra njeriun, ka mbaruar. Dhe, sikurse e dini. optimizmi është shpirti i fitores.

— Këtu s'ka vend për optimizëm. Unë shoh dy mundësi: të dorëzohemi, që do të thotë të humbasim lirinë, po jo jetën dhe e dyta. të vritemi këtu ose të na kapin gjermanët. gjë që është njëlloj, pasi sjell po atë rezultat, vdekjen tonë.

Dy rrudha që shprehnin inat u përvijuan në ballin e komisarit.

— Dhe ju keni zgjedhur të parën?

— Of cos¹⁾

— Si të dëshironi, major! Është e drejta juaj dhe puna juaj.

— E ju?

— Ne shpresojmë se do ta çajmë rrethimin. Madje shpejt.

— E pamundur!

— E shoh që s'ju bind dot dhe më vjen keq.

«Nganjëherë ne harrojmë me kë kemi të bëjmë. — mendoi. — Ky s'është partizan dhe unë po harxhoj kot frymë e kohë, të cilën sidomos tani e kemi të shtrenjta.»

Majori pa orën dhe ngjeshi bustinën në kokë.

— Desha të mos këtë asnjë keqkuptim, — tha. — Më detvrojnë rrethianat.

— Në këtë rast, detvra ma do që vendimin tuaj ta kemi me shkrim. Më falni për kërkesën.

— Of cos... of cos, — belbëzoi majori dhe shkroi në

1) Natyrisht

cast një deklaratë të shkurtër, ku thoshte që dorëzohej me dëshirë, në kushte të vështira për të.

Komisari e palosi më dysh dhe e futi në çantë.

— Unë... po shkoj, — tha së fundi majori.

I erdhi turp të thoshte «unë po dorëzohem».

Te dera vështrimet e tyre u takuan edhe një herë.

Majori:

«Oh, ju po merrni veten më qafë. Mua më dhimbsemi dhe më vjen shumë keq që s'po më dëgjoni!»

Komisari:

«Nuk do t'ia dëshiroja askujt të ulej deri këtu.»

*

* * *

Komandanti ishte me dy shokë të qarkorit të Partisë.

— E? — pyeti ai sapo hyri komisar Petroja.

— Donte të na bindte të dorëzoheshim.

— Ia dhe përgjigjen?

— Në vend.

— Ç'tha?

— Atëherë po dorëzohem vetë, tha.

— Në drejt të vejë! Kot ia zgjate kaq shumë. Ndërkohë ne sheshuam njëfarë plani. Po të ndërrojmë bazën, mund t'i mashtrojmë akoma. Mirëpo lufta kërkon të jemi në krye të partizanëve e jo të lozim kukafshehtas me gjermanët. Derrit i plagosur është i rrezikshëm, po furia e tij tregon që po i shterin fuqitë. Mjafton të bësh që t'i shkojë vrulli huq. Pra, të çajmë. Pritja është vdekje, veprimi e lëvizja — jetë.

Jo nga përroi. As nga mali. Ato shtigje do t'i kenë zënë mirë e mirë. Ku mund të mos e shkojnë ndër mend? Rrugës së fshatit. Dëbora që bie, tanimë po merr anën tonë. Flokët e dëborës do t'ua zënë sytë, që u plaçin!

Komisari dëgjonte e shihte zjarrin. Xhezoja prushiti hirin e nxehtë e hodhi ca shkarpa. Gjuhët e flakëve u lëpinë pas karthjeve të thata, që kërcitnin. Gjuhët e flakëve kanë vetinë të tërheqin vështrimin e njeriut.

Ato po i shikonin të gjithë. Flakët u ngritën e u shumuan edhe më.

— Mirë, të ndjekim jetën! — foli komisari, duke e parë komandantin buzagaz.

Atë çast hyri Laveri, i zoti i shtëpisë. Dukej i shqetësuar dhe shikonte sa njërin, tjetrin.

— Xhezoja më tha që do të ikni. Pse të ikni? Kur të marrë flakë çatia, atëherë po. Njësitë e fshatit ka zënë vend tek avllia. Besa, nuk vijnë dot te ju, pa shkelur mbi trupat tanë!

— Ky e ka therur dhinë! — e ndërpreu Xhezoja.

— Dhinë?!

Të gjithë e dinin që Laveri kishte vetëm një dhi.

— Ju keni tërë këto ditë që po luftoni e s'keni vënë asnjë kafshatë bukë në gojë. Unë vajta tek Adili, te Zihniu. Nuk kishin miell. Po të kishin, nuk ma kursenin. As për ju s'e kursenin.

Komisari ndjeu një përpëlitje në gjoks. Një valë e ngrohtë gjaku iu ngjiti me vrull. Sytë iu veshën me një si avull të butë. Vetiu iu drodhën qerpikët.

Gjithë ata burra s'e thanë dot një fjalë të vetme. Mallëngjimi ua lidhi gjuhën. Laverit sikur i vinte turp për druajtjen e tyre. Xhezoja vente e vinte nëpër dhomë, duke e qortuar me të pëshpëritur: «Po pse, mor jahu, pse e bëre këtë? Ti nuk i njeh, a si? Do t'u mbetet peng për tërë jetën!»

«Peng i një mirënjohjeje të thellë, mendonte komisari. Po mirënjohjes me mirënjohje, zemrës me zemër. Punë e luftë të pakursyer për t'i shpërthyer armiqtë».

*

* * *

Shtabi e çau rrethimin. Në mbrëmje u bashkua me forcat e një batalioni, që po i vinte në ndihmë.

Operacionit po i binin pendët. Duke u tërhequr, gjermanët lanë edhe të vrarë, edhe të plagosur, edhe robër. Ndër ta që edhe majori anglez.

Dhe major Geri u kthye sërish në shtabin partizan.
— Hello! — e përshëndeti komisari e i dha dorën.
Anglezi e zgjati me përtesë të tijën, po sytë s'i
ngriti.

— Gëzohem që u takuam rishtas, major! Të dy
gjallë e shëndoshë, siç e shihni!

Majori sytë përdhe. Ishte tepër kryelartë për të
thënë se komisari kishte pasur të drejtë. Po në sy s'e
shihte dot. I vinte turp. Nuk pati guxim të bisedonte
edhe një herë, po ndryshe, siç e kërkonte gjendja e re.

Të nesërmen ai gjeti një shkak e u largua për-
gjithmonë nga shtabi.

DITËN E PËRVJETORIT

Më i riu shkante përpara. I ruhej baltës dhe kërcente sa nga një anë e rrugës në tjetrën. Djaloshi i shkathët ecte shpejt dhe nganjëherë qëndronte e shihte pas. Tjetri, një burrë i gjatë e nofullgjerë, nuk nxitonte, megjithatë prapa s'mbetej. Ai kishte veshur një kostum stofi të ashpër, pantallonat mbledhur filluskë përfund nja një pëllëmbë sipër këpucëve me qafa.

Asnjëri nuk fliste.

Djali digjej nga kërshtëria për njeriun që shoqëronte. E njihte dhe nuk e njihte. E kishte parë disa herë me komandant Tekiun. Komandant Tekiu bisedonte gjatë me të. Ai i pati thënë sikur i njoftonte një gjë me shumë rëndësi.

«Kajo, do të shoqërosh shokun Kiço. Ki kujdes!»

Krahas kërshtërisë, djali ndiente mbi vete peshën e një përgjegjësie të veçantë, si të kishte marrë diçka nga vlera e tjetrit. Ditët e fundit pati dëgjuar që ky shoku Kiço qe emëruar komisar i çetës së re.

«Nuk shkëputet dot nga puna e terrenit, me të

cilin është mësuar, apo mendo për detyrën e re?» gati foli me zë djali. Pastaj shtoi: «Ndofta e shtrëngon ndonjë punë me shumë rëndësi që ka të bëjë me të dyja çetat!»

Ja donte zemra të ishte kështu. Dhe po të ndihej nevoja që edhe ai të jepte ndihmën e vet, nuk do të kursehej. Ndërkaq dolën sipër në një sheshitirë.

— Mua ma thonë emrin Kajo, — tha djali. — Jam nga kjo anë. Partizani më i ri i çetës së parë të Gorës.

Kiço Llambi ngriti kokën. Djali e kishte përme-ndur me krenari që ishte partizan i çetës së parë të Gorë-Oparit, çeta e parë në krejt qarkun e Korçës.

— Dhe tashti ti, o Kajo, dëshiron të dish për mua?
— Kiço Llambi rregulloi syzet dhe hoqi kapelën strehëgjere. — Unë jam nga Korça. Më i madhi i shtatë fëmijëve të një punëtori. Im atë ishte një burrë i fortë, gdhendte gurë për qoshe shtëpish, për puse, gurë varresh. Pa s'i dilte me këto e hapte puse me dinamit. Njëherë i plasi në dorë. S'më harrohet kur e sollën me kalë në shtëpi, mbështjellë me velenxë. Njëri sy iu prish fare. Prapë s'e la punën. Po puna e rrëzoi shpejt e vdiq pa u plakur. Atëherë unë hyra si ndihmësmuratori. Ja, kështu. Pastaj në shoqërinë «Puna». Dhe... të tjerat i përkasin luftës.

— Ti je komunist?

— Si thua ti?

— Je, je!

— Komunisti, o Kajo partizani, s'i takon vetes. Ai lipset t'i kushtohet me gjithë shpirt shoqërisë.

— Pse të jenë komunistë vetëm komisarët?

— Komunistë nuk janë veç komisarët. Po ti ku e ke fjalën?

— Të ishin gjithë partizanët!

— Ti, ke dëshirë?

— Shumë!

— Atëherë do të bëhesh!

Partizani i ri u ngrah e sytë i ndritën. Një shpresë e brendshme, që i vlonte, iu nxit e desh të

shpërthente. Duke e përmbajtur të mos dilte para kohe, nisi të merrej me ca përfytyrime trimërie.

Kiço Llambi mendonte tjetër gjë. Punët e Lëvizjes po shkonin mirë. Gora ziente. Edhe Opari. Çdo ditë e më fort po ndihej një frymë e re kryengritëse. Mikpritja për partizanët shtohej bashkë me dëshirën për të dëgjuar fjalën e tyre. Traktet qarkullonin çuditërisht shpejt dhe lexoheshin me një frymë. Ai që ndoshta s'dinte fare shkrim e këndim, e mësonte përmendsh e ia kumtonte tjetrit. Të shumtë qenë fshatarët që nuk i dhanë taksat. U hapën koçekët e të dhjetave në Kucakë. Bile, në një fshat, javën e kaluar, një fshatar pyeti me merak e si me turp:

«Kundër jush do të luftoka im bir?!»

«Po.»

«Ah, unë i mjeri, sa ligisht qenkam gënjyer! Ç'bëra, unë virani! Po si ta laj gabimin?»

«I thuaj të ikë nga milicia, pushkën t'ia kthejë fashizmit.»

«Këtë e mendova dhe unë. Sonte gjumi s'më zë, nesër ka marrë fund!»

Kiço Llambi ndiente ngazëllimin që të jep një punë e madhe e nisur mbarë. Me aksionin kundër postës së karabinierisë, në qendrën e komunës, në Kucakë, gjithë Opari i Poshtëm ishte i lirë.

E megjithatë, megjithatë...

Beu i Moglicës ishte lidhur kokë e këmbë me fashistët e po nxitohej në punën e vet prej tradhtari, Maliq Dushari vinte shkopinj nën rrotë, duke thënë të mos nguteshin. Pasho Kolaneci po ashtu. Këta i trembnin fshatarët me lloj-lloj mënyrash. Por ishin dinakë dhe hidhnin gurin e fshihnin dorën.

— E di ti pse po vemi te xha Rozani sonte? — i tha Kajos.

— Jo.

— Dy veta s'e kanë një hall, Kajo. Me sa di unë, xha Rozani është njeri i ndershëm e patriot.

— Është. Ka qenë mik me Malkë Zvarishtin. Edhe Riza Cerovën thonë që e ka njohur nga afër.

— Ja, e sheh? Patriot i vjetër, këshillat nacional-gjirimtare i pranon, traktet e Partisë, që thonë se toka i përket atij që e punon, i pëlqejnë. Megjithatë lëkundet. Ç'i thua ti kësaj? Taksat i dorëzoi gjer më një. Misrin nuk shkoi ta merrte kur hapëm koçekët. Dhe ai është në krye të një familjeje të madhe e i shkon fjala në fshat e përtej.

Kiço Llambi mendonte për atë fshatar dhe përpiqej ta përfytyronte sipas fjalëve të Teki Kolanecit. Është njeri i mirë, i punës, po nga e tija nuk heq dorë kollaj. Kështu i pati thënë ai. Dhe Kiçoja ndiente mëri e admirim për xha Rozanin edhe pa e njohur vetë. Mëri, se dashur padashur po e pengonte punën e Lëvizjes. Admirim, se duhej të qe njeri me karakter.

— A e lidh gjë ndonjë krushqi a gjëkafshë tjetër me beun e Moglicës?

— Ncëk!

— Po me Pashon a Maliq Dusharin?

— Jo! — mohoi përsëri Kajoja.

Përtej gardhit, në një livadh të vogël kullotnin një mushkë me samar dhe një lopë me viçin pas. Një burrë veshur me shajak të zi po shkulte purtekat e fasuleve. Ua hiqte fasulnishtet pleksura si dredhëza dhe purtekat e pastruara i vinte stivë mënjanë.

— Tungjatjeta! — e përshëndeti Kiço Llambi.

— Tungjatjeta!

— Ky është, dora vetë! — pëshpëriti Kajoja.

Kiço Llambi po e vëzhgonte me kureshtje. Fshatari ishte afro pesëdhjetë vjeç, me sy të vegjël hetues, me brazda rrudhash në ballë, në faqe, madje edhe në qafë.

— Urdhëroni! — tha ai e u çapit në një rruginë shtruar me plloça. Sipër rruginës ishte sajuar njëfarë tende nga pjergulla e madhe që shtrihej tejtejt. Nga një kolibe brenda avllisë u lëshua me skërmitje të egër një qen i madh leshtor.

— E, e, Murro! I kemi miq, — e qetësoi i zoti.

Qeni hungëroi i mërzitur që ia pre në hovin.

— Urdhëroni! — tha edhe një herë xha Rozani kur

u ndodhën para shtëpisë. Ai vuri buzën në gaz, ngjiti shkallët hapi një derë dhe aty e nxori Kiçon përpara. Oda ishte e madhe, pa tavan. Në dysheme, afër zjarrit ishte shtruar një shkorsë, ndërsa në të dyja anët e vatrës kishte postiqe.

— Ja, mirë se na erdhët! — uroi fshatari duke u dhënë sërish dorën.

Ai vuri ca dru në zjarr, pastaj diç kërkoi në një kamare në mur. Kiçoja e ndiqte me sy, duke menduar nga e si do t'ia niste. Në pritje mori mashën e zuri të skërmiste urët e zjarrit. Thëngjijtë prushiteshin e lëshonin shumë shkëndija.

* * *

Në mëngjes, sapo zbardhi, Kiçoja dëgjoi një kollitje të lehtë prapa derës. U ngrit dhe e shpoi Kajon me bërryl. Ky kërcëu drejt e në këmbë dhe u sul te pushka. Duke u veshur, Kiçoja e shihte buzagaz. Kajoja e vuri re e bëri sikur u shtriq.

Luajti rezja e dera u hap duke gërvitur si me druajtje. Në prag u dha xha Rozani me një peshqir të bardhë në dorë. Pas tij, një djalë i gjatë sillte ibrikun e një legen të vogël bakri. Kiçoja shpejtoi t'u dilte përpara. Ndërkohë një djalë tjetër, i shkurtër, zeshkan, që i ngjante shumë Rozanit dhe që ky i fliste me përkëdheli: «Hë, Malkë, hë, bir!», ndezi zjarrin e shtroi sofrën pranë vatrës. Djali i gjatë solli një tepsi me trahana.

Djemtë panë nga i ati. Ai ngriti e uli vetullat dhe ata dolën të heshtur.

Gjatë gjithë këtyre veprimeve u këmbyen pak fjalë: «Mirëmëngjes, a fjetët mirë?» «Mirë, të falemi nderit! Po ju?» «Ç'ka.»

Rozani mori një çyrek bukë misri në dollap, e theu në mes, gjysmën e la mbi sofër dhe pjesën tjetër e thërrmoi në trahananë që akoma avullonte. Duart e

tij 'me gishtërinj eshtakë e nxirrnin bukën si nga mokrra të gurta.

— Bujrëm!

Një copë herë u ndie vetëm brambullima i zjarrit në vatër dhe fërkimi i lugëve në tepsi. Porsa mbaruan së ngrëni, Rozani trokiti me mashë në vatër. Djali i gjatë hyri për së dyti dhe e mori sofrën me gjithë tepsinë e boshatisur.

Rozani ndiqte djalin me sy, Kiçoja Rozanin. Veprimet e plakut, sado të natyrshme në dukje, fshihnin një si pyetje: ja, e bëmë dhe këtë, pastaj?

Gjithë me një shqetësim të tillë të brendshëm, ai nxori kutinë e duhanit.

— E pi? — pyeti Kiçon.

— Po.

— Po ti? — iu kthye Kajos.

— Edhe unë.

Ai i pa në sy edhe njërin, edhe tjetrin, ndërsa kutinë e kishte zgjatur paksa përpara.

«Ti e more vesh që mbrëmë këtë. Pyet për t'u gjendur në muhabet, apo kërkon të thuash që na dhe duhan e s'ta kthym?» mendoi Kiçoja.

Ai nxori kutinë e vet, e hapi dhe e përmbysi. Kutia ishte bosh. Rozani ngriti kokën. Në trarët e nxirë varreshin ca kurorë misri e shumë vargje me duhan.

— Nuk i patë?

— Si jo! Edhe të mos i shihnim, erën ua ndiem që sa hymë.

— Pse s'i mbushët kutitë? Fletët janë të thata e roniten sa t'i fërkosh një herë.

— Do të qe njëfarë vjedhjeje.

— Vjedhje?

Rozani zgjati krahun, mori në kamare një qese me duhan të grirë e ua vuri përpara.

— Mbushini!

Tani ishte ai që ndiqte veprimin e ngadalshëm të të dy mysafirëve. I bëhej se i njihnte. Të paktën i kishte parë një herë. Atë partizanin e ri, po se po. Ja, ca ditë të shkuara ishte me çetën e Teki Kolanecit.

Atij i dukej se edhe Kiçoja sesi e shikonte. Kjo ia shtonte druajtjen dhe pyeste veten: «Pse kanë ardhur tek unë? U ra udha apo vijnë nergut?»

— Ki-ki-ki! — ia thërriti një këndes.

Të tre kthyen kokën nga dritarja. Një këndes i madh kishte hipur majë gardhit dhe fryhej i ngrëhosur.

— A më këndofsh mbi petë! — tha Rozani me të qeshur.

Kiço Llambi vuri buzën në gaz, po mendjen s'e pati aty.

Në mbrëmje ndenjën të tre deri vonë. Biseduan e për çfarë nuk biseduan. Kiçoja foli gjatë, për Luftën Nacionalçlirimtare, për aksionet e partizanëve. Ja, ai i postës së Kucakës që një pjesëz. Çeta e Mokrës i kishte prerë rrugën një autokolone fashiste në Përrenjas. U shkatërruan pesë makina e u vranë njëzet fashistë. Çeta e Moravës sulmoi postbllokun e Zvezdës... Pastaj folën për Bashkimin Sovjetik e luftën që bëhej kudo.

Rozani i tëri sy e veshë. Kiçoja e afronte bisedën: «Ja, e di ti, xha Rozan, e di se fshatarët tanë dëgjuan fjalën e Partisë dhe nuk i dhanë taksat? Bëhen katër mijë e ca kuintalë pa dorëzuar. Qeveria e fashistët nuk guxojnë të përdorin dhunën për t'i vjelë. Se...»

«Mos u bë vonë, o djem? Se jeni dhe të lodhur», e ndërpreu me marifet plaku.

Ky marifet nuk që i pari. Ai gjithë e largonte bisedën, duke bërë pyetje nga më të ndryshmet.

— Djemtë i paske burra, — tha papritur Kiçoja.

— Burra e me fëmijë.

— Dhe nuk i lë të rrinë këtu?

— Kanë punë.

— Edhe mbrëmë kishin punë?

— Në fshat flenë shpejt, që të ngrihen shpejt.

«A, jo, mor Rozan Gora, sado i zgjuar, prapë të pikaset shqetësimi. Të thashë që na ra udha këtej e desha të njihesha me ty, po ti e kupton që një arsye më e fortë më ka sjellë te ti.»

Të tre pinin duhan e shikonin zjarrin. Cigaret e zjarri sikur hanin inat kush të digjej më shpejt.

— Aty më parë në Moglicë më bënë dy pyetje me spec, — tha Kiçoja.

Rozani mbajti vesh.

— Kur fashizmin do ta shembë Rusia, pse të derdhim gjakun edhe ne? Liria vjen se vjen. Kështu më tha njëri.

Rozani thithi fort cigaren e trazoi zjarrin me mashë.

— E ti ç'i the?

— Ç'i thashë unë? Një gjë që dihet dhe që do t'ia thoshe edhe ti: çdo popull lipset të ketë istikamin e vet në këtë luftë të madhe. Shqiptarët nuk e kanë për fis të rrinë në bisht e të presin t'ua shtrojnë sofrën të tjerët. Le që, varet, kush e shtron sofrën e për se. Ja, ky djali më thotë që ti ke qenë shok me Malkë Zvarishtin.

— I shkreti Malkë!

— Pse thua «i shkreti!»?

— Luftoi me kë s'luftoi, mirëpo...

— Ti do të thuash që vajti dëm? A, jo! Po të mos luftonte ai, po të mos luftonin Themistokliu, Çerçizi, Isa Boletini e shumë të tjerë, nuk do të kishim Shqipëri sot.

Rozani ngriti kokën.

— Edhe xha Rozani ka luftuar me Malkën, — tha partizan Kajoja dhe aty për aty pyeti: — Po Kajo Babienin, o xha Rozan, e ke njohur?

— Isha i vogël atë kohë.

Si për të plotësuar mangësinë, gjysmë me këngë e gjysmë me të recituar, ai shtoi:

— *Ky Babieni në një breg,
ndizet zjarr, kërcet dyfeg,
O Kajo, o trim i mirë,
ç'e nderove Shqipërinë!*

Rozani i shkeli syrin partizanit të ri, po në të vërtetë e kishte me tjetrin. Donte t'i thoshte që dhe ai s'e hante thatë. Nga ana e tij, Këçoja e pa që biseda i doli në shteg.

— Ka që e nderojnë Shqipërinë, ka që e turpërojnë. Ca me dashje ca pa e ditur as vetë. — Ai e ktheu vështrimin nga Rozani: — Të parët janë tradhtarë...

Rozani lëvizi vendit e sytë i flakërinë.

— Më ke ardhur mik e të nderoj si mik. Ama, mos më fyej! — tha.

— Pse të fyhesh ti?

— Po ajo dihet, kujt i djeg, kruhet! — ia këputi Kajoja.

— Kajo! — i tërhoqi vëmendjen Këço Llambi.

Ai vetë deshi ta çonte bisedën në një pikë, prej ku nuk mund të mbetej më një gjendje e amullt. Por e pa se ajo shkoi larg.

— O, Rozan Gora, ne e patëm fjalën për tradhtarët! Ti s'je i tillë, se, po të ishe, nuk do të të vinim mysafirë. E, sa për ata që rrinë duarkryq e bëjnë sehir me lugën në brez...

— As i tillë nuk jam unë!

— Nuk je.

— Atëherë?

— Qëllon t'i ngulet në shpirt njeriut një ndjenjë rehatie. Jepet pas saj dhe e kërkon ku të jetë e ku të mos jetë. Harron çdo gjë tjetër, e zënë ethet e frikës se mos e shqitin soje. Po e kapi kjo sëmundje njeriun, vate, hiqja fillin, edhe të këqija të tjera mund të bëjnë fole tek ai pastaj.

Rozani mori të dridhte një cigare. Një sapo e kishte nderur dhe një tjetër e mbante në vesh. Po s'diti ç'të bënte tjetër. Fjalët i digjnin për brenda, e shponin si thika.

«Ashtu, posi, mendoi Këçoja. Po s'e bëre dot një hap sot, si mund ta kërcesh hendekun e madh nesër? Se aksionet do të shtohen, se beut sot i marrim dritin, nesër kokën, kurse ty kjo do të të duket hata...»

— Ç'që ajo pyetja e dytë?

Kiço Llambi e pa tjetrin drejt në sy. Deshi të mbahej fort, apo me këtë kalim linte të kuptonte që nuk i mbante kurrizi më?

«Ky të jep ujë me bisht të lugës!» mendoi.

«Ky ta këndoka kartën në xhëp!» mendoi Rozani.

— Pyetja e dytë the? Ajo ka të bëjë me gruan. E dini ju, komunistët, më pyetën, ç'është motra, gruaja e shoqëria, apo i ngatërroni sipas qejfit?

Rozani vetiu uli kokën. Kur e ngriti sërish, vëmendja e tij u tendos. Partizan Kajoja kërceu më këmbë.

— Shpifje e ndyrë! Më trima e më të ndershëm se komunistët s'ka! S'ka, ore, merr vesh ti? Ja, unë i njoh vetë!

— Mirë, Kajo, po ulu. Edhe xha Rozani mbase ka njohur. Riza Cerova komunist ishte, xha Rozan. Dhe ka qenë një kohë në Rusi. Si ta merr mendja, nuk ka qenë i ndershëm ai?

— Po pse të vemi aq larg ne? Ja, more, komandant Tekiu është komunist! Shoku Kiço është!...

Këtu Kiço Llambi ktheu kokën nga partizani si për ta ndaluar të përmendte emra, kurse Rozani prapë i uli sytë në vatër e tha ngadalë:

— Pyetje me spec paskësh qenë vërtet.

— Nuk ishte e atij që e bëri, — tha Kiçoja.

— Ë?

— Nuk e kishte të tijën, themi. Të drejtën më thuaj: ty s'të kanë ardhur në vesh fjalë të këtilla?

— Të të them jo, gënjej.

— Ashtu! — Kiçoja psherëtiu thellë.

— Ku kërkon të dalësh, or mik?

— Tek ata që po lidhen dita-ditës me fashistët, xha Rozan. Ata llapin kësisoj.

— Eh, llafi, llaf. Edhe ata flasin, edhe ju flitni.

— Njëlloj janë?

— Kush ua pret kërthizën?

— Puna. Atë që themi ne, e bëjmë.

Dhe ai solli përsëri shembuj të veprës së deriatë-

hershme të Lëvizjes. Ndërsa fliste Kiçoja, tjetrit i silleshin në kokë të kundërta. Po këto s'qëndronin më këmbë, ngriheshin e binin në kokën e tij.

— Më hedh fjalë për nderin e komunistëve beu i Moglicës! Ai, që shkon me oficerët fashistë nëpër shtëpitë e lyera me bojë të kuqe dhe rend si zagar pas grave të botës! Se ai e shokët e tij i kanë qitur këto fjalë. Që ta prekin fshatarin atje ku i dhemb. Por partizani, për lirinë e nderin jep jetën. Ka ku të vejë më?

Rozani ia nguli sytë.

«Toka, atij që e punon?! Ua, ç'përrallë! Po ta lë ai që e ka blerë me flori?! Pa taksa! Shiko gjer'ku venë, kalamajtë! Të lë qeveria pa taksa? Jo, s'të lë! S'ka pasur e s'ka qeveri që të mos marrë taksa. Po punë kalamajsh, thuaj! Petulla me ujë!»

Këto i kishte dëgjuar pikërisht nga Pashoja. Ndaj tani mbajti vesh ca më tepër Kiçon, kur e zuri në gojë.

— Halli i tyre është si e si të shtojnë pasurinë e ta ruajnë. Kush e kush më shumë. Maliq Dushari të ka bagëti sa për tetë fshatra bashkë. Pashoja ëndërron si t'ia kalojë. Kështu, ai pushti i Moglicës e të tjerët si ata. Që t'ia arrijnë qëllimit, spiunë bëhen, tradhtarë bëhen, shpifës të ndyrë bëhen. E kam parë me sytë e mi spiunin Iliaz Panariti në demonstratën e vjetme. Hyri ndërmjet demonstruesve, i vajti pas Koci Bakos që hidhte parullat «Rroftë Shqipëria!», «Rroftë liria!», «Poshtë fashizmi!» dhe e qëlloi me kobure përpara veshit. Dhe Koci Bakoja ishte punëtor e njeri i mirë, si ti e si unë. Koburen do të marrin të gjithë një ditë këta kundër popullit. Beu i Moglicës në udhë e sipër është. Ama tradhtarët i pret i njëjti fat, — dhe Kiçoja bëri me gisht shenjën e pushkatimit.

Pasoi një heshtje mjaft e gjatë. Secli mendonte për ato që ishin thënë dhe shkante ndër mend ç'do të thoshte më tej.

— Po ne dimë t'i ndajmë të mirët nga të këqijtë. Të mirët, patriotët, të ndershmit, duam të mbeten të

tillë përjetë! Të mos u përlyhen emri e virtytet. Ti nuk e more misrin që të ra të në hise nga hapja e koshereve. Pate frikë. A s'është kështu? Frikë, ose akoma s'ke besim te ne.

Rozani lëvizi vendit e u sheshua më mirë.

— O mik, a flasim ca më zhgjeshur?

— Flasim.

— Xheç kam mësuar dhe unë nga jeta. Edhe nga këto që më the. Një djalë e jap. Dy djem i jap. Edhe në u vrafshin, hallall ia bëj luftës për liri. Ama që të prishem me qeverinë, me taksidarin, me beun, kështu, bram, përnjëherë... këtu, të them të drejtën, druhem. Jam frikacak? Jo, bre! Ti i njohke, po dhe unë i njoh. Dhe që po lidhen me italianin, ta besoj. Po këtu e kam frikën. Se e kanë pasur dhe e kanë dorën të gjatë. Ai të djeg, të vret, të rrëmben mall e gjë, të çnderon.

— Po, mundet.

Rozani nuk e priste këtë pohim kaq të hapur. Madje gjatë gjithë bisedës Kiçoja ishte krejt i çiltër dhe kjo çiltërsi në një çështje kaq të madhe, si kjo e fundit, plakun sikur e shkrehu.

— Ja, e pranove dhe vetë! — tha e s'pati më fuqi të fliste.

— Lufta është luftë. Edhe gjak kërkon, edhe sakrificë kërkon. Ca më tepër lufta që kemi nisur ne. Kush i druhet për këtë shkak, nuk ka asnjë ndryshim nga ai që bën sehir e pret t'ia shtrojnë të tjerët.

— Më ngjan se i vumë kapak atij muhabeti.

— I vumë e ia heqim prapë. Të vërtetën ta shohim në beben e syrit, sado e hidhur qoftë.

Sytë e Rozanit u mbushën me pejza të kuqe, a thua hidhërimi i asaj së vërtete u derdh aty menjëherë e tërësisht. Ai hodhi sytë nga dritarja.

— Shiu paska reshtur; — tha.

«Ç'bëra që i thashë se kemi për të vajtur në Strelcë!» mendoi Kiçoja, ndërsa që në hall si ta vijonte dhe më bisedën. Ai e kishte tepër të vështirë të niste prapë nga e para. Megjithatë, teksa bëhej gati për t'u

nisur, po mendonte t'i thoshte: «Xha Rozan, turp, nder, sonte gjene këtu na ke», kur plaku u tha vetë:

— Çapni, dhe ejani prapë!

* * *

Në të kthyer nga Strelca, përroi ishte mbushur buzë më buzë, buçiste e rrokulliste trungje drurësh, degë e gurë. Urën e ngushtë, bërë nga dy lisa të shtrirë tejtejt, e kishte flakur anash. Dy djem si nja tetëmbëdhjetëvjeçarë ishin strukur nën një tumbë dushku e prisnin të binte uji.

Kiço Llambi kërkoi me sy një vend të gjerë. Pak më poshtë përroi bërrylonte e sikur qetohej disi.

— E ke kapërcyer ndonjëherë lumën kur është i turbullt? — e pyeti Kajon.

— Të thashë që jam i këtejshëm!

— Hë, unë harrova fare!

Partizan Kajoja gjeti një vend të përshtatshëm, hyri në ujë me kujdes dhe i mbështeti mirë e mirë këmbët. Atëherë ktheu kokën nga tjetri. Ndryshe nga ç'mendonte ai, Kiçoja po i hiqte këpucët. I mori ato e çorapet në një rën dorë, pastaj rrëmbeu nën sjetull njërin nga djemtë dhe hyri në përrua. Ecte me hapa të shkurtër, këmbët i ngrinte fare pak. Po s'i shtrëngove shputat pas truallit, po i le të t'i ngrejë uji, s'ke gjë, të për lau! mendoi. Shiko përpjetë e mos ki frikë! — i tha djalit. Ti prit aty! — iu kthye tjetrit.

Shtрати i përroit ishte plot gurë e gropa. Diku shikeli bosh, për pak u rrëzua. Pastaj e goditi në noçkë një diçka e mprehtë. I dhembti shumë e shtrëngoi dhëmbët. Me sa dukej përroi rrokulliste gurë përfund. Ai u bë akoma më i kujdesshëm. Se kishte të bënte me të panjohurën, të fshehtën, tinzaren. Deshi t'ia kujtonte këto partizanit Kajo, po ndër kohë ai me djalin tjetër në kurriz. doli matanë.

— Tani, hë, nisuni! — u tha ai djemve.

— Nuk do të vini në fshatin tonë?

— Jo, sonte kemi punë gjatë.

— Vdekje fashizmit! — i a bënë të dy përnjëherësh me grushtet në ballë.

Kiço Lllambi vuri buzën në gaz. Lëvizja ka arritur deri te këta, mendoi. Shtrihet e përhapet si pa e kuptuar dhe hedh rrënjë në zemrat e njerëzve. Edhe në zemrat e njoma.

Ndërsa shtrydhte pantallonat, shkoi ndër mend si ishte njohur e dashuruar ai vetë me idetë komuniste. Tjetër kohë ajo. Sa për Kajon...

— Si e rrëmbeve ashtu! — ia bëri papritur partizani Kajo. — Sikur të qe një thes me kashtë!

U vunë sërish në udhë. Shiu s'kishte të rreshtur. Bridhte nëpër rrëpirat, shkiste në vende argjilore e formonte rrëkeza të vogla që derdheshin në përrua. Poshtë uturinte lumi i madh. Në monopatin ku ecnin kishte qëlluar një kërcel i shkukur. Pas kërcelit ishin ngjeshur degë e gjethe dhe uji sipër kësaj pengese kishte bërë një farë pellgu.

Kiçoja e hoqi kërcelin. Uji i ndenjtur u sul me rrëmbim. Ai shikonte sa ujën, aq dhe kërcelin, sikur të thoshte me vete: ky kërcel e pati bërë vërtet gjithë atë pellg?

— Xha Rozani! — tha partizani i ri duke qeshur.

Në fillim Kiçoja kujtoi se Rozani po vinte që lart dhe pa andej. Pastaj, kur vuri re të qeshurën e partizanit, e kuptoi ku e kishte fjalën ai dhe qeshi edhe vetë.

Ecnin dhe ai gjithnjë mendonte. Shiu i imët binte lehtë, pa zhurmë, pa u ndier fare. Toka e thithte të gjithin, sikur donte t'i ndihmonte.

— Ç'thua, o Kajo, a i ka lënë mbresë biseda jonë?

— Patjetër! Gjithë ditën atë ka bluar me vete.

— E ka bluar, mirë, po ç'ka nxjerrë vallë?

— Miell të mirë, ma ha mendja.

— Ashtu shpreson ti?

— Shpresoj e besoj.

— Nganjëherë mendoj dhe unë kështu si ti. Po

nuk jam i sigurt. Më ngjan se u pendua që na përcolli ca si vrazhdë dhe u shtrëngua ta ndreqte duke na ftuar t'i vemë prapë.

— Jo, ftesën ai e kishte menduar që më parë.

— Kur më parë?

— Qëkurse ti e preke në plagë. Hem i dhembti, hem i pëlqeu. Do ca kohë që ta mbledhë mendjen.

«Edhe kjo mund të jetë, mendoi Kiço Llambi duke e çmuar mençurinë e djalit. A do të ketë marrë guxim, vallë, për ta kapërcyer druajtjen? Eh, sikur!»

— Kur dola përjashta, gjeta rast e fola me djemtë.

— Ç'u the?

— Hëni, more, u thashë, nuk ju vjen një çikë zor që të vijmë ne e të bindim babanë tuaj?

— Kështu u the?

— Kështu, posi!

— Dhe ata nuk t'u zemëruan?

— Jo, pse të më zemëroheshin? E, e, e ke kollaj ti, më tha ai i gjati. Pse e paskam kollaj, ia ktheva, mos më përcollën me petulla mua?

— Pa shih, pa shih! — ia bëri me interesim Kiçoja.

— Ai Malka, ai finoku, veç dëgjonte, e në fund tha: nuk piqen tërë rrushtë. njëherësh. Mirë, ia ktheva dhe atij, ama shikon rrushi rrushin e piqet. Këtu dolët ju dhe e premë fjalën.

Ndërkohë arritën te rrugina shtruar me plloça. Murroja u hodh nga kolibja me vrullin e zakonshëm, po hungërima i mbeti në grykë. Ai hapi gojën e rrotulloi sytë si i turpëruar që s'i njohu menjëherë.

— Pa-pa-pa, si qenkeni qullur! Vu e vu ky viran shi, na kalbi! — tha Rozani në mes të shkallëve. — Neslie, moj! — thërriti ai.

Zjarri bubullinte në vatër. Hyri me nxitim një grua fytyrëzbehtë, e shoqja. Ajo solli dy palë rroba të djemve.

— Ndërrohuni! — tha e doli me nxitim.

Xha Rozani u vinte rrotull, duke u dhënë herë një gjë e herë një tjetër. Kur ata u ndërruan e nderën duart nga zjarri, ai nxori shishen e rakisë:

— Rrëkëlleni nga një gllënjë. Kjo ta largon fto-
mën! Neslie, moj! — thirri për së dyti.

·Kësaj radhe tok me Neslien hyri dhe Limi, ai i
gjati, i cili rrokullisi me të shpejtë sofrën pranë vatrës.
Pastaj hyri një nuse e re me ibrikun në dorë dhe një
tjetër me një tepsì që mezi e mbante.

Ishte vënë në lëvizje gjithë familja. Kiço Llambi
habitej dhe hera-herës këmbente ndonjë vështrim me
Kajon. Rri i qetë, ia bënte ky duke i shkelur syrin.
Dalja e grave xheç tregonte dhe ai, që i njihte më
mirë zakonet e krahinës, hem gëzohej, hem i druhej
ndonjë marifeti të plakut, po këtë dyshim nuk donte
t'ia kumtonte Kiços. Pse ta shqetësonte para kohe ose
kot së koti. Dalja e grave mund të ishte vërtet një priti-
je për miq të ngushtë, e atëherë s'mbetej veçse ta shkreh-
te pushkën nga gëzimi.

Në sofër u shtruan edhe dy djemtë e mëdhenj.
Tepsia kishte një petanik të trashë dhe mbi të një kë-
ndez të pjekur.

— E bëri sebeb vetë! — tha Rozani për të. — Ja,
mirë se na erdhët! — dhe shaplosi e u vuri përpara
Kiços sarmanikun e një kofshë, Kajos kofshën tjetër.

Kiçoja nuk bënte naze në të ngrënë. Hante ç'i
vinte përpara, pa u druajtur. Dhe hante mirë. Rozani
kënaqej më tepër duke u shërbyer të dy miqve, sesa
me shijen e kësaj dreke-darkë që ishte jo e zakon-
të. Pastaj, kur u ngrit sofrja, ai i mbajti aty djemtë dhe
hidh e prit herë me njërin e herë me tjetrin.

— Hiç nuk ngjasin, viranët. Jo sikur të jenë vë-
llezër, po si të jenë pjellë njëri këtu e tjetri në Otojakë.
Ja, shikojini dhe vetë. Njëri stërhell, tjetri si i përzhir-
tur në zheg. Limi vete e vjen, ama ky Malka... Le,
po i vura dhe emrin e atij të ndërës.

Malka ia shkeli syrin Kajos. Kajoja bënte po këtë
gjë me Kiçon dhe ndiqte me zell ç'thoshte xha Rozani,
shpesh hynte edhe vetë në ato biseda me hidh e prit.
Kiço Llambi e njihte këtë lloj të foluri të fshatrave, po
nuk i përgjigjej dot dhe shikonte sa njërin, tjetrin, duke
u përpjekur të mos i shpëtonte asgjë. Dikur ia nguli

sytë ca si rreptë të zotit të shtëpisë. Mos vallë kësaj here ai donte t'i përcillte butë-butë?

Rozani xheç pikasi në shqetësimin e tij. Nderi kënd nga dritarja, veprim që, me sa dukej, e bënte sa herë ndërronte bisedë, dhe tha:

— Ama ra, ë! Shi i madh, po tokës i bëri punë paq.

— Nuk e ka te shiu! — i pëshpëriti partizani Kiços.

Rozani u kthye me fytyrë nga Kiço Llambi.

— Demek kështu, o komunist!

Kiçoja u ndeh të dëgjonte. Rozani s'i tha gjë tjetër. Pas pak iu kthye djemve të tij:

— O Limi, nesër më sabah të shkosh e të ngarkosh misrin që na kanë caktuar ata të këshillit. Ti, Malkë, merr austriaken, e di ti ku e kam fshehur, dhe përgatitu! Që tashti u përket këtyre shokëve. O Kiço, ti e di vetë ç'do t'i thuash e si do ta mësosh. Unë e ngas ca, por edhe e dua, shejtanin!..

Këtu plaku u gëlltit e fjala iu njom.

— Dhe tashti të biem e të flemë, se vajti vonë! Haj, bëfshi gjumë të ëmbël!

* * *

Kiço Llambi hoqi syzet e po i fshinte me ngadalë. Ndihej shumë i emocionuar.

— Kajo, fituam një njeri! — tha. — Fituam një njeri të mirë e të fortë dhe i shtuam Lëvizjes një bazë të sigurt. Jam i gëzuar dhe ty të falënderoj, se m'u bërë shok e më ndihe shumë.

Gëzimi ia largoi gjumin. Suksesi sjell me vete freski e forcë. I ndiente të dyja. Dontë t'ia bënte të ditur sa më parë Tekiut. Mori bllokun, shkëputi që andej një fletë dhe zuri të shkruante. Shkroi më parë VF-LP, pastaj datën: 8 nëntor 1942.

Befas kalemi i mbeti pezull. Sytë e tij u mbërthyen mbi atë datë. Iu njomën sërish, edhe më tepër.

«Si sot një vit!» — mendoi i mallëngjyer.

Iu përvijuan ethet e përgatitjes së demonstratës, demonstrata vetë. Në rreshtat e parë ai, vëllai Raqi, motër Ollga, kunati. Gjithë familja e të afërmit. Ollga, që fëmijën dymuajshe, e pati lënë me të vjehrrën, sulej përpara pa iu dridhur qerpiku, me një zjarr të brendshëm në shpërthim.

— Shokë që bien.

«Ecni ju!»

«Koci, mos!»

«Të mos ndërpritet demonstrata!»

Mbledhur nëpër shtëpi, vonë në mbrëmje, çdo bisedë që hapej ishte për demonstratën. Ishte ngjarja më e madhe, më tronditëse që kishin jetuar. Nuk kishte pasur kurrë ndonjëherë një gjendje shpirtërore aq të mprehtë.

Partizan Kajoja po e shihte në sy. Sytë e komisarit ndritnin. Kur lëvizte qerpikët, dhe këtë e bënte shpesh, sytë e tij xixëllues shpërndanin reflekse të buta.

— Një vit më parë bëmë Partinë, Kajo.

«Një vit! Në ditën e përvjetorit, xha Rozani me Lëvizjen. Malka me çetën. Partizan Kajoja...»

— Që atë ditë u pranove?

Kiço Llambi pohoi me kokë.

«Shok i dashur, që sot ti je anëtar i Partisë Komuniste Shqiptare. E ke treguar që mund të jesh një komunist i mirë.»

Komisarit iu kujtuan këto fjalë që ia patën thënë në qarkor. Ai me gjithë shpirt donte t'ia përsëriste ato për partizan Kajon.

PASQYRA E LËNDËS

1) Bredhi i gjelbër	3
2) Vallja e ngritjes	14
3) Nusja e malit	30
4) Gjerondai	43
5) «30, vjeshtë e dytë 917»	61
6) Një zë, një shpresë	78
7) Vij nga Shqipëria	92
8) Robinja	112
9) Isuf Arapi	125
10) Disa nga të shumtët	136
11) Mëngjesi i rrethimit	145
12) Copëza nga një jetë	156
13) Largimi i dytë	176
14) Ditën e përvjetorit	191